



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE
MARS 2024

REVISTA USHTARAKE

(edicioni i parë)

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 1, datë 28.02.2024
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake

Kryetari i bordit

Gjeneral Brigade **Bardhyl Nuredinaj**

Anëtarët e Bordit

Kolonel Msc. **Ulsi Rexhaj**

Dr. **Etleva Smaçi**

Prof. Asoc. Dr. **Teki Kurti**

Kolonel (R) Dr. **Ahmet Leka**

Nënkolonel (R) Dr. **Enrik Ago**

Nënkolonel Dr. **Fitim Karasani**

Kolonel Msc. **Hysni Gjergji**

Msc. **Fatjon Hoxhalli**

Përgatiti për botim: Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit

Art design: Engjellushe Llulla

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2023 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në "Revista Ushtarake" janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve dhe pozicioneve të tyre individuale, edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak
Shtypur: Mars 2024

PËRMBAJTJA E REVISTËS USHTARAKE

RUBRIKA E PARË:

Analiza dhe vlerësime për sigurinë dhe mbrojtjen..... 7

**Kundërzbulimi ushtarak nga paragjykim i së shkuarës,
në një doktrinë e inteligjencës së epokës kibernetike.....** 9

Kolonel Msc. Hysni Gjergji,
Kolonel Msc. Ulsi Rexhaj
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

**Bllokada e grupit të armatosur “Houthi” në Detin e Kuq dhe pasojat
e fushatës së Perëndimit kundër tyre.....** 25

Kolonel Msc. Dilaver Hoxha
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Ukraina ose alarmi global i luftërave hibride të Putinit..... 41

Kolonel Arben Dhuli
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Rusi-Ukrainë: përfundimi i konfliktit dhe implikimet strategjike..... 59

Nënkolonel Dr. Fitim Karasani
Akademia e Forcave të Armatosura
Nënkolonel Dr. Luljeta Tafani
Ministria e Mbrojtjes

Siguria dhe ndikimi i saj në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare..... 75

Nënkolonel (R) Msc. Kristo Rapo
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

RUBRIKA E DYTË: 97

Arsimimi dhe Stërvitja

**Ndërtimi i marrëdhënieve publike online
nga Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelenskyy.....** 99

Msc. Edlira Prendi
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA

Kontraktorët civilë, roli i tyre në mbështetjen e veprimtarisë së FARSH.....	111
Nënkolonel (R) Dr. Enrik Ago Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak	
Sfidat ligjore të Bashkimit Evropian për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe aksesin në drejtësi, harmonizimi dhe implementimi në legjislacionin shqiptar.....	125
Dr. Entela Abdul Universiteti “Luarasi”	
RUBRIKA E TRETË:	137
Mbrojtja kibernetike dhe zhvillimet inovative	
Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike: mjet politikash për të forcuar mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë kibernetike të IKI.....	139
Nënkolonel Msc. Dashnor Beta Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak	
Analizimi i fushës shkencore të menaxhimit në Shqipëri: Një studim bibliometrik.....	159
Dr. Gentian Hoxhalli Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA Gentjan Ulaj Universiteti “Luarasi” Nives Lamce Universiteti “Luarasi” Iris Kruja Universiteti “Luarasi”	
Avioni pa pilot i tipit TB-2 “Bayraktar” në mbështetje të operacioneve në nivel force të bashkuar dhe komponenti (ajror, tokësor, detar).....	169
Nënkolonel Msc. Eduart Pllaha Forca Ajrore	
RUBRIKA E KATËRT:	187
Studime historike	
Aleanca ushtarake e Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë.....	189
Kolonel (R) Dr. Ahmet Leka Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA	
Figura e Skënderbeut në studimet e historiografisë ushtarake, raporti i saj me studimet e Historisë Kombëtare.....	205
Dr. Etleva Smaçi Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, AFA	
Ushtria kombëtare (1912 - 1939) në shtypin e shkruar shqiptar.....	213
Prof. Asoc. Dr. Teki Kurti Drejtor i Arkivit Qendror të FARSH, MM	

RUBRIKA E PARË

ANALIZA DHE VLERËSIME PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN

Kundërzbulimi ushtarak nga paragjykim i së shkuarës, në një doktrinë e inteligjencës së epokës kibernetike

Kolonel Msc. Hysni Gjergji,
Kolonel Msc. Ulsi Rexhaj
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Qëllimi i këtij punimi është asistimi, informimi dhe ndërgjegjësimi i ushtarakëve dhe civilëve në Forcat e Armatosura për kërcënimin e mundshëm nga Shërbimet Inteligjente Armike (SHIA), që operojnë kundër Shqipërisë dhe NATO-s. Kundërzbulimi (KZ) nuk është një shkencë ekzakte, por një probabilitet mundësish, të varura nga shumë faktorë objektivë dhe subjektivë. Është folur shumë për agjentët, spiunazhin dhe tradhtinë, janë krijuar mite dhe legjenda, janë paragjykuar dhe glorifikuar shumë personalitete të përfshirë, në varësi të kohës, situatës dhe interesit.

Me anën e këtij shkrimi informues dhe analitik, të bazuar në njohuri akademike dhe përvoja profesionale, synojmë të mbrojmë nga gabimet e mos informimit ushtarakët tanë ndaj teknikave që mund të përdorin zbuluesit e huaj që lirisht hyjnë dhe qëndrojnë në vendin tonë. Gjithashtu, për lexuesin ushtarak kemi sjellë disa praktika, raste të publikuara, që SHIA po ndjek për rekrutim të agjentëve të tyre edhe në radhët tona. Ky ndërgjegjësim mund të përçojë njohuri të përgjithshme te ushtarakët tanë, në mënyrë që ata “t’i kuptojnë sa më parë” veprimet e një përfaqësuesi të SHIA-s, me qëllim që të mos bien në “grackat” profesionale të ndërhuara nga ai. Kundërzbulimi duhet distancuar nga tabuja dhe reminishencat negative e të kaluarës dhe një nga mënyrat për t’ia arritur këtij qëllimi është edhe ky punim.

Historikisht, luftërat dhe konfliktet e armatosura kanë sjellë në vëmendjen e publikut dhe drejtuesve politiko-ushtarakë rëndësinë dhe aktivitetin e kundërzbulimit. Kjo vërtetohet më së miri me luftën 2-vjeçare në Ukrainë, ku lajmet për kapjen e agjentëve të zbulimit rus dhe depërtimin e diplomatëve spiunë janë në faqet e para të shtypit botëror.

Në epokën kibernetike, burimet tradicionale njerëzore të kundërzbulimit lipset të koordinojnë me të rejtat që sjell zhvillimi teknologjik dhe inteligjenca artificiale (IA), të adoptojnë metoda të reja për të konkurruar tendencat dhe kërcënimet e spiunazhit kibernetik dhe IA në zhvillim. Gjasat janë për evoluim të përdorimit të informacionit, dezinformacionit, fake news dhe IA, në infrastrukturën e përbashkët të operimit, që është interneti. Spiunazhi në fushën kibernetike e ka ndryshuar dhe kërkon një qasje të re të disiplinës së kundërzbulimit pas vitit 2024, që mendohet të jetë kufiri i ri i KZ.

Në këtë studim është theksuar vlera gjithnjë në rritje e kundërzbulimit si një nga shtyllat e inteligjencës, për sigurinë e FARSH, mbrojtjen e informacionit kombëtar dhe të NATO-s, infrastrukturës ushtarake si dhe në zbulimin dhe neutralizimin e kërcënimeve që drejtohen nga SHIA.

Fjalët kyçe: Kundërzbulim, CI, HUMINT, spiunazh “histori mbulimi” “vijë sjellje”, rekrutim, SHIA

1. Qasjet historike dhe akademike të teorisë së kundërzbulimit

Paraardhëse e kundërzbulimit sidomos në shtetet e lindjes, në të cilën ka qenë pjesë edhe Shqipëria, ka qenë policia sekrete, sigurimi i shtetit (ndonjëherë është njohur si policia politike), si agjenci e policisë që vepronte në fshehtësi, për të mbrojtur pushtetin një partiak dhe autoritetin e një regjimi politik. Forcat e policisë sekrete gjatë Luftës së Ftohtë ishin të lidhura me regjimet autoritare dhe përdorshin për të ruajtur pushtetin politik ose regjimin totalitar. Sigurimi i shtetit ishte i destinuar në mënyrë specifike për të vepruar jashtë dhe mbi ligjin, në mënyrë që të shtypnin disidentët politikë, përmes akteve të fshehta të terrorit dhe të frikësimit (të tilla si rrëmbimi, marrjes në pyetje shtrënguese, tortura, internim, etj.) dhe drejtoheshin kundër armiqve politikë të autoritetit qeverisës një partiak.

Në Shqipëri, si në të gjithë Evropën Lindore, gjurma dhe hija që ka lënë sigurimi i shtetit komunist në memorien e njerëzve është vështirë të fshihet edhe për disa vite. Ne kemi trashëguar një strukturë kundërzbulimi, e cila konsideronte kundërshtarë të gjitha zbulimet e huaja të lindjes dhe perëndimit. Kundërzbulimi ishte i shtrirë në çdo njësi dhe repart ushtarak, bëmat e të cilit nuk lejojnë edhe sot ta shohin si ndihmues rolin e tij në demokraci. Perceptimi luan rol të rëndësishëm në sintetizimin e vlerave konkurruese për një shtet, i cili

përdor vlerësimet e inteligjencës për të marrë vendime të duhura, të udhëhequra dhe të drejtuara nga prioritetet e interesave kombëtare. Kundërzbulimi në Evropën Lindore, sikurse dhe në Shqipëri, duke u identifikuar me sigurimin e shtetit, krijoi perceptimin e paligjshmërisë, frikës dhe mosbesimit, gjë e cila zgjati për shumë kohë edhe në vitet e demokracisë. Deri në fund të Luftës së Ftohtë, kundërzbulimit, spiunazhit dhe tradhtisë i vishej edhe vello turpi, ndërsa patriotizmit i vishej petku i heroit. Përcaktimi i heroit dhe tradhtarit atëherë bëhej në varësi të palës për të cilën i njëjti person kishte shërbyer apo ishte dëmtuar. Gjithë këtë aktivitet e drejtonin dhe e vlerësonin pikë së pari specialistët e kundërzbulimit.

Heroi i njëres anë është tradhtar për palën tjetër. Si shembuj mund të përmendim anglezin Kim Filbi, busti i të cilit është vendosur për nder të shërbimit të tij ndaj shtetit sovjetik në një shesh të Moskës, ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar ai është tradhtari më i madh anglez gjatë Luftës së Ftohtë; koloneli rus Oleg Penkovsky që informoi SHBA-të lidhur me krizën e raketave bërthamore në Kubë, ka bustin në nder të tij në Uashington, por është masakruar dhe as varri nuk i gjendet në Rusi. Të dy këta oficerë të lartë ishin specialistë dhe funksionarë të lartë të kundërzbulimit që tradhtuan vendin e tyre pasi ideologjikisht ishin kundërshtarë të regjimeve nga rridhnin. Për këtë dhe shumë arsye të tjera, sektorit të kundërzbulimit i kërkohet të zhvillojë mekanizmat e duhur të sigurisë për të mbrojtur vetveten, infrastrukturëndhe, si dhe individët e përzgjedhur. Kjo mbrojtje realizohet nëpërmjet masave dhe procedurave të përshtatshme për mbrojtjen e informacionit, që zhvillohen brenda ose jashtë territorit shtetëror nga SHIA.

Lufta e afirmoi këtë disiplinë shumë të rëndësishme të Inteligjencës. Kundërzbulimi ukrainas u bë i famshëm vetëm kur publikoi se zbuloi, ndaloi dhe ekzekutoi për tradhti të lartë si bashkëpunëtor rus, negociatorin ukrainas në bisedime me Rusinë, Denis Kireev, më datë 5 mars 2022. Ndërsa më 7 gusht 2023 nëpërmjet kundërzbulimit ushtarak, zbulohet dhe parandalohet nga një atentat që po përgatitej për të eliminuar presidentin Zelenskyy. SBU¹ rezulton të ketë kapur shumë robër rusë me informacione të klasifikuara të cilat po përdoren gjatë rezistencës ukrainase.

Aktualisht, ka botime të shumta akademike që ofrojnë qasje të reja për KZ, sidomos në epokën e mbulimit digjital të luftës, si pjesë e luftës kundër spiunazhit ekonomik dhe industrial. Publikime të tjera mbulojnë një gamë më të gjerë se sa të domenit KZ, me fokus ndikimin e tij në vendimmarrjen ushtarake dhe politike, por edhe proceset e kundërspiunazhit, mashtrimit dhe

¹ https://en.wikipedia.org/wiki/Security_Service_of_Ukraine (Ukrainian: Служба безпеки України, romanized: *Sluzhba bezpeky Ukrainy*) or SBU (Ukrainian: СБУ)

ato hibride të operacioneve luftarake². Me të njëjtën qasje, Loch K. Johnson³, në librin e tij të studimeve të Inteligjencës, bën një trajtim gjithëpërfshirës të temës, duke përfshirë përvojën historike dhe mësimet e nxjerra në luftëra dhe konflikte të kundërzbulimit.

Operacionet e kundërzbulimit identifikojnë dhe zbulojnë aktivitetet e zbulimit të huaj, që synon të cenojë sigurinë e shtetit dhe identifikojnë kërcënimet nga personeli ynë i brendshëm që përpiqet të penetrojë për interes të shërbimit të huaj të inteligjencës SHIA. Analizat e brendshme të kundërzbulimit shpesh herë anashkalohen ose nuk janë të thella pasi në konceptin e ri të inteligjencës, analiza është një departament i ndarë. Në përgjithësi, oficerët e kundërzbulimit janë aktivë dhe atyre u pëlqen më shumë puna në terren se sa puna në zyrë. Ata janë impulsivë dhe komplet ndryshe nga analistët e vërtetë. Shumë e dëmshme është mungesa e bashkëpunimit midis departamenteve të kundërzbulimit civile dhe ushtarake. Xhelozia dhe egoja për të pasur privilegjin e informacionit ka bërë që të mos shkëmbehen dhe ndërthuren informacione plotësuese nga të dyja shërbimet dhe për rrjedhojë, rezultati është zero.

Aktualisht, dokumentet dhe doktrinat kryesore që NATO⁴ publikon dhe që normojnë punën e shërbimeve inteligjente të aleancës e përcaktojnë spiunazhin si “veprimtari që kryhet nga një shtet, fuqi armike, agjenci e zbulimit të tij, në mënyrë të fshehtë dhe të paligjshme, duke përdorur dhunë, shtrëngim, blerje ose rekrutim të personave që e posedojnë; që synon të shtien në dorë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror””. Në terma ushtarakë, informacioni i klasifikuar është çdo dokument, shkresë, skicë, hartë, fotografi, imazh, film, pajisje, plan, armatim apo program softueri, ekspozimi i të cilit në publik apo futja në dorë nga pala kundërshtarë, gjykohet që cenon sigurinë kombëtare. Pikërisht, kundërshtimin e spiunazhit të huaj e ka detyrë kundërzbulimi ose kundërspiunazhi, të cilat shumë herë janë e njëjta gjë. “Të kesh mungesë të kundërzbulimit do të thotë të jesh në ring me sy të lidhur.”⁵

Literatura bashkëkohore në fushën e KZ, të përgatitur nga ish-drejtuësit e inteligjencës, vjen kryesisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar. Në shumicën e rasteve, këto publikime ofrojnë një pasqyrë të brendshme të praktikave të qeverive në lidhje me operacionet e FBI ose MI5. Ndërsa publikimeve dhe studimeve të autorëve që nuk janë të fushës iu mungon një qasje akademike dhe e strukturuar ndaj kundërzbulimit si shkencë dhe doktrinë. Përveç kësaj, botimet e tjera akademike ofrojnë

² Jennifer Sims and Burton Gerber, *Transforming US Intelligence*, 2005.

³ Loch K. Johnson, *Handbook of Intelligence Studies*, Imprint: Routledge, London, 2007.

⁴ (AJP 2) NATO doctrine for intelligence, counterintelligence and security.

⁵ Thënie e Gjeneral David M. Shoup, Komandant i Korpusit të flotës detare të SHBA-ve, 1960.

qasje të ndryshme për KZ si pjesë e luftës kundër spiunazhit ekonomik dhe industrial, që në fakt është vetëm një pjesë e KZ. Ky është një sektor gjithashtu i rëndësishëm, jo vetëm në lidhje me mbrojtjen fizike të informacionit, personave dhe infrastrukturës, por edhe në zbulimin dhe neutralizimin e kërcënimeve.

Charles Burton Marshall⁶ në shkrimet e tij thotë se: “Të studiuarit në kolegji nuk i kanë mësuar asgjë atij përsa i përket spiunazhit, rolit të shërbimeve të inteligjencës apo rolit që luan propaganda dhe dezinformacioni. Tendenca e shteteve për të pasur një sjellje të dyfishtë; duke pasur politika parashikuese dhe eficiente, një farë hapje dhe tjetra është mbyllja dhe mbështjellja me mister dhe sekret edhe fenomeneve, të cilave hapja e sekretit e dëmton.” Kjo dritare në këtë “jetë të dyfishtë” të shteteve, për të cilat Marshall ka shkruar, është e mbyllur dhe pak e njohur në punën e KZ, ndërsa në lidhje me dimensionin e sigurisë kombëtare vendimmarrësit dhe studiuesit e kanë neglizhuar këtë njohje.

2. Kundërzbulimi, perceptimi, realiteti dhe sfidat përtej 2024

Kundërzbulimi (i njohur shpesh si kundërspiunazhi⁷) është temë studimi për ish-zyrtarë të inteligjencës, por edhe për studiuesit akademikë në kontekstin e studimeve për marrëdhëniet ndërkombëtare. Prandaj, literatura aktuale në dispozicion vjen kryesisht nga shkrimet e ish-personelit të Inteligjencës dhe puna kërkimore e studiuesve me reputacion dhe studiuesve të rinj, të cilën edhe unë po përpiqem ta bëj. Një rishikim i misionit dhe bibliografisë ekzistuese për kundërzbulimin tregon se nuk ka një intensitet të konsiderueshëm në punën akademike, në raport me lëndët e tjera kërkimore.

Për të analizuar KZ, është e rëndësishme të përcaktohen qartë marrëdhëniet ndërmjet Informacionit dhe Inteligjencës. Shumë agjenci e quajnë Informacionin si “njohuri në formë të papërpunuar” që mund të përdoret për të hartuar Inteligjencën. Dallimi midis dy termave ndikon ndjeshëm në analizën dhe trajtimin e produkteve përfundimtare të inteligjencës (zbulim dhe kundërzbulim). Në thelb, kundërzbulimi përfshin një gamë të gjerë opsionesh operacionale dhe taktike të inteligjencës, të cilat mund të çojnë në keqinformimin dhe mashtrimin e kundërshtarit, duke e çuar në vendime të gabuara strategjike. Në këtë rast, kundërzbulimi është një element kyç, në lidhje me informacionin e pasaktë të kundërshtari, duke shfrytëzuar drejtuesit

⁶ Charles Burton Marshall, *Limits of american foreign policy*, 1953. Ch.B.Marshall ka shërbyer në një sërë detyrash si: këshilltar, profesor dhe autor i specializuar në studime ndërkombëtare dhe politikë-bërjen në Uashington.

⁷ Kundërspiunazhi bashkë me kundërsabotazhin, kundërsubversionin dhe kundërterrorizmin janë disiplinat përbërëse të kundërzbulimit.

e vet. Detyra e parë kritike e një departamenti të KZ është mbrojtja dhe sigurimi i informacionit të brendshëm dhe sekreteve shtetërore ushtarake, nga inteligjenca e huaj.

Gjatë këtij procesi, zyrtarët e KZ janë përgjegjës për vendosjen e procedurave të përshtatshme dhe kushteve të sigurisë, si dhe për kryerjen e veprimeve të nevojshme për të ruajtur të paprekshme strukturat në komunitetin e inteligjencës, si dhe të zvogëlojnë në mënyrë drastike shanset për çdo zbulim apo rrjedhje. Këto korniza sigurie kanë të bëjnë si me funksionimin e një shteti, ashtu edhe me besueshmërinë e personelit që është i përfshirë në detyra të ndjeshme dhe sensitive.

Është e nevojshme që, në mjedisin e sotëm teknologjik që po ndryshon me shpejtësi, oficerët e KZ duhet të sigurojnë që masat proaktive të sigurisë kibernetike të jenë ato të duhurat. Në këtë rast, lind nevoja për kundërzbulim kibernetik. Ky koncept përshkruan procesin e marrjes së masave për identifikimin, menaxhimin dhe adresimin e veprimeve të agjencive të huaja të inteligjencës dhe aktorëve të tjerë, që përdorin teknologjitë më të fundit dhe hapësirën kibernetike për të aksesuar sistemet dhe proceset e sigurisë në një shtet target. Këto përpjekje të shërbimeve të huaja synojnë të marrin informacion ose material analitik të çdo forme dhe përmbajtje.

Është gjithashtu e rëndësishme të promovohet vendosja e procedurave alternative, për shkëmbimin e informacionit kritik, me metoda jashtë fushës së rregullt të hapësirës kibernetike. Ky proces duhet të zbatohet në vendet ku nevoja për shkëmbimin e produkteve sensitive të Informacionit dhe Inteligjencës, bazohet në mjete alternative, pasi nuk ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike për shpërndarjen e sigurt të tij. Në këtë rast, materiali i ndjeshëm transferohet në letër dhe jo elektronikisht nga agjentë të trajnuar posaçërisht, me qëllim që të mos shkaktojë dëme në sistemet e brendshme të informacionit të një shteti dhe në sigurinë e tij. Ky dëm mund të lidhet si me paaftësinë e sistemeve të informacionit për të funksionuar për një periudhë të caktuar kohore, ashtu edhe me mundësinë e shkatërrimit të pjesshëm ose të plotë të tyre nga kundërshtari.

Në mjedisin kompleks dhe bashkëkohor të sigurisë të rrezikuar nga lufta hibride, ekziston një nevojë urgjente për t'i kushtuar vëmendje dhe përshtatur kërcënimeve me rritje të shpejtë dhe të larmishme në hapësirën kibernetike. Duhet marrë parasysh aftësitë e avancuara teknologjike të SHIA-s, në kryerjen e operacioneve sulmuese të inteligjencës përmes hapësirës kibernetike dhe luftës hibride ku komponenti informativ është parësor. Spiunazhi dhe të punuarit në mënyrë të padukshme të kundërshtarëve tanë kanë pasur mundësinë për të na dëmtuar si në rang kombëtar ashtu dhe në atë të aleancës. Duhet pranuar gjithashtu edhe ndryshimi i konceptit dhe mentalitetit të vjetër

që ajo që nuk shikohet nuk ekziston, pasi kërcënimet⁸ dhe rreziqet jo te gjitha veshin uniforma ushtarake dhe mbajnë armë zjarri. Veprimet e SHIA-s janë të paparashikueshme dhe jo lehtë për t'u zbuluar, drejtuar dhe ndjekur. Kjo bën të domosdoshme që strukturat të KZ dhe ato të sigurisë nga repartet deri në MM duhet të ndërtojnë programe, të zhvillojnë trajnime, të njihen me raste nga vendet partnere, të ndërtojnë skenarë, të zhvillojnë imagjinatën me qëllim të jenë të ndërgjegjshëm dhe të përditësuar me mënyrat dhe mjetet që përdorin shërbimet inteligjente kundërshtarë.

Partneriteti në fushën e kundërzbulimit, si siguri ofensive në operacionet e KZ, është çështje e diskutueshme dhe ka vërtetuar që nuk mund të konsiderohet tabu. Ne duhet të jemi në radhe të parë të përgatitur vetë për të kryer misionin e sigurisë kombëtare; partnerët do të na ndihmojnë pasi të kenë përmbushur pikë së pari interesat e tyre. Profesionistët e kundërzbulimit dhe studiuesit e kësaj fushe e dinë mirë këtë.

Po të kemi parasysh vetëm rastet e deklaruara në shtyp lidhur me sulmet e disa shërbimeve “partnere” kundër SHBA-ve do na bindin që vendet “mike” kanë shërbime të inteligjencës armiqësore!? Për fat të keq, edhe në disa vendet të tjera ish-komuniste, oficerët dhe punonjësit e kundërzbulimit nuk kanë janë të vlerësuar ashtu siç ata e kanë merituar. Është e vërtetë që këta oficerë nuk janë shumë të njohur, punën e tyre e vlerësojnë vetëm një numër i vogël njerëzish dhe në shumicën e rasteve, ata njihen nga lajmet e këqija. Kundërzbuluesit nuk janë të mirëpritur gjithmonë, madje vetëm kritikohen kur punët shkojnë keq. Më së shumti edhe te ne ashtu si edhe në vendet e tjera të NATO-s, kryesisht lindore; shumica e oficerëve të talentuar nuk dëshirojnë dhe shmangen nga marrja e përgjegjësisë në fushën e kundërzbulimit. Kundërzbulimi ka qenë dhe mbetet jo prestigjioz dhe ka një reputacion të keq të trashëguar edhe nga e kaluara.

Në praktikën moderne, misione të ndryshme sigurie janë të lidhura me kundërzbulimin nga niveli kombëtar deri në nivelin taktik ushtarak në terren. Një sërë disiplinash sigurie janë pjesë e menaxhimit të sigurisë dhe pjesë përbërëse e kundërzbulimit, duke përfshirë: sigurinë fizike, sigurinë e personelit, sigurinë e komunikacionit, sigurinë e sistemeve të informacionit, sigurinë e operacioneve dhe sigurinë kibernetike.

⁸ Sipas konceptit të NATO-s, një *rrezik* përkufizohet si “gjendje që rrezikon interesat kombëtare në përgjithësi, por jo sovranitetin dhe integritetin territorial të një shteti, grup shtetesh apo aleance”. *Kërcënimi* është një evoluim i menjëhershëm ose i përshkallëzuar i një rreziku konkret të pa administruar ose të administruar në mënyrë jo efektive. Ai konkretizohet deri në përdorimin e mjeteve të ndryshme, duke përfshirë mjetet e dhunës, duke vështirësuar dhe vënë në diskutim gjendjen ekzistuese. Kështu, kërcënimi mund të përkufizohet si rrezik konkret, i shkallëzuar dhe me objektiva të përcaktuar qartë.

Kundërzbulimi ose kundërspiunazhi ka një qëllim që i tejkalon disiplinat e sipërcituara për nga rëndësia, dhe që është: penetrimi me agjenturë i SHIA-s. Sistemi më i mirë i sigurisë në botë nuk mund të sigurojë një mbrojtje të plotë dhe përshtatshme kundër penetrimit, pasi teknikat e përdorura përfshijnë elementin njeri (HUMINT). Për shembull, në shërbimin britanik, rasti i Të Pestëve të Kembrixhit dhe dyshimet e mëvonshme rreth shefit të MI5, Sir Roger Hollins, shkaktuan pasiguri dhe kaos në MI5. Britanikët u penetruan nëpërmjet Filbit, por ai nuk u zbulua asnjëherë nga kundërzbulimi. Në shërbimin amerikan, pati gjithashtu mosmarrëveshje të shumta rreth akuzave kontradiktore për “urithe” (mole⁹) në SHBA. Dezertorët Anatoliy Golitsyn dhe Yuri Nosenko¹⁰, si dhe mbështetësit e tyre në CIA, hodhën dritë për penetrimet ruse brenda institucioneve të sigurisë amerikane dhe jo FBI si organi më i lartë i kundërzbulimit amerikan.

Kundërzbulimi mbrojtës është disiplina që operon duke kërkuar për pika të dobëta në brendësi të organizatës së vet, të cilat mund të shfrytëzohen nga shërbimet e huaja (FIS)¹¹. Analizat e kundër inteligjencës japin vlerësime strategjike rreth veprimtarisë së shërbimeve të inteligjencës kundërshtarë, si dhe përgatisin skenarë për hetime apo operacione që janë duke u kryer. Kundërspiunazhi mund të përfshijë edhe akte proaktive kundër FIS, të tilla si: agjentë të dyfishtë, operacione mashtrimi, ose rekrutim të oficerëve të shërbimeve të huaja. Kundërspiunazhi shkon përtej të qenit reagues, duke u përpjekur të zbulojë, ndërpresë dhe përmbysë aktivitetin e shërbimeve kundërshtarë të inteligjencës, duke rekrutuar agjente në radhët e shërbimeve kundërshtarë, duke diskretituar personelin që është besnik ndaj shërbimit të tij, si dhe duke i mohuar kundërshtarit shfrytëzimin e atyre burimeve që mund të jenë të dobishme për të. Kundërzbulim ose kundërspiunazh janë masat që ndërmerren për të zbuluar spiunët e armikut ose sulmet fizike kundër vendit apo vendeve dhe shërbimeve mike, për të parandaluar dëmin, rrjedhjen e informacionit, dhe aty ku është mundësia për të kthyer veprimtarinë e kundërshtarit në dobi të shërbimit që përballet me të.

Në disa rrethana, arrestimi i agjentëve të zbulimit të huaj nga kundërzbulimi, mund të jetë hapi i parë, ku të ndaluarit i jepet mundësia të bashkëpunojë (të kthehet në agjent të dyfishtë) ose në të kundërt të përballet me pasoja të rënda, përfshirë këtu edhe dënimin me vdekje për kryerje të aktivitetit të spiunazhit. Bashkëpunimi mund të konsistojë në zbardhjen e gjithçkaje që agjenti i arrestuar di rreth organizatës së inteligjencës së cilës i shërbente, por do të

⁹ Mole (urith)- agjentë të dyfishtë të rekrutuar nga radhët e shërbimeve kundërshtarë.

¹⁰ Oficerë të KGB-së ruse të cilët dezertuan në maj 1964 te CIA dhe MI6.

¹¹ FIS - *Foreign Intelligence Services*.

ishte më mirë sikur agjenti i arrestuar të bashkëpunonte aktivisht në veprimtari operative që ka për qëllim të mashtrojë kundërshtarin. Rusia dhe Ukraina po i përdorin gjerësisht këto forma¹².

FIS të shteteve totalitare kanë aftësinë të eksplorojnë shoqëritë e hapura, duke arritur që të rekrutojnë edhe individë që punojnë në komunitetin e inteligjencës perëndimore. Kundërspiunazhi ofensiv perëndimor është mjeti më i fuqishëm për të gjetur të infiltruarit dhe për t'i neutralizuar ata, por nuk është i vetmi. Komuniteti i kundër inteligjencës së NATO-s do të synojë që të manipulojë spiunët e huaj, të kryejë hetime agresive, të bëjë arrestime dhe, nëse janë të përfshirë zyrtarë të huaj, ata të përjashtohen. Spiunët e huaj mund të përdoren pa vetëdije ose me dëshirë për t'u kthyer në agjentë të dyfishtë¹³. Në doktrinën amerikane, KZ shihet si masa kryesore për të kundërshtuar aktivitetin HUMINT¹⁴ të shërbimeve të huaja (FIS).

Ne po përpiqemi të sjellim në vëmendje pse ky sektor i fushës së Inteligjencës nuk është trajtuar si një aspekt kyç i sigurisë nga aktorët shtetërorë. Kundërzbulimi është një pjesë integrale e procesit të inteligjencës, e kryer nga shërbimet e Inteligjencës shtetërore (civile dhe ushtarake) apo edhe nga korporatat private të krijuara posaçërisht për këtë qëllim. Kontributi i KZ në sigurinë e shtetit është jetik, pasi ruan stabilitetin politik të një shteti, duke siguruar funksionimin e përhershëm dhe sigurinë e tij të brendshme, si dhe ndikon në procesin e vendimmarrjes ndaj një shteti kundërshtar, nëpërmjet operacioneve të mashtrimit, dezinformimit, sabotazhi, subversionit etj., që ndikojnë në politikën dhe çështjet ushtarake.

3. Hapësira kibernetike është “kufiri i ri” i kundërzbulimit.

Është në natyrën njerëzore të jesh kureshtar se çfarë bën tjetri, çfarë planifikon të bëjë apo dhe çfarë ai zotëron. Ndërsa shtetet dhe ushtritë e kanë pasur nevojë jetike të dinë për kundërshtarin sa i fortë numerikisht, ushtarakisht, ekonomikisht dhe moralisht, kundërshtari është. Në aspektin kombëtar subjekti kryesor i KZ tonë (civil dhe ushtarak) janë SHIA dhe agjentët e tyre të zbulimit. Sipas përkufizimit¹⁵ “agjent” është një person që punon për një SHIA ose një qeveri e huaj. Agjentët e huaj me ose pa kombësi shqiptare, që operojnë në vendin tonë, janë të vetëdijshëm dhe trajnuar që të punojnë ilegalisht për llogari të shtetit të huaj dhe të mbrohen nga KZ ynë.

¹² <https://www.evropaelire.org/a/rusia-ndikimi-ne-afrike-/32758652.html>

¹³ <http://www.panorama.com.al/cia-tenton-te-rekrutoje-agjente-te-dyfishte-ne-rusi-i-kerkon-si-punonjes-ne-shba/>

¹⁴ HUMINT- Inteligenca e bazuar në agjenturë me burime njerëzore.

¹⁵ AJP 20 NATO - doktrinat e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë

KZ funksionon në terren me anë të rrjeteve sekrete informative të inteligjencës njerëzore, të cilat në kombinim me aktivitete të tjera operacionale, çojnë në mbledhjen e inteligjencës së nevojshme. Kundërzbulimi menaxhohet dhe analizohet nga oficerë të specializuar të inteligjencës, të cilët janë përgjegjës për prodhimin e vlerësimeve të rrezikut të sigurisë ushtarake dhe që kërkojnë të zbulojnë çdo anomali sigurie në lidhje me sigurinë e brendshme. Raportet e kundërzbulimit janë jashtëzakonisht të ndjeshme dhe prodhojnë sinjale paralajmëruese, në lidhje me boshllëqet e mundshme të sigurisë në agjencitë shtetërore të inteligjencës civile dhe ushtarake, si dhe departamentet e tjera qeveritare sipas problematikës. Për të kuptuar vlerën e KZ, si një mjet operacional dhe si një proces analitik në komunitetin e inteligjencës, ai duhet të lidhet me Ciklin e Inteligjencës. Përveç kësaj, është e dobishme të shqyrtohet dallimi midis Informacionit dhe Inteligjencës në mënyrë që të përcaktohet kontributi dhe roli i tyre në procesin e Inteligjencës.

Byroja Federale e Hetimit¹⁶ (FBI) është procedurë të mbrojtjes së sekreteve të komunitetit të inteligjencës amerikane si dhe të aseteve kritike të kombit, duke penguar aktivitetet e spiunëve të huaj, si dhe duke mbrojtur “armët e shkatërrimit në masë” amerikane që të mos bien në duart e gabuara. Në përcaktimin amerikan, kundërzbulimi (CI¹⁷) është art edhe shkencë dinamike dhe gjithnjë në ndryshim. Kohët e fundit, ndryshime të rëndësishme shoqërore dhe teknologjike e kanë detyruar fushën e kundërzbulimit dhe agjencitë përbërëse të saj të adoptojnë metoda të reja për të përballuar tendencat dhe kërcënimet e reja kibernetike dhe IA në zhvillim. Qëllimi i CI është të mbrojë¹⁸ sekretet shtetërore ushtarake nga (zbulimi) spiunazhi i fuqive të huaja armiqësore dhe ndonjëherë edhe miqësore. Historikisht, kjo metodë e zbulimit të SHIA-s ka përfshirë¹⁹ drejtimin e agjentëve të dyfishtë, krijimin e burimeve brenda organizatave armike, joshjen e dezertorëve, mbledhjen e informacionit nga burime të huaja ose shërbimet e inteligjencës, si dhe krijimin e proceseve strikte verifikimi për agjencinë e inteligjencës.

James Olson²⁰, ish-shefi i kundërzbulimit për CIA-n, iu drejtua kështu studentëve të kundërzbulimit të NCIX²¹ në Uashington: “NCIX duhej të krijoj

¹⁶ FBI - Agjencia kryesore e kundërzbulimit të SHBA-ve.

¹⁷ CI- Counter intelligence.

¹⁸ <https://www.amazon.com/Intelligence-Secret-World-Spies-Anthology/dp/0199348529>

¹⁹ https://books.google.com/books?id=6HusBwAAQBAJ&pg=PT1484&lpg=PT1484&dq=Counterintelligence+by+Gail+H+Nelson&source=bl&ots=1ONviYts3h&sig=ACfU3U2oHyO1SfFeo-Asc47YuNp7sL7JiQ&hl=en&sa=X&ved=2ahUKewiyqK71s_jrAhUElawnKHwTNC7IQ6AE-wEnoECACQAQ#v=snippet&q=

²⁰ James Olson, ish-shefi i kundërzbulimit për CIA-n.

²¹ <https://www.encyclopedia.com/politics/encyclopedias-almanacs-transcripts-and-maps/ncix-national-counterintelligence-executive-united-states-office>

programe trajnimi të kundërzbulimit në mbarë komunitetin e inteligjencës. ‘Mos jini të fshehtë pa arsye, por trajnioni njerëzit tuaj’”. Olson e quajti NCIX/ NCSC²² një hap në drejtimin e duhur dhe sfidë për t’i bërë politikë-bërësit të kuptojnë se CZ është si një mjet mbrojtës ashtu edhe sulmues. Integrimi është i rëndësishëm por nuk do të zgjidhë çdo problem, por do t’i lejojë agjencitë të integrojnë operacionet e tyre pa probleme, duke shmangur rrjedhjet dhe kompromise të tjera sipas parimit “need to know” ose nevojë për njohje.

KZ ushtarak është kompleks por detyrat parësore të tij janë të mbrojtë sekretet ushtarake dhe ushtarake të vendit si dhe të zbulojë agjentët e SHIA, të mundshëm që e synojnë këtë sekret shtetëror. KZ operon në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha sektorët e sigurisë së një shteti, sektorin privat, qofshin ato organe publike apo kompani private, por dhe institucione akademike. Kjo qasje e përbashkët e inteligjencës brenda një shteti, është jashtëzakonisht e rëndësishme për funksionimin e duhur të sigurisë së tij. Pa koncept të unifikuar të komunitetit të inteligjencës në nivel kombëtar (AISM, SHISH) dhe një bashkëpunim efektiv midis institucioneve shtetërore, publike dhe private, është e pamundur të shmangët ndërhyrja e huaj keqdashëse dhe të mbrohet siguria e brendshme, ushtarake, politike, ekonomike, si dhe infrastrukturën kritike.

Detyra e parë kritike e KZ kombëtar dhe NATO-s ku ne jemi pjesë, është mbrojtja e informacionit të brendshëm, si dhe sekreteve ushtarake të aleancës. Gjatë këtij procesi, zyrtarët e KZ janë përgjegjës për ndërtimin e procedurave dhe kushteve të sigurisë, si dhe për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme që të zvogëlojnë shanset për çdo zbulim të huaj, apo rrjedhje inteligjence. Këto rregulla sigurie në FARSH kanë të bëjnë, si me funksionimin e FARSH ashtu edhe me besueshmërinë e personelit, që është i përzgjedhur në detyra me akses në informacion sekret të NATO-s. Për këtë qëllim, është e nevojshme të bëhet ngritja e procedurave të veçanta të sigurisë së brendshme, të cilat çojnë në identifikimin e dobësive të sigurisë, me boshllëqet e infrastrukturës, si dhe individëve që mund të përbëjnë një “kërcënim të brendshëm” për agjencitë tona të inteligjencës.

Duke analizuar vetëm të dhënat e media-s tonë dhe asaj të huaj për ngjarjen në ish-fabrikën e armëve në Gramsh më 20 gusht 2022, arrihet në përfundimin e arsyeshëm se kundërzbulimi ynë ka bërë një punë të shkëlqyer. Në objektin strategjik që ruhet me rojë ushtarake, dhunohet siguria, fotografet në fshehtësi dhe reagohet me armë të ftohta, kundër personelit ushtarak të sigurisë. Shkelësit

²² National Counterintelligence and Security Center (NCSC) leads national counterintelligence (CI) for the United States government. It is part of the Office of the Director of National Intelligence (ODNI).

e sigurisë janë shtetas rusë, qeveria e të cilëve e ka shpallur Shqipërinë vend armiqësor më 7 mars 2022. Në praktikën e SHIA ndaj NATO-s dhe Shqipërisë, është e zakonshme praktika e zgjedhjes së “mbulesës së besueshme” dhe e “vijës së sjelljes” pa dyshime. Për kryerjen e operacioneve relativisht të lehta, këto shërbime si për rastin e Gramshit besohet të kenë përdorur nënkontaktorë. Kjo bëhet me qëllim që emri i tyre dhe ID, të mos gjendet askund në organikat dhe borderotë e Shërbimeve Inteligjente edhe nëse ato kapen apo posedohen nga kundërshtarët. Këta operacione janë programuar me qëllim që të “mohohen” lehtësisht nga shtetet përgjegjëse sponsor i SHIA-s, pasi në këtë mënyrë çdo gjë do të duket personale, “turistike” dhe pasioni i një blogeri. Përdorimi dhe kontaktimi i paramilitarëve në luftë, i mercenarëve për të kryer krime dhe i personave të zakonshëm për të kryer spiunazh, bëhet pikërisht për këtë qëllim; për të mohuar implikimin e qeverive dhe agjencive shtetërore, që mbështesin, sponsorizojnë dhe qëndrojnë pas tyre. Kërkesa për ekstradim në Rusi, pasi “autorja ka kryer të njëjtën shkelje edhe në Rusi”, është pjesë e “mbulesës”. Autorja ruse bën ‘bluf’ duke thënë se është e rrezikuar në Rusi dhe kërkon strehim politik në Shqipëri. Gjithçka është e menduar, llogaritur mirë, me skenarë të mundshëm, me vija sjellje profesionale të spiunazhit dhe mbrojtje ligjore profesionale.

Arsyeja pse u zgjodh ky objekt në Gramsh, mund të jetë plani i deklaruar disa muaj më parë në media, i mundësisë së rivënies në punë të këtij objekti strategjik, për llogari të NATO-s, në të ardhmen. Incidenti që ndodhi në Gramsh²³ mori edhe vëmendjen e mediave ndërkombëtare prestigjioze. Kanali informativ britanik Sky News, i cili i ka kushtuar një rëndësi të madhe luftës në Ukrainë, e raportoi ngjarjen si spiunazh rus në Shqipëri, më 21 gusht 2022. Tabloidi gjerman “Bild” në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në ish-uzinën e armëve në Shqipëri ka komentuar: “Situatë e ndjeshme në Shqipëri! Dyshimi është i qartë: ata ishin agjentë rusë. Në lidhje me pasaportat e zbuluara ukrainase, gazeta thotë: “Nuk jemi të befasuar, pasi qindra mijëra pasaporta ukrainase përfunduan në duart ruse në territoret e pushtuara. Sigurisht, njësia operacionale ruse e GRU qëndron pas sulmit.” Edhe mediat greke kanë raportuar për ngjarjen Zougla.gr ka²⁴ bërë edhe një historik të shkurtër për fabrikën duke theksuar se në të kaluarën ajo ka prodhuar pushkë ruse AK-47 dhe tani përdoret për të çmontuar armët e vjetra dhe mund të rivihet në punë për llogari të NATO-s. Ajo nuk është e panjohur edhe nga analistë të luftës në Ukrainë²⁵. Vetëm mediat tona nuk e analizuan sa dhe si duhet, madje ranë në

²³ <https://m.facebook.com/pamfleti.net/posts/604174244396596/>

²⁴ <https://www.zougla.gr/kosmos/article/alvania-dio-rosi-ke-enas-oukranos-sinelif8isan-otan-prospa8isan-na-isel8oun-se-ergostasio-oplon>

²⁵ <https://dosja.al/newsmobile//236631/>

kurthin e tyre, duke i nënvlerësuar dhe ironizuar me këtë fakt. Madje më 24 shkurt 2024, propagandisten e kësaj ngjarje e ftuan në një emision televiziv, duke e justifikuar ndalimin e saj si reminishencë të kaluarës. Nuk e kam fjalën për ato media apo analistë që mund të jenë të sponsorizuar nga Rusia, por për ndjesinë e përgjithshme që opinioni ynë mbart ndaj këtyre operacioneve.

Operacionet e inteligjencës së huaj janë “të maskuara” ose “klandestine”, ku në përgjithësi përfshijnë 90% aktivitete të hapura dhe të ligjshme, ndërsa vetëm 10% është spiunazh. Inteligjenca armiqësore përdor mjekët, gazetarët, eksploratorët, shkencëtarët, profesorët, sportistët etj., pasi shfrytëzon profesionin e tyre të lirë për të lëvizur, pyetur, takuar, fotografuar, filmuar, blerë etj. Gjithçka bëhet për të fshehur gjatë udhëtimeve të këtyre kategorie profesionale edhe “pak” spiunazh. “Turistët spiunë” mund të filmojnë disa qindra objekte vërtetë turistike dhe historike, por inteligjencës që i drejton ato, i nevojitet vetëm njëra, mes tyre. “Vija e sjelljes” dhe “mbulesa²⁶” e operacioneve të “maskuara”, janë shumë të afërta me të vërtetën, me historinë që justifikohen agjentët nënkontaktorë. Këta fakte, mjaftojnë për ta vlerësuar realisht këtë ngjarje, si dhe falënderuar ushtarët tanë për kurajën, guximin dhe profesionalizmin e treguar. Në një raport të kundërzbulimit të vitit 2010, Paul Redmond, një ish-Shef i Kundërzbulimit në CIA, i identifikoi²⁷ kërcënimet e hapësirës kibernetike si fushat sfiduese për operacionet e KZ të SHBA në të ardhmen. Shfrytëzimi i mediave sociale nga kundërshtarët, përbën një nga sfidat më të rëndësishme të kundërzbulimit kibernetik për të gjithë shtetet, veçanërisht për shkak se fushatat më të dëmshme dhe përçarëse të dezinformimit, shpesh asistohen dhe zgjerohen nga platformat e mediave sociale. Rusia përdori rrjetet e mediave sociale si mjete propagande për të nxitur trazirat gjatë revolucionit ukrainas²⁸ të vitit 2014 dhe për të nxitur histerinë e ushtrimit të Jade Helm të vitit 2015²⁹ në kontenë Bastrop, Teksas.

Rusia vendosi operacione kibernetike edhe më të gjera³⁰ gjatë zgjedhjeve presidenciale në SHBA të vitit 2016, zgjedhjeve presidenciale franceze të vitit 2017 dhe zgjedhjeve federale gjermane të vitit 2017. Është e qartë se mediat sociale mund të ndikojnë në fuqitë e huaja dhe ndihmojnë në qëllimet e politikës së brendshme dhe të jashtme të një kombi. KZ në SHBA hap çdo

²⁶ <https://spyscape.com/article/spy-glossary>

²⁷ <https://www.iwp.edu/wp-content/uploads/2014/07/20140721-RedmondCounterintelligenceChapter2010.pdf>

²⁸ <https://www.amazon.com/War-140-Characters-Reshaping-Twenty-First/dp/046509614X>

²⁹ <https://www.texastribune.org/2018/05/03/hysteria-over-jade-helm-exercise-texas-was-fueled-russians-former-cia/>

³⁰ <https://www.cfr.org/report/countering-russian-information-operations-age-social-media>

12 orë investigime kundërzbulimi³¹ lidhur me Kinën, deklaroi drejtori Christopher Wray gjatë një dëgjese në senatin e “Homeland security commity” më 21 shtator 2021³².

Pavarësisht përpjekjeve të fundit³³ nga Qendra Kombëtare e Kundërzbulimit dhe Sigurisë (NCSC) për t’u mbrojtur kundër ndërhyrjeve të huaja në sistemet politike të SHBA-së, Shtetet e Bashkuara mbeten të pambrojtura ndaj fushatave dezinformuese të fuqive të huaja. Komuniteti i inteligjencës (KI) mund të luftojë kërcënimet e huaja duke bërë «një angazhim të ripërtërirë³⁴ për sigurinë kibernetike “. Christopher Costa dhe Joshua Geltzer, dy veteranë të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, shtojnë se KZ duhet të punojë “shumë hapur³⁵, duke identifikuar dezinformatat e përhapura nga kundërshtarët e huaj dhe duke e zbuluar me shpejtësi përpara se të “bëhet viral” dhe të rrënjësohet në mendjet amerikane. Ndërsa SHBA-ja ka bërë njëfarë përparimi duke bashkuar forcat me sektorin privat për të adresuar kërcënime të tilla, integrimi midis entiteteve të inteligjencës së sektorit të saj publik ka një frenim dhe Shtetet e Bashkuara mbeten vulnerabël për të integruar plotësisht shërbimet e tyre të inteligjencës³⁶.

Këto përpjekje SHIA të huaja synojnë të marrin informacion ose material analitik të çdo forme dhe natyre, si dhe të shkaktojë dëme në sistemet e brendshme të informacionit të një shteti dhe në sigurinë e tij. Dëmi i SHIA mund të ketë të bëjë, si me paaftësinë e sistemeve të informacionit për të funksionuar për një periudhë të caktuar kohore, ashtu edhe me mundësinë e shkatërrimit të pjesshëm ose të plotë të tyre. Antagonizmi strategjik në rritje të vazhdueshme midis fuqive globale dhe rivalëve gjeopolitikë, duhet të jetë një shqetësim i veçantë për Komunitetin e Inteligjencës si kombëtare shqiptare ashtu dhe të NATO-s, duke marrë parasysh aftësitë e avancuara teknologjike, në kryerjen e operacioneve hibride të SHIA përmes hapësirës kibernetike. Për më tepër, pajisjet dhe metodat e posaçme teknologjike, janë të nevojshme për konfigurimin e rrjeteve shtetërore për dërgimin dhe marrjen e informacionit të koduar ndërmjet agjencive dhe shërbimeve qeveritare, në mënyrë që të mbrohet funksionimi i sigurt i tij.

³¹<https://www.nbcnews.com/politics/national-security/china-other-countries-now-top-u-s-intel-s-global-n1263950>

³² Sept. 21, 2021, By [Dareh Gregorian](https://www.nbcnews.com/author/dareh-gregorian-ncpn925686) <https://www.nbcnews.com/author/dareh-gregorian-ncpn925686>

³³ <https://thehill.com/policy/cybersecurity/482413-new-federal-strategy-prioritizes-defending-us-against-foreign-threats-to>

³⁴ <https://www.georgetownjournalofinternationalaffairs.org/online-edition/2017/12/22/covert-action-in-the-age-of-social-media>

³⁵ <https://www.defenseone.com/ideas/2019/10/fight-disinformation-rethink-counterintelligence/160582/>

³⁶ http://cchs.auburn.edu/_files/restructuring-the-us-intelligence-community.pdf

Këto aplikacione teknologjike mund të sigurohen, ose nga tregu, duke shfrytëzuar teknologjinë dhe përvojën ekzistuese nga kontraktorët privatë, ose mund të zhvillohen brenda vendit, nga personeli i specializuar në FARSH dhe agjencitë civile të inteligjencës. Antagonizmi strategjik në rritje midis fuqive globale dhe rivalëve gjeopolitikë, duhet të jetë një shqetësim i veçantë për Inteligjencën e NATO-s, po ashtu edhe të vendit tonë.

Përfundime

- Përmbajtja e këtij punimi synon t'iu shërbejë ushtarakëve në FARSH dhe MM, që të kuptojnë qasjet, teknikat dhe mënyrat e sjelljes së SHIA-s, që të mos përdoren si prova, kurthe, apo shantazh, për rekrutim të tyre.

- Oficerët e KZ konsiderohen si luftëtarë të padukshëm, që e sakrifikojnë jetën njëlloj si në paqe ashtu dhe kohë luftime. Për arsye se punën e tyre e shikojnë vetëm pak njerëz, ata duhet të vlerësohen më shumë edhe përmes publikimeve dhe medias.

- Ushtarakët shqiptarë dhe partnerët në misione brenda dhe jashtë vendit, duhet të trajnohen për të dalluar “vijën e sjelljes” dhe “mbulesën³⁷” e operacioneve të “maskuara”, pasi ata janë “skenarë” shumë të afërt me të vërtetën. SHIA janë të mirëpërgatitura³⁸ që për çdo situatë, të justifikojnë, veprimet, mjetet dhe sjelljet e “spiunëve turistë”, “blogger” etj.

- Shfrytëzimi i mediave sociale nga kundërshtarët tanë përbën një nga sfidat më të rëndësishme të kundërzbulimit kibernetik, i cili nganjëherë duhet të ekspozojë “hapur” për publikun, veçanërisht fushatat e dëmshme, mohuese dhe përçarëse të dezinformimit.

- Viti 2024 e gjen infrastrukturën e operimit të informacionit dhe luftën hibride, në një nivel të ri të paparë më parë. Lufta hibride, interneti dhe IA në evoluim do të rrisin pa diskutim në të ardhmen inteligjencën në fushën kibernetike, çka e bën të domosdoshëm edhe rritjen e nivelit profesional të KZ, si dhe të vendosin balancën e raportit të ndryshuar të burimeve teknologjike, me ato HUMINT.

- Kërcënimet globale në zhvillim kërkojnë një transformim themelor të operacioneve të kundërzbulimit dhe kundërspiunazhit, veçanërisht një integrim më të plotë të operacioneve të KZ kibernetik në inteligjencën ushtarake; agjencitë e inteligjencës civile kundërzbulimit kibernetik, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe sektorit privat.

³⁷ <https://spyscape.com/article/spy-glossary>

³⁸ Të njohura si “cover story” në gjuhën e inteligjencës

Literatura e shfrytëzuar:

1. Michelle Van Cleave, *Kundërzbulimi dhe Strategjia Kombëtare* (Uashington, DC: Shkolla për Edukimin Ekzekutiv të Sigurisë Kombëtare/ Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare), 2007.
2. Danimarkë, Ministria e Financave, *Strategjia Daneze e Sigurisë Kibernetike dhe Informacionit*, 2018.
3. Agjencia Kombëtare e Sigurisë, Udhëzues për Sigurinë e Infrastrukturës së Rrjetit, 2-7; Qendra Kombëtare e Kundërzbulimit dhe Sigurisë, “Strategjia Kombëtare e Kundërzbulimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës 2020-2022”, 2020.
4. <https://www.dni.gov/index.php/ncsc-features/2741-the-national-counter-intelligence-strategjia-e-shtetet-e-bashkuara-e-amerikes-2020>.
5. Interpol, “The Protection of Critical Infrastructures”, 129-130.
6. David Oman, *Understanding Digital Intelligence: A British View* në Eugenie de Silva (ed.), *Siguria Kombëtare dhe Kundërzbulimi në Epokën e Spiunazhit Kibernetik* (Hershey, PA: IGI Global, 2016).
7. Elementet Themelore të Disiplinës së Kundërzbulimit (Uashington, DC: ONCIX, 2006), 20-25; Departamenti i Ushtrisë i SHBA-së, Procedurat Hetimore të Kundërzbulimit (Uashington, DC: Departamenti i Shtabit të Ushtrisë, 2020), 6-10.
8. Sims & Gerber, *Vaults, Mirrors and Masks*, 129-130; Departamenti i Ushtrisë, *Manuali i Operacioneve të Kundërzbulimit në terren* (Uashington, DC: Departamenti i Shtabit të Ushtrisë, 1972).
9. Michael D. Stouder & Scott Gallagher, *Krijimi i Strategjisë Operacionale të Kundërzbulimit: Një Udhëzues për Menaxherët*, *Revista Ndërkombëtare e Inteligjencës dhe Kundërzbulimit*, 26:3 (2013).
10. Moravej, “Çështje kritike”, 56; Alguliyev Rasim et al., “Siguria e informacionit si një komponent i sigurisë kombëtare”, *Revista e Sigurisë së Informacionit: Një Perspektivë Globale*, 30:1 (2020).
11. Wetering, “Kundërzbulimi”, 266.
12. Lisa A. Kramer dhe Richards J. Heuer, *Vulnerabiliteti i rritur i Amerikës ndaj spiunazhit të brendshëm*, *Revista Ndërkombëtare e Inteligjencës dhe Kundërzbulimit*, 20:1 (2007), 50-64.
13. Qendra Kombëtare e Kundërzbulimit dhe Sigurisë, *Zbutja e Kërcënimeve të Brendshme për Subjektet e Infrastrukturës Kritike të SHBA: Udhëzime nga një perspektivë e inteligjencës* (Uashington, DC: Qendra Kombëtare e Kundërzbulimit dhe Sigurisë, 2021), 4.

Bllokada e grupit të armatosur “Houthi” në Detin e Kuq dhe pasojat e fushatës së Perëndimit kundër tyre

Kolonel Msc. Dilaver Hoxha
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Veprimet e fundit të Houthi-t për bllokimin e anijeve tregtare që kalojnë nëpër ngushticën Bab al-Mandab, përbëjnë një shqetësim për rajonin, Perëndimin dhe vendet e tjera në mbarë globin. Incidentet e krijuara nga kjo organizatë nëpërmjet sulmeve me raketa dhe dronë, kanë krijuar implikime me përmasa globale, duke pezulluar transportin ndërkombëtar nëpërmjet Detit të Kuq. Reagimi i Perëndimit ka qenë menjëhershëm, ku Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar, me mbështetjen edhe të disa vendeve partnere, filluan një fushatë ushtarake kundër militantëve Houthi. Nëpërmjet kësaj fushate synohet goditja e infrastrukturës ushtarake të Houthi-t, e cila nënkupton një përshkallëzim të konfliktit në Lindjen e Mesme. Kjo fushatë nuk është mbështetur nga vendet arabe, pasi ata i konsiderojnë sulmet e Houthi-t si një hakmarrje të justifikuar për veprimet e ushtrisë izraelite kundër palestinezëve në Rripin e Gazës. Në këto kushte, arabët nuk duan të përfshihen ushtarakisht në ndalimin e tyre. Veprimet ushtarake nga vendet perëndimore kundër Houthi-t konsiderohen të nevojshme për të mbrojtur një rrugë kritike tregtare pavarësisht rreziqeve të qenësishme. Një veprim më i konsoliduar i Perëndimit, për qetësimin dhe zgjidhjen afatgjatë të kësaj situatë, mund të konsiderohet një mision i BE-së, pse jo dhe i NATO-s.

Fjalë kyçe: Houthi, Hamas, Jemen, Deti i Kuq, Fushatë, Bllokadë, OAE, OSG.

1. Grupi i armatosur “Houthi” në Jemen dhe veprimtaria e tij

“Houthi-t” dhe roli i tyre në historinë e Jemenit.

Houthi-t janë një grup i armatosur politik dhe fetar me origjinë nga provinca veriperëndimore Saada e Jemenit, që përkrah pakicën myslimane shiite prej rreth 35 % të popullsisë së Jemenit të quajtur Zejdi (Zaydis)¹. Houthi-it e kanë filluar rebelimin e tyre në qershor 2004 dhe janë duke intensifikuar veprimtarinë e tyre në rajon. Vlen të theksohet se Zejdi-t përbëjnë rreth 8% të 70 milionë shiitëve në botë. Një imam Zejdi sundoi Jemenin për 1000 vjet, përpara se të përmysej në vitin 1962. Që atëherë, Zejdi-t, të zhveshur nga pushteti i tyre politik, kanë luftuar për të rivendosur autoritetin dhe ndikimin e tyre në Jemen.

Në vitet ‘80, klani “Houthi” filloi një lëvizje për të ringjallur traditat Zejdi, duke u ndjerë i kërcënuar nga predikuesit salafistë të financuar nga shteti, të cilët krijuan një bazë në zonat Houthi. Megjithatë, jo të gjithë Zejdi-t janë të lidhur me lëvizjen Houthi. Për më tepër, në vitet 1990, ky klan u rishfaq në Jemenin verior, pjesërisht edhe si një reagim ndaj rritjes së ndikimit financiar dhe fetar saudit.

Kryengritësit Houthi janë përleshur me qeverinë e Jemenit për më shumë se një dekadë. Që nga viti 2011, lëvizja Houthi është zgjeruar përtej rrënjëve të saj Zejdi dhe është bërë një lëvizje më e gjerë kundër qeverisë qendrore. Kryengritësit gjithashtu i referohen vetes si Ansarallah ose “Partia e Zotit”.

Pikëpamjet politike të Houthi-t.

Houthi-t nuk promovojnë një ideologji koherente dhe platforma e tyre politike është e paqartë dhe kontradiktore. Kryengritësit fillestarë Houthi dëshironin të imitonin Hezbollahun, të kishin pushtet pa sunduar në të vërtetë². “Houthi-t kanë qenë gjithmonë një grup milicie që tani ka filluar të merret me politikë,” tha eksperti jemenas Gregory Johnsen, i cili studioi dhe jetoi në vend për vite me radhë, për “Fresh Air” të NPR në prill 2015. “Dhe ata nuk e dinë vërtet se si kanë për të sunduar.”

Emblema e Houthi-t ofron vetëm një pamje të gjerë të pikëpamjeve të grupit. Ai përbëhet tërësisht nga frazat e mëposhtme: “Zoti është i madh, vdekje Amerikës, vdekje Izraelit, mallkim për çifutët, fitore për Islamin”. Por, sipas Les Campbell në Institutin Kombëtar Demokratik, denoncimi i ngjashëm me Hezbollahun nga Houthi-t për Shtetet e Bashkuara dhe Izraelin shpesh duket “kryesisht për t’u treguar”. Lidhjet e tyre me ish-presidentin Saleh kërcënojnë ta ekspozojnë grupin si “një grup tjetër që ndan plaçkën e korrupsionit”.

¹ Cameron Glenn from the U.S. Institute of Peace, the primary author of this article “*Who are Yemen’s Houthis?*”, originally published it in 2015.

² Garrett Nada and Mattisan Rowan, the U.S. Institute of Peace, “*Who are Yemen’s Houthis?*”2022.

Rrënjët Zejdi të Houthi-t nuk diktojnë domosdoshmërisht qasjen e tyre ndaj politikës. Udhëheqësit e tyre kanë pohuar se nuk po përpiqen të ringjallin imamatin Zejdi, por përkundrazi kërkojnë përfshirje më të madhe politike. Që nga viti 2011, ata kanë përdorur gjuhë nacionaliste dhe populiste në mesazhet e tyre në vend që ta inkuadrojnë veten si një lëvizje rreptësisht Zejdi. Gjithashtu ata kanë bërë një sërë aleatësh politikë sunitë.

Houthi-t morën pjesë në Konferencën e Dialogut Kombëtar të sponsorizuar nga OKB-ja nga viti 2013 deri në 2014. Ndërsa ata nuk e hodhën poshtë agjendën e reformës në parim, Houthi-t kundërshtuan propozimet për të kthyer Jemenin në një shtet federalist me gjashtë rajone. Propozimi do të lidhë Saadën me Sanaan, por Houthi-t duan që Saada të jetë rajoni i saj autonom.

Udhëheqësit e Houthi-t dhe ngritja e tyre në pushtet.

Abdul Malik al Houthi, vëllai i Hussein al Houthi, ka qenë udhëheqës shpirtëror, ushtarak dhe politik i grupit që nga viti 2007³. Pak dihet për jetën e tij personale dhe ai bën pak paraqitje publike. Kunati i tij, Youssef al Midani, është nënkryetar. Dy vëllezërit e Abdul Malik, Jahia dhe Abdul-Karim, janë gjithashtu udhëheqës të lartë të lëvizjes.

Pas muajsh protestash, Presidenti Saleh ia dorëzoi pushtetin zëvendësit të tij, Abd Rabbuh Mansour al Hadi në nëntor 2011. Por Hadi gëzoi pak mbështetje popullore në Jemen dhe Houthi-t përfituan nga vakumi i pushtetit në veri. Nga viti 2012-2013, ata tërhoqën shumë ndjekës dhe aleatë dhe konsoliduan kontrollin e tyre territorial, duke u shtyrë në jug drejt Sanaa.

Në shtator 2014, Houthi-t morën kryeqytetin. Ata fillimisht ranë dakord për një marrëveshje paqeje të ndërmjetësuar nga OKB-ja, e cila u kërkonte të tërhiqeshin nga Sanaa pas formimit të një qeverie uniteti. Por, në janar 2015, Houthi-t hodhën poshtë kushtetutën e sapo hartuar të qeverisë dhe morën në dorë pallatin presidencial. Presidenti Hadi dhe qeveria e tij dhanë dorëheqjen më 22 janar 2015. Muajin tjetër, Houthi-t njoftuan se një këshill presidencial prej pesë anëtarësh do të zëvendësonte Hadin. Hadi u largua nga jugu në Aden dhe tërhoqi dorëheqjen e tij, duke e shpallur veten president legjitim të Jemenit. Si përgjigje, kryengritësit Houthi filluan të bombardojnë selinë e Hadi në Aden⁴.

Më 14 prill 2015, Thesari i SHBA-ve vendosi sanksione ndaj Abdul Malik al Houthi për përfshirje në akte që “kërcënojnë paqen, sigurinë ose stabilitetin e Jemenit”. Në të njëjtin muaj, Këshilli i Sigurimit i OKB-së vendosi një embargo armësh kundër Houthi-t dhe futi në listën e zezë Abdul Malik al Houthi.

³ Cameron Glenn from the U.S. Institute of Peace, the primary author of this article “*Who are Yemen’s Houthis?*”, originally published it in 2015.

⁴ Garrett Nada and Mattisan Rowan, the U.S. Institute of Peace, “*Who are Yemen’s Houthis?*”2022.

Kush po i mbështet dhe si Houthi-t?

Irani akuzohet gjerësisht për mbështetjen e Houthi-t, një lëvizje shiite zejdi që ka luftuar kundër qeverisë me shumicë sunite të Jemenit që nga viti 2004⁵. Zyrtarët iranianë kanë mbështetur kauzën e Houthi-t dhe e kanë krahasuar grupin me Hezbollahun. “Irani mbështet betejat e drejta të Ansarullahut në Jemen dhe e konsideron këtë lëvizje si pjesë të lëvizjeve të suksesshme të Zgjimit Islamik,” tha në tetor 2014 Ali Akbar Velayati, një këshilltar i lartë i Udhëheqësit Suprem Khamenei.

Zyrtarët jemenas, shtetet sunite përfshi SHBA-të, kanë pretenduar dhe kanë treguar me prova në mënyrë të përsëritur se Irani dhe përfaqësuesi i tij Hezbollah kanë ofruar armë, trajnime dhe mbështetje financiare për Houthi-t, por zyrtarët iranianë dhe të Hezbollahun i kanë mohuar ose minimizuar pretendimet. Shtetet e Bashkuara, në koordinim me Arabinë Saudite, kanë paraqitur prova fizike të transferimeve të armëve iraniane për grupin. Megjithatë, Houthi-t kanë burime të tjera mbështetjeje nga mbështetës vendas dhe organizata bamirëse, si dhe nga tregtia e paligjshme.

Konflikti i Houthi-t me qeverinë qendrore.

Hussein Abdreddin al Houthi, një klerik i shquar Zejdi dhe anëtar i parlamentit nga viti 1993 deri në 1997, u bë një kritik i fortë i presidentit Ali Abdullah Saleh në vitet 1990. Ai akuzoi qeverinë se ishte lidhur shumë ngushtë me Shtetet e Bashkuara dhe Izraelin. Tensionet u rritën më tej pasi presidenti Saleh thuhet se i preu fondet Hussein al Houthi në vitin 2000. I frustruar nga statusi i dobët politik dhe ekonomik i Zejdive, ai filloi të mblidhte mbështetës për demonstrata antiqeveritare në fillim të viteve 2000⁶.

Qeveria lëshoi një urdhër për arrestimin e al Houthi-t dhe ndjekësit e tij filluan të përlesheshin dhunshëm me forcat e sigurisë. Al Houthi u vra nga forcat e sigurisë në vitin 2004. Që atëherë, të afërmit dhe mbështetësit e tij kanë zhvilluar gjashtë kryengritje kundër qeverisë, të njohura si luftërat Houthi. Presidenti Saleh akuzoi Iranin për mbështetjen e rebelimeve. Houthi-t nënshkruan një marrëveshje armëpushimi me qeverinë në vitin 2010, por iu bashkuan protestave të Pranverës Arabe kundër Saleh një vit më vonë.

Tensionet e Houthi-t me Sauditët.

Me kërkesë të Hadiut, Arabia Saudite së bashku me një koalicion prej nëntë kombesh të tjera sunite, më 26 mars 2015 nisën sulmet ajrore kundër pozicioneve

⁵ Cameron Glenn from the U.S. Institute of Peace, the primary author of this article “*Who are Yemen’s Houthis?*”, originally published it in 2015.

⁶ Cameron Glenn from the U.S. Institute of Peace, the primary author of this article “*Who are Yemen’s Houthis?*”, originally published it in 2015.

pozicioneve të Houthi-ve në Jemen. Houthi-t mbetën sfidues. “Luftëtarët tanë nuk do të evakuhohen nga qytetet kryesore apo institucionet qeveritare,” tha lideri Houthi Abdul-Malik al Houthi më 19 prill. “Kushdo që mendon se ne do të dorëzohemi është duke ëndërruar.” Lufta midis Houthi-t dhe qeverisë së njohur ndërkombëtarisht të Jemenit dhe mbështetësve të saj u zvarrit, pavarësisht përpjekjeve të OKB-së për të ndërmjetësuar bisedimet e paqes.

Më 21 prill, zyrtarët sauditë njoftuan përfundimin e fushatës, të njohur si operacioni “Stuhia Vendimtare”, duke pretenduar se kishin degraduar me sukses infrastrukturën ushtarake të Houthi-t. Houthi-t gjithashtu ranë dakord të përmbushin disa kërkesa të OKB-së, duke përfshirë lirin e ministrit të Mbrojtjes të Jemenit, të cilin ata e mbanin rob. Por, Arabia Saudite rifilloi sulmet ajrore dy ditë më vonë, por një muaj nga fushata Houthi-t nuk ishin dëbuar nga Sanaa dhe Hadin nuk ishin rikthyer në pushtet.

Përpjekjet e shumta për bisedimet e paqes të organizuara nga Kombet e Bashkuara dështuan. Dy tentativat e para ishin në Zvicër në qershor dhe dhjetor 2015. Kombet e Bashkuara u përpoqën përsëri në Kuvajt në prill 2016, por diskutimet u ndërpre në gusht dhe luftimet midis Houthi-t dhe forcave pro-qeveritare rifilluan.

Që nga marsi 2017, shtatë marrëveshje armëpushimi ishin thyer duke kthyer konfliktin. Tensionet midis koalicionit të udhëhequr nga Arabia Saudite dhe Iranit u përshkallëzuan ndjeshëm më 4 nëntor 2017, kur një raketë balistike u qëllua në Aeroportin Ndërkombëtar të Mbretit Khalid në Riad. Situata u përkeqësua më tej kur Houthi-t vranë ish-presidentin Ali Abdullah Saleh më 4 dhjetor 2017. Në dhjetor 2017, pas 30 muajsh të fushatës së udhëhequr nga Arabia Saudite në Jemen, Houthi-t kishin kryesisht kontrollin e Jemenit Verior.

Në vitin 2018, sulmet me raketa të Houthi-t në Arabinë Saudite u bënë gjithnjë e më të zakonshme. Luftimet përkeqësuan atë që Kombet e Bashkuara e quajtën “kriza më e keqe humanitare në botë”. Në dhjetor 2018, palët ndërluftuese u takuan në Stokholm, Suedi, për bisedimet e para në dy vjet. Ata ranë dakord për një armëpushim, shkëmbim të të burgosurve dhe tërheqje të trupave të koalicionit nga porti i Hodeidah, i cili trajton shumicën e importeve. Por armëpushimi u prish në fillim të vitit 2019.

Më 14 shtator 2019, Houthi-t pretenduan meritën për sulmet me dronë në dy instalime kryesore të naftës në Arabinë Saudite⁷. Por inteligjenca amerikane e paraqitur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së thuhet se tregoi se sulmi e kishte origjinën nga brenda Iranit, jo nga Jemeni. Sekretari i Shtetit Mike Pompeo akuzoi Iranin për kryerjen e “sulmit të paprecedentë ndaj furnizimit me energji

⁷ Garrett Nada and Mattisan Rowan, the U.S. Institute of Peace, “Who are Yemen’s Houthis?”, 2022.

në botë”. Ministri i Jashtëm iranian, Mohammad Javad Zarif, hodhi poshtë pretendimet e SHBA në një postim në Twitter.

Më 10 janar 2021, administrata Trump njoftoi se do të përcaktonte Houthi-t si një organizatë terroriste globale. Departamenti i Shtetit akuzoi Gardën Revolucionare të Iranit për ofrimin e raketave, dronëve dhe trajnimit për Houthi-t në kundërshtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Irani “vazhdon të pengojë përpjekjet e Kombeve të Bashkuara dhe vendeve mike për të zgjidhur krizën në mënyrë paqësore dhe për t’i dhënë fund konfliktit”, tha Pompeo në një deklaratë. Përcaktimi hyri në fuqi më 19 janar 2021 - një ditë para përfundimit të mandatit të Trump.

Administrata Biden, megjithatë, e revokoi listën më pak se një muaj më vonë. “Ne kemi dëgjuar paralajmërimet nga Kombet e Bashkuara, grupet humanitare dhe anëtarët dypartiakë të Kongresit, ndër të tjera, se emërtimet mund të kenë një ndikim shkatërrues në aksesin e jemenasve në mallrat bazë si ushqimi dhe karburanti,” tha Sekretari i Shtetit Antony Blinken më 12 shkurt 2021. Ai sqaroi se udhëheqësit e lartë Houthi – Abdul Malik al Houthi, Abd al Khaliq Badr al Din al Houthi dhe Abdullah Yahya al Hakim – do të mbeten të sanksionuar si individë. Grupi u hoq nga listat terroriste më 16 shkurt 2021.

Houthi-t e zgjeruan fushën e konfliktit në fillim të vitit 2022 duke sulmuar Emiratet e Bashkuara Arabe me dronë dhe raketa balistike. Forcat ushtarake të Emirateve dhe të SHBA-ve kapën dy raketa balistike të lëshuara nga Houthi-t në drejtim të Abu Dhabit më 24 janar 2022. Si kundërpërgjigje, rreth 2000 trupat amerikane të vendosura në bazën ajrore Al Dahfra të strehuar në bunkerë u kundërpërgjigjën me raketa Patriot. Një zëdhënës i Houthi-t paralajmëroi se Emiratet e Bashkuara Arabe ishin “bërë një vend i pasigurt”.

Në prill të vitit 2022, Houthi-t dhe qeveria e Jemenit ranë dakord për një armëpushim dymujor të ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara. Shtetet e Bashkuara dhe Irani mirëpritën armëpushimin. Në qershor 2022, palët ndërluftuese ranë dakord ta zgjasin atë edhe për dy muaj të tjerë. “Armëpushimi përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm në trajektoren e luftës dhe është arritur përmes vendimmarrjes së përgjegjshme dhe të guximshme nga palët”, tha në një deklaratë Hans Grundberg, i dërguari i posaçëm i OKB-së për Jemenin.

2. Zhvillimet aktuale në rrjedhën e ngjarjeve më të rëndësishme që lidhen me “Houthi-t”.

Në javët e fundit, Houthi-t, të cilët kontrollojnë pjesë të Jemenit, kanë ngacmuar/provokuar anijet tregtare që kalojnë nëpër ngushticën Bab al-Mandab ose nga Kanali i Suezit. Pas incidenteve të mëvonshme, si sulmet me raketa dhe dronë, në mes të dhjetorit, pronarët më të mëdhenj të anijeve pezulluan trafikun nëpër

Detin e Kuq. Për t'u theksuar është fakti se kjo rrugë lehtëson 10-12 për qind të vlerës së tregtisë botërore dhe afërsisht një të tretën e transportit të naftës në det. E para që ndërmori një veprim të tillë ishte kompania gjermane e anijeve Hapag-Lloyd, e ndjekur nga daneze Maersk, CMA CGM franceze dhe MSC italiane. Këto katër kompani së bashku përbëjnë 53 për qind të transportit global të kontejnerëve. British Petroleum (BP) vendosi të ndjekë shembullin e tyre, duke vëzhguar implikimet e pezullimit të transportit nëpër Detin e Kuq. Një kronologji e shkurtër e ngjarjeve kryesore gjatë dy muajve të fundit, dhjetor 2023-Janar 2024, jepet si vijon:

4 dhjetor 2023, Houthi-t kryen një sulm ndaj anijeve në brigjet e Jemenit. Dronët qëlluan drejt tre anijeve tregtare midis Detit të Kuq dhe Gjirit të Adenit, të cilat ishin nisur për në Izrael. Objektivi i sulmit mund të ishte edhe shkatërruesi “USS Carney”, i cili po i shoqëronte dhe rrëzonte raketat që vinin. Houthi-t e Jemenit kanë njoftuar sulme të tjera në të ardhmen. Gjithashtu “USS Carney”, i cili ka disa javë që mbron trafikun në Detin e Kuq, është sulmuar, dhe ky incident ishte më i madh. Përshkallëzimi mund të shkaktojë hakmarrje të SHBA-së, si goditje me raketa ose sulme ajrore mbi bazat Houthi në Jemen, dhe do të përqendrojë më tej vëmendjen në konfliktin në Lindjen e Mesme, në kurriz të luftës në Ukrainë.

Houthi-t kanë kryer pothuajse çdo ditë sulme me dronë dhe raketa kundër anijeve tregtare që kalojnë tranzit në Bab al Mandeb që nga 9 dhjetori. Fushata e sulmit Houthi i sinjalizon komunitetit ndërkombëtar se Boshti i Rezistencës mund të rrezikojë anijet rreth Bab al Mandeb, përveç ngushticës së Hormuzit⁸.

18 dhjetor 2023, sipas gazetës “The Economist”, kriza e re e Suezit kërcënon ekonominë globale. “Më shumë se një mijë milje larg Gazës, po zhvillohet një krizë detare që mund ta kthejë luftën midis Izraelit dhe Hamasit në një çështje globale”, theksohet në një artikull të The Economist⁹. Që nga 15 dhjetori, katër nga pesë kompanitë më të mëdha të transportit të kontejnerëve në botë, CMA CGM, Hapag-Lloyd, Maersk dhe MSC, kanë pezulluar shërbimet e tyre në Detin e Kuq - duke zgjedhur të devijojnë anijet e tyre përmes rrugës më të gjatë dhe më qarkore rreth Kepit të Shpresës së Mirë për të mbrojtur anijet dhe ekuipazhet e tyre. Vendimi vjen si përgjigje ndaj një sërë sulmesh të fundit nga rebelët Houthi në Jemen, të cilët kanë shënjestruar anijet që besohet se janë të lidhura me Izraelin. Dymbëdhjetë për qind e tregtisë globale kalon nëpër ngushticën më të kërcënuar, Bab al-Mandab. Në këto kushte SHBA mund të fillojë të përdorë forcën kundër militantëve.

⁸ Brian Carter, Annika Ganzeveld, Johanna Moore, and Nicholas Carl, Institute of the Study of the War/ ISW, *Iran Update*, December 24, 2023.

⁹ *The Economist* “A new Suez crisis threatens the world economy”, December 16, 2023.

2 janar 2024, Amerikanët fundosin varkat e Houthi-t. “Të dielën, helikopterët ushtarakë amerikanë fundosën tre varka të vogla që i përkisnin militantëve Huti në Detin e Kuq”¹⁰. Kjo ishte në përgjigje të bombardimeve të anijeve amerikane që po siguronin anijen civile të kontejnerëve Maersk Hangzhou, e cila u sulmua dy herë nga Houthi. Kjo është vrasja e parë e individëve nga ky grup i mbështetur nga Irani nga forcat amerikane që nga vjeshta 2023, kur filluan sulmet ndaj anijeve tregtare. Shtëpia e Bardhë në një deklaratë theksoi se nuk kërkon të përshkallëzojë konfliktin, por do të mbrojë interesat e saj në rajon përmes vetëmbrojtjes.

11 janar 2024, Houthi-t përshkallëzojnë sulmet në Detin e Kuq. Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar, me mbështetjen e Holandës, Kanadasë, Australisë dhe Bahreinit, filluan një fushatë ushtarake kundër militantëve Houthi të Jemenit, të cilët pothuajse kishin bllokuar trafikun detar në Detin e Kuq përmes sulmeve me raketa mbi anijet tregtare. Që atëherë, forcat perëndimore kanë kryer disa sulme kundër objektivave tokësore të Houthi-t, por kjo nuk arriti të ndalojë sulmet në det. Presidenti i SHBA Joe Biden dhe komandantët ushtarakë pranojnë se një fushatë më e gjatë që përfshin më shumë pjesëmarrës do të jetë e nevojshme për të eliminuar kërcënimin ndaj arteries jetike tregtare të botës. Kjo do të gjenerojë implikime ushtarake dhe strategjike.

12 janar 2024, sipas Reuters, SHBA dhe Britania e Madhe sulmojnë Houthi-t në Jemen. “Shtetet e Bashkuara dhe Britania nisën sulme nga ajri dhe deti kundër objektivave ushtarake Houthi në Jemen në përgjigje të sulmeve të lëvizjes ndaj anijeve në Detin e Kuq, një zgjerim dramatik rajonal i luftës Izrael-Hamas në Gaza”¹¹. Operacioni u mbështet nga Australia, Bahreini, Kanadaja dhe Holanda. Objektivat e saj përfshinin një bazë ushtarake pranë aeroportit Sanaa. SHBA njoftoi se megjithëse nuk dëshiron të përshkallëzojë tensionet, nuk do të hezitojë të ndërmarrë hapa të mëtejshëm. Këto veprime u dënuan nga Irani që mbështet Houthi-t. Vetë Houthi-t kanë njoftuar sulme të vazhdueshme ndaj anijeve që shkojnë drejt Izraelit.

12 janar 2024, sipas PR24, BE planifikon të dërgojë anije luftarake në Detin e Kuq. “Korrespondentja e Radios Polake në Bruksel, Beata Płomecka, ka parë dokumentin e përgatitur nga Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm. Është vetëm një draft që duhet të vendosin shtetet anëtare.”¹² Në Detin e Kuq, rebelët jemenas Houthi të mbështetur nga Irani po bombardojnë. anije me dronë dhe raketa. Operacioni i BE-së do të zgjaste një vit; të paktën tre shkatërrues ose fregata me aftësi shtesë zbulimi, kibernetike, satelitore dhe luftarake informative

¹⁰ CNN, janar 2024.

¹¹ Phil Stewart, Idrees Ali dhe Mohammed Ghobari për *Reuters*, janar 2024.

¹² *Radio Polake*, 24 janar 2024.

do të merrnin pjesë çdo gjashtë muaj. Operacioni do të fillonte në shkurt ose mars.

24 shkurt 2024: Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA kanë njoftuar një numër sanksionesh kundër atyre që mbështesin, mundësojnë ose ofrojnë punën e Houthis, grupi përfaqësues i mbështetur nga Irani në Jemen, përgjegjës për sulmet e përhapura kundër anijeve tregtare në Detin e Kuq, tha Zyra e Jashtme e Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë (FCDO)¹³.

3. Masat e ndërmarra nga Perëndimi për zhblokimin e situatës dhe implikimet kryesore.

- **Koalicioni i udhëhequr nga SHBA-të dhe Britania e Madhe nisën sulmet kundër Houthi-t.** Në sulmin e parë, koalicioni përdori avionë nga një aeroplanmbajtëse amerikane dhe avionë luftarakë britanikë, të cilët, siç thuhet në njoftimin zyrtar, hodhën bomba të drejtuara me saktësi në 60 objektiva në 16 vendndodhje. Forca goditëse shoqërohej nga avionë zbulues, komandues dhe cisternë. Në sulmin e dytë, raketat e lundrimit Tomahawk u lëshuan nga një destroyer amerikan që vepronte në Detin e Kuq. Komanda amerikane që mbikëqyr operacionet në Lindjen e Mesme ka raportuar se këto veprime janë mbështetur nga Kanadaja, Australia, Holanda dhe Bahreini.

- **Synimi i sulmeve të Perëndimit mbetet goditja e infrastrukturës ushtarake të Houthi-t, por jo luftë me Jemenin.** Objektivat e shpallura zyrtarisht përfshijnë aeroportet, stacionet e radarëve, pozicionet e mbrojtjes ajrore, qendrat e komandës, lëshuesit dhe depot e armëve. Kjo tregon se objektivi i veprimeve është eliminimi ose dobësimi i aftësive ushtarake të Houthi-t. Sulmet ajrore janë të përqendruara në rajonet perëndimore dhe veriore të Jemenit, zona të kontrolluara nga Houthi-t. Uashingtoni ka dhënë garanci se SHBA nuk po kërkon një luftë me Jemenin, por është e fokusuar në privimin e Houthi-t nga kapaciteti për të ndërprerë trafikun detar në një rrugë vendimtare globale. Presidenti Joe Biden ka vënë në dukje se Irani, si mbështetësi kryesor politik dhe i armatosur i rebelëve jemenas, ishte informuar paraprakisht për qëllimin për të nisur sulmet.

- **Marina perëndimore planifikon të rrisë mbrojtjen në afërsi të Kanalit të Suezit.** Shtëpia e Bardhë ka njoftuar se do të krijojë një task-forcë detare të ngarkuar me mbrojtjen dhe shoqërimin e anijeve tregtare në Detin e Kuq nga sulmet e mundshme të piratëve Houthi. Task-forca do të përbëhet nga anije luftarake amerikane dhe ka të ngjarë të përfshijë anije nga Franca dhe Britania. Ndërsa Ekipi Detar 153, i krijuar nga 39 vende, aktualisht operon në zonë, duke mbrojtur kryesisht Gjirin e Adenit kundër piratëve somalezë, grupi i ri do të fokusohet ekskluzivisht në sigurimin e hyrjes në Detin e Kuq përmes

¹³ Foreign, Commonwealth & Development Office and The Rt Hon Lord Cameron, 28.02. 2024.

ngushticës Bab al-Mandab. Jake Sullivan, këshilltari i sigurisë i presidentit amerikan, ende nuk e ka specifikuar përbërjen e këtij “koalicioni të gjerë”. Njoftimi tashmë është përballur me kundërshtimin e Iranit, mbrojtësi politik i Houthi-t, i cili ka sugjeruar se mund të çojë në “probleme të jashtëzakonshme” me lundrimin nëpër Gjirin Persik.

- **BE po shqyrton mundësinë e një misioni detar në rajon.** Kryeqytetet kryesore dhe Këshilli i BE-së kanë miratuar sulmet amerikano-britanike kundër Houthi-t, si një mjet për të mbrojtur lirinë e tregtisë detare. Në të njëjtën kohë, Brukseli po planifikon të dërgojë anije në Detin e Kuq në një operacion të ngjashëm me atë të iniciuar nga SHBA në dhjetor 2023, i quajtur “Prosperity Guardian”, nga i cili shumica e vendeve evropiane abstenuan. BE-ja po mendon krijimin e një njësie që përfshin të paktën tre shkatërrues ose fregata të ngarkuara me patrullimin dhe mbrojtjen e rrugës detare që përfshin Kanalin e Suezit, Detin e Kuq, ngushticën Bab el Mandeb dhe Gjirin e Adenit. Propozimi i misionit është bërë nga Italia, Franca dhe Gjermania për të mbrojtur anijet e Detit të Kuq nga sulmet e rebelëve Houthi. “Ne kemi rënë dakord, në parim, për të filluar misionin e BE-së në Detin e Kuq,” tha Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Josep Borrell, dhe “tani duhet të punojmë në unanimitet se kur (do të fillojë)”. Drafti po kalon aktualisht për konsultime midis qeverive, me Këshillin e BE-së që pritet ta diskutojë atë në një samit të sigurisë në shkurt 2024¹⁴.

- **Operacioni i ri do të krijojë një tendosje mbi asetet detare dhe ajrore perëndimore.** Operacioni në Detin e Kuq aktualisht përfshin një grup sulmi të aeroplanmbajtësve të marinës amerikane me aviacion të bazuar në transportues, një destroyer britanik dhe avion RAF nga një bazë në Qipro. Gjatë fazës së parë të operacionit, amerikanët kishin në dispozicion një aeroplanmbajtëse më shumë, por kjo u kthye në bazën e Norfolk në janar pas një misioni disa mujor. Mbështetja holandeze ishte e kufizuar në dërgimin e një oficeri. Megjithatë, pjesëmarrja evropiane në patrullimin e Detit të Kuq pritet të rritet me nisjen e misionit të planifikuar të pavarur të BE-së. Qeveritë e Gjermanisë, Francës, Spanjës, Italisë dhe Holandës po mendojnë të marrin pjesë. Vendosja e të paktën tre anijeve të tipit shkatërrues ose fregatë, me mbështetjen e nevojshme ajrore, të parashikuar në supozimet e operacionit, do të shterojë burimet që i duhen NATO-s për parandalimin dhe shtimin e mbrojtjes.

- **Operacioni kundër sulmeve të Houthi-t në det gjeneron kosto të lartë.** Anijet dhe avionët përdorin llojet më të shtrenjta të municioneve në dispozicion të forcave perëndimore për të rrëzuar dronët dhe raketat Houthi. Raketat SM-2 të përdorura nga sistemi i mbrojtjes ajrore të anijeve amerikane kushtojnë më

¹⁴ ANSA English, “EU OKs new Red Sea mission – Borrell”, January 22, 2024.

shumë se 2 milion USD secila dhe kostoja e raketave anti-balistike SM-3 ose SM-6 (përdorimi i të cilave ende nuk është konfirmuar zyrtarisht) është më shumë se 10 milionë dollarë. Çdo raketë lundrimi Tomahawk, e përdorur për të sulmuar objektivat tokësore, kushton më shumë se 2 milionë dollarë. Mbajtja e patrullave të vazhdueshme detare dhe një prani ajrore me ndihmën e zbulimit dhe helikopterët për evakuim kushtojnë dhjetëra miliona dollarë në ditë. Një operacion i gjerë detar dhe ajror gjithashtu rrit rrezikun e aksidenteve. Dy Navy Seals u zhdukën gjatë përgjimit të një dërgese armësh iraniane në janar.

- **Përçarja mes botës arabe dhe Perëndimit do të zgjerohet.** Fushata amerikano-britanike kundër Houthi-t nuk është mbështetur nga vendet arabe në Lindjen e Mesme, të cilat më parë kanë bashkëpunuar ushtarakisht me Amerikën dhe Britaninë: Egjipti, Arabia Saudite, Omani, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Jordania (pjesëmarrja e Bahreinit është për shkak të rolin e saj si pritës i një baze detare të SHBA). Kjo rrjedh nga fakti se arabët i konsiderojnë sulmet Houthi si një hakmarrje të justifikuar për veprimet e ushtrisë izraelite kundër palestinezëve në Rripin e Gazës dhe nuk duan të përfshihen ushtarakisht në ndalimin e tyre. Nëse BE-ja nuk arrin të vendosë një dialog me shtetet arabe dhe nuk fiton të paktën një pranim të mbrojtjes së armatosur të trafikut të anijeve, përshtypja e një ndërhyrjeje tjetër perëndimore do të thellohet në rajon dhe pakënaqësia ndaj pjesëmarrësve të tij do të rritet.

- **Rreziku në rritje i sulmeve ndaj bazave perëndimore në rajon.** Kjo ka të bëjë kryesisht me forcat amerikane dhe aleatët e tyre të dislokuar në Irak (2500 trupa amerikane, 4000 në misionin e NATO-s), Liban, vendet e Gjirit dhe që veprojnë në territorin sirian (rreth 900 trupa). Kërcënimi kryesor për këto trupa do të jenë sulmet ajrore të kryera duke përdorur dronë, raketa lundrimi dhe raketa balistike. Nëse ato janë intensive, ato mund të jenë të vështira për t'u zbrapsur nga sistemet e mbrojtjes ajrore. Shumica e bazave amerikane nuk kanë mbrojtje të mjaftueshme dhe kanë pësuar më shumë se 150 sulme nga Houthi-t jemenas, Hezbollah libanez dhe grupe të armatosura shiite të mbështetura nga Irani brenda Irakut që nga tetori i vitit 2023.

- **Veprimet e Uashingtonit dhe Londrës kanë ngjallur kritika nga partnerët rajonalë.** Dënimi më i zëshëm erdhi nga aleati i NATO-s dhe i të dy vendeve, Turqia. Presidenti Recep Tayyip Erdoğan tha se hakmarrja kundër Houthi-t do ta kthente Detin e Kuq në një det gjaku. Arabia Saudite, e cila dikur udhëhoqi koalicionin perëndimor-arab që ndërhyri në luftën civile në Jemen, bëri thirrje për përmbajtje dhe ndalimin e përshkallëzimit. Aleatët e tjerë arabë të Perëndimit: Omani, Emiratet e Bashkuara Arabe, Jordania dhe Egjipti shprehën shqetësim. Vendet arabe theksojnë se konflikti është rezultat i veprimeve të Izraelit (të cilat ata i konsiderojnë kriminale) kundër Hamasit palestinez në Rripin e Gazës. Rivalët globalë të Perëndimit, Rusia dhe Kina,

protestuan kundër sulmeve në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ndërsa Irani gjithashtu shprehu kritika të ashpra.

- Houthi-t njoftuan intensifikimin e sulmeve ndaj anijeve perëndimore.

Komandanti i përgjithshëm i Houthi deklaroi se grupi do të synonte “burimet e kërcënimit në tokë dhe det”. Zëdhënësi Houthi u shfaq në televizionin Al-Jazeera, duke njoftuar një “përgjigje të fortë dhe efektive” dhe duke sugjeruar zgjerimin e qëllimeve të grupit për të synuar “të gjitha interesat e SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe”. Të dielën, amerikanët rrëzuan një raketë të lëshuar drejt destroyerit të tyre. Në kryeqytetin e Jemenit, Sanaa, i cili kontrollohet nga Houthi-t, u zhvillua një demonstratë me mijëra njerëz në mbështetje të autoriteteve dhe me slogane armiqësore ndaj SHBA-ve dhe Izraelit. Mediat dhe komentatorët vendas i paraqesin sulmet perëndimore si një degëzim të luftës së Izraelit me Hamasin, në të cilën grupi dominues në Jemen është në anën e palestinezëve.

- Parashikimet janë se do të ketë presion të shtuar për ndërmjetësimin me Houthi-t.

Vendet që mbështeten në Kanalin e Suezit, duke përfshirë SHBA-në, vendet e BE-së dhe vendet arabe, që nga mesi i dhjetorit janë përfshirë në bisedime me përfaqësuesit Houthi në Oman. Kina gjithashtu ka të ngjarë të përfshihet në këto diskutime. Abdel Salam, zëdhënësi i lëvizjes, ka theksuar se motivi kryesor i sulmeve në Bab al-Mandab është ndalimi i agresionit të Izraelit kundër Gazës. Megjithatë, ai shtoi se, nëse palestinezët marrin ndihmë humanitare, Houthi-t mund të konsiderojnë “reduktimin e përshkallëzimit” në zonat detare nën kontrollin e tyre. Njëpërmjet sulmeve dhe de-përshkallëzimit të tyre, Houthi-t synojnë të rrisin rëndësinë e tyre rajonale dhe të pengojnë sulmet e koalicionit të udhëhequr nga Arabia Saudite nga ana e Jemenit që ata aktualisht e kanë nën pushtim.

- Inflacioni parashikohet të ngadalësohet gradualisht.

Sulmet në Detin e Kuq do të bëjnë që kostot e transportit të mallrave të rriten përsëri. Anijet e ngarkesave pritet të zgjedhin një rrugë shumë më të gjatë rreth Afrikës, duke çuar në rritje të shpenzimeve. Kostot e sigurimit për mallrat që lundrojnë nëpër ujërat e kërcënuara gjithashtu do të rriten. Presioni mbi çmimet e naftës pritet të rritet. Kjo, së bashku me ngrirjen e parave të gatshme të lidhura në investues të mëdhenj, shpenzimet që lidhen me magazinimin dhe kërkimin e furnizuesve të rinj, shpesh në vendet me kosto më të larta prodhimi, do të intensifikojnë presionet e kostos. Si rezultat, çmimet e prodhimit, të cilat kanë qenë në rënie muajt e fundit, tani mund të fillojnë të rriten. Kjo përkon me një periudhë të rimëkëmbjes së konsumit, e karakterizuar nga përmirësimi i gjendjes dhe një rritje e pagave reale në SHBA dhe Evropë, përfshirë Poloninë. Kjo, nga ana tjetër, mund t'i fuqizojë prodhuesit për t'i transferuar këto kosto të rritura te klientët. Për rrjedhojë, arritja e objektivave të inflacionit në këto

ekonomi mund të shtyhet.

- Kompanitë po përgatiten për të rimbushur magazinat dhe mundësimin e gjenerimit të furnizimeve kritike. Periudha 2020-2021 dëshmoi ndërprerje të konsiderueshme në zinxhirët e furnizimit global, kryesisht që i atribuohen politikës zero të Kinës për Covid-19. Kjo shkaktoi një ndryshim në strategjitë e inventarit të kompanive, duke i shtyrë ato të blinin sasi më të mëdha materialesh dhe produktesh gjysmë të gatshme sa më shpejt që të ishte e mundur. Kishte një rritje të kërkesës për hapësirat e magazinave dhe bizneset kërkuan burime furnizimi në afërsi të impianteve të prodhimit dhe tregjeve të synuara. Gjatë vitit të kaluar, situata është normalizuar gradualisht. Kompanitë kanë zvogëluar inventarët, kanë likuiduar mallrat ekzistuese dhe kanë reduktuar porosinë e reja. Megjithatë, situata në Detin e Kuq tregon se importimi i mallrave nëpërmjet kësaj rruge është i rrezikshëm dhe lundrueshmëria e tij varet nga faktorë të paparashikueshëm që mund të vonojnë transportin nga Azia. Ky zhvillim ka të ngjarë të nxisë kompanitë edhe një herë që të rishqyrtojnë dhe rindërtojnë inventarët e tyre.

Përfundime

- Lëvizja Houthi pritet të vazhdojë sulmet në Detin e Kuq derisa luftimet më të dhunshme në Gaza të marrin fund. Duke përfituar nga konflikti midis Izraelit dhe Hamasit, Houthi-t synojnë të forcojnë pozicionin e tyre në Jemen dhe të fitojnë njohjen si një aktor i rëndësishëm rajonal. Negociatat në Oman janë në fazat e tyre të hershme, gjë që i ofron Houthi-t një mundësi për të zhvilluar një fushatë detare ose për të kryer sulme raketore kundër anijeve civile brenda rrezes së dronëve dhe raketave të tyre. Ata ka të ngjarë të bllokojnë pothuajse plotësisht trafikun detar në portin izraelit të Eilat për disa muaj. Egjipti, i cili vendos tarifa për kalimin transit në Kanalin e Suezit, natyrshëm që do të vuajë pasojat.
- Veprimet ushtarake nga vendet perëndimore kundër Houthi-t nënkuptojnë një përshkallëzim të konfliktit në Lindjen e Mesme, i cili konsiderohet i nevojshëm për të mbrojtur një rrugë kritike tregtare pavarësisht rreziqeve të qenësishme. Ndërsa strategjia ushtarake fillimisht mund të përfshijë sulme precize në objektiva të zgjedhura, bombardimet e vazhdueshme për një periudhë të zgjatur janë thelbësore për efektivitetin. Mundësia e përshkallëzimit ose hakmarrjes nga Houthi-t ose grupe të tjera të mbështetura nga Irani nuk mund të hidhet poshtë. Veprime të tilla mund të synojnë potencialisht bazat ushtarake perëndimore ose izraelite, postet diplomatike, bizneset dhe qytetarët, si brenda Lindjes së Mesme dhe më gjerë.
- Strategjia e veprimit të kufizuar ushtarak nga Perëndimi rrezikon të shterojë burimet e tij ushtarake pa ndonjë garanci për eliminimin e aftësive

sulmuese të Houthi-t. Veprime të tilla nga Perëndimi mund të rrisin kërcënimin e sulmeve hakmarrëse të Houthi-t dhe të shtojnë pakënaqësinë e partnerëve të tyre arabë. Një situatë e tillë mund të rezultojë e dëmshme për koalicionin perëndimor në aspektin strategjik dhe operacional. Ndërsa në Jemen nevojiten veprime më intensive ushtarake, destabilizimi politik do të jetë më i vështirë për t'u menaxhuar.

- Një mundësi e mirë për stabilizimin e situatës në Detin e Kuq mund të jetë organizimi i një misioni për sigurinë në det, i drejtuar nga NATO me pjesëmarrje edhe të partnerëve të saj. Në lidhje me këtë mundësi, përvoja e Aleancës Euroatlantike nuk ka munguar. Konkretisht, një operacion i tillë është zhvilluar në Mesdhe në periudhën 2001-2016, i cilësuar Operacioni kundër terrorizmit “Active Endeavor”(OAE). Në korrik 2016, në Samitin e Varshavës, NATO njoftoi transformimin e misionit në një operacion më të gjerë të sigurisë detare në Mesdhe, i cili mori emrin Operacioni “Sea Guardian” (OSG)¹⁵. Ai është një operacion i sigurisë detare që nuk lidhet me Nenin 5, i cili synon të punojë me palët e interesuara mesdhetare për të ruajtur ndërgjegjësimin e situatës detare, për të penguar dhe luftuar terrorizmin dhe për të përmirësuar ndërtimin e kapaciteteve. Disa nga detyrat përfshijnë: mbështetjen e ndërgjegjësimit të situatës detare, ruajtjen e lirisë së lundrimit, kryerjen e detyrave të ndalimit, kundër terrorizmit detar, kontributin në ndërtimin e kapaciteteve, kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. NATO u kërkon forcave nga vendet aleate që të mbështesin këtë operacion në mënyra të ndryshme përmes mbështetjes aktive dhe gatishmërisë. Kështu, numri mbështetës i anijeve, avionëve, personelit dhe qendrave të operacioneve aleate ndryshojnë gjatë gjithë drejtimit të këtij operacioni.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Brian Carter, Ashka Jhaveri, Nicholas Carl, Johanna Moore, Peter Mills, Amin Soltani, Alexandra Braverman and Kathryn Tyson - Institute of the Study of the War/ ISW), Street NW, Suite 515 Washington, DC 20036.
2. Giulio Coppi, International Peace Institute Report Part Title: Assessing the Security and Humanitarian Situation Report Title: The Humanitarian Crisis in Yemen: Report Subtitle: Beyond the Man-Made Disaster Report.
3. Idrees Ali, Phil Stewart and Mohammed Ghobari, Yemen's Houthis vow strong response after new US strike. <https://www.reuters.com/world/middle-east/biden-warns-more-strikes-yemens-houthis-if-red-sea-attacks-persist-2024-01-13/>

¹⁵ Burimi elektronik: <https://shape.nato.int/ongoingoperations/operation-sea-guardian-osg->

4. Michael Horton, Houthis now drawing support from former enemies in Yemen. <https://responsiblestatecraft.org/houthis-support-middle-east-yemen/>
5. Seth J. Frantzman, US, Allies' strikes on Houthis show West means business in Red Sea, analysis, https://www.jpost.com/middle-east/article-783330#google_vignette
6. Patrick Wintour - US carries out fifth strike against Houthis as Biden admits bombing isn't stopping attacks.
7. Trevor Johnston, Matthew Lane, Abigail Casey, Heather J. Williams, Ashley L. Rhoades, James Sladden, Nathan Vest, Jordan R. Reimer, Ryan Haberman, Could the Houthis Be the Next Hizballah? Iranian Proxy Development in Yemen and the Future of the Houthi Movement.
8. <https://www.theguardian.com/world/2024/jan/18/defiant-houthi-leader-mocks-biden-and-calls-for-boycott-of-israeli-goods-yemen>
9. <https://www.mei.edu/publications/houthis-war-and-yemens-future>
10. Bearing the Brunt of War in Yemen: International Law Violations and their Impact on the Civilian Population A Briefing Paper. <https://www.icj.org/wp-content/uploads/2018/09/Yemen-War-impact-on-populations-Advocacy-Analysis-Brief-2018-ENG.pdf>
11. Dario Sabaghi, What do Houthi attacks in the Red Sea mean for global trade? <https://www.newarab.com/analysis/what-do-houthi-attacks-red-sea-mean-global-trade>
12. Dr. Moosa Elayah Radboud, Dr. Lau Schulpen Radboud, Dr. Bilqis Abu-Osba, Dr. Bakeel Al-Zandani, Yemen: a Forgotten War and an Unforgettable Country
13. Cameron Glenn from the U.S. Institute of Peace, the primary author of this article "Who are Yemen's Houthis?", originally published it in 2015.
14. Garrett Nada and Mattisan Rowan, the U.S. Institute of Peace, "Who are Yemen's Houthis?", 2022.
15. Polityka Insight, Słupecka 602-309, Warszawa.
16. The Economist, december 2023.
17. ANSA English, january 2024
18. CNN, january 2024
19. Polish Radio24, january 2024.

20. Congress and the War in Yemen: Oversight and Legislation 2015-2021, Updated February 10, 2022. <https://crsreports.congress.gov/product/pdf/R/R45046>
21. https://www.kpsrl.org/sites/default/files/201803/1028_yemen_a_forgotten_war_and_an_unforgettable_country.pdf
22. <https://ctc.westpoint.edu/wp-content/uploads/2022/10/CTC-SENTINEL-102022.pdf/>
23. https://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/research_reports/RR2500/RR2551/RAND_RR2551.pdf/

Për një Ukrainë, ose alarmi global i luftërave hibride të Putinit

Kolonel Msc. Arben Dhuli

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar. *Fillimi i shekullit të 21-të solli një paradigmë të re sigurie. Qasja e vjetër e shekullit të 20-të u tregua më shumë se kurrë e vjetruar. Për këtë arsye, nevojitej një ndryshim për të mbajtur ritmin me realitetin dhe ideologjinë e re. Rusia, si epoka luftarake e “mposhtur” e Luftës së Ftohtë, kishte nevojë të rishfaqte fuqitë e saj dhe të rifitonte ndikimin në botë, sidomos në pjesën më të madhe rreth kufijve të saj.*

Qëllimi i këtij punimi është që, nëpërmjet fakteve, analizës, argumenteve, të vërtetojë rizgjimin e Ruisë, e cila kërkon të ndryshojë qasjen e saj moderne luftarake duke zhvilluar teori të reja, por rezultati i kësaj lufte hibride qëndron ende si një provë e gjallë në Ukrainë/Krime, Gjeorgji/Osetinë e Veriut dhe Moldavi/Transnistri.

Bazuar në fakte historike të paraqitura në këtë punim, jam përpjekur të tregoj demonstrimin që Rusia po fuqizohet në shumë vende të botës, për të marrë të njëjtin përfitim të paligjshëm, edhe në të ardhmen. Për t’u përafëruar edhe me situatën aktuale pasi ato çfarë janë trajtuar kanë gjetur zbatim në konfliktin pothuajse dyvjeçar, ndërmjet Ruisë dhe Ukrainës, mund të themi se të gjithë faktorët kanë dhënë ndikimin e tyre dhe e kanë përshkallëzuar situatën në dimensione katastrofike.

Me gjithë mbështetjen e NATO-s dhe shteteve më të fuqishme ende shohim vështirësi për të parashikuar fundin e këtij konflikti të kombinuar hibrid dhe konvencional.

Fjalë kyçe: Luftë hibride, grupe terroriste, sulm terrorist, mjete konvencionale dhe jokonvencionale, Wagner, Gerasimov, Ukrainë, Rusi, Deti i Zi

1. Përkufizime dhe koncepte të luftës hibride

Frank Hoffman¹ ka thënë :“Ndryshimi më i dallueshëm në karakterin e luftës moderne është natyra e paqartë ose e përzier e luftimit. Ne nuk përballemi me një numër të madh sfidash të dallueshme, por me konvergencën e tyre në luftëra hibride.” Pra, e cila përdor politikën dhe përzien luftën konvencionale, të parregullt dhe kibernetike, me metoda të tjera ndikuese, siç janë lajmet e rreme, diplomacia, tarifa e ligjit dhe ndërhyrja e huaj në zgjedhje. Lufta hibride mund të përdoret për të përshkruar dinamikën fleksibël dhe komplekse të hapësirës së betejës, që kërkon një përgjigje shumë adaptuese dhe elastike. Nuk ka asnjë përkufizim të pranuar botërisht të luftës hibride. Disa analistë debatojnë nëse termi hibrid është i dobishëm. Për përcaktimin e luftës hibride² thuhet se kjo luftë pushoi së qeni një temë e studiuar vetëm nga strategët ushtarakë dhe hyri në fushën më të gjerë të politikave si një sfidë e rëndësishme e sigurisë. Në vitin 2008, ish-shefi i Shtabit i Ushtrisë Amerikane e përcaktoi kërcënimin hibrid si një kundërshtar që përfshin “kombinime të ndryshme dhe dinamike të aftësive konvencionale, të parregullta, terroriste dhe kriminale.”³ që në të njëjtën kohë përdor një përzierje të përshtatur mjetesh ose aktiviteteve konvencionale, të parregullta, terroriste dhe kriminale në hapësirën operative të betejës. Gjithashtu, NATO përdor “ termi për të përshkruar” kundërshtarët me aftësinë për të përdorur në të njëjtën kohë mjete konvencionale dhe jokonvencionale, në mënyrë të përshtatur në ndjekjen e objektivave të tyre», aktorë, qëllimi i të cilëve është, të minojnë ose të dëmtojnë një objektiv duke kombinuar mjetet ushtarake të hapura dhe të fshehta. Një kundërshtar hibrid përdor kombinimin e metodave konvencionale dhe të parregullta. Metodatat dhe taktikat mund të përfshijnë aftësi konvencionale, taktika dhe formacione të parregullta, diplomaci, akte terroriste, dhunë pa dallim dhe aktivitete kriminale, gjithashtu përdorin veprime klandestine për të shmangur atribuimin ose ndëshkimin. Metodatat përdoren njëkohësisht në të gjithë spektrin e konfliktit me një strategji të unifikuar. Shembuj aktualë janë aspiratat transnacionale të Shtetit Islamik, taktikat e përziera, formacionet e strukturuar dhe përdorimi mizor i terrorizmit si pjesë e arsenalit të tij. Është fleksibël dhe përshtatet shpejt. Për shembull, përgjigjja e Shtetit Islamik ndaj fushatës së bombardimeve ajrore të SHBA-ve, ishte një reduktim i shpejtë i përdorimit të pikave të kontrollit, të kolonave të mëdha dhe të telefonave celularë. Militantët gjithashtu u shpërndanë në mesin e popullatës civile. Dëmi kolateral civil nga sulmet ajrore mund të përdoret si një mjet efektiv rekrutimi. Kjo taktikë është

¹ Frank Hoffman, 2007. *The Rise of Hybrid Wars*

² James K. Wither (2020) *Defining Hybrid Warfare*.

³ Ish-Shefi i Shtabit të Ushtrisë Amerikane George W. Casey Jr. (Shefi i 36-të i Shtabit të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara nga 10 Prill 2007.

vënë re edhe në ditët e sotme në zhvillimet e konfliktit në Gaza ku, militantët e grupit Hamas maskoheshin nëpër spitale dhe përmes popullsisë civile çka sillte edhe pasojën e humbjeve të jetëve të civilëve të pafajshëm. Përdor gjithashtu sisteme të avancuara të armëve dhe teknologji të tjera përçarëse. Armët e tilla tani mund të blihen me çmime të volitshme. Për më tepër, teknologji të tjera të reja po përshtaten në fushën e betejës, siç janë rrjetet celulare. Rritja e rrjeteve të komunikimit masiv ofron mjete të fuqishme propagande dhe rekrutimi. Përdorimi i faqeve të internetit të lajmeve të rreme për të përhapur histori të rreme është një element i mundshëm i luftës hibride.

2. Ushtritë tradicionale përballë luftës hibride

Ushtritë tradicionale e kanë të vështirë t'i përgjigjen luftës hibride. Organizatat e mbrojtjes kolektive si NATO, mund ta kenë të vështirë të bien dakord për burimin e konfliktit, gjë që e bën të vështirë përgjigjen. Një artikull i botuar në *Global Security Review*, “Çfarë është Lufta Hibride?”⁴, krahason nocionin e luftës hibride me konceptin rus të luftës “jolineare”, të cilën e përcakton si vendosjen e “forcave ushtarake konvencionale dhe të parregullta në lidhje me sulme psikologjike, ekonomike, politike dhe kibernetike”.

Artikulli i atribuon pjesërisht vështirësinë taksonomisë ushtarake “të ngurtë” ose statike të përdorur nga NATO për të përcaktuar vetë konceptin e luftës. Një luftë hibride zhvillohet në tre fusha beteje të dallueshme. Ato janë: fusha e betejës konvencionale, popullsia indigjene e zonës së konfliktit dhe komuniteti ndërkombëtar. Në një kërcënim hibrid, fuqia e fortë shpesh është e pamjaftueshme. Konflikti evoluon nën radar, madje edhe një përgjigje “e shpejtë” rezulton të jetë tepër vonë. Kombinimi i metodave konvencionale dhe të parregullta nuk është i ri dhe është përdorur gjatë historisë. Disa shembuj të atij lloji luftimi gjenden në Luftën Revolucionare Amerikane (një kombinim i Ushtrisë Kontinentale të Xhorxh Uashingtonit me forcat e milicisë) dhe Luftërat e Napoleonit (rregulltarët britanikë bashkëpunuan me guerilët spanjollë). Shembuj të luftës hibride në konflikte më të vogla gjatë shekullit të 19-të. Për shembull, ndërmjet viteve 1837 dhe 1840, Rafael Carrera, një udhëheqës rebel fshatar konservator në Guatemalë, zhvilloi një fushatë të suksesshme ushtarake kundër liberalëve dhe qeverisë federale të Amerikës Qendrore duke përdorur një strategji që kombinonte taktikat klasike guerile me operacionet konvencionale. Qasja hibride e Carrera-s ndaj luftës i dha atij avantazhin mbi armiqtë e tij numerikisht superiorë dhe të armatosur më mirë. Pas vitit 1945, Lufta e Vietnamit pa taktika hibride të luftës të përdorura nga të dyja palët, me SHBA-të që përdorën CIA-n për të mbështetur partitë e luftës

⁴ Joshua Stowell. “What is Hybrid Warfare?”. *Global Security Review*. Retrieved 26 July 2018.

civile në Laos dhe Luftën Civile Kamboxhiane, si dhe grupet etnike brenda Vietnamit për kauzën e saj dhe Bashkimi Sovjetik. Pas vitit 1989, përfundimi i Luftës së Ftohtë krijoi një sistem uni polar me një fuqi ushtarake mbizotëruese amerikane. Edhe pse kjo ka zbutur konfliktet tradicionale, konfliktet rajonale dhe kërcënimet që ndikojnë në dobësitë e strukturës ushtarake konvencionale, po bëhen më të shpeshta.

Në kohët e sotme, ISIL në Irak është një aktor joshitetëror që përdor taktika hibride kundër ushtrisë konvencionale irakiane, i cili ka aspirata tranzitore dhe përdor taktikë dhe terrorizëm të parregullt e të rregullt. Si përgjigje, Iraku iu drejtua vetë taktikave hibride duke përdorur aktorë joshitetërorë dhe ndërkombëtarë për të kundërshtuar përparimin e ISIL-it. Shtetet e Bashkuara ishin gjithashtu pjesëmarrëse hibride dhe përdorën një kombinim të fuqisë ajrore tradicionale, këshilltarëve të trupave qeveritare irakiane, peshmerga kurde, milicive sektare; ajo gjithashtu trajnoi forcat opozitare brenda Sirisë. Përdorimi i gjerë i qeverisë ruse në konfliktet, e Luftës Civile Siriane dhe pushtimi rus i Ukrainës, i kontraktorëve ushtarakë privatë si ata të “Grupit Wagner”, u veçua në vitin 2018 nga ekspertet, si një pjesë kyçe e strategjisë ruse të luftës hibride, për të çuar përpara interesat e saj. Në mënyrë të veçantë, Rusia përdori një kombinim të luftës tradicionale luftarake, për ndikimin ekonomik, strategjive kibernetike dhe sulmeve të dezinformimit kundër Ukrainës. Në lidhje me Rusinë, Jānis Bērziņš, drejtori i Qendrës për Siguri dhe Kërkime Strategjike, ka botuar gjerësisht për të argumentuar se përdorimi i termit “hibrid” për të karakterizuar strategjinë ruse është mashtrues pasi Rusia ka përkufizimet dhe konceptet e veta: “fjala ‘hibrid’ është tërheqëse pasi mund të përfaqësojë një përzierje të çdo gjëje. Megjithatë, kuadri i tij bazë ndryshon nga ai i zhvilluar nga rusët për shkak se i pari është një koncept ushtarak dhe rezultat i mendimit ushtarak amerikan. Për më tepër, koncepti i Gjeneratës së Re “Warfare” përfshin operacione konvencionale. Moska ka akuzuar Uashingtonin për kryerjen e një lufte hibride kundër Ruisë gjatë (colour revolutions) revolucionit me ngjyra ose portokalli. Perceptimi i saj për të qenë në luftë ose në një gjendje të përhershme konflikti me SHBA-në dhe aleatët e saj u rrit më tej nga kryengritja e Maidanit të vitit 2014 në Ukrainë. Aktivitetet e Ruisë në ish-shtetet sovjetike, janë përshkruar si të neveritshme të menduarit të Luftës së Ftohtë. Gjenerali Philip Breedlove, në një seancë dëgjimore në Senatin amerikan në shkurt 2016, pretendoi se Rusia po përdor refugjatët për të dobësuar Evropën dhe po drejton fluksin e refugjatëve për të destabilizuar zonat dhe rajonet në aspektin ekonomik dhe për të krijuar trazira sociale.

Më 10 shkurt 2016, ministri finlandez i Mbrojtjes Jussi Niinistö në një takim të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s tha se “Finlanda pret që Rusia të hapë një front të dytë, me rreth 1 milion emigrantë që mund të mbërrijnë mbi

kufirin finlandez-rus”. Është një term interesant, por do ta zbatojta mbi të gjitha për Shtetet e Bashkuara dhe strategjinë e saj të luftës është me të vërtetë një hibrid, lufta nuk synonte aq shumë për të mposhtur armikun ushtarakisht, por për të ndryshuar regjimet në shtetet që ndjekin një politikë që Uashingtonit nuk i pëlqen. Është duke përdorur presionin financiar dhe ekonomik, sulmet e informacionit, përdorimin e të tjerëve në perimetrin e një shteti përkatës si prokurë dhe natyrisht presionin e informacionit dhe ideologjitë nëpërmjet organizatave joqeveritare të financuara nga jashtë. A nuk është një proces hibrid dhe jo ajo që ne e quajmë luftë?”⁵

3. Ukraina, ose alarmi global i luftërave hibride të Putinit

Si pjesë e agresionit të saj hibrid, Rusia ka sulmuar vazhdimisht hapësirën digjitale të Ukrainës. Ajo është bërë vendi i parë që ra viktimë e sulmit të suksesshëm në sistemin e saj energjetik. Në dhjetor 2015, keqberësi rus, arriti të hakeronte sistemet kompjuterike që kontrollonin tre furnizues ukrainas të energjisë. Rreth 30 nënstacione të energjisë elektrike janë mbyllur, rreth 230 mijë persona kanë mbetur pa energji elektrike për 1 deri në 6 orë. Sulmi i radhës dhe më pak i gjerë kibernetik ndodhi natën nga 17 deri më 18 dhjetor 2016. Për më shumë se një orë, nënstacioni “Pinvnichna” dhe qytetarët e bregut të djathtë të Kievit, si dhe zonat fqinje të rajonit kanë mbetur pa energji elektrike. Në qershor 2017, hakerët ushtarakë rusë nisën një sulm kundër Ukrainës me qëllim të prishjes së sistemit financiar të vendit. Virus i quajtur “NotPetya” ka shkatërruar të dhënat kompjuterike në banka, kompani energjetike, institucione shtetërore, zyrtarë të lartë dhe në aeroport. Pas kësaj, virusi ishte përhapur në të gjithë botën dhe është bërë sulmi kibernetikës më i kushtueshëm dhe më përçarës në histori, ka shkaktuar humbje miliarda dollarë në Evropë, Azi dhe Amerikë. Ukraina, SHBA, Britania e Madhe dhe Australia akuzuan zyrtarisht Rusinë për kryerjen e sulmit duke përdorur virusin “NotPetya”. “Ishte pjesë e përpjekjeve të rregullta të Kremlinit për të destabilizuar Ukrainën, të cilat theksojnë përfshirjen e Rosisë në konflikt”⁶.

Ndërsa detajet filluan të dalin në fund të vitit 2020 për sulmin masiv kibernetik të Rosisë ndaj Shteteve të Bashkuara, pati shumë zemërim dhe alarm, por pak në rrugën e tronditjes së vërtetë. Në vend të kësaj, një atmosferë e pashmangshme shoqëroi lajmin e sulmit. Kjo përgjigje disi e refuzuar ilustron se sa është mësuar bota perëndimore me realitetin e një Rusie armiqësore. Nuk ishte gjithmonë kështu. Pak më shumë se tetë vjet më parë,⁷ ndihej mjaft

⁵ Ministri i Jashtëm rus Sergey Lavrov, tha në Klubin e Diskutimit Valdai në nëntor 2014,

⁶ Fjala e ish-ministrit finlandez i Mbrojtjes, Jussi Niinistö, në takimin e ministrave të Mbrojtjes të NATO-s më 10 shkurt 2016

⁷ Deklaratë e presidentit të SHBA-ve, Barack Obama, tetor 2012.

rehat me Rusinë për të tallur rivalin e tij presidencial, Mitt Romney, sepse e quajti vendin armikun numër një gjeopolitik të Amerikës. “Vitet 1980 tani po thërrasin për të kërkuar kthimin e politikës së tyre të jashtme, sepse, e dini, Lufta e Ftohtë ka mbaruar për 20 vjet,” tha Obama në atë kohë. Si kaluam nga një linjë presidenciale në një Luftë të re të Ftohtë në më pak se një dekadë? Ndërsa ngjarje të tilla si lufta e shkurtër e Moskës me Gjeorgjinë e vitit 2008 kishin tensionuar më parë marrëdhëniet, pika e vërtetë e kthesës erdhi në shkurt 2014 kur Rusia pushtoi gadishullin e Krimesë të Ukrainës. Kjo ishte një pikë kthese në historinë e shekullit të njëzet e një, që shënoi agimin e një epoke të re dhe shqetësuese të konkurrencës ndërmjet Ruisë dhe Perëndimit. Që kur “burrat e vegjël të gjelbër” të Putinit (ushtarët rusë pa shenja) pushtuan për herë të parë Krimenë shtatë vjet më parë, konfrontimi ka vazhduar të zgjerohet dhe të përshkallëzohet.

Gjatë kësaj periudhe, agresioni rus ka marrë forma të ndryshme. Shembulli më i spikatur mbetet lufta e padeklaruar dhe e vazhdueshme në Ukrainën lindore, e cila ka kushtuar mbi 14,000 jetë dhe ka zhvendosur miliona. Putini gjithashtu ka vendosur forca hibride ruse në mbarë botën, ka lëshuar ekipe vrasësish dhe ka tentuar të paktën një grusht shteti në Ballkan. Hakerët rusë kanë vendosur standarde të reja në luftën kibernetike, duke synuar gjithçka, nga partitë politike deri tek infrastruktura thelbësore. Ndërkohë, Moska u ka dhënë mbështetje ekstremistëve politikë dhe lëvizjeve separatiste në të gjithë BE-në dhe më gjerë, e ndihmuar dhe nxitur në çdo hap nga një makineri e madhe dezinformuese e mbështetur nga Kremli, e cila ka arritur të ndoti plotësisht internetin.

Qëllimi i gjithë kësaj nuk është të mposhtet Perëndimi, të cilin Rusia e njeh si të pamundur. Në vend të kësaj, Moska kërkon të sigurojë pozicionin e saj duke minuar joshjen e traditave liberale dhe institucioneve demokratike që lejojnë botën perëndimore të dominojë imagjinatën globale. Në pamundësi për të konkuruar në një garë të fuqisë së butë për zemrat dhe mendjet, Moska ka vendosur të zbresë opozitën poshtë në nivelin e saj. Kjo shpjegon pse Rusia mbështet forcat anti-establishment të të gjitha llojeve në të gjithë Perëndimin, pavarësisht nëse ato përfaqësojnë ekstremin e majtë apo të djathtë të spektrit politik. Çdo gjë që thëllon ndarjet ekzistuese brenda shoqërive perëndimore shihet si në interes të Ruisë, nga teoritë e konspiracionit COVID deri te lajmet e rreme për mizoritë e emigrantëve.

Zyrtarisht, Moska i njeh rajonet separatiste të Ukrainës lindore si territor ukrainas dhe është e angazhuar për riintegrimin e tyre në Ukrainë. Në praktikë, Kremli ka ndërmarrë hapa të konsiderueshëm për t'i bërë të kota çdo përpjekje riintegrimi në të ardhmen. Që nga pranvera e vitit 2014, popullsia vendase është përballur me një breshëri të pamëshirshme të propagandës ruse

që lavdëron Kremlinin dhe demonizon Ukrainën. Duke filluar nga pranvera e vitit 2019, Moska ka filluar shpërndarjen e shpejtë të pasaportave ruse për banorët e rajoneve të pushtuara. Kjo strategji e armatosur e shtetësisë po e transformon Ukrainën Lindore të pushtuar në një protektorat pasaportash dhe po i hap rrugën ndërhyrjes së hapur ruse. Edhe nëse Ukraina do të ishte në gjendje të rimarrë kontrollin nominal mbi rajonin, numri i madh i mbajtësve të pasaportave ruse do t'i siguronte Moskës justifikime të pafundme për të ndërhyrë dhe për t'i mohuar Ukrainës sovranitetin e plotë.

Komentet e fundit të Putinit e bëjnë të qartë se qëllimi i tij është të vazhdojë të ndjekë politika të tilla gjatë vitit 2021. Rusia ka një histori të provuar të përditësimit të shpejtë të pajisjeve dhe doktrinës bazuar në përvojën e saj ushtarake në Detin e Zi dhe rajonet ngjitur. Në vitin 2008, pavarësisht se siguroi objektivat e saj strategjike në luftën e saj me Gjeorgjinë, udhëheqja ruse iu përgjigj dështimeve taktike dhe operacionale me ndryshime të mëdha. Mësimet nga Gjeorgjia çuan në një strukturë force më të dobët dhe të orientuar nga brigada; një sistem komandimi rajonal i rinovuar; dhe një fokus i shtuar në goditje me precizion dhe armë të modernizuara që të gjitha u ekspozuan kur Rusia filloi operacionet në Ukrainë në 2014. Mënyra e luftës e Rusisë ka ndryshuar në mënyrë dramatike që nga viti 2008. Ushtria ruse ka të ngjarë të bëjë disa reforma të tjera bazuar në operacionet e saj në Siri që nga viti 2015. Atje, Rusia u mundësoi forca të saj ekspeditare në një pjesë të madhe aksesin detar nëpërmjet Detit të Zi dhe ato mbështeteshin më shumë në fuqinë ajrore sesa në çdo operacion të mëparshëm rus. Ukraina dhe shtetet e tjera të Detit të Zi mund të mbledhin detaje nga operacionet në Lindjen e Mesme dhe ngritja e prillit 2021 për të projektuar «Vështrimin e Ri» “New Look” të ardhshëm të Rusisë. Këto veprime të fundit ofrojnë mjaft prova për një forcë të ardhshme ruse që do të përfshijë një fokus më të madh në informacion, automjete pa pilot dhe fuqi ajrore, të cilat duhet të informojnë planifikimin ushtarak të Detit të Zi.

4. Plani, instrumentet, format dhe armët hibride ruse në Detin e Zi

Rusia ka një histori të provuar të përditësimit të shpejtë të pajisjeve dhe doktrinës bazuar në përvojën e saj ushtarake në Detin e Zi dhe rajonet ngjitur. Në vitin 2008, pavarësisht se siguroi objektivat e saj strategjike në luftën e saj me Gjeorgjinë, udhëheqja ruse ju përgjigj dështimeve taktike dhe operacionale me ndryshime të mëdha. Këto veprime të fundit ofrojnë mjaft prova për një forcë të ardhshme ruse që do të përfshijë një fokus më të madh në informacion, automjete pa pilot dhe fuqi ajrore, të cilat duhet të informojnë planifikimin ushtarak të Detit të Zi. Siç është përshkruar në një raport të fundit nga Instituti për Studimin e Luftës “Mbulimi i Krizave të Ukrainës”, Rusia e sheh operacionin e saj sirian si një përvojë të madhe mësimore me disa pengesa kryesore.

Së pari, udhëheqja ruse e sheh informacionin si një fushë të rëndësishme të theksit për të ardhmen e afërt. Ata shpresojnë të fitojnë një avantazh nëpërmjet monitorimit të saktë të fushëbetejës dhe shpërndarjes së komunikimeve në nivelin e njësisë, duke tejkaluar kështu kundërshtarët si në shpejtësinë ashtu edhe në cilësinë e vendimmarrjes. Vëzhguesit kanë vërejtur se rezultatet nga ky mësim ishin tashmë të dukshme në stërvitjet Kavkaz 2020, në të cilat forcat ruse demonstruan komunikime ndër-shërbimesh dhe ndërpushe në një operacion kompleks. Një mësim i dytë vjen nga përvoja ruse me automatet pa pilot ose dronët. Oficerët rusë ende i shohin dronët si një mundësi për betejën e informacionit, siç tregohet nga plani i tyre për të zëvendësuar skuadriljet Su-24MR me dronët e vëzhgimit dhe zbulimit Altius. Me gjasë duke parë suksesin taktik të dronëve azerbajxhanas (veçanërisht atyre që shkatërruan mbrojtjen ajrore të prodhuar nga Rusia) në konfliktin e Nagorno-Karabakut, Rusia gjithashtu po zgjeron me shpejtësi aftësitë e goditjes së flotës së saj të dronëve. Ministria ruse e Mbrojtjes filloi të eksperimentonte me disa koncepte pa pilot, duke përfshirë automjete luftarake urbane, grupe detare anti-nëndetëse dhe grupe ajrore të aktivizuara me AI. Njoftimet e tjera detajojnë sistemet pa pilot që shërbejnë në logistikën e vijës së parë dhe rolet e municioneve / kamikazëve.

Shtetet e Detit të Zi mund të marrin mësimet e tyre si nga armatimet e reja të Rosisë, ashtu edhe nga konfliktet e fundit. Së pari, ndërsa Rusia ka theksuar armët pa pilot, shtetet fqinje duhet të shmangin të mësuarit e tepërt të mësimave të konfliktit të Nagorno-Karabakut. Ukraina bleu kohët e fundit dronët e armatosur Bayraktar TB2 nga Turqia pas suksesit të tyre kundër armaturës armene dhe sistemeve më të vjetra kundërajrore në Nagorno-Karabakh. Megjithatë, zhurma rreth TB2 mund të jetë e gabuar. Këta dronë pësuan shkallën më të lartë të dëmtimit në Siri, kur u përballën me mbrojtje ajrore që zbehte në krahasim me sistemet që ka Rusia. Disa hapa të fundit në këto fusha tregojnë se shtetet e Detit të Zi janë në rrugën e duhur. Në vitin 2021, Rumania bleu raketën Detare Strike nga Norvegjia dhe pajisje komanduese plotësuere nga forcat ukrainase të SHBA-së mund të dëshirojnë të ndjekin shembullin, por vetëm kjo blerje paraqet një kërcënim real për anijet ruse që operojnë nga Sevastopol. Për të ndërprerë fuqinë ajrore ruse, Ukraina dhe Gjeorgjia mund të duan gjithashtu të ndjekin Rumaninë në blerjen e platformave moderne të mbrojtjes ajrore si raketat Patriot, megjithatë, një strategji më e zgjuar mund të përfshijë blerjen e raketave më të vogla, më pak të kushtueshme, të lëshuara nga mbajtës me rreze të mesme, të cilat Rusia i kishte identifikuar si një kërcënim në Siri. Pilotët rusë nuk janë përballur me forca kompetente që i shënjestrojnë ata me sisteme të mbrojtjes ajrore të lëvizshme nga njeriu ose mbrojtje të tjera ajrore për një kohë të gjatë. Për sistemet kundër dronve, mund të jetë e preferuese të shihet se çfarë prodhon industria e mbrojtjes amerikane

në dy vitet e ardhshme, një sistem me kosto të ulët dhe lehtësisht të shpërndarë do ti përshtatej (faturave) bëhet fjalë për blerjen.

Fqinjët e Rosisë në Detin e Zi janë nën presion të vazhdueshëm ushtarak dhe politik nga Kremli. Ata po ndërtojnë një strategji parandaluese dhe kanë bërë përparime gjatë viteve të fundit në shtimin e aftësive kryesore. Megjithatë, parandalimi me mohim të plotë është një detyrë e vështirë, madje edhe ndërmjet shteteve me burime të ngjashme në dispozicion; këtu, Rusia do të mbajë një avantazh të madh në shpenzime në krahasim me Ukrainën, Gjeorgjinë ose çdo vend tjetër të Detit të Zi. Fqinjët e Rosisë në Detin e Zi janë nën presion të rëndësishëm dhe politik nga Kremli.

Si një objektiv i luftës hibride të Rosisë, Ukraina është një rast unik studimor. Jo vetëm që ofron të dhëna të vlefshme për analiza dhe mësim të nxjerra, por është gjithashtu një nga viktimat më të cënueshme. Afërsia e tij gjeografike dhe historike me Rusinë, si dhe ambicjet ruse për të marrë kontrollin e Ukrainës si pjesë e trashëgimisë së saj, ka të ngjarë të nënkuptojnë se Kremli ka trajnuar forcën e plotë të makinerisë së tij hibride të luftës në Ukrainë. Duke pas parasysh këtë, qëndrueshmëria që ka treguar Ukraina që nga pavarësia, dhe veçanërisht pas vitit 2014, është e jashtëzakonshme dhe e denjë për analiza të hollësishme. Në veçanti, duhet të merren parasysh sulmet ndaj politikës, ushtrisë, ekonomisë, strukturës sociale dhe hapësirës së informacionit të Ukrainës. Rusia ka përdorur mjete ushtarake konvencionale kundër Ukrainës, por ka shtuar disa kthesa për të frustruar dhe lodhur më tej viktimën e saj. Trupat ruse, të cilët edhe gjatë operacioneve më gjithëpërfshirëse ushtarake kundër Ukrainës në vitet 2014-2015 ishin të veshur me uniforma të gjelbra ushtarake ruse pa shenja dhe shirita, u etiketuan “burra të gjelbër” “green men”. Por nuk kishte asnjë deklaratë zyrtare lufte apo as pranim nga qeveria ruse se kishte dërguar ushtarë në Ukrainë. Presidenti rus Vladimir Putin pranoi se trupat e vendit të tij e kishin pushtuar Krimenë vetëm pas përfundimit të operacionit special. Ndërkohë, udhëheqja ruse nuk e ka pranuar asnjëherë praninë e trupave ruse në Ukrainën lindore, megjithëse provat tregojnë se Rusia ka dërguar armë dhe trupa moderne në luftë. Kremli ka luajtur lojëra fjalësh për të zbardhur shkeljet e tij të së drejtës ndërkombëtare, duke pretenduar, për shembull, se ushtarët rusë “humbën” dhe u gjendën në zonën e luftës. Një herë tjetër, kur anëtarët e forcave speciale ruse u kapën në Ukrainë, Putin pohoi se Rusia “asnjëherë nuk ka thënë se nuk ka pasur njerëz që janë të angazhuar në zgjidhjen e çështjeve të caktuara, duke përfshirë edhe sferën ushtarake”. Për sa i përket pranisë së armëve të tyre në territoret e okupuara të Ukrainës, zyrtarët rusë kanë thënë se ndoshta luftëtarët i kishin marrë ato nga ushtria ukrainase ose i kishin marrë disi ato vetë. Në një shembull tjetër hibriditeti, mercenarë nga i ashtuquajti “Grupi Wagner” një formacion

paraushtarak rus që ka luftuar në konflikte globale, duke përfshirë në Siri dhe ndoshta në Sudan dhe Republikën e Afrikës Qendrore, janë shfaqur në Ukrainë. Po aq energjikisht, dhe pavarësisht nga hetimi ndërkombëtar, Rusia mohon që trupat e saj rrëzuan një avion pasagjerësh të linjës ajrore “Malaysia Airlines” mbi Ukrainë në korrik 2014. Një nga argumentet e Rosisë është se Ukraina ishte e detyruar të mbyllte hapësirën ajrore në zonën e luftës. Rusia ka bllokuar gjithashtu përpjekjet për të ngritur një gjykatë ndërkombëtare dhe ka injoruar kërkesat e mëdha nga hetuesit në Holandë (Hagë), duke minuar dhe ngadalësuar hetimin. Rusia po përpiqet të transferojë përgjegjësinë nga vetja në Ukrainë, edhe kur provat vërtetojnë pa mëdyshje fajin e Rosisë.

Qëllimi kryesor i operacioneve ushtarake të Rosisë në këtë fazë është të mbajë ukrainasit të demoralizuar dhe të stresuar nga kërcënimi gjithnjë i pranishëm i agresionit të shtuar. Duke e mbajtur luftën në zierje të vazhdueshme, Rusia ushqen zhgënjimin dhe pakënaqësinë që shpreson që ukrainasit do t'i drejtojnë gradualisht politikanët e tyre. Ai zemërim krijon dyshime se, për shembull, politikanët ukrainas nuk janë të interesuar për t'i dhënë fund luftës, ndoshta përfitojnë prej saj, ose po e përdorin atë për të antagonizuar votuesit pro-rusë. Në këtë mënyrë, konflikti i zgjatuar mbjell kaos në politikën e Ukrainës dhe u jep një shtysë lëvizjeve që dukeshin ose marginale apo edhe armiqësore ndaj Ukrainës pesë vjet më parë. Instrumentet politike janë armët më të rëndësishme në arsenalin e luftës hibride. Përdorimi më i dukshëm i tyre nga Rusia në Ukrainë është mbështetja e saj për liderët e partisë Platforma Opozitare. Bllokada ekonomike si instrument i luftës hibride. Ukraina pësoi goditje ekonomike në disa fronte, duke përfshirë industrinë e humbura në Krime dhe në lindje, kostot e drejtpërdrejta të luftës, humbja e tregtisë me Rusinë dhe masat ndëshkuese të vendosura nga Rusia nga ndalimet e importit deri tek sanksionet ekonomike kundër individëve. Si rezultat, pas vitit 2014 tregtia ndërmjet Rosisë dhe Ukrainës ra me 75% dhe, sipas ekonomistëve ukrainas, ka rënë përsëri në nivelin e fillimit të viteve 2000. Të gjitha këto probleme ndihmuan në tkurrjen e ekonomisë së Ukrainës, me PBB-në që ra nga 183 miliardë dollarë në vitin 2013 në 91 miliardë dollarë në vitin 2015, duke arritur në 153 miliardë dollarë në vitin 2019. Në Ukrainë, lufta informative në mediat tradicionale zhvillohet më pak nëpërmjet rrjeteve ruse, të cilat arrijnë vetëm 9% të popullsisë. Qëllimi i strategjisë së informacionit të Rosisë nuk është aq shumë t'i bëjë ukrainasit të shikojnë me dashamirësi ndaj Rosisë, se sa të mbjellin mosbesim dhe destabilitet brenda vendit, të delegitimojnë qeverinë dhe të ngrenë pyka ndërmjet njerëzve dhe autoriteteve, dhe ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri dhe politikë. Një efekt i luftës së saj hibride në Ukrainë ka qenë krijimi i mbështetjes së brendshme për anëtarësimin e Ukrainës në Bashkimin Evropian (BE) dhe NATO. Për të analizuar evolucionin e luftës hibride të Rosisë, është e rëndësishme të merret në konsideratë periudha

përgatitore, përpara përdorimit të forcës ushtarake kundër Ukrainës, sepse ajo i lejoi Kremlinit të testonte fillimisht disa metoda të shtrëngimit. Kështu, Moska ishte e vetëdijshme për dobësitë e ushtrisë ukrainase dhe shërbimeve të sigurisë, veçanërisht në Krime, ku 90% e anëtarëve të Shërbimit të Sigurisë së Ukrainës (SBU) kaluan në anën ruse pas pushtimit. Rusia gjithashtu kuptoi se si të punonte në sferën e informacionit. Televizioni rus, i cili ishte veçanërisht i popullarizuar në Ukrainën lindore dhe jugore, përhapi histori gjatë protestave të vitit 2014 për një grusht shteti në Kiev nga radikalët e krahut të djathtë që përbënin një kërcënim për qytetarët rusisht folës. Operacioni i Tuzlës krijoi precedentin e disa taktikave të operacioneve speciale në kuadrin e një lufte hibride. Për shembull, qeveria ruse u shkëput nga ndërtimi i një dige në Tuzla që kishte nxitur mosmarrëveshjen, duke drejtuar gishtin në vend të kësaj te autoritetet lokale. Pavarësisht notave diplomatike dhe deklaratave të ashpra publike, Rusia heshti. Vetëm pozicioni i koordinuar i Ukrainës e detyroi Rusinë të ndalonte ndërtimin e digës pikërisht në kufirin administrativ të epokës sovjetike. Deklaratat e qeverive perëndimore ka të ngjarë të ndikuan në veprimet e Ruisë, e cila në atë kohë dukej se vlerësonte bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare. Sulmet kibernetike kanë qenë gjithashtu qendrore për luftën hibride ruse. Vetëm në vitin 2018, SBU raportoi rreth 360 sulme kibernetike të njohura kundër Ukrainës, dhe në vitin 2019, numri ju afrua 500. Në prag të zgjedhjeve presidenciale në vitin 2019, Ukraina u përgatit për më shumë sulme kibernetike, veçanërisht kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndërsa zgjedhjet u zhvilluan pa ndërprerje të mëdha, disa zyrtarë ukrainas numëruan deri në një sulm kibernetik çdo 40 minuta kundër disa institucioneve të Ukrainës. Specialistët e NATO-s trajnuan partnerët e tyre ukrainas për t'iu kundërvënë sulmeve kibernetike përpara zgjedhjeve lokale të vendit në vitin 2020. Falsifikimet dhe dezinformata janë bërë gjithashtu pjesë përbërëse e luftës hibride të Ruisë.

5. Analiza dhe konsiderata mbi doktrinën ruse si një model të ri lufte në rajonin e Detit të Zi

Synimi i Ruisë për të ruajtur pozicionin e saj dhe për t'u rikthyer si një lojtar kryesor, ushtarak dhe ekonomik është vlerësuar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Ruse Gjenerali Valeri Gerasimov. Ky është një plan i supozuar për të kombinuar operacionet psikologjike me operacionet politike, me qëllim për të destabilizuar Perëndimin. Ose ndoshta janë vetëm operacione të fshehta dhe dezinformata. Apo ndoshta qëllimi është të shkatërrohet e gjithë arkitektura e rendit global. Vetë konfuzioni rreth asaj se çfarë saktësisht përfshin kjo “doktrinë” tradhton pikën themelore: ajo nuk ekziston, besohet se është organizatori pas konceptit të kombinimit të taktikave ushtarake, teknologjike, informacioni, diplomatike, ekonomike, kulturore dhe

të tjera për qëllimi i arritjes së qëllimeve strategjike të njohura si “Doktrina Gerasimov”. Në vend të kësaj, kur Gerasimov foli për një “mjegullim të linjave midis shteteve të luftës dhe paqes” në të cilën “roli i mjeteve joushtarake për arritjen e qëllimeve politike dhe strategjike është rritur dhe, në shumë raste, ka tejkaluar fuqinë e forcës të armëve në efektivitetin e tyre”, gjithashtu trajton në mënyrë eksplicite atë që ai mendonte se ishte një mënyrë e re perëndimore e luftës.

Për rusët, ngritja e Pranverës Arabe dhe Revolucionit me Ngjyra të Eurazisë post-Sovjetike nuk ishin thjesht përgjigje popullore ndaj regjimeve të korruptuara dhe autoritare, por rezultat i fushatave dinake perëndimore-amerikane në destabilizimin e fshehtë. Rënia e Bashkimit Sovjetik, së bashku me dështimin ekonomik, bëri që Rusia të tërhiqej nga pozicioni i një fuqie globale në një fuqi rajonale. Për më tepër, vendet ish-komuniste, së bashku me vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, kaluan drejt modelit të biznesit perëndimor, si brenda ish-blokut sovjetik, ashtu edhe jashtë kësaj sfere ndikimi. Këto fakte dhe mungesa e lidhshimit kanë bërë presion të madh politik mbi politikën e Kremlinit. Fuqia ushtarake u dobësua dhe pothuajse brenda natës u gjetën shumë trupa të stacionuara jashtë kufijve të Rusisë, me forcat ushtarake në postet, portet dhe bazat e tyre ajrore, pas një dekade nga rënia e BRSS, situata është përkeqësuar dhe rreziku për të humbur disa pozicione strategjike u bë një realitet. Një nga këto vende është Gadishulli i Krimesë, me pamjen e tij pranë Detit të Zi nga e cila ushtron kontrollin mbi rrugët e vjetra tregtare. Edhe pse u nënshkrua një marrëveshje ndërmjet Ukrainës dhe Rusisë për marrjen me qira të objekteve ushtarake në Krime, menjëherë pas rënies së BRSS, pati një nivel ankthi në rritje; humbja e hyrjes në Detin e Zi.

Zgjerimi i NATO-s drejt Lindjes ishte shkas që e bëri Rusinë të reagoje dhe të gjente mënyra për të kundërshtuar atë që ata thonë se është rrethimi i Rusisë mëmë dhe kërcënim për vetë ekzistencën dhe interesin e saj. Udhëheqja ushtarake duhej të zhvillonte një doktrinë të re luftarake bazuar në faktin se shekulli i ri i 21-të kërkon diçka më të mprehtë sesa forca brutale e makinës ushtarake ose sulmi bërthamor. Pas Luftës së Ftohtë, politikanët rusë (në realitet, ish-skaloni i dytë i partisë komuniste në krye gjatë perestrojkës së Gorbaçovit dhe KGB-së) duhej të gjenin mënyra për të përballuar dështimin ekonomik, pozicionin e zhytur të ushtrisë dhe ndikimit në botë. Qëndrimi më i dhimbshëm i atyre kohërave konsistonte në humbjen e kontrollit dhe ndikimit mbi ish-vendet sovjetike dhe humbjen e fuqisë së saj ushtarake. Nga ana tjetër, nga ana evropiane, ish-vendet anëtare të Paktit të Varshavës kanë lëvizur drejt integritetit në BE dhe NATO, dhe rreziku i disa ish-anëtarëve të BRSS, si Ukraina dhe disa nga kombet Kaukaziane (p.sh. Gjeorgjia dhe Azerbajxhani) i njëjti besim bëri që Rusia të reagoje dhe të gjente mënyra për ta penguar apo

edhe për ta bërë të pamundur një realitet të tillë. Kështu, që kur presidenti në vend mori pushtetin në Rusi, ringjallja u shfaq në politikën e brendshme e të jashtme, si dhe në bizneset ndërkombëtare dhe veprimet ushtarake. Rezultati i kësaj tani quhet “doktrina e Gerasimov”. Marrëdhënia transatlantike ishte nën presion, fillimisht pasi Barack Obama “u kthye në Azi” (këtu bëhet fjalë për qëllimet strategjike të SHBA-ve) dhe më pas kur Trump prezantoi një transaksionalizëm të ri konfrontues. Sfiduesit nga Pekini në Teheran po vinin në dyshim rendin ndërkombëtar. Edhe themelet e demokracisë perëndimore dhe projekti evropian po viheshin nën presion. Ngjarjet rreth kufijve rusë dhe brenda vendeve ish-sovjetike (duke nxitur frymën nacionaliste mes popullatës së pakicave ruse jashtë atdheut), kanë forcuar pozicionin e saj në tregun e hidrokarbureve, qëndrimin monopol mbi marrësit e naftës të gazit natyror në Evropë, së bashku me luftërat e vogla dhe konfliktet e ngrira në afërsinë e saj, e cila u formësua dhe testoi qasjen e re në lidhje me kërcënimet hibride dhe luftën. U deshën disa vite derisa bota perëndimore dhe NATO reagues ndaj këtij kërcënimi të ri dhe të fshehtë, kryesisht sepse brenda botës perëndimore veprimet e Rusisë nuk perceptohen njësoj si në Evropën Lindore. Doktrina e Gerasimov do të përfshihet në misionin për të mbajtur Krimenë nën dominimin rus si një bastion ushtarak në portat e Detit të Zi dhe Kaukazit. Gazi natyror dhe nafta janë mjete që Rusia përdor për të ndikuar në vendimet politike në BE dhe për të thyer kohezionin brenda NATO-s.

Ukraina, si një ish-shtet anëtar i BRSS dhe historik nën ndikimin e Kremlinit, me një pakicë të madhe ruse brenda kufijve të saj, ishte një objektiv i përsosur për sukses. Të ashtuquajturit “green man” të pidentifikuar u koordinuan dhe udhëhiqeshin saktësisht në veprimet e tyre duke mbajtur terrenin kyç dhe sekuestruan ndërtesat kryesore të qeverisë në zonë. Në mars të vitit 2014, “green man” kapi platformat e shpimit (naftë) ukrainase të kompanisë “Chornomornaftogas” (Deti i zi Oil & Gas), të blera së fundmi, me vlerë më shumë se 800 milionë dollarë. Më vonë, komuniteti i vullnetarëve dhe hetuesve “Infra Napalm” zbuloi prova se këto borde shpuese u kapën nga ushtarët e rregullt të Regjimentit të 104-të të Sulmit Ajror të Divizionit të 76-të të Sulmit Ajror të Forcave të Sulmit Ajror të Federatës Ruse. Federata Ruse po përdor tubacionet e kapura ukrainase për të prodhuar gaz në mënyrë të paligjshme në Odesa, zonë ekskluzive ekonomike të Ukrainës. Anijet ushtarake ruse dhe forcat speciale mbrojnë prodhimin e paligjshëm të burimeve të Ukrainës. Është tregues se kjo fushë gazi ndodhet më afër vijës bregdetare të Ukrainës sesa me Krimenë e pushtuar nga Rusia me 50 kilometra. Që nga fillimi i vitit 2018 Rusia ka prodhuar në mënyrë të paligjshme më shumë se 3.5 miliardë kub metra gaz dhe ka shpuar 11 puse. U bë një propagandë afatgjatë drejtuar popullatës ruse në Krime. Kryengritësit dhe separatistët u mbështetën me armatim, municion dhe inteligjencë nga Kremli për të luftuar kundër

autoriteteve lokale. Institucioni politik ukrainas ishte kontrolluar nga Kremli nëpërmjet oligarkëve vendas. Popullsia vendase në zonat ku etnikët rusë janë të grumbulluar, ndikuar dhe indoktrinuar me lajme të rreme dhe nxitur në trazira civile.

Qasja e kontrolluar e filtruar dhe e kufizuar në burime të tjera informacioni për t'i bërë njerëzit të besojnë atë që media ruse e paraqiste si përpjekje e re e neofashistëve për të marrë përsipër. Ajo që kemi parë është e lehtë të përshkruhet si militarizimi i Krimesë.... Ata kanë sjellë një aftësi ajrore, kanë rritur aftësinë e tyre për të projektuar fuqinë detare prej andej. Ne shohim sisteme shumë të afta të mbrojtjes tokë-ajër që shtrihen në rreth 40 për qind të Detit të Zi dhe kemi parë sisteme shumë të sofistikuara të mbrojtjes raketore që shtrihen pothuajse në të gjithë Detin e Zi... Krimeja është bërë një platformë shumë e madhe e projektimit...". deklaroi Philip Breedlove, gjenerali i Forcave Ajrore të SHBA. Gjithashtu ai shton se "Koncepti i luftës hibride u jep Perëndimit luksin për të zgjedhur nga një sërë veprimesh – një fushatë mediatike këtu, një ndërhyrje kibernetike atje (dhe madje edhe vrasjet e herëpashershme politike) dhe interpretimin e tyre si ngjarje të izoluar të njëpasnjëshme. Nuk ka nevojë të lidhni pikat. Në të vërtetë, shpesh është më e lehtë të shikosh faqen e papërfunduar, duke sugjeruar mundësi që bëhen të qarta vetëm me një përfundim të qëllimshëm të figurës. Taktikat hibride nuk janë një sekuencë e rastësishme improvizimesh, por pasqyrojnë një rend prapa spektrit të mjeteve të përdorura. Kjo e bën detyrën e liderëve politikë dhe mendimtarëve strategjikë që t'i përshtatin aktivitetet e tilla drejtpërsëdrejti brenda objektivave politike të diskutuara nga Carl von Clausewitz, i cili shpjegoi se lufta ishte një shtrirje e politikës me mjete të tjera. Duke menduar për konkurrencën e vazhdueshme me Rusinë, duhet të kemi parasysh se "hibridi" i referohet mjeteve, jo parimeve, qëllimeve ose natyrës së luftës". Nadia Schadow, ish-zëvendëskëshilltare e Sigurisë Kombëtare për Strategjinë në administratën Trump, shkroi një pjesë në "War on the Rocks". Sulmet e para serioze kibernetike ndaj sistemeve të informacionit të kompanive private dhe institucioneve qeveritare u vunë re qysh gjatë ngjarjeve revolucionari "Euro Maydan" në vitin 2013. Në përputhje me faktet e dukshme nga Ukraina dhe disa vende të tjera pranë kufijve rus, vërtetohet edhe një herë se kjo ishte një fushatë e koordinuar, me një dizajn operacionale të përcaktuar qartë për të arritur objektivat strategjikë dhe dominimin ushtarak në zonë, duke ruajtur varësinë ekonomike dhe duke krijuar një zonë tampon ndërmjet botës perëndimore/NATO-s dhe Rusisë. Duke qenë se rrjedha e veprimit është e ngjashme në konfliktet e fundit të mëdha në të cilat përfshihen më pas BRSS dhe Rusia, si dhe nga analizat e faktorëve lidhur me rrethanat dhe situatën politiko-ekonomike, Rusia ka përshtatur doktrinën e saj të luftës dhe ka testuar me sukses atë. Efektet në nivelin strategjik, si dhe pozicioni i ri që shfaq Rusia, çojnë në përfundimin se mënyra e zhvillimit të luftës ka evoluar në

aspektin e qasjes dhe ajo që Clausewitz e përkufizon si “lufta totale tani është bërë realitet i përditshëm dhe përfshin absolutisht të gjitha instrumentet e fuqisë në dispozicion. Në ditët e sotme, një luftë fillon shumë kohë para se të hidhet plumbi i parë”.

6. Disa qasje dhe përvojë personale përreth luftës hibride në Ukrainë

Në vitin 2019 në Akademinë e Forcave Tokësore në Sibiu Rumani nën drejtimin e Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë rumune u zhvillua stërviija “Focsani Gate Full Spectrum Joint Deterrence Simulation-TTX 2019-2”. Stërviija u bashkë organizua me Qendrën e Luftës së Gjeneratës së Re nga SHBA-të dhe Qendrën e Strategjisë së Re në Rumani. Objektivi kryesor i kësaj stërviije ishte analiza në nivel shumëkombësh, koordinimi ndërinstucional, ndërveprimi në nivel strategjik dhe operacional, i aspekteve që lidhen me menaxhimin e një krize shumëdimensionale. Në këtë stërviije morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, e Brendshme, e Punëve të Jashtme dhe e Komunikimit dhe Doganat. Skenarët e trajnimit morën parasysh ndikimin e zhvillimeve të fundit rajonale në fushën e sigurisë, në planifikimin e reagimit ndërinstucional dhe ushtarak ndaj krizës, si dhe testin e reagimit në kontekstin e përdorimit të aftësive të reja luftarake, veçanërisht në terren, duke pasur parasysh edhe përdorimin e mbështetjes që rrjedh nga efektet simuluese si dhe disa vendime të marra në menaxhimin e krizave. Lidhur me skenarin dhe drejtimet e veprimit, nga “New Generation Warfare Center” u prezantua një briefing i përditësuar kushtuar sfidave të sigurisë në rajonin e Detit të Zi. Duke marrë parasysh skenarët dhe drejtimet e veprimit, ata u përfruan me situatën aktuale si dhe lidhjet e ndikimit rus nëpërmjet politikës, afrimit të njëjësive ushtarake ruse dhe vendosjes së tyre në këtë zonë interesi.

Pjesë e skenarit ishte gjithashtu zhvendosja masive e emigrantëve përmes Polonisë dhe bllokada në zonën e interesit të Detit të Zi si dhe përfshirja e rajonit të Krimesë dhe Gjeorgjisë. Ndër më të rëndësishmet u konsideruan ndërhyrjet e agjencisë ruse të inteligjencës duke krijuar bllokadë të disa rrjeteve informative si dhe lajmeve të rreme (*fake news*) në media. Në përgjigje të situatave pasi objektivi kryesor ishte përballja me një skenar të mundshëm të luftës hibride, reagimi ishte edhe në këtë bashkërendim dhe bashkëveprim të forcave. Gjithashtu në bazë të fushëveprimit të hartës dhe veprimeve si dhe informacionit të dhënë në konferencë, i prezantuar krahas burimeve të brendshme, duke përfshirë ndërveprimin ndërinstucional dhe kryesisht në drejtim të marrjes së masave të sulmeve ushtarake dhe shpërnguljes masive të refugjatëve nga Polonia që supozohej të merrej me tre divizionet e NATO-s të vendosura në Ukrainë (një divizion norvegjez, një divizion anglez dhe një divizion amerikan) gjithashtu ofroi mbështetje ajrore dhe mbështetje nga Forcat Ajrore Turke. Ky ndërveprim dhe koordinim u drejtua nga Qendra e

Përbashkët Operative si pjesë e ekipit të trajnimit.

Më pas në fund të prezantimit nga të pranishmit u trajtuan pyetje specifike të cilat ishin më shumë në përputhje me veprimin e Agjencive të Mbrojtjes nga veprimet e paligjshme (kibernetike) dhe më shumë ato të operacioneve doganore në tokë dhe det dhe lumenj. Gjithashtu duke marrë masa për të dhënë informacion sa më shpejt të jetë e mundur nga Agjencia Rumune e Inteligjencës (SRI). Përfaqësuesit e ministrive sipas fushës së përgjegjësisë i kthyen përgjigjet sipas fushave të interesit lidhur me masat e marra për kontrollin dhe parandalimin e tyre. Në përfundim, gjenerallejtënant (R) Ben Hodge, Presidenti i Qendrës për Analizë të Politikave Evropiane, adresoi disa rekomandime specifike të cilat u shtrinë në të gjithë gamën e trajnimit. Një rekomandim ishte *Situata dhe Demonstrimi i Mundësive* duke konsideruar gjithashtu mundësinë e përfshirjes së infrastrukturës së BE-së kërkesat, si dhe duke marrë parasysh rajonin e Detit të Zi, i përshtatshëm për praninë e trupave të Aleancës. Duke analizuar faktorët e bashkëpunimit dhe ndërveprimit, ai theksoi se “përveç përfshirjes në skenar dhe drejtime të veprimit, por përfshirja e Forcave Ajrore Turke nuk mjafton për t’u mbrojtur, do të doja të shihja një prezantim më të madh të forcave mbështetëse siç kujtoj katër vite më parë kur isha komandant i (USAREUR)”. Rekomandimi tjetër kishte të bënte me shpejtësinë e veprimit. Në shpejtësinë e veprimit sidomos në marrjen e informacionit fillestar është mirë të veprohet dhe të shkëmbehet informacion me Agjencitë e Inteligjencës së Ukrainës dhe Gjeorgjisë, e cila do të ndihmonte shumë në marrjen e vendimit shpejt pasi shpejtësia është shumë vendimtare në ditët e sotme. Gjithashtu afrimi dhe lëvizja e aseteve kyçe duke i zhvendosur në këtë zonë pasi përafrimi i kapaciteteve ndihmon në ndërhyrjen e shpejtë të elementeve këtu mund të parashikoni që Forcat Speciale të vendosen në vartësinë operacionale të Forcave Ajrore pasi krijon mundësia për një ndërhyrje më të shpejtë. Si përfundim, u vlerësuan si një masë pozitive e punëve të brendshme dhe njohja me situatën e fundit, duke e përcaktuar skenarin e këtij ushtrimi si rekomandime fleksibël dhe koherente dhe njëkohësisht pozitive dhe të nevojshme, duke i marrë në konsideratë si mësim të evidentuara. Gjithashtu mund të kihet parasysh një skenar i jashtëzakonshëm i cili do të jetë më specifik i varur nga lloji hibrid kundërshtar dhe do të jetë i kombinuar me njësi të ndryshme të gjitha forcat e armatosura dhe gjithashtu me bashkëpunim me aleatët.

Përfundime

- Rusia tregoi edhe një herë karakterin e vet hegjemonist duke prishur kështu çdo balancë diplomatike dhe ushtarake.
- Pavarësisht se Ukraina nuk po dorëzohet dhe po lufton në çdo drejtim dhe

i kundërpërgjigjet ofensivës Ruse por, përsëri në mënyrë periodike, forcat ruse po sulmojnë pareshtur objektivat e civilëve të pambrojtur.

- Nëpërmjet bllokimeve ekonomike Rusia po mundohet të krijojë krizë ekonomike në Ukrainë, duke bllokuar shitjen e drithërave.
- Faktor pozitiv është që shtetet e NATO-s po qëndrojnë në mbështetje të ushtrisë ukrainase duke e suportuar atë me armë dhe municione. Edhe Shqipëria është renditur me këto vende duke dhënë kontributin e saj.
- Gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe situatën e përshkallëzuar si rezultat i zhvillimeve të fundit mbi bazën e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe Strategjisë Ushtarake po rishikohen edhe njëherë planet e mbrojtjes kombëtare.
- Duke filluar nga viti 2024, GDP për ushtrinë shqiptare do të jetë në kufijtë e 2% të prodhimit të përgjithshëm bruto, e cila do të shërbejë për rritjen e aseteve ushtarake dhe modernizimin e ushtrisë.
- Është e domosdoshëm për t'u krijuar formacione të reja me qëllim marrjen e masave për çdo situatë që do të krijohet si rezultat i kësaj lufte që dihet se është më e përhapura si dhe parashikimet që po bëhen edhe për shtetet e Ballkanit Perëndimor.
- Në perspektivën e FARSH, lipset që AISM dhe ASNI, të kenë parasysh se faktori i vetëm nga çdo kërcënim është marrja e masave për të vlerësuar ecurinë e veprimit dhe pas tij për të dhënë drejtimin specifik për epërsinë në luftën hibride.
- Përkundër strukturës që janë rishqyrtuar vitet e fundit është një detyrim që të krijojmë njësitë taktike me forcat e bashkuara për çdo faktor dhe kusht të paparashikueshëm hibrid.

Literatura e shfrytëzuar

1. Hoffman, Frank (2007). *Conflict in the 21st Century: The Rise of Hybrid Wars (PDF)*. Arlington, Virginia: Potomac Institute for Policy Studie.
2. Pindjak, Peter (2014-11-18). »Deterring hybrid warfare: a chance for NATO and the EU to work together?« .NATO Review. ISSN 0255-3813. Archived from the original on 2015-12-06.
3. Berzins, J. (2019). "Not 'Hybrid' but New Generation Warfare". in Howard, G. and Czekaj, M. (Eds.) *Russia's Military Strategy and Doctrine*. Washington, DC: The Jamestown Foundation.
4. Von Clausewitz, Carl (1989). Howard, Michael; Paret, Peter (eds.). *On*

War. Princeton, NJ: Princeton University Press. p.593.

5. Jasper, Scott; Moreland, Scott (2014-12-02). "The Islamic State is a Hybrid Threat: Why Does That Matter?". *Small Wars Journal*. Small Wars Foundation. Retrieved 2015-08-05.
6. Burkle, Frederick (24 March 2022). "Bastardizing Peacekeeping and the Birth of Hybrid Warfare". *Prehospital and Disaster Medicine*. **37**(2): 147– 149. doi:10.1017/S1049023X22000425. PMID 35322776. S2CID 247617444.
7. Deep, Alex (2015-03-02). "Hybrid War: Old Concept, New Techniques". *Small Wars Journal*. Small Wars Foundation. Retrieved 2015-08-05.
8. Whitney, Craig R. (December 2012). "Ruling Arms". *World Policy Journal*. **29**(4): 86–93. doi:10.1177/0740277512470932. Archived from the original on 28 December 2012. Retrieved 17 June 2016.
9. Mc Cuen, John J. "Hybrid Wars" (PDF). *Military Review*. **88** (2): 107.
10. "HYBRID THREATS–Hybrid Co E". *Hybrid CoE*. Retrieved 2018-01-31
11. Stowell, Joshua. "What is Hybrid Warfare?". *Global Security Review*. Retrieved 26 July 2018.
12. Wither, James K. (2016). "Making Sense of Hybrid Warfare". *Connections*. **15** (2): 73–87. doi:10.11610/Connections.15.2.06. ISSN 1812-1098. JSTOR 26326441.
13. Lavrov, Sergey (2014-11-25). "REMARKS BY FOREIGN MINISTER SERGEY LAVROV AT THE XXII ASSEMBLY OF THE COUNCIL ON FOREIGN AND DEFENCE POLICY". Retrieved 2017-02-02.
14. Carden, James (6 December 2014). "Russia and America's Dangerous Dance". *The National Interest*. Retrieved 19 February 2017.
15. Galeotti, Mark (5 March 2018). "I'm Sorry for Creating the 'Gerasimov Doctrine'". *Foreign Policy*. Slate Group. Retrieved 19 March 2022.
16. Mason Clark (2020) për Institutin për Studimin e Luftës Russian Hybrid Warfare.
17. Katerina Zarembo, Sergey Solodokyy (2021) The Evolution of Russian Hybrid Warfare: The case of Ukraine.
18. NATO Review-Hybrid Warfare–New Threats, Complexity, and 'Trust' as the Antidote.
19. Hybrid warfare-Wikipedia`

Rusi-Ukrainë: përfundimi i konfliktit dhe implikimet strategjike

Nënkolonel Dr. Fitim Karasani
Akademia e Forcave të Armatosura

Nënkolonel Dr. Luljeta Tafani
Ministria e Mbrojtjes

Trajtesë e shkurtuar.

Prej një dekade, kurba e ndryshimit të mjedisit të sigurisë po arrin në pikat ekstreme të tij. Faktorët përcaktues të këtij ndryshimi janë të shumëllojshëm dhe termi permacrisis, si një periudhë e zgjatur paqëndrueshmërie dhe pasigurie, po bëhet gjithnjë e më i përdorshëm. Krahas faktorëve të tjerë përbërës të mjedisit, kërcënimi apo cenimi i integritetit territorial, po ndikon më shumë se sa çdo herë tjetër që nga viti 1945. Një nga këta faktorë është edhe konflikti Ukrainë-Rusi, konflikt i cili në forma nga më të ndryshmet ka amplifikuar mënyrën e sjelljes së shumë shteteve apo organizatave në drejtim të politikave të sigurisë. Ky konflikt po shërben si tregues i zbatueshmërisë të ligjit ndërkombëtar, i multilateralizmit të OKB-së, NATO-s, BE-së, apo mënyrës së sjelljes së aktorëve globalë. Pas çdo cenimi të mjedisit, veçanërisht kur ai konsiston në formën më “brutale” të tij siç është konflikti i armatosur, studiuesit fokusohen në atë që, sa do zgjasë ky konflikt, sa ndikon ai në mjedisin aktual, a mund të përfundojë konflikti në paqe të qëndrueshme, çfarë mjedisi sigurie pasues do ta shoqërojë atë, cilat mund të jenë implikimet e tij strategjike? etj.

Në shkrimin pasues, nëpërmjet krahasimit nga historia ushtarake e rasteve të tilla, jepen ide modeste për vazhdimësinë e këtij konflikti të armatosur, të gjasave të arritjes së një paqeje të mundshme, implikimet e mundshme strategjike etj.

Fjalë kyçe: konflikt i armatosur, operacion special ushtarak, ndikim strategjik, marrëveshje paqeje, aktor global, parashikueshmëri.

Hyrje

Që nga fundshekulli i kaluar, studiuesit e politikave të sigurisë, kur flitet për parashikimin e mjedisit të ardhshëm, përgjigja përfshihet me trinomin: kompleksitet, pasiguri, paparashikueshmëri. Nëse do tentonim të gjenim një përgjigje të tillë për rezultatin e konfliktit Rusi-Ukrainë, për periudhën e mundshme të ndërprerjes së luftimeve dhe mënyrën e arritjes së saj, për ndikimin e tij në sigurinë evropiane, nuk do të mund të gjenim një mënyrë për ta parashikuar atë.

Në aspektin politik, jo vetëm Putini që e kishte pjesë të idesë dhe parashikimit të tij mos funksionalitetin e plotë të NATO-s, por edhe shumë të tjerë, nuk mendonin që aleanca do të shfaqej aq e bashkuar. Nuk u mendua që Gjermania do të “*linte pas krahëve*” politikën konstruktive të ndërtuar për pesë dekada me radhë me ish-Bashkimin Sovjetik dhe Rusinë dhe, për më tepër, u hapi rrugë ndryshimeve kushtetuese nga Bundestagu si për lëvizjen e trupave të saj ushtarake jashtë territorit të vendit ashtu dhe për fond shtesë në forcat e armatosura¹. Askush nuk e parashikoi që neutralitetit shekullor të Finlandës dhe Suedisë do ti vinte fundi, dhe Finlanda të bëhej anëtare i 31 i NATO-s në vitin 2023, apo Suedia në prag të saj pas hapave të ndërmarrë nga Turqia.

Në aspektin ushtarak strategjik, askush nuk e parashikoi që forcat e armatosura të Ukrainës do të kishin mënyrë tjetër kundërpërgjigje nga ajo e pushtimit të Krimesë. Jashtë çdo parashikimi, forcat e armatosura ruse nuk po arrinin të realizonin objektivat ushtarake. Në fushë beteje, askush nuk mendoi që shkatërrimi i digës Kakhovka në qershor 2023, do të sillte surpriza të papritura në vazhdimin e luftimeve. Askush nuk e parashikoi se shirat edhe terreni i rënduar në pranverën e vitit 2023 do të pengonin një kundërofensivë ukrainase. Nuk ka asnjë bazë historike për të parashikuar se sa do të zgjasin luftimet dhe kur mund të kemi një formë përfundimi konflikti.

Në dukje, lufta në Ukrainë është shndërruar në një luftë rrënimi ku asnjëra palë nuk duket se ka avantazhin. Si Ukraina po ashtu edhe Rusia kanë arsyet e tyre gjeostrategjike për të vazhduar luftën. FA-të e të dy palëve kanë krijuar mbrojtje të përparuar duke përfshirë rrjete llogore, fusha të minuara, mbështetje të vijave të para të luftimit, forca të blinduara, dronë, mbrojtje raketore, etj.

1. Përfundim i Operacionit Special Ushtarak apo i konfliktit të armatosur?

Deklarimi i kryer nga Presidenti i Rusisë për fillimin e Operacionit Special

¹ Në rreth 100 miliardë euro kur buxheti vjetor për forcat e armatosura ka qenë afro 53 miliardë në vit. Burimi elektronik: <https://www.sipri.org/databases/milex>

Ushtarak (OSU) ngriti pikëpyetjet e para në termin e përdorur. Termi filloi që të studiohej si në pikëpamjen e ligjit ndërkombëtar, ashtu edhe në atë se çfarë mund të përfaqësojë në aspektin ushtarak. Moska vazhdon përdorimin e termit OSU, një term i teorisë ushtarake ruse. Litvinenko², në letrën e hapur drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Ruse specifikon, “*se një OSU ndryshon nga operacionet e tjera të kombinuara të FA në mënyrën se si FU përdoret për të arritur qëllimet ushtarake. Qëllimi i OSU është të arrijë përmes një qasje të drejtpërdrejtë qëllimin strategjik, nga një operacion i vetëm vendimtarë i kryer nga një formacion i kombinuar i armëve*”³. Sipas tij, ndryshimi i OSU dhe një operacioni të ndërmarrë nga Forcat e Armatosura (FA) dhe trupat e tjera, është se qëllimi i OSU është i lidhur drejtpërdrejtë me qëllimet dhe objektivat e tjera ushtarako-politike, në kontrast me operacionet sulmuese ose mbrojtëse.

Detyrat ushtarako-politike në operacionet speciale ulen deri në nivelin e veprimeve taktike të formacioneve. Ky kuptim është rrënjësor edhe në konceptin rus të konfliktit ushtarak, ku “*lufta është forma më intensive e konfliktit ushtarak brenda tipave të tjera të konfliktit të armatosur, siç është OSU, duke qenë në spektrin e konfliktit të armatosur por më pak intensive*”⁴. Nëse do të shpreheshim më thjeshtë, OSU është një mënyrë e të bërit luftë por shkalla e intensitetit të saj është në një nivel më të ulët. Sipas tyre, arritja e fitores në OSU, mund të arrihet më thjesht “*përmes aplikimit të një përzierje të metodave të ndryshme ushtarake dhe jo ushtarake për të detyruar udhëheqjen e armikut të pranojë termat/kushtet që ai nuk i ka pranuar.*”⁵

Sipas rusëve, arritja e fitores të asaj që ata e quajnë luftë, mund të kërkojë mobilizim ushtarak, ekonomik dhe social, operacione të thella dhe të shumta dhe që kanë synime ushtarako-strategjike duke çuar në kapitullimin ushtarako-politike të atij vendi. Duke gjykuar perceptimin rus, teoria ushtarake e tyre krahas ndryshimit të mënyrës së angazhimit të forcave pjesëmarrëse dhe objektivave që arrijnë, në doktrinën ruse parashikohet dhe afati kohor përkatës, “*kohëzgjatja e operacioneve speciale ushtarake, e cila është relativisht e shkurtër, 10 deri 15 ditë*”⁶.

² Vladimir Kvachkov (1948), ish kolonel dhe pjesëmarrës në disa konflikte si Afganistan (1983), Azerbajxhan (1990), Taxhikistan (1992). Pjesë e stafit të Center for Military and Strategic Research of Russian Defence Ministry.

³ <https://www.ndc.nato.int/research/research.php?icode=777>.

⁴ <https://encyclopedia.mil.ru/encyclopedia/dictionary/details.htm?id=12840@morfDictionary>.

⁵ Charles, B. Review of “*Preparation and Conduct of Military Actions in Local Wars and Armed Conflicts*”, Russian Studies Series 03/21, NATO Defense College, Rome, November 2018. <https://www.ndc.nato.int/download/downloads.php?icode=564>.

⁶ Batyushkin, S. *Preparation and Conduct of Military Action in Local Wars and Armed Conflicts*, KnoRus, 2017, pg.20

Realisht, përveçse në Perëndim, edhe brenda Rosisë ka pikëpamje të ndryshme për përdorimin e këtij termi, pikëpamje që kur kanë qenë në drejtim të kundërt të asaj që është thënë publikisht, janë censuruar. Edhe pse ka teori të ndryshme në Rusi për termin, ato kanë një emërues të përbashkët që, një operacion i tillë është më pak intensivë se sa një konflikt i armatosur. Në këndvështrimin perëndimor, përdorimi i termit OSU është thjeshtë një eufemizëm për “luftë”.

Përdorimi i termit “operacion” është kyç. Duke pasur këtë kuptim të natyrës së një OSU, duket sikur vërtet Moskë parashikoi një operacion të vetëm të zgjeruar për të arritur qëllimin e “çmilitarizimit dhe *denazifikimit*” në një periudhë të shkurtër kohore. Aktualisht, pamundësia e Rosisë për të arritur ato që kishte menduar në fillim të agresionit, duket e pamundur. Megjithatë nuk është deklaruar hapur, pikëpamja e teoricienëve rus për OSU, duket se tashmë nuk quhet operacion por “luftë”. Këmbëngulja për përdorimin e mëtejshëm të këtij termi duket që është veçse arsye politike pasi pranimi i termit “luftë” do të thoshte që OSU është një dështim.

Koncepti i fjalës luftë/konflikt i armatosur ka pësuar ndryshime të vazhdueshme dhe nuk është pjesë e këtij shkrimi. Diçka tjetër është e vërtetë, termi OSU nuk figuron në të drejtën ndërkombëtare. Nëse dikur duhej që të shpallej që të kishim luftë, tashmë nuk ka nevojë. Ekzistenca e një konflikti të armatosur vërtetohet në bazë të fakteve, pavarësisht nga kualifikimi i tij i brendshëm apo shpallja e luftës nga njëra palë apo tjetra. Sipas Konventave të Gjenevës, një konflikt i armatosur ekziston kur “*një shtet përdor FA, kundër një shteti tjetër edhe nëse gjendja e luftës nuk njihet nga njëra prej tyre*”⁷. Pavarësisht doktrinës ruse në emërtimin përkatës, faktet tregojnë që tashmë kjo është një luftë, për më tepër, zërat brenda Rosisë thonë që jo vetëm është luftë por disa e quajnë luftë lokale dhe disa të tjerë luftë botërore.

2. “Jetëgjatësia” e konfliktit të armatosur

Gjatë studimit historik të zhvillimit të luftërave, parë si në aspektin kohor dhe në aspektin e përfshirjes së palëve ndërluftuese, konstatohen disa varietete luftërash si: luftëra periodike, luftëra të shkurtra, luftëra të gjata, luftëra lokale, luftë botërore, etj. Duke studiuar konfliktin aktual në Ukrainë, pyetje më domethënëse në varietetet e luftërave të përmendura më sipër, është, sa do të zgjasë ky konflikt i armatosur?

Parë në aspektin kohor të zgjatjes së saj, historia ushtarake tregon që lufta më e shkurtër është konflikti në mes Perandorisë Britanike dhe Zanzibarit, më 27

⁷ Konventat e Gjenevës, Neni3,pg 13, pdf.

[https://ckrm.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/ZENEVSKI%20KONVENCII%20%](https://ckrm.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/ZENEVSKI%20KONVENCII%20%20)

gusht 1896⁸. Lufta më e gjatë është lufta Sino-Japoneze që filloi në vitin 1937 dhe zgjati deri në vitin 1945⁹. Në shekullin XX kemi një shembull klasik të luftës të shkurtër, lufta gjashtë ditore Arabo-Izraelite¹⁰.

Konstatimi i përgjithshëm në drejtim të kohëzgjatjes së luftërave është fakti që ato asnjëherë nuk kanë zgjatur aq kohë sa është planëzuar, ato kanë qenë gjithnjë më të gjata. Gjithashtu, jo në pak raste luftërat kanë përfunduar papritmas dhe po ashtu në shumë raste humbësi apo fituesi kanë qenë të ndryshëm nga parashikimet paraprake. Lufta e Parë Botërore e shek. XX dhe Lufta Afgane shek. XXI, tregojnë që lufta mund të përfundojë papritur. Në të dyja rastet, këto luftëra përfunduan pasi njëri nga palët luftuese ishte rrënuar deri në pamundësi të vazhdimit të luftimit. Normalisht ky duhet të ishte një parashikim i mundshëm por kjo nuk kishte ndodhur.

Shumë luftëra nuk kanë përfunduar edhe pse luftimet formale kanë pushuar ose kemi pasur një marrëveshje armëpushimi. Intervali kohor pasues ka shërbyer thjeshtë si një pauzë lufte. Shumë nga këto marrëveshje kanë çuar në paqëndrueshmëri të tilla sa në disa raste, kanë cenuar mjedisin e sigurisë. Dalja në skenë e perandorive spanjolle, suedeze, britanike dhe franceze, çuan në një sërë luftërash të ndërthurura në vend të paqes. Kështu, trazirat demokratike në Francë që përmbysën monarkinë kishin thujse rezultat si Pranvera Arabe. Kjo lëvizje në Francë solli luftërat napoleonike 1808-1815. Beteja e Waterloo-s¹¹ çoi në një paqe në dukje të qëndrueshme në Evropë, që në fakt u pasua nga disa konflikte, që ishin parathënia e luftës Franko-Gjermane në vitin 1870¹². Përfundimi i kësaj lufte realisht u bë parathënia e L.I.B.

Luftërat mund të përshkallëzohen në mënyrë të pa parashikueshme. Nuk e mendoi njeri që një atentat në Sarajevë do të përfshinte botën në LIB. Nuk u parashikua që fitoret e Gjermanisë ndaj Rusisë në 1917 dhe sukcesi i saj në 1918, do të ndodhte që po brenda këtij viti të kishim një shkatërrim të Gjermanisë.

⁸ Kjo luftë zgjati afërsisht 40 minuta dhe përfundoi me vdekjen e Princit Khalid ibn Barghash dhe zëvendësimit të tij me Hamoud bin Mohammed. <https://www.britanica.com/event/Anglo-Zanzibar-War>.

⁹ Mitter, R. *China's Good War: How World War II is Shaping a New Nationalism*. Harvard University Press, 2020.

¹⁰ Lufta Gjashtë Ditore, e njohur edhe si Lufta e Tretë Arabo-Izraelite, u zhvillua në mes Izraelit dhe një koalicioni shtetesh arabe (Egjipti, Siria dhe Jordania) nga 5-10 Qershor 1967.

¹¹ Beteja e Waterloo-s u zhvillua më 18 qershor 1815 nga ushtria napoleonike kundër koalicionit të përbërë nga Anglia, Austria, Rusia, Prusia, Suedia, etj. Ishte beteja e fundit për Napoleonin e cila shënoi humbjen përfundimtare të Tij.

¹² Traktati i Frankfurtit më 10 maj 1971, është traktati i paqes që përfundoi Luftën Franko-Prusiane. Fitorja gjermane konsolidoi besimin ndaj militarizimit i cili do të mbizotëronte shoqërinë gjermane deri në vitin 1945. Më i rëndësishëm ishte aneksimi i Alsace-Lorraine nga Gjermania, i cili çoi në një paqe të paqëndrueshme deri në vitin 1914.

Përfundimi i LIB dhe Paqja e Versajës në të vërtetë u bënë themeli për tensionimin e situatës deri në krijimin e rrethanave të fillimit të Luftës së Dytë Botërore. Edhe pas 70 viteve, konflikti në mes arabëve dhe izraelitëve, (1948, 1956, 1967 dhe 1973), kemi pasur përpjekje për paqe e cila nuk është arritur asnjëherë në të vërtetë (shpresojmë të ndodh në luftën aktuale Izrael-Hamas (Palestinë)). Edhe në Azi, kemi një luftë të madhe në vitet 1950-1953 të shoqëruara me episode konflikti në mes K. Veriut dhe K. Jugut. Pas vitit 1953, të dy Koretë janë përfshirë në garë armatimi që përfshin si armët konvencionale, bërthamore apo kërcënimet kibernetike. Mbajtja e Konferencës së Parisit për Vietnamin¹³ ishte parathënia e tërheqjes së SHBA-ve që i dha fund luftës, por në të vërtetë kemi një paqe të paqëndrueshme.

Në Lindjen e Mesme, kemi për vite me radhë një luftë në mes Irakut dhe Iranit (1980-1988), e cila edhe përse u arrit një armëpushim, kemi ndërhyrje të vazhdueshme ushtarake iraniane. Lufta e Parë e Gjirit 1990-1991, ishte parathënia e kalimit në sulm ndaj Irakut në vitin 2003, ku akoma kemi disa ndërhyrje të tjera për kontrollin e tij. Afganistani ishte fillimisht skenë lufte civile, më pas një pushtim rus, më pas një luftë që përfshiu një koalicion të udhëhequr nga SHBA 2000-2021. Realisht në Afganistan nuk mund të thuhet që kemi një situatë më të qetë.

Përfundimet e luftërave janë arritur me konferenca paqe ose marrëveshje armëpushimi. Në të njëjtën kohë kemi konstatimin që marrëveshje të tilla (të paqes), shpesh nuk nënkuptojnë përfundimin e luftës. Lufta e Vietnamit dhe ajo e Afganistanit tregojnë se fitimi në disa beteja të veçanta apo marrëveshje për paqe, nuk kanë bërë të mundur një paqe të vërtetë në terma strategjik. Këto dy raste, na kthejnë në idetë e strategëve apo mendimtarëve ushtarakë të shekullit XIX, në atë të përcaktimit të qartë të objektivave politikë dhe ushtarak si dhe arritja e tyre në arritjen e paqes së qëndrueshme. Nuk mund të mendohet që arritjet e objektivave ushtarakë janë tregues që është arritur edhe objektivi politik.

Një formë tjetër shfaqje lufte, që mund të thuhet një version i LF, një luftë që në dukje është një luftë për t'u ripozicionuar si aktor global, shfaqet kur Rusia pushtoi Krimenë në vitin 2014, veprim që thellohet më tej me sulmin ndaj të gjithë territorit ukrainas në 14 shkurt 2022.

1.1. Diversitet kushtesh për paqe.

Lufta Rusi-Ukrainë, në fakt, evoluoi në një konflikt të gjatë që në javët e para

¹³ Në janar 1973, u nënshkrua Traktati i Paqes i Parisit nga ShBA dhe tre palët vietnameze. Ai parashikonte tërheqjen e plotë të trupave amerikane brenda 60 ditësh dhe krijoi një proces politik për zgjidhjen paqësore të konfliktit në jug. Marrëveshja e Parisit në fakt nuk i dha fund luftimeve në Vietnam. Në vitin 1974, Hanoi, pas ndërmarrjes së veprimeve ushtarake hyri në Saigon (Ho Chi Minh) duke e marrë atë. Në këtë mënyrë mori fund Lufta e Dytë e Indokinës.

të luftimeve. Rusia fillimisht vlerësoi si të mundur që, vendosja e forcave të saj në kufi të Ukrainës, do tu mundësonin atyre që të fitonin betejën vendimtare përpara se Ukraina, të mund të reagoje në mënyrë efektive. Rusia vlerësoi se mund të përsëriste sukseset e saj në Krime dhe të mund të merrte në kontroll Ukrainën brenda 10-ditësh. Gabimeve të saj iu shtuan edhe aftësitë e disa vendeve për ti dhënë Rusisë paralajmërim strategjik dhe suport Ukrainës për të rezistuar. Duke mos rikujtuar të gjithë dinamikën e luftimeve, mund të themi vetëm faktin që kjo luftë u shoqërua me ndryshime të habitshme në fushë betejë si: përdorimi masiv i armëve të drejtuara, raketave, UCAV¹⁴, por edhe i automatikëve, mitralozave, etj. Panorama aktuale e konfliktit tregon një fushë betejë të ngjashme me atë të L.I.B, megjithëse të dy palët po luftojnë me armë moderne.

Me gjithë humbjet reciproke, Rusia dhe Ukraina nuk kanë shfaqur shenja të dukshme që të negociojnë. Asnjëra nga palët nuk kanë sugjeruar kushte për përfundimin e luftimeve që pala tjetër të duket e gatshme që t'i pranojë. Kemi mbase një spekulim, në atë që është përqendruar në nevojën e Putinit për të pretenduar një lloj fitoreje në mbajtjen e pjesëve të territorit në Ukrainë që ka pushtuar tashmë. Kjo zgjidhje do të mundësonte që Putini të ruante edhe territorin e Krimesë që pushtoi në 2014. Megjithatë, deri tani Putini ka mbajtur të njëjtin qëndrim, atë që Ukraina nuk është një shtet legjitim dhe që ka një karakter nazist. Fjalimi i tij, për bashkimin e krahinave të pushtuara fokusohet në *“përdorimin e forcës për sigurimin e pavarësisë dhe sovranitetit të Republikës Popullore të Donetskut dhe Luhanskut...”*¹⁵. Kjo lloj retorike nuk do të thotë se Putini nuk do të jetë i gatshëm të bëjë kompromis për zgjidhje, nëse mendon që kjo luftë po kërcënon mbështetjen e tij të brendshme dhe stabilitetin e Rusisë. Stabiliteti i regjimeve që përfshihet në luftëra, zgjat derisa rrënimi të bëhet i dukshëm.

Në anën tjetër të një paqe të mundshme, është plani i paqes i Zelensky-it në vendosjen e kushteve, edhe pse këto janë më shumë qëndrime politike se sa kushte për negociata. Planin e paqes së tij, kërkonte ndryshime të mëdha në mënyrën se si Rusia kishte qasjen ndaj sigurisë së Ukrainës¹⁶. Planin kishte të bënte në fillim me sigurinë dhe rrezatimin bërthamor, me sigurinë ushqimore, me sigurinë energjetike, integritetin territorial të Ukrainës, me tërheqjen e forcave ruse, etj.

Nga një analizë e thjeshtë e kërkesave të dy palëve, është e dallueshme që ekziston një hendek midis pikëpamjeve të dy liderëve për përfundimin e

¹⁴ Unmanned Combat Aerial Vehicle.

¹⁵ Extract from Putin's Speech on the Ukraine, Reuters, February 21, 2021. <https://www.reuters.com/world/europe/extracts-putins-speech-ukraine-2022-02-21/>

¹⁶ *“Explainer: What is Zelensky's 10-point peace plan?”* Reuters, December 28, 2022. <https://www.reuters.com/authors/reuters/>

konfliktit. Mund të ketë zëra që Rusia të lëshojë vetëm territoret e kapura nga fillimi i luftës aktuale por kur bëhet fjalë edhe për Krimenë duket një opsion shumë i vështirë.

2.2. Perspektivat e pasigurta për një fund të qëndrueshëm të luftimeve.

Përfundimi apo qëndrueshmëria e konfliktit do të varet shumë nga rrjedha e luftimeve gjatë çdo muaji dhe vitit që sapo hyri. Të dyja palët kanë përmirësuar forcat dhe aftësitë e tyre luftarake. Rusia ka mobilizuar dhe ritrajnuar forcat e saj dhe ka treguar se mund të luftojë në mënyrë efektive në mbrojtje. Ajo ka treguar gjithashtu se mund të synojë ekonominë e Ukrainës dhe të kryejë një fushatë sulmesh për të dobësuar moralin e popullsisë civile. Sa i përket Ukrainës, ajo filloi kundër ofensivën dhe ka kryer sulme të vazhdueshme dhe në brendësi të territorit rus, ka modernizuar forcat e armatosura por ka pasur problematik në drejtim të ndihmave të ofruara.

Sforcimet e imponuara nga lufta mund të nënkuptojnë se Ukraina dhe Rusia do të jenë të gatshme të kënaqen me një formë të armëpushimit që pasqyron vijën në gjendjen aktuale të luftës. Kjo gjendje e perceptuar, i jep Rosisë një lloj fitoreje të kufizuar territoriale që do të përfshijë një urë tokësore për në Krimë dhe të bazohet në disa grupe lumenjsh për të rritur stabilitetin e saj.

Problemi do të ishte se mund të ketë pak thellësi për një zonë të çmilitarizuar dhe çdo zgjidhje e tillë, nuk ka gjasa të sigurojë ndonjë bazë për besimin reciprok. Marrëveshja që mund të arrihet, mund t'i japë fund luftimeve, por nuk besoj se do të jetë një imazh bindës i paqes. Siç dëshmojnë Marrëveshja e Armëpushimit në Luftën Koreane në 1953 dhe Rezoluta 598 e Këshillit të Sigurimit që i dha fund luftimeve Iran- Irak, një marrëveshje armëpushimi mund t'i lejojë të dyja palët të shmangin negociimin e zgjidhjeve të qëndrueshme, të kryejë provokacione apo përplasje të armatosura dhe të vazhdojnë garën e armatimit¹⁷.

Në aspektin e përfundimit të luftës, stabiliteti politik dhe burimet ekonomike të secilës palë, janë variabla kritik që mund të përcaktojnë rezultatin e këtij konflikti. Në drejtim të aspektit politik, ndryshimi i kursit të veprimit të grupit Wagner, ka ngritur pikëpyetje në lidhje me nivelin e kontrollit në të ardhmen e Putinit. Deklaratat e tij se *“shumë nga ata që deri dje mbështetin OSU në Ukrainë, sot ose kanë dyshime ose janë kundër asaj që po ndodh”*¹⁸, mund të përsëritet.

A duhet menduar që ngjarje të tilla mund të kërcënojnë regjimin e Putinit? Duhet rikujtuar, që të tilla fenomene në regjimet autoritare janë më shumë

¹⁷ Resolution 598 | UN | Britannica

¹⁸ *“Wagner Group Leader Accuses Russian ‘Decision-Makers’ Of Treason For Lack Of Ammunition In Ukraine,”* April 26, 2023, <https://www.rferl.org/a/russia-pirgozhin-wagner-ammunition-treason-ukraine-war/32380761.html>.

rregull se sa përjashtim. Hitleri kreu një spastrim masiv, të quajtur “*long knives*”. Ai neutralizoi dhe shpërndau udhëheqësin e trupave paramilitare Rohm¹⁹ apo i mbijetoi një atentati ushtarak në korrik 1944²⁰. Edhe Stalini kreu një seri spastrimesh në ushtrinë e tij në vitet 1930 dhe më të madhin në vitin 1937²¹, duke mbijetuar.

Aspekti ekonomik përbëhet nga dy zëra: rrjedha e ndihmës për Ukrainën dhe gjendja ekonomike e Rusisë. Rusia aktualisht duket sikur është në gjendje që t’i mbijetojë presionit të sanksioneve ekonomike dhe politike perëndimore. Shumë studime janë fokusuar në pasojat e luftës Rusi-Ukrainë si në rritjen ekonomike, tregjet e mallrave dhe sigurinë ushqimore. Rusia pak muaj pas kalimit në agresion, mobilizoi dhe zgjeroi forcën e saj ushtarake duke riaktivizuar industrinë ushtarake dhe importoi armë nga vende të tjera si Irani. Krahas kësaj, Rusia përballë bllokadës ekonomike, gjeti alternativa të tjera për të anashkaluar pasojat e mundshme ekonomike duke forcuar partneritetin me Kinën, Arabinë Saudite dhe shtete të tjera të Gjirit.

Ekonomia e Ukrainës është më e brishtë. Konstatimet janë që në vitin 2022, importet e Ukrainës ishin 47.3 % më të ulëta, në të kundërtën Rusia përjetoi një ndikim më të papërfillshëm. Edhe në rast armëpushimi, ndodhja në lindje të saj e Bjellorusisë dhe Rusisë, do të ishte pengesë serioze. Rindërtimi i Ukrainës mund të ketë pasoja afatgjata dhe qeveria ukrainase vlerësoi në qershor 2023 se “*do t’i duheshin të paktën 18 miliardë dollarë më tepër ndihmë për të kryer funksionet e saj*”²². Pikëpyetjet në këtë rast do të ishin edhe më të mëdha nëse Ukraina nuk do të merrte krahinat apo territoret e mësipërme. Mjaftojmë të kujtojmë studimin e RAND i vitit 2023, nëpërmjet shembujve historikë vlerëson se rimëkëmbja e Ukrainës kërkon “*një kosto totale prej 750 miliardë dollarë për periudhën 2023-2032*”²³. Këto shifra tregojnë se lufta tashmë i ka shkakuar Ukrainës dëme kritike dhe cilado qoftë forma e përfundimit të konfliktit, do të ngrejë çështjen e rimëkëmbjes. Deri më tani, nuk ka shenja të qarta se Rusia ose

¹⁹ Ernst Röhm ishte një nga organizatorët kryesorë të “*Storm Troopers*”. I frikësuar për një rivalitet të mundshëm Hitleri urdhëroi vrasjen e tij nga trupat SS (Schutzstaffel). <https://www.britannica.com/event/Night-of-long-Knives>.

²⁰ Komploti i 20 korrikut 1944 ishte një përpjekje e dështuar për të vrarë Hitlerin dhe për të përmbysur rrëgjimin nazist në Gjermani. Komplotuesit ishin pjesë e rezistencës gjermane, kryesisht të përbërë nga oficerë të Wehrmach.

²¹ Më 11 Qershor 1937, një gjykatë ushtarake urdhëroi ekzekutimin e shumë oficerëve me përvojë. Në mesin e tyre ishte Tukhachevski, që cilësohej strategu më i aftë i Ushtrisë së Kuqe. <https://www.jstor.org/stable/j.ctt1ch7967>.

²² Washington Post, 26 April 2023, <https://www.washingtonpost.com/world/2022/04/26/austin-putin-ukraine-support-military-russia/>.

²³ North Atlantic Military Committee Decision on M.C.14/1: A report by the Standing Group on Strategic Guidanc, <https://www.nato.int/docu/stratdoc/eng/a521209a.pdf>.

Ukraina do të vuajnë nga rraskapitja ekonomike dhe politike. Të dyja palët aktualisht duket se do të jenë në gjendje të gjejnë burimet për të luftuar ndoshta më tej se viti 2024. Sa më gjatë të zgjasë lufta, aq më shumë ajo do të lodhë forcat ushtarake nga të dyja palët dhe do të ushtrojë presion mbi liderët e Rusisë dhe Ukrainës për të gjetur kompromis.

3. Lufta në Ukrainë dhe ndikimet strategjike

Luftimet aktuale midis Rusisë dhe Ukrainës janë vetëm një pjesë e arsyes pse lufta nuk do të përfundojë. Ashtu si shumë luftëra lokale, lufta në Ukrainë ka pasur ndikime të mëdha strategjike. Nuk ka ndonjë mënyrë për të ditur saktësisht se cilat ishin qëllimet e Putinit në nisjen e pushtimit të dytë të Ukrainës, por fjalimet e tij dhe përfitimet e mundshme strategjike e bëjnë të qartë se qëllimi strategjik ishte të rivendoste fuqinë e Rusisë në raport me Perëndimin dhe SHBA.

Lufta në Ukrainë është në thelb një projekt neo-imperialist që Putini e cilëson *“uniteti i rusëve dhe ukrainasve”*²⁴. Ai duket se ndan të njëjtën pikëpamje me Brzezinski²⁵ se *“pa Ukrainën Rusia pushon së qeni perandori por me Ukrainën e pushtuar dhe më pas të nënshtruar, Rusia bëhet automatikisht Perandori”*²⁶. Parë në këtë këndvështrim, kuptohet se sa e vështirë është për Rusinë që të pajtohet me “humbjen” e të paktën të rajoneve që ajo tashmë i ka shpallur zona ruse. Është e qartë nga fjalimet e Putinit se, lufta në Ukrainë është rezultat i perceptimit të tij se, Rusia ka pësuar humbje të papranueshme për shkak të shpërbërjes së ish-BS dhe se zgjerimi i NATO-s përbënte një kërcënim të papranueshëm. Ai e sheh mungesën e progresit ekonomik të Rusisë dhe rënien e saj si fuqi e madhe për faj të perëndimit. Sido që të jetë rezultati i përfundimit të luftës, ndikimi i saj do të rrisë konfrontimin midis Rusisë, pjesës më të madhe të Evropës dhe SHBA.

Shpërbërja e BS ndryshoi pozicionin strategjik të Rusisë, ku ajo dominonte Evropën Lindore. Rusia kishte thellësi strategjike dhe mund të kërcënonte lehtësisht si krahët dhe rajonin qendror të NATO-s. Me një Gjermani jo vetëm të bashkuar por edhe në NATO dhe me shumicën e shteteve të ish-Evropës Lindore në këtë organizatë, ato avantazhe tashmë ishin cinguar. Tashmë forcat e NATO-s ishin pozicionuar drejtpërdrejt në kufijtë e Rusisë. Të vetmet

²⁴ Vladimir Putin, *“On the Historical Unity of Russians and Ukrainians”*, President of Russia, 12 July 2021, <http://www.en.kremlin.ru/misc/66182>

²⁵ Zbigniew Brzezinski (1928-2017), studiues i marrëdhënieve ndërkombëtare të ShBA-së dhe këshilltarë sigurisë kombëtare (1977-1981). Ai luajti rolin kyç në negociatat për traktatin e armëve bërthamore SALT II, 18 qershor 1979.

²⁶ Brzezinski, Z. *Strategic Vision: America and the Crisis of Global Power*, New York: Basic Books, 2012.

vende të cenushme të aleancës ishin vendet Baltike, por këto mund të bëhen kërcënime serioze nga NATO për Saint Petersburg, thelbin e industrisë së Rosisë, nëse përforcohen nga vendet e tjera të organizatës. Nëse mund të mendohet që Rusia do të kishte mungesë në *“thellësinë strategjike”*, kjo nuk ishte diçka që shfaqej për herë të parë ndaj saj. Normalisht që kufijtë e Rosisë, nëse Ukraina do të ishte pjesë e NATOS-s, janë shumë më shumë se sa të vendeve anëtare të NATO-s para pushtimit të saj. Kufijtë e sotëm tokësorë të Rosisë kufizohen nga 14 shtete ku, kufijtë me vendet që janë pjesë e aleancës janë: Estonia 324 km, Finlanda 1309, Letonia 332, Lituania 261 km, Norvegjia 191 km, Polonia 209 km ndërsa vetëm kufiri i Ukrainës është 1944 km²⁷.

Nëse mund të thuhet që asaj i është *“cenuar thellësia strategjike”*, ato janë të dukshme që në vitet 1990 me Marrëveshjen 2+4²⁸. Gjithsesi, për zgjerimin e mëvonshëm të NATO-s në vitin 1993, në letrën e Yeltsin drejtuar liderëve evropian, kërkonte garanci *“në terma shumë më të forta se sa ishin deklaruar ndonjëherë më parë”*²⁹. Në këtë kontekst, zgjerimi drejt lindjes sipas politikës së jashtme ruse, duhet të ishte më i kontrolluar se sa bashkimi i dy Gjermanive. Mund të thuhet që, qoftë për naivitët të liderëve rusë (teori që janë ringjallur së fundmi në Rusi), qoftë për një *“dobësim”* të përgjithshëm të Rosisë, apo faktor tjetër, zgjerimi i NATO-s në 1999 dhe 2004, krijoi pamjen e sotme të *“thellësisë strategjike”* të Rosisë.

Nëse fokusohemi në hartën e mundshme të Rosisë nëse ajo do të jetë e suksesshme, kapja e të gjithë Ukrainës do ti kishte dhënë Rosisë një rritje të thellësisë strategjike. Në këtë rast Rusia do kishte një kontroll të mundshëm të Detit të Zi, aftësi për të kontrolluar dhe dominuar Bjellorusinë dhe Moldavinë, dhe do t'i shtonte aksesin në Mesdhe, Ballkan, Bullgari, Iran, Irak, etj. Kapja e Ukrainës do ti kishte dhënë asaj mundësi në kontrollin e pjesës më kritike të drithërave në botë dhe eksporteve të tjera. Do ti jepte mundësinë e përdorimit të një leve ekonomike në përdorimin e eksporteve të saj të naftës dhe gazit dhe kontroll mbi bazën industriale të Ukrainës³⁰. Gjeopolitikisht pushtimi de facto i Ukrainës do ishte me pasoja në ruajtjen e rendit ndërkombëtarë (aq sa mund të jetë stabil). Siç përmendëm më sipër, nevoja për të qenë aktor global i Rosisë, me ardhjen dhe rriardhjen e herëpashershme të Putinit në pushtet, u bë më e dukshme pas viteve 2010.

²⁷ <https://www.cia.gov/the-world-factbook/field/land-boundaries/>.

²⁸ Hailbronner, Kay. *“Legal Aspects of the Unification of the Two German States”*, (PDF). European Journal of International Law. Marrëveshjen 2+4 u nënshkruar nga RFGJ, RDGJ dhe katër fuqi. (ShBA, BM, Franca dhe BS).

²⁹ Letra dërguar Clinton është de klasifikuar dhe e plotë gjendet në: <https://nsarchive2.gwu.edu//dc.html?doc=4390818-document-04-Re-translation-of-Yeltsin-letter-on>

³⁰ <https://oec.world/en/profile/country/ukr?latestDataNonSubnationalMonthSelector=202008>

Në praktikë, të njëjtat çështje strategjike ndihmuan në formësimin e sjelljes së shumicës së shteteve evropiane dhe të NATO-s në mbështetjen e Ukrainës. Ukraina shkaktoi ekuivalentin e një lufte shumë më të gjerë ndërmjet NATO-s dhe Ruisisë. Jo vetëm paralajmërimet e vazhdueshme të Zelensky-it, por shumica e partnerëve evropian dhe ShBA, bënë të qartë se pushtimi i Ukrainës ishte një pjesë e një kërcënimi shumë më të gjerë.

Kështu, filluan planet për të zgjeruar forcat e tyre ushtarake duke hartuar strategji të reja dhe mbështetur sanksionet jo vetëm politike. Kjo ishte një përgjigje shumë më ndryshe nga pushtimi Krimesë. Në atë kohë, shumica e vendeve të NATO-s nuk arritën të bënin ndryshime serioze në strategjitë e tyre. Vetëm 7 vende arritën në kufirin e 2% të shpenzimeve ushtarake dhe vetëm një nga këto, Polonia, u fokusua në rritjen domethënëse në aftësitë luftarake. Pasi Rusia sulmoi Ukrainën, shumica e vendeve të NATO-s dhe vendet fqinje me Rusinë, njoftuan për plane serioze për të rritur shpenzimet ushtarake. Ndërsa ShBA vazhduan të përqendroheshin te Kina, dhuroi ndihma të mëdha ushtarake dhe filloi të ristrukturojë forcat e saj në Evropë. Edhe NATO rivitalizoi aktivitetin e saj të planifikimit dhe miratoi konceptin strategjik 2022, që në thelb ishte rritja e aftësive mbrojtëse të saj kundër veprimeve ushtarake të Ruisisë.

Në mënyrë më koncize, luftimet shkaktuan një përzierje rajonale të luftës ekonomike dhe përpjekjeve ushtarake që kanë marrë karakterin e një lufte politiko-ekonomike midis Ruisisë dhe Perëndimit. Çdo pauzë e luftimeve midis Ruisisë dhe Ukrainës, ka shumë pak gjasa që ti japë fund luftës ekonomike, garës së armatimeve dhe ripërtëritjes të aftësive luftarake bërthamore midis Ruisisë dhe Perëndimit. Hapja e një gare armatimi, mund edhe mos të çojë në një konflikt më të zgjeruar por ai tashmë ka çuar në një formë të re të LF, konflikt që po i shton më shumë “karburant” konkurrencës strategjike.

Kjo konkurrencë do të formësohet nga rrjedha dhe rezultati i luftës midis Ruisisë dhe Ukrainës. Nëse Rusia do arrinte disi të marrë një fitore vendimtare ndaj Ukrainës, ndikimi më i madh strategjik do të jetë ripërcaktimi i kufirit të konfrontimit më të gjerë midis Perëndimit dhe Ruisisë me përfitime ruse. Nëse NATO do të krijojë një parandalim efektiv ajo do të duhet të intensifikojë shumë përpjekjet për të ndërtuar forcat e saj dhe për të siguruar parandalimin bërthamor strategjik. Një fitore e Ukrainës do të kishte pothuajse efektin e kundërt. Nëse një rezultat i tillë nuk do të largonte Putinin apo lider të tjerë të tillë, do të ushtronte edhe më shumë presion mbi Rusinë për të gjetur kundërshtarë të tjerë strategjik ndaj NATO-s apo do ta shtynte të rigjallëronte potencialin bërthamor dhe numrin e forcave të ushtarake. Ajo do të përpiqej edhe më shumë të përçajë vendet e NATO-s si dhe të risë ndikimin e saj ndaj vendeve që janë në kufi me NATO-n. Kjo mënyrë veprimi do të përfshinte një

gamë të gjerë operacionesh në zonën gri dhe ndryshimi midis konfrontimit dhe konfliktit mund të jetë minimal dhe i pa sigurt.

Si rezultat, ndikimi strategjik i luftës në Ukrainë mund të rezultojë të jetë më i qëndrueshëm dhe më i rëndësishëm për sa i përket efekteve të saj rajonale dhe globale se sa rezultati i luftimeve në Ukrainë. Çdo armëpushim ose marrëveshje paqeje midis Ukrainës dhe Rosisë do ta bëjë përsëri Ukrainën një pjesë të konfrontimit më të gjerë që po zhvillohet midis Perëndimit dhe Rosisë.

Përfundime

Panoramë e situatës aktuale ushtarake tregon që, nëse nuk do të kishim ndryshime të mëdha, rezultati i kësaj lufte do të jetë që ajo do vazhdojë me vite. Faktorë përmbysës së këtij parashikimi mund të jenë ndryshime jo vetëm të emrave në udhëheqjen e Rosisë por edhe në qasjen ndaj konfliktit, apo ndryshime të sjelljes së evropianëve dhe amerikanëve ndaj ofrimit të ndihmës ushtarake ndaj Ukrainës.

Perspektiva për një përfundim të shpejtë të luftës në Ukrainë janë minimale. Krahasuar me dy vitet e para të luftës, Putin është më i fortë politikisht se sa ushtarakisht. Presidenti Zelensky ka pranuar që ofensiva pranverore e ndërmarrë nga FA të Ukrainës, nuk arritën suksesin që ata dëshironin. Aktualisht Rusia kontrollon rreth 18 % të territorit të Ukrainës. Në dukje të parë kjo luftë do të zvarritet së vazhduari por jo pafundësisht. Ofensiva Ukrainase nuk është se ka ndalur por nuk ka as përparim rus. Më shumë se kurrë përfundimi i kësaj lufte varet nga vendimet politike të marra kilometra larg qendrës së konfliktit, në Uashington dhe në Bruksel.

Shpresohet që shfaqja mbresëlënëse e unitetit evropian dhe amerikan në vitet 2022 dhe disa lëkundje të saj në vitin 2023, të mos thellohet më tej në vitin 2024. Hezitimi në disa kryeqytete të Evropës, e kanë inkurajuar Putinin në planin e tij për një përballje me një Evropë jo të bashkuar. Është më e komplikuar që demokracitë të kenë një mbështetje afatgjatë për luftën se sa vendet që kanë regjime të tjera. Disa qëndrime të disa vendeve të BE-së, sidomos i Hungarisë, do të thotë që viti 2024 do të jetë më i vështirë për Ukrainën. Gjithsesi, në takimin e Janarit 2024 në Forumin Ekonomik Botëror, një nga katër akset që u përqendruan bisedimet, ishte arritja e sigurisë dhe bashkëpunimit në një botë të trazuar, në një botë që po hynë në një Luftë të Re të Ftohtë³¹.

Fund viti i shkuar u shoqërua me vendimin e BE-së për të hapur bisedimet e anëtarësimit me Ukrainën dhe Moldavinë. Hapja e bisedimeve nuk ka shumë rëndësi për faktin e fillimit të një procesi për të qenë sa më afër BE-së por më

³¹ Kaplan, R. "A New Cold War Has Begun" Foreign Policy, January 7, 2019

shumë. Kjo do të thotë në mënyrë implicite mbështetjen e vazhdueshme për Kievin pasi një e ardhme në BE e Ukrainës do të ishte e pamundur me një fitore të plotë të Ruisë. Politika amerikane ka gjasa që të mos ketë një kthim 180 gradë në politikën e saj të ndjekur ndaj Ukrainës. SHBA-të, si Kongresi por edhe Presidenti, ka miratuar në vazhdimësi paketa ndihmash por vazhdimësia mendohet që do ketë më shumë ngadalësi si për shkaqe të brendshme politike ashtu edhe për ato industriale.

Lufta në Ukrainë u kthye në një luftë të epokës industriale. Kjo luftë ka ndikime në ekonomi pasi industria e luftës e drejton prodhimin në drejtim të lëndëve të para për këtë industri. Lufta e epokës industriale është një luftë midis shoqërive, ajo që ndodh në fushën e betejës bëhet në fund të fundit vetëm një simptomë e asaj lufte.

Kjo ka ndikuar direkt në shtimin e buxhetit të shumë vendeve por edhe të Ruisë e cila e ka rritur buxhetin e saj me 30 % më shumë se sa dy vitet kaluara. Viti që sapo filloi do të demonstrojë nëse Rusia dhe furnizuesit kryesorë të saj Koreja e Veriut dhe Irani, apo Ukraina me mbështetësit e saj, do të jenë të përgatitur për të përmbushur kërkesat në rritje të luftës së epokës industriale.

Me shfaqjen e hezitimit perëndimor që mbështet Ukrainën dhe me mungesën e shkaqeve të shmangies së drejtimit të Ruisë nga Putini, i vetmi përfundim i parashikueshëm do të jetë një zgjidhje e negociuar që tani për tani të dyja palët vazhdojnë të refuzojnë. Pra në thelb, ky vit duket të jetë një vit konsolidimi në atë që kanë arritur, si Kievi ashtu dhe Moska. Në këto rrethana, edhe nëse do kishim një përfundim konflikti Rusi-Ukrainë, ai nuk do pasohej nga një paqe e vërtetë.

Viti 2024, është një vit në të cilin, jo vetëm kjo luftë apo konflikti Izrael-Hamas, por në tërësinë e tij, do të ketë ngjarje që do rrisin shkallën e kompleksitetit të mjedisit global. Në këtë vit janë zgjedhjet në ShBA, janë zgjedhjet për në Parlamentin Evropian dhe kemi zgjedhje të radhës në disa vende të Perëndimit. Gjithashtu Putini ka hedhur kandidaturën e pestë si president i Ruisë që mbahen në muajin mars të po këtij viti, zgjedhje të cilat nuk priten që të sjellin ndryshime në qeverisjen e Ruisë. Vështirësi e paparashikueshmërisë rritet nga një riformatim politik i mundshëm që mund të ndodhë në Evropë dhe ShBA, të cilat deri tashmë, me ulje ngritjet e tyre, kanë bashkëpunuar për ngjarje që mund të cenojnë rendin global.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Charles Kelly Bartles, Review of *“Preparation and Conduct of Military Actions in Local Wars and Armed Conflicts”*, Russian Studies Series

- 03/21, NATO Defense College, Rome, November 2018.
2. <https://www.rferl.org/a/russia-pirgozhin-wagner-ammunition-treason-ukraine-war/32380761.html>.
 3. <https://www.sipri.org/databases/milex>
 4. Konventat e Gjenevës, <https://ckrm.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/ZENEVSKI%20>
 5. North Atlantic Military Committee Decision on M.C.14/1: A report by the Standing Group on Strategic Guidance, <https://www.nato.int/docu/stratdoc/eng/a521209a.pdf>
 6. Rana Mitter, *China's Good War: How World War II is Shaping a New Nationalism*. Harvard University Press, 2020
 7. Robert Kaplan. "A New Cold War Has Begun" Foreign Policy, January 7, 2019
 8. Sergey Batyushkin, *Preparation and Conduct of Military Action in Local Wars and Armed Conflicts*, KnoRus, 2017
 9. Washington Post, <https://www.washingtonpost.com/world/2022/04/26/austin-putin-ukraine-support-military-russia/>
 10. Zbigniew Brzezinski. *Strategic Vision: America and the Crisis of Global Power*, New York: Basic Books, 2012.

Siguria dhe ndikimi i saj në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare

Nënkolonel (R) Msc. Kristo Rapo
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Teoritë klasike të marrëdhënieve ndërkombëtare na mësojnë se siguria është diçka që vjen me pavarësinë e ofruar nga sovraniteti. Sipas Thomas Hobbes' "siguria e njerëzve është ligji suprem" nga ku dalin detyrat e sovranëve dhe nga ku diktohet se qeveritë formohen për hir të paqes dhe se paqja diktohet për hir të sigurisë.

Marrëveshjet e veçanta të sigurisë realizohen nëpërmjet institucioneve dhe praktikave të diplomacisë, kushtet e të cilave zakonisht vendosen në mirëkuptime, dakordësi, procesverbale, shënime, deklarata, traktate, besëlidhje dhe statute. Kur diplomacia është e pamjaftueshme për të dhënë rezultatin e dëshiruar, kur një lloj kërcënimi bëhet i pa tolerueshëm dhe një zgjidhje e negociuar duket e pamundur, atëherë siguria ndiqet përmes veprimtarisë së luftës. Fuqitë e mëdha, më shumë se çdo institucion tjetër politik, ekonomik, social, fetar ose kulturor, janë të ngarkuara me përgjegjësinë e përcaktimit të interesave të tyre dhe për më tepër, rregullimit të politikave për hir të "paqes dhe sigurisë ndërkombëtare". E cilësuar kjo për pakicat që vuajnë nga shtypja e një shumice, mungesa e vetëvendosjes, dhe kësisoj anëtarësimin në shoqërinë e shteteve, ofron mundësinë e sigurisë.

Fjalët kyçe: siguria, marrëdhëniet ndërkombëtare, sistemi politik, sovraniteti, dilema e sigurisë, shteti juridik, balanca e fuqive.

¹ Thomas Hobbes, filozof anglez i shekullit të 17-të.

Hyrje

Lufta dhe konflikti i armatosur ka ndikuar seriozisht në kushtet e jetesës së një numri të madh njerëzish në një mënyrë shumë negative gjatë historisë. Studimet rreth sigurisë filluan si një mënyrë për të kapërcyer ose reduktuar pasojat e konflikteve të armatosura. Kështu që rëndësia e sigurisë ndërkombëtare dhe studimi i saj nuk mund të nënvlerësohet. Nëse dikush përpiqet të përmirësojë kushtet e jetesës së të gjithë popujve të globit, atëherë një aspekt shumë i rëndësishëm për t'u marrë parasysh është parandalimi i konfliktit.

Përballë një konteksti strategjik gjithnjë e më kompleks dhe të paqëndrueshëm, forcat progresiste në botë, veçanërisht BE-ja dhe SHBA-të, janë përkushtuar për të forcuar sigurinë dhe stabilitetin duke mbrojtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, sipas organizmave ndërkombëtarë dhe siç përcaktohet nga Karta e OKB-së. Kjo mund të arrihet nëpërmjet reagimit ndaj krizave, ndërtimit të kapaciteteve, veçanërisht për rritjen e sigurisë kibernetike, dhënien e ndihmës humanitare etj. Fuqitë e mëdha, fuqitë e mesme, por edhe ato me ndikim rajonal apo global duhet të jenë aktorë të përgjegjshëm dhe të dobishëm për sigurinë në botë. Në kontekstin e sotëm gjeopolitik në ndryshim, partneritetet e sigurisë e të mbrojtjes reciprokisht të dobishme janë thelbësore për të mbështetur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla dhe multilaterizmin efektiv, për të arritur qëllimet e përbashkëta dhe për të kontribuar në paqen dhe sigurinë në mbarë botën. Bashkëpunimi midis të gjitha organizmave dhe me partneritetet është një shtyllë kyçe për agjendën e sigurisë dhe mbrojtjes ndërkombëtare.

Nëpërmjet hapjes së rrugëve për dialog dhe partneritet sa më koherent, konsistent dhe gjithëpërfshirës duhet synuar që të mbahet një nivel i lartë ambicie në siguri dhe mbrojtje. Është koha që nëpërmjet organizmave ndërkombëtare, forumeve, iniciativave, marrëveshjeve apo traktateve të bëhet vlerësimi kolektivisht në kontekstin e zhvillimeve gjeopolitike dhe partneriteteve të sigurisë dhe mbrojtjes. Të gjithë së bashku, politikanë, vendimmarrës të lartë, përfaqësues ushtarakë, shoqëria civile, liderë të mendimit dhe formues të opinionit duhet të shqyrtojnë tendencat, çështjet dhe iniciativat në siguri dhe mbrojtje dhe se si ato mund të kontribuojnë në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Tashmë është e qartë se të gjitha shtetet dhe qeveritë e tyre duhet të mbështesin dhe jenë të bashkuar pas rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla dhe në unison me Kombet e Bashkuara në thelbin e tij. Kjo është diçka që i bashkon të gjithë dhe i orienton ato, për të vazhduar të punojnë në thelbin e sistemit ndërkombëtar dhe jo vetëm për ta mbrojtur atë por për ta bërë edhe më të fortë. Të gjithë e dimë se partneriteti nuk është një varësi, por është një forcë, pra të

bëhesh partner do të thotë të jemi më të fortë. Që të përfitojmë të gjitha palët duhet që të përshtatim partneritetet tona të dobishme reciproke, me qëllim që kjo të na ndihmojë të përmbushim përgjegjësitë tona ndërkombëtare. Në forumin Shuman për Siguri dhe Mbrojtje J. Borrel theksoi: “Unë dua t’ju dërgoj një mesazh: Bashkimi Evropian lindi për të zgjidhur problemet brenda Evropës. Bashkimi Evropian erdhi nga hiri i luftës, nga një luftë e tmerrshme. Evropa pothuajse bëri vetëvrasje. Ne po vrisnim njëri-tjetrin aq shumë sa në fund, vendosëm që duhej të bëhej paqja - dhe e bëmë (atë)”.² Gjithashtu, Borrel ndër të tjera theksoi se “Lufta e Ftohtë mbaroi dhe bota u bë globale. Tani Bashkimi Evropian duhet të realizojë diçka më shumë sesa thjesht të bëjë paqe mes evropianëve, por të jetë një aktor në botë që mund të kontribuojë për një botë më të mirë. Ne duam të bëhemi një partner më i fortë dhe më i vlefshëm, brenda NATO-s po se po, por dhe me pjesën tjetër të botës pra me këdo që dëshiron të kontribuojë për një botë paqësore dhe të begatë. Duhet të marrim seriozisht rolin e gjithsecilit komb apo shtet, i fuqishëm, i dobët me apo pa influencë qoftë, në botën globale në të cilën po jetojmë, e cila nuk është aspak bota e vitit 1945, as ajo e fundit të shekullit të kaluar, por është krejtësisht ndryshe dhe në këtë botë të re, ne mund dhe duhet të bëjmë më shumë dhe më mire, sot e për vitet në vijim.”

1. Siguria, një vlerë thelbësore e jetës njerëzore, detyrim reciprok i shtetit dhe qytetarëve

Termi i sigurisë është i lidhur ngushtë me atë të sovranitetit. “Siguria” vjen nga latinishtja *securitas*, që do të thotë liri dhe që rrjedh nga kujdesi ose siguria. Kjo fjalë u përcoll në gjuhët romane e më pas në anglisht, me të njëjtin kuptim thelbësor krejtësisht të paprekur. Domethënia më e rëndësishme e “sigurisë” është kushti që “të jesh i mbrojtur ose jo i ekspozuar në rrezik”³. Kjo nënkupton të qenit “i lirë nga kujdesi, frika ose ankthi apo alarmi”, që është një ndjenjë sigurie ose lirie nga mungesa e rrezikut. Hedley Bull⁴, lidhur me thelbin e sigurisë për qëllimet tona argumenton se “siguria në politikën ndërkombëtare nuk do të thotë asgjë më shumë se siguri: ose siguri objektive, siguri që ekziston në të vërtetë, ose siguri subjektive, ajo që është ndjerë ose përjetuar”. Ajo është strehë dhe përkujdesje në marrëdhëniet tona me njerëzit e tjerë, të cilët së bashku me shtetet e bëjnë veten të sigurt duke krijuar forca të armatosura, kontakte diplomatike dhe rregullime të tjera që synojnë mbrojtjen e tyre.

² Fjalimi i përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Josep Borrel, mbajtur në Forumin Shuman për Siguri dhe Mbrojtje, mars 2023.

³ Marrë nga Oksford, fjalori anglez.

⁴ Hedley Norman Bull, professor of International Relations at the University of Oxford.

Së pari, duhet të kuptojmë idenë e sigurisë si një vlerë thelbësore e jetës njerëzore dhe supozimet themelore të saj. Për të qenë të sigurtë nuk duhet të ndikohemi nga rreziku apo frika. Dëshira për siguri është një përgjigje mbrojtëse dhe vetëmbrojtëse ndaj faktit ose kërcënimit që mund të dëmtohem nga qeniet e tjera njerëzore. Nëse nuk do të kishte njerëz kërcënues, nevoja për të garantuar sigurinë do të zhdukej. Katër supozimet kryesore që qëndrojnë në themel të idesë së sigurisë janë: siguria në çfarë, nga çfarë, për çfarë dhe me çfarë mjetesh.

Çështjet e sigurisë dhe pasigurisë janë pjesë përbërëse e të gjitha çështjeve që lidhen me problemet dhe praktikatat e diversitetit etnik në një botë të shteteve kombëtare, duke përfshirë vetëvendosjen, kufijtë, të drejtat e njeriut dhe të pakicave, spastrimin etnik, gjenocidin dhe ndërhyrjen humanitare. Këto theksojnë rëndësinë e sigurisë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Ashtu siç është mbijetesa fizike çështje parësore e çdo individi, ashtu edhe siguria kombëtare është çështje parësore e çdo shteti. Kontrolli që bëjmë nëse është mbyllur dera hyrëse e shtëpisë para se të flemë, është dilema e sigurisë. Kurse shteti, me monopolin e tij ndaj përdorimit të forcës, është ai që kujdeset për rendin dhe qetësinë e qytetarëve, ndërsa natyra anarkiste e politikës ndërkombëtare i bën shtetet më vete shumë të pasigurta, kur bëhet fjalë për qëllimet e shteteve të tjera. Kështu, në mungesë të një qeverie të vetme botërore dhe pranisë së subjekteve të armatosura (shteteve) të cilat sjellin vendime autonome për luftë dhe paqe, lind ajo që Jon Herc⁵ e quan “dilemë e sigurisë”, e cila mund të shpjegohet në këtë mënyrë: “Kërkimi i sigurisë nga ana e një shteti A prodhon pasiguri te një shtet tjetër B, i cili duke u frikësuar nga qëllimet e shtetit A, ndërmer masa për të rritur sigurinë e tij, por kjo veçse e përforcon pasigurinë e shtetit A dhe kështu deri në pafundësi, e ndonjëherë deri në absurditet! Sipas shkencave politike dilema e sigurisë është një situatë në të cilën veprimet e ndërmarra nga një shtet për të rritur sigurinë e vet shkaktojnë reagime nga shtetet e tjera. Këto reagime ndikojnë dhe sjellin një zvogëlim dhe jo rritje të sigurisë së këtij shteti.

Me anëtarësimin në NATO, vendi ynë e zgjidh dilemën e sigurisë me fqinjët e vet. Shtetet e vogla në Ballkan me armatat qesharake në miniaturë nuk do të ishin aspak qesharake kur do të fillonin të luftonin me njëra-tjetrën, duke e zgjidhur përmes konfliktit dilemën e tyre të sigurisë. Kështu, të ulur në tryezë të përbashkët në Bruksel, nën ombrellën e Amerikës, vendet e Ballkanit bashkëpunojnë dhe hartojnë planet e veta të sigurisë.

Çdo shtet harton politikën e sigurisë kombëtare, që është dokument ku përshkruhet se si një vend ofron siguri për shtetin dhe qytetarët e vet dhe

⁵ Jon H. Herz, është studiues amerikan i marrëdhënieve ndërkombëtare që formuloi konceptin e “security dilemma”.

shpeshherë prezantohet si një dokument i përgjithësuar. Ky dokument mund të quhet gjithashtu plan, strategji, koncept ose doktrinë dhe ka një rol për të tashmen dhe të ardhmen, pasi skicon interesat bazë të vendit dhe përcakton udhëzimet për trajtimin e rreziqeve dhe mundësive aktuale apo në të ardhmen. Ato janë në hierarki superiore ndaj politikave të tjera të sigurisë, si doktrinës ushtarake, strategjisë së sigurisë së brendshme etj., të cilat merren me sigurinë kombëtare në bazë të agjencive apo çështjeve të veçanta. Gjithashtu, dallohet prej tyre nga gama e temave që trajton dhe përpiqet të skicojë si rreziqet e brendshme, ashtu edhe ato të jashtme. Së fundi, ajo mëshon t'i integrojë dhe të bashkërendojë kontributet e aktorëve të sigurisë kombëtare në raport me interesat dhe rreziqet që konsiderohen më të rëndësishmet dhe me ato ndërkombëtare.

Disa shtete, si Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Kina nuk kanë dokument të veçantë e të unifikuar të politikave të sigurisë, por mbështeten te politikat e mbrojtjes ose në “dokumente të bardha” – projekt-dokumente të politikave, që përqendrohen vetëm në mbrojtjen kombëtare. Një pjesë tjetër e shteteve nuk i bëjnë publike këto dokumente ose nuk i kanë të shkruara politikat gjithëpërfshirëse për sigurinë apo mbrojtjen. Është e domosdoshme që shtetet duhet të kenë një politikë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të sigurisë kombëtare dhe arsyet kryesore janë:

- të sigurojë që qeveria do t'i trajtojë të gjitha rreziqet në mënyrë gjithëpërfshirëse;
- të rrisë efikasitetin e sektorit të sigurisë duke optimizuar kontributet e të gjithë aktorëve të sigurisë;
- të drejtojë zbatimin e politikës së sigurisë;
- të ndërtojë konsensusin e brendshëm të vendit;
- të rrisë besimin dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Për një kohë të gjatë rreziqet e brendshme dhe të jashtme janë trajtuar veçmas, por gjithnjë e më shumë politikat e sigurisë janë duke përfshirë vlerësimet gjithëpërfshirëse si të mjedisit të brendshëm ashtu edhe të atij ndërkombëtar, duke u formuluar si një kornizë gjithëpërfshirëse, produkt i një analize të thellë e të gjitha rreziqeve ndaj sigurisë kombëtare. Kjo kërkon që të konsultohen të gjitha palët e interesuara, qeveritarë të ndërlidhur me çështjet e sigurisë dhe, do të ishte ideale po të merrej edhe kontributi i palës ndërkombëtare dhe asaj joqeveritare. Këto politika mund të ndihmojnë në harmonizimin e kontributeve të numrit në rritje të palëve të sigurisë, duke përfshirë ata të nivelit kombëtar, qeverisjes lokale, komunitetit të biznesit (p.sh., në mbrojtje të infrastrukturës jetike), organizatat e ndryshme të shoqërisë civile, si dhe institucionet rajonale dhe ndërkombëtare.

Palët politike që përfshihen në sigurinë kombëtare duhet të drejtohen nga

politika e sigurisë kombëtare, e cila ofron modele për bashkërendimin e vendimeve operative me pikësynimet afatshkurtra dhe afatgjata të kësaj politike. Nëpërmjet procesit të centralizuar bëhet i mundur përdorimi optimal i burimeve, duke iu shmangur pabarazive, gjërave të panevojshme dhe mungesave gjatë hartimit dhe zbatimit. Duke thelluar diskutimin dhe bashkëpunimin përgjatë linjave profesionale, qeveritare dhe partiake sigurojmë zbatim sa më të gjerë të politikës së sigurisë. Ky dialog kontribuon për krijimin e një konsensusi në lidhje me vlerat dhe interesat kombëtare bazë, si dhe rreziqeve që i sfidojnë ato.

Politikat e sigurisë kombëtare janë instrumente për ndërtimin e besimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Një politikë koherente dhe transparente ia komunikon bashkësisë ndërkombëtare shqetësimet e shtetit në lidhje me sigurinë, duke mundësuar kështu mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në shkallë ndërkombëtare. Sfidat kryesore për politikën e sigurisë kombëtare janë:

- Të baraspeshojë hapjen dhe fshehtësinë. Disa vende përpiqen ta shmangin këtë duke përdorur gjuhë të paqartë (njihet si “paqartësi strategjike”). Përmbajtja e saj duhet të pasqyrojë pikësynimet e përgjithshme të sigurisë, ndërsa zbatimin e tyre t’ua lerë doktrinave dytësore ose mekanizmave të tjerë të planifikimit.
- Të perceptohet si një konflikt mes nevojës për të ruajtur lirinë e veprimit dhe kufizimeve të vendosura në veprimet e drejtuesve. Shumë shtete parapëlqejnë të merren me çështje të veçanta se sa me vende të veçanta, ndërsa në se duhet t’i jepet një sinjal i qartë ndonjë vendi, ai mund të përmendet me emër.
- Të baraspeshohen çështjet e politikës së sigurisë kombëtare kundrejt kostos së tyre, qoftë në aspektin njerëzor, qoftë në atë material.
- Të baraspeshojë debatin publik me kontributin e ekspertëve, në qoftë se ka një perceptim se dokumenti është bërë peng i interesave politike, kjo mund të minojë dobinë e tij.

Ekziston një përgjegjësi e ndërsjellë e shtetit dhe e individit. Qytetari është i detyruar të ndërmarrë veprime për të ruajtur një shoqëri të shëndoshë. Këto përfshijnë ndihmën për zbatimin e ligjit, rritjen e fëmijëve të shëndetshëm, pjesëmarrjen në jetën sociale, pagesën e taksave etj. Marrëdhënia midis shtetit dhe individit shprehet në mbrojtje të plotë të këtij të fundit nga institucionet e pushtetit shtetëror, siguria e individit mbrohet me ligj. Sipas Hobbs “Siguria e njerëzve është ligji suprem”. Në periudhën moderne, ideja e vlerës më të lartë të të drejtave dhe lirive është deri diku deklarative. Gatishmëria e shtetit dhe e shoqërisë për zbatimin praktik të modelit të shtetit juridik përcaktohet në konsolidimin kushtetues të parimeve bazë të tij, gjë që tregon zhvillimin evolucionar. Natyra e marrëdhënies midis shtetit dhe individit është treguesi më i rëndësishëm i sigurisë dhe kushteve të shoqërisë në përgjithësi. Kufizimet

ligjore për lirinë e njerëzve dhe veprimet në shoqëri janë objektive, prandaj shteti duhet të përcaktojë kufijtë e ndërhyrjes së tij në këtë fushë. Për më tepër, ato janë të përqendruara në interesat e vetë njerëzve, në mënyrë që një person të mos vuajë nga liria e një personi tjetër. Është shumë e rëndësishme të qartësohet përgjegjësia reciproke midis shtetit dhe individit. Nëse një person është përgjegjës për veprimet e tij, funksioni më i rëndësishëm i shtetit është të mbrojë jetën, sigurinë, pronën dhe lirinë e tyre. Kontradiktat duhet të zgjidhen nga organet e paanshme gjyqësore mbi bazën e një të drejte ligjore.

Edhe në lashtësi, ideja e ndërtimit të një shteti ligjor dhe siguria e individit ka shqetësuar mendimin filozofik, duke qenë në kërkim të formave të së drejtës të jetës publike, ndaj sundimit despotik dhe absolutizmit. Problemet e formimit dhe zhvillimit të një shteti juridik, parimet themelore të tij, marrëdhëniet midis shtetit dhe shoqërisë mbeten ende të pazgjidhura. Sot, shtetet aspirojnë të bashkohen në një bashkësi të vetme globale, të ndërtuar mbi ndërvëprimin dhe respektin e ndërsjellë, gjë që rrit më tej interesin për çështjen e sigurisë dhe të një shteti ligjor për zhvillimin e vlerave të përbashkëta të individit dhe ato universale për të gjitha shtetet.

Në këtë drejtim, një shtet juridik, i ndërtuar mbi parimin e shtetit të së drejtës, që konsiderohet si prioriteti më i lartë, ndryshon përkufizimin në: “Krijimi i një sistemi garancish politike, juridike, civile dhe publike që garantojnë vlefshmërinë e dispozitave kushtetuese, përgjegjësia reciproke e shtetit dhe e individit, përbëjnë procesin e formimit të shtetit ligjor”⁶. Kjo çon në shfaqjen e një marrëdhënieje të re midis individit dhe qeverisë, që është thelbësisht ndryshe nga një shtet autokrat. Shoqëria civile, ku qytetarët e lirë janë të bashkuar, përfaqëson një bazë sociale për një shtet ligjor. Ajo realizon të drejtat dhe liritë individuale të një personi, mundësitë e punës krijuese, mbështet dhe siguron pluralizëm mendimesh. “Tranzicioni në një shtet ligjor nga metodat totalitare shoqërohet me një riorientim të mprehtë dhe intensiv të veprimtarisë shoqërore të pushtetit shtetëror”⁷.

Baza e një shteti juridik janë parimet e drejtësisë dhe humanizmit, barazia e të drejtave dhe lirive individuale. Ky shtet, duke ushtruar epërsinë e pushtetit dhe ekskluzivitetin e tij, realizon sigurimin e plotë të lirisë së marrëdhënieve publike, bazuar në barazi dhe drejtësi për të gjithë qytetarët duke garantuar sigurinë e tyre. Një shtet kombëtar i mirë qeverisur është një organizatë e sigurtë sigurie. Ishte kjo arsyeja që ai zëvendësoi përfundimisht klanet, shoqëritë fisnore, çifligjet, qytetet e lira, esnafët mesjetarë, dukatet, shtetet dinastike dhe madje edhe perandoritë, për t’u bërë forma bazë e organizimit

⁶ Afanasev, S. A. (2017) *Political rights and freedoms*.

⁷ Avdeev, D. A. (2017) *Constitutional and municipal law*, 3.

politik modern. Termi “siguri kombëtare” i referohet kështu të gjitha atyre politikave publike nëpërmjet të cilave shteti kombëtar siguron mbijetesën e tij si një komunitet i veçantë dhe sovran, duke e bërë këtë, sigurinë dhe prosperitetin e qytetarëve të tij. Detyrimi reciprok i sigurisë ndërmjet shtetit kombëtar dhe qytetarëve të tij është baza normative mbi të cilën justifikohet pretendimi i shtetit kombëtar për të qenë mbrojtës i popullit. Megjithatë, që modeli i sigurisë kombëtare të jetë i vërtetë, fuqia shtrënguese e shtetit duhet të përdoret si mjete i fundit dhe sa më rrallë që të jetë e mundur.

2. Siguria në këndvështrimin e shoqërisë ndërkombëtare dhe roli i fuqive të mëdha

Siguria ndërkombëtare aspirojnë drejt arritjes së një kushti të përgjithshëm të paqes, rendit dhe ligjshmërisë brenda shoqërisë së shteteve. Historia e shoqërisë ndërkombëtare paraqitet si një luftë e vazhdueshme me problemet e çrregullimit dhe pasigurisë, si shoqëruese të saj. Në praktikë, përgjegjësia kryesore për ofrimin e sigurisë ndërkombëtare ka rënë mbi ato shtete që ne i referohemi si fuqi të mëdha. Roli i tyre do të vlerësohet nga balanca e fuqisë dhe koncepti i fuqive të mëdha. Një problem i përsëritur është ai i garantimit që të gjitha fuqitë e mëdha të mbeten dhe luajnë rolin e qytetarëve të mirë ndërkombëtarë, që veprojnë për të mbështetur e jo për të përmbysur ligjin ndërkombëtar dhe balancën e fuqive. Kur një fuqi e madhe fillon të veprojë si një ngacmues ose jashtë ligjeve ndërkombëtare, siguria rrezikohet dhe rritet potenciali për luftë. Këto trajtohen si kufizime themelore të sigurisë ndërkombëtare në kontekstin e ndërhyrjes ushtarake, mospërhapjes bërthamore dhe ndryshimeve klimatike.

Parimet kryesore organizative si sovraniteti, barazia formale, pavarësia dhe mosndërhyrja në punët e brendshme, të cilat ende qeverisin shoqërinë ndërkombëtare të shteteve, u parashtruan në disa traktate të bashkuara së bashku si “Paqja e Vestfalisë” në 1648.⁸ Megjithatë, disa shtete kanë qenë gjithmonë më të privilegjuar se të tjerët. Midis gati 200 shteteve të fillim-shekullit të njëzet e një, disa janë fuqitë më të mëdha rajonale ndërsa disa janë vende mjaft të vogla. Historikisht, shtetet e vogla ushtrojnë rrallë ndikim të madh në çështjet botërore dhe shpesh nuk kanë qenë as të lirë të zgjidhnin rrugën e tyre historike. Në rastet kur shtetet e vogla janë me ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare, zakonisht janë në një kuptim negativ: ata rriteshin në rëndësi nëse ishin objekt agresioni ose konkurrence midis fuqive të mëdha, ose pengje të balancës rajonale të ndarjes së pushtetit nga fuqitë e mëdha.⁹

⁸ Kjo marrëveshje u përfundua në qytetet e Osnabruck dhe Munster të rajonit të Vestfalisë, Gjermani.

⁹ Francisco de Vitoria, filozof, teolog dhe jurist katolik i liraljaljes spanjolle, Universitetin e Salamankës, Spanjë (1991), fq. 290–1

Shumë prej tyre historikisht janë interesante dhe të rëndësishme në vetvete dhe disa luajnë rol të rëndësishëm në çështjet rajonale. Megjithatë, pavarësisht nga trumbetimet politike se historitë e të gjitha kombeve kanë peshë të barabartë morale, e vërteta mbetet se ato nuk janë boshti rreth të cilit rrotullohet historia botërore dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, por janë fuqitë e mëdha që i përcaktojnë ato, qoftë duke vepruar veçmas apo së bashku. Për të njëjtën arsye, konsideratat kryesore etike që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë ndërkombëtare kanë qenë dhe mbeten domeni i shteteve më të mëdha dhe më të fuqishme.

Termi “**fuqi e madhe**”¹⁰ nënkupton një shtet sovran që është i njohur si shtet, i cili ka aftësinë dhe ekspertizën për të ushtruar ndikimin e tij në shkallë globale. Këto shtete posedojnë forcë ushtarake dhe ekonomike, si dhe ndikim diplomatik dhe mundësi imponuese, që mund të çojnë deri në atë pikë ku shtetet e mesme apo të vogla të marrin në konsideratë mendimet e tyre, para se të ndërmarrin vendimet apo veprimet e veta. Sipas marrëdhënieve ndërkombëtare statusi i “fuqive të mëdha” mund të karakterizohet në aftësitë e pushtetit, aspektet hapësinore dhe dimensionet e tij. Ky status mund të njihet formalisht në konferenca të tilla si: Kongresi i Vjenës, ose një strukturë ndërkombëtare si Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (Kina, Franca, Rusia, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA janë pesë anëtarë të përhershëm). Njëkohësisht ai mund të njihet jo zyrtarisht në një forum të tillë si G7, që përbëhet nga Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Britania e Madhe dhe SHBA.

Fuqi e mesme, në marrëdhëniet ndërkombëtare, është një shtet, pozicioni i të cilit në spektrin e fuqisë ndërkombëtare është në “mes”, pra nën atë të fuqive të madhe, por me aftësi të mjaftueshme për të formësuar ngjarjet ndërkombëtare.

Fuqi e dobët ose varësia nga jashtë, janë shtetet në strukturën globale të fuqisë të cilët mbështeten ekonomikisht nga vendet më të forta, duke i lejuar këto të fundit të ushtrojnë kontroll të rëndësishëm mbi sjelljen ekonomike dhe politike të tyre. Kjo nxit moszhvillimin, adoptimin e politikave për interesat e një vendi më të fortë, që mund të pengojë rritjen e brendshme, të përshpejtojë shkatërrimin e mjedisit ose të krijojë rritje të përkohshme që përjashton zhvillimin e qëndrueshëm dhe pavarësinë ekonomike.

Cathal J. Nolan¹¹ ka shqyrtuar marrëdhëniet e sigurisë dhe të fuqive të mëdha, të cilat pavarësisht nga një doktrinë e “barazisë radikale shtetërore” që u shfaq nxitimthi gjatë dekolonizimit, ende formojnë “boshtin rreth të cilit rrotullohet historia botërore dhe marrëdhëniet ndërkombëtare”. Rrjedhimisht, pyetjeve të

¹⁰Termi “Fuqitë e Mëdha” u përdor për herë të parë në një traktat, vetëm në 1815, në Kongresin e Vjenës.

¹¹ Cathal J. Nolan është Drejtor i Institutit Ndërkombëtar të Historisë në Shkollën Pardee të Studimeve Globale dhe Profesor i Historisë në Universitetin e Bostonit.

sigurisë u përgjigjen duke iu referuar interesave dhe vlerave të këtyre të parëve mes të barabartëve, kjo për arsye sepse pushteti është ende monedha kryesore e marrëdhënieve ndërkombëtare. Nolan argumenton se një etikë e re e sigurisë ndërkombëtare e nisur nga SHBA-të ka evoluar në një “konsensus të përafërt rreth një pikëpamjeje të modifikuar liberale ndërkombëtariste, një wilsonianism¹² më të kujdesshëm, i cili e sheh sigurinë afatgjatë kombëtare dhe ndërkombëtare si të arritur nga përparimi drejt një konfederate të shoqërive të ndërvarura e të lira”. Megjithatë, kërcënimi më i madh për këtë konsensus vjen jo nga një Amerikë e gjallëruar nga një politikë e jashtme muskulore e “ndryshimit të regjimit”, por nga një Rusi autokratike dhe një Kinë enigmatike.

Kongresi i Vjenës dhe sistemi i proceseve në të cilin ai çoi, ishte një pikë kthese e vërtetë. Shënohet si e para nga katër përpjekjet e mëdha në historinë moderne ndërkombëtare për të mbështetur bashkëpunimin e fuqive të mëdha në kohë paqeje, në arritjen e një mundësie më të mirë të marrëdhënieve ndërkombëtare nëpërmjet konsultimeve të vazhdueshme dhe marrjes së vendimeve me konsensus bazuar në marrëveshjet e përgjithshme dhe parimet e drejtësisë ndërkombëtare. Në secilën nga tre përpjekjet e mëparshme (1815, 1919-20 dhe 1944-45), aleancat fitimtare të përbëra nga fuqitë e mëdha jashtëzakonisht të ndryshme dhe shpesh armiqësore u përpoqën të zgjeronin zakonet e bashkëpunimit të kohës së luftës në periudhën e pasluftës. Ata e bënë këtë jo vetëm për të formuar dhe kontrolluar gjeopolitikën e botës së pasluftës, megjithëse ky motiv sigurisht ishte i pranishëm, por edhe për të ndërtuar një shoqëri ndërkombëtare më të rregullt dhe të ligjshme. Sa herë që u tentua një gjë e tillë, nuk arritën që ato të mbështesin përpjekjet e tyre, duke u përplasur për dallimet territoriale ose ideologjike, ose duke rënë pre e revanshizmit të hidhur të disa fuqive të tjera të mëdha të mbetura jashtë konsensusit nga disfata, ose për arsye ideologjike ende të pa pajtuara me idenë e partneritetit.

Në marrëdhëniet midis fuqive të mëdha ende dominojnë konsideratat thelbësore etike të sigurisë ndërkombëtare, sepse fuqia si një motiv dhe forcë lëvizëse në punët e shteteve dhe kombeve ruan një rëndësi të gjithanshme dhe mbetet qendrore për arritjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të sigurisë. Me fundin e Luftës së Ftohtë dhe me triumfin e dukshëm të ideve liberale ndërkombëtare për sigurinë, pjesërisht në fakte dhe globalisht në retorikë në të drejtën ndërkombëtare, realiteti tregon ende betejat e konfliktit të pushtetit midis komuniteteve politike diskrete (shtetet). Me fillimin e shekullit të njëzetë ekziston një konsensus i pashprehur midis fuqive të mëdha për detyrimet e tyre themelore ndërkombëtare. Parimet kryesore të këtij konsensusi janë:

- Të ruajnë një rend të shëndoshë politik dhe shoqëror brenda kufijve të tyre kombëtarë, të cilët duke pasur parasysh përmasat e tyre të mëdha përfshijnë

¹² Termi vjen nga idetë dhe propozimet e Presidentit Woodrow Wilson

pjesën më të madhe të botës.

- Të ruajnë rendin politik në rajonet e tyre, nëse është e nevojshme dhe me ndërhyrje ushtarake, ose atë që dikur quhej “sferat e tyre të ndikimit” apo edhe “oborret e tyre”.
- Të bashkëpunojnë për ruajtjen e një rendi ndërkombëtar sigurie që respekton të drejtat sovraane të gjithë anëtarëve, por gjithnjë e më shumë pranon një të drejtë të kufizuar të hetimit ndërkombëtar dhe madje edhe të ndërhyrjes kolektive, për të lehtësuar pasojat njerëzore dhe për të bllokuar agresionin nga shtetet që kërcënojnë të përdorin armë të shkatërrimit në masë.
- Të respektojnë dhe përçojnë korpusin kryesor të së drejtës ndërkombëtare ndaj vetes (d.m.th., detyrimet ndërmjet anëtarëve të shoqërisë së shteteve).
- Të promovojnë tregtinë e lirë si një e mirë praktike e favorshme për prosperitetin e ndërsjellë dhe për paqen afatgjatë ndërkombëtare.
- Të ofrojnë ndihmë humanitare në kohë katastrofash dërrmuese kombëtare ose në vende ku “shtetet e dështuara” ose regjimet gjenocide shkaktojnë kriza të rënda humanitare.
- Të bashkëpunojnë për gjetjen e zgjidhjeve për çështjet e rëndësishme globale që mbeten përtej zgjidhjes nga ndonjë shtet apo rajon i vetëm.

Ruajtja e një rendi të arsyeshëm, të drejtë të brendshëm politik dhe shoqëror renditet në krye të listës së detyrimeve të fuqive të mëdha. Megjithatë, provat sugjerojnë se ruajtja e stabilitetit të brendshëm është edhe një sukses që në fund të fundit mbështetet përparimin jo vetëm të marrëdhënieve politike, sociale dhe ekonomike brenda vendit, por është dhe kontributi i vetëm më i madh që çdo shtet, veçanërisht një fuqi e madhe, mund të japë për sigurinë ndërkombëtare. Dy shtetet që kanë bërë më shumë se çdo tjetër për të çuar përpara një etikë të re ndërkombëtare të sigurisë bashkëpunuese, SHBA-të dhe Britania e Madhe janë historikisht më të qëndrueshme dhe më të suksesshme brenda vendit. Shtetet që sot njihen si fuqi të mëdha janë: Kina, Japonia, Rusia dhe SHBA-të, por kësaj liste duhet t’i shtohet dhe India si një fuqi në rritje, ndonëse e penguar nga mosmarrëveshjet e brendshme, politikat e vjetruara ekonomike dhe marrëdhëniet intensivisht armiqësore me fqinjët dhe rivalët kryesorë bërthamorë. Koha mund ta ndryshojë këtë listë, por ajo është po aq e besueshme sa çdo tjetër që mund të mblidhet në këtë moment historik të pasigurisë dhe tranzicionit të madh.¹³

Shumë çështje apo pyetje vazhdojnë të ekzistojnë rreth qeverisjes së fuqive të mëdha. Largimi i SHBA-ve nga një rol tradicional stabilizues, politika e “ndryshimit të regjimit” dhe “çlirimit dhe largohu”, qoftë përfundimisht e suksesshme apo jo, nuk ka gjasa të ndryshojë modelet më të mëdha të

¹³ Platoni (1993), f. 60, 196–212

ndërveprimet diplomatik dhe politik ndërkombëtar. Këto modele janë vendosur nga luftërat e mëdha, të nxehta dhe të ftohta të shekullit të kaluar, normat dhe vizioni diplomatik, të përqendruara te lidershipi i qëndrueshëm dhe fuqia ushtarake e ekonomike e SHBA-ve.

Së pari, çështja më kyç dhe më e diskutueshme sot është Rusia, përçarësi i madh i sigurisë ndërkombëtare gjatë gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë e në vazhdim. Rusia e pas luftës së ftohtë mbetet një shoqëri e brendshme e paqëndrueshme dhe thellësisht e padrejtë. Në vend që të konvertohet në një shoqëri tregu e cila mund të thithë sovjetikën e saj, ajo u deformua në një kleptokraci në të cilën nomenklatura dhe shërbimet e sigurisë ishin aleate me kriminelët tradicionalë për të zgjedhur eshtrat e një sistemi të vdekur. Liderët rusë kanë qenë dhe janë formalisht dhe retorikisht demokratë, ata synojnë të luajnë lojën e vjetër të epokës sovjetike të nxitjes së racizmit dhe ksenofobisë mes popullatës. Dhe këtë e kanë çuar përtej kufijve të Ruisë, duke rinovuar ndërhyrjen në çështjet e brendshme politike të disa shteteve të “jashtë vendit të afërt”. Politika e brendshme ruse e korruptuar dhe gjithnjë e më autokratike e përjashton pjesëmarrjen e saj në çdo sistem bashkëpunimi të sigurisë të ndërtuar nga shtetet e tjera në Evropë. Përballë fakteve të tilla, bota e jashtme nuk mund të bëjë pothuajse asgjë, përveç mbështetjes dhe mbrojtjes së demokracive të reja periferike nga ndërhyrjet e paligjshme politike ruse.

Rusia vazhdon ta konsiderojë perëndimin si “kërcënim ekzistencial”. Së fundmi ajo miratoi një strategji të re, që sipas Vladimir Putin, u bë e nevojshme prej “përmbysjeve aktuale në arenën ndërkombëtare”. Kjo strategji justifikohet si reagim i Moskës ndaj “natyrës ekzistenciale të kërcënimeve ndaj sigurisë dhe zhvillimit të vendit tonë nga veprimet e shteteve jomiqësore” dhe së fundmi ajo ka klasifikuar 20 shtete si “jomiqësore”, ndër to janë: SHBA-të, Gjermania, Britania e Madhe dhe Polonia, ndërsa Kina dhe India shpallen aleate të Ruisë në skenën botërore.

Së dyti, pyetja për sigurinë në fillimin e mijëvjeçarit të ri është: cili do të jetë drejtimi i ardhshëm që ka marrë Kina? Nëse elitat qeverisëse të Kinës mund të përshtatin teorinë dhe institucionet e tyre politike aq shpejt dhe me sukses sa kanë politikën e tyre ekonomike, është një shqetësim thelbësor për të gjithë njerëzimin. Ndërsa nëse Kina do të luftojë për t’u shfaqur si një fuqi e madhe e begatë, gjerësisht demokratike (ose të paktën, politikisht më moderne dhe më përfaqësuese) atëherë, e gjithë superstruktura e sigurisë në Azi dhe në botë do të forcohej jashtëzakonisht shumë. Pozicionimi i politikës së jashtme së Kinës në marrëdhëniet moderne ndërkombëtare përcaktohet nga dimensionet gjeopolitikë i përvojës së saj historike dhe qëllimeve strategjike afatgjata, të pavarura nga programet e liderëve individualë. Një aspekt tjetër i rëndësishëm janë cilësimet themelore të sistemit të saj politik dhe ekonomik si faktorët kyç

që përcaktojnë kuadrin dhe dinamikën e politikës së jashtme kineze. Nisur nga një armatim i fortë dhe të intensifikuar, politika agresive ndaj fqinjëve në Detin e Kinës Jugore, roli në përhapjen e armëve bërthamore, bashkëpunimi me regjimet autokratike dhe organizatat terroriste, deri sot Kina konsiderohej si një “konkurrenente sistematike”, tani ajo paraqet “një sfidë sistematike”. Partneriteti në rritje i Kinës me Rusinë dhe bashkëpunimi në rritje i Rusisë me Iranin pas pushtimit të Ukrainës, janë dy zhvillime shumë shqetësuese. Tensionet aktuale në rajonin Indo-Paqësor mund të kenë pasoja në sigurinë globale, që janë më të mëdha sesa konflikti në Ukrainë. Rusia vazhdon të jetë kërcënimi më akut dhe ajo që ka ndryshuar është se siguria kolektive ndërkombëtare tani është thellësisht e lidhur me rezultatin e konfliktit në Ukrainë.

Në lidhje me sigurinë, një sulm i armatosur përtej kufijve të njohur të një shteti interpretohet si një kërcënim për sigurinë njerëzore dhe shtetërore, veçanërisht për ata, banesat dhe jetesa e të cilëve shtrihen drejtpërdrejt në rrugën e ushtrive sulmuese ose bëhen objektiva, qëllimisht ose jo, të bombardimeve nga ajri. Ngjarja më e rëndësishme që po ndodh sot në botë është agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës, zhvillimi më i rëndësishëm në politikën evropiane që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Tani që ka kaluar rreth dy vjet nga fillimi i saj, veprimet në terren, zhurma dhe mashtrimi propagandistik kanë filluar të tregojnë më mirë dhe më saktë pse po ndodh e gjithë kjo. Gjithsesi, në këtë luftë mund të veçohen shtatë fusha mosmarrëveshjesh midis Rusisë dhe Ukrainës, që i grupojmë në shkaqet thelbësore: rajonet separatiste; ura tokësore e Krimesë; irredentizmi rus; rivaliteti lindje-perëndim; energjia; uji dhe nazizmi. Gjashtë prej të cilave janë të besueshme dhe është folur dhe dëgjuar edhe më parë për to. Është e vështirë të jepet një narrativë koherente e luftës pa bërë analizën e shkaqeve, por që asnjëri prej tyre nuk e shtjellon plotësisht konfliktin. Në rastin më të mirë, këto janë gjysma e shkaqeve të luftës, por sipas analizës në marrëdhëniet ndërkombëtare kemi dhe mosmarrëveshjet e negociimit: goditja parandaluese (preventive war); lufta parandaluese (preemptive war); llogaritjet e gabuara; irracionaliteti dhe përfitimet personale.

Sipas shkencave politike në marrëdhëniet ndërkombëtare, ajo gjithçka që duhet të bëjmë është të konvertojmë vlerën e jetëve të humbura, dëmeve të Ukrainës dhe mungesës së efikasitetit monetar në kilometra katrorë tokë. Kjo mund të duket e çuditshme, por çdo ndarje e territorit në interes të asaj, që është më mirë sesa të kishin bërë një luftë, është reciprokisht më e preferuar dhe këto lloj krahasimesh bëhen gjatë gjithë kohës edhe për temat e tjera. Kjo është një arsye e madhe pse luftërat sot janë më të rralla, por nëse duam të kuptojmë se pse ndodh një luftë, duhet të shpjegojmë pse palët nuk mund të arrijnë një marrëveshje të negociuar, duke e ndarë procesin në dy etapa:

Së pari, duhet të përcaktojmë dhe të diskutojmë për çështjet thelbësore, për të

cilat këto dy vende janë të gatshëm të luftojnë. Së dyti, duhet të evidentojmë dhe të shqyrtojmë “mosmarrëveshjet e negociimit”, pra ato çka i pengon ata të arrijnë në një nga marrëveshjet e negociuara.

Ekzistenca e njëkohshme e të dyjave është baras me luftë nëse kemi elementë të njëres pa tjetrën, atëherë nuk kemi luftë. Pra për të shkuar domosdoshmërisht në një luftë, duhet të kemi ekzistencën e përbashkët si të elementëve të grupit a, ashtu edhe të grupit b. Në parim të gjitha këto janë e njëjta histori dhe ky nuk është një lajm i mirë, sepse atëherë luftërat do të zgjasnin për një kohë relativisht të gjatë dhe përfundimi i tyre nënkupton humbje ushtarake për njërën palë:

- Agresori mposhtet dhe nuk mund të arrijë synimin e tij.
- Sulmuesi realizon objektivin dhe mund ushtarakisht palën tjetër, deri në atë pikë sa mbrojtësi nuk mund të përpiqet më ta rimarrë atë.

Të dyja këto janë të mundshme të ndodhin midis Ukrainës dhe Ruisë, por në fund do të ndodhë vetëm njëra prej tyre. Ukraina, me veprimet e saj ka qenë aktive dhe e guximshme, por ajo nuk ka fuqinë e duhur ushtarake për të pushtuar Rusinë dhe për të shkatërruar të gjithë fuqinë e saj ushtarake. Ndërsa Rusia mund t'i ketë këto aftësi ndaj Ukrainës, por duke pasur parasysh vështirësitë e deritanishme, kjo duket e pamundur, pasi disfata ushtarake e deritanishme është mjaft e pazakontë për këto lloje luftërash.

Mënyra tjetër se si mund të përfundojë lufta si rezultat i shkaqeve thelbësore është një ndryshim themelor në objektivat dhe preferencat e saj dhe sipas kësaj shkaqet thjesht pushojnë së ekzistuari. Në këtë drejtim nuk ka gjasa që Zelensky të vendosë papritur se nuk është më i interesuar për pjesë të veçanta të Ukrainës dhe të mund t'i lëshojë ato. Po kështu, nuk ka gjasa që Putin të vendosë papritur që nuk është i interesuar për kapjen dhe mbajtjen e pjesëve apo rajoneve të veçanta të Ukrainës. Ajo që është më e besueshme është që Putin të bëhet i detyruar të largohet dhe kjo është pjesë e strategjisë së SHBA-ve për të ndikuar në rezultatin e luftës.

Duke qëndruar në linjë me temën, nuk është e domosdoshme të ketë një disfatë ushtarake për t'i dhënë fund luftës. Por për motive parandaluese, nganjëherë shkaku i luftës është rezultat i një ndryshim afatgjatë në ekuilibrat e fuqisë. Nëse ndalojmë burimin e ndryshimit të pushtetit ekuilibri i së nesërme barazohet me të sotmin, atëherë nuk do të shqetësohemi për të ardhmen. Gjithsesi ky është një konflikt që për momentin nuk mund të parashikohet.

3. Siguria individuale në shoqërinë ndërkombëtare

Arritja e një komuniteti njerëzor global, i cili do t'i kapërcejë kufijtë ndërkombëtarë dhe do t'i tejkalojë të drejtat dhe interesat e komuniteteve të veçanta, qofshin këto shtete ose grupe shtetesh, ka një origjinë fisnike

në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në paradigmen e sigurisë njerëzore për mbrojtjen e të drejtave universale të njeriut, të drejtës humanitare, krimeve kundër njerëzimit dhe në doktrinën e përgjegjësive për të mbrojtur ka kufizime të pashmangshme, që janë pasojë e drejtpërdrejtë e faktit se marrëdhëniet ndërkombëtare mbeten të organizuara mbi bazën e sovranitetit shtetëror dhe vlerave pluraliste.

Komuniteti ndërkombëtar është frazë e përdorur në gjeopolitikë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare për t'iu referuar një grupi të gjerë njerëzish dhe qeverish të botës. Për të aktualizuar një shoqëri të mirë, ne duhet të rivlerësojmë parimet e saj, të përvijojmë komponentët themelorë që veprojnë në lëvizjet shoqërore dhe së fundi, të konceptojmë një rrugë drejt aktualizimit të së ardhmes në një komunitet njerëzor sa më të arrirë ndërkombëtar. Menno Boldt¹⁴ parashtron natyrën e globalizimit dhe sfidon natyrën e hegemonisë demokratike perëndimore dhe të drejtave kushtetuese të njeriut, duke vënë në dukje të metat e tyre në arritjen e një shoqërie sa më të mirë. Ai jep një koncept të rifreskuar të një shoqërie në një epokë globale, arkitektura e së cilës është formësuar kryesisht nga globalizimi ku të gjithë banorët e tokës mund të arrijnë njerëzimin përmes lirisë globale, drejtësisë sociale dhe dinjitetit njerëzor të pranuar botërisht dhe të barabartë.

Epoka globale, ndryshe nga rendet e kaluara shoqërore, i ka rrënjët në kapitalizëm dhe karakterizohet nga globalizimi, që është një doktrinë dhe sistem i rendit shoqëror të bazuar në imperativat ekonomiko-utilitare. Fenomenet e globalizimit janë rezultat i rindërtimit të hartës gjeopolitike të cenuar nga ndërvarësia ekonomike, politike dhe kulturore. Për të realizuar një shoqëri të mirë, ne duhet të kuptojmë marrëdhënien midis këtyre tre fushave dhe rolin e tre komponentëve të pushtetit, autoritetit dhe historisë. SHBA-të kanë rolin e tyre formëzues në epokën globale, si dhe efektet e veprimeve të tyre për rendin e ardhshëm global. Komponentët themelorë të rendit shoqëror kanë të bëjnë me autoritetin dhe vlerat shoqërore relacionale dhe ofrojnë potencial për marrëdhënie të qëndrueshme e të parashikueshme, si dhe kanë kapacitetin për t'i humanizuar ose çnjerëzuar ato. Rendet shoqërore në epokën moderne pasqyrojnë evolucionin nga doktrinën e kishës, rregullit apo ligjit hyjnor në zhvillimin e qeverive laike dhe përfundimisht në shtetet kombëtare sovraane. Në secilin rast përfshihen të tre komponentët dhe ndërtimi i hegemonisë sunduese për dinjitetin njerëzor dhe të drejtave të njeriut në epokën globale.

Autoriteti i rendit shoqëror mbi të drejtat e njeriut ka ndryshuar nga një mënyrë morale që buron nga shtetet kishë (të përcaktuara nga rendi sintetik i bazuar në doktrinën) në një model liberal demokratik (kryesisht i përcaktuar

¹⁴ Menno Boldt, *A Quest for Humanity: The Good Society in a Global World*, University of Toronto Press, July 2011.

nga rendi laik dhe ligjor për të drejtat e njeriut). Globalizimi kërkon një zgjerim dhe zbatim universal të të drejtave globale të bazuara në dinjitetin njerëzor. Ndërsa bota jonë kalon nga shtetet laike në një shtet global, ne do të vazhdojmë të bëhemi më të ndërvuarur dhe do të kërkojmë një pranim të rendit shoqëror të ankoruar nga të drejtat e njeriut të kuptuara në mënyrë universale. Ky konceptualizim është mjaft sakarin:¹⁵ ndërsa globalizimi përparon dhe ne vazhdojmë të evoluojmë në një shtet global, kapitalizmi nëse ruan kursin e tij aktual i rreshton të drejtat e njeriut dhe dinjitetin njerëzor pas imperativave ekonomike utilitare dhe i avancojnë më tej të drejtat e njeriut të shoqërive perëndimore, që pranojnë autoritetin e hegjemonisë kapitaliste. Këto virtyte mund të arrihen nëpërmjet një rendi shoqëror moral global duke përqafuar njerëzimin transcendent¹⁶.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut është hartuar si rezultat i shkeljeve më të rënda të dinjitetit njerëzor, e veçanërisht pas përvojës së Holokaustit në Luftën e Dytë Botërore. Përqendrimi i saj është te qenia njerëzore, kurse preambula e saj i referohet “lirisë nga frika dhe skamja”. Koncepti i sigurisë njerëzore ka të njëjtën qasje “Shumica e kërcënimeve kundër sigurisë njerëzore nxjerrin në pah drejtpërdrejt ose tërthorazi dimensionin e të drejtave të njeriut”. Qëllimi i saj është që, përmes parandalimit të konflikteve dhe adresimit të hollësishëm të shkaqeve të pasigurisë, të mbrojë të drejtat e njeriut dhe të krijojë një kulturë politike globale të bazuar në të drejtat e njeriut. Në këtë kontekst, arsimimi për të drejtat e njeriut paraqet një strategji në drejtim të realizimit të sigurisë njerëzore, pasi i mëson njerëzit që zgjidhjet e problemeve të tyre t’i kërkojnë para së gjithash në bazat e sistemit të vlerave të përgjithshme globale, të mbështetura në sundimin e ligjit dhe tek e drejta, e jo duke u bazuar në pushtet.

Siguria njerëzore promovohet në shoqëri në formë të decentralizuar, duke filluar nga nevojat themelore, si ato të grave ashtu edhe të burrave, siç janë: problemet e sigurisë personale, varfërisë, diskriminimit, drejtësisë sociale dhe demokracisë. Liria nga eksploatimi¹⁷ ose korrupsioni fillon vetëm atëherë kur njerëzit nuk pranojnë që të drejtat e tyre të shkelen edhe më tutje. Institucionet e shoqërisë civile (sikurse transparenca ndërkombëtare) përkrahin procese të emancipimit, bazuar në njohuritë mbi të drejtat e njeriut, pasi ato ofrojnë bazën e nevojshme të zhvillimit dhe sigurisë njerëzore.

Ekzistojnë disa lidhje ndërmjet të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore. Format e sigurisë personale, sociale dhe sigurisë ndërkombëtare, përputhen me të drejtat ekzistuese të njeriut. Politikat e sigurisë duhet të integrohen më

¹⁵ Është një ëmbëlsues artificial pa vlera ushqyese.

¹⁶ i jashtëzakonshëm, i mrekullueshëm.

¹⁷ shfrytëzim, abuzim, keqpërdorim etj

shumë me strategjitë për promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe zhvillimit. Të drejtat e njeriut, e drejta humanitare dhe e drejta e refugjatëve ofrojnë kornizën normative mbi të cilën bazohet qasja e sigurisë njerëzore. Cenimi i tyre paraqet kërcënime, prandaj përdoren si indikatorë për paralajmërim të hershëm, në parandalimin e konflikteve, gjithashtu luajnë rol gjatë periudhës së pasluftës për menaxhimin dhe transformimin e konflikteve, si dhe për ndërtimin e paqes.

Përmes transferimit të dijes, ndërtimit të aftësive dhe formësimit të sjelljeve, në fushën e të drejtave të njeriut arrihet niveli i kulturës së vërtetë të parandalimit. Përveç që të drejtat e njeriut janë një instrument esencial për parandalimin e konflikteve, ato janë bërthama e konceptit të ndërtimit të qeverisjes dhe demokracisë. Përmes pjesëmarrjes aktive, ngritjes së transparencës dhe përgjegjësisë, ato përbëjnë bazën e trajtimit të problemeve shoqërore dhe globale. Qeverisja përshkruhet nga dy forma komplementare të ndërtimit të kapaciteteve: “ndërtimit të shtetit” dhe “ndërtimit të shoqërisë”. E para ofron “siguri demokratike”, që më së miri mund të shihet pas përfundimit të një konfliktit në përpjekjet për rehabilitim dhe rindërtim. “Zhvillimi shoqëror përfshin arsimimin e gjerë për të drejtat e njeriut, me qëllim aftësimin e njerëzve për kërkimin e të drejtave të tyre dhe respektimin e të tjerëve.”¹⁸

Siguria njerëzore në esencë është një përpjekje për ndërtimin e shoqërisë globale ku, siguria e individit është në qendër të prioriteteve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit janë përshtatur në një rrjet koherent për mbrojtjen e individit.

Arritja e një komuniteti me të ardhme të përbashkët për njerëzimin kërkon pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e të gjitha kombeve dhe popujve dhe kjo do të thotë të përqafosh diversitetin dhe të njohësh vlerën e kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme, për të punuar së bashku drejt qëllimeve të përbashkëta. Fryma e solidaritetit dhe bashkëpunimit janë dy elementet thelbësore, pa të cilin komuniteti i fateve të përbashkëta të njerëzimit nuk mund të arrijë qëllimet e tij.

Promovimi i paqes, siguria dhe stabiliteti në botë, si dhe i sfidave të tjera globale mund të adresohen më së miri së bashku, duke shfaqur solidaritetin e duhur dhe të nevojshëm dhe mbi të gjitha duke demonstruar përkushtimin e duhur. Krijimi i komunitetit të fateve të përbashkëta të njerëzimit pasqyrohet në njohjen e ndërvarësisë dhe ndikimit reciproke të tyre. Ato janë të ndërlidhura ngushtë dhe për më tepër ndikohen dhe kërkojnë veprim kolektiv në përballjen e sfidave globale të shumta siç janë ndryshimet klimatike, pandemitë apo edhe terrorizmi. Fatkeqësisht, jo gjithmonë është e thjeshtë të ndërtohet bazën e një

¹⁸ Dr. Walther Lichem, President, InterPress Service; Former Ambassador, Austria.

besimi dhe solidariteti reciprok midis popujve. Ndër mekanizmat për të ndërtuar lidhje sa më të forta kulturore dhe arsimore midis kombeve dhe popujve vlejné për t'u përmendur:

- Inkurajimi i shkëmbimeve studentore dhe akademike.
- Mbështetja e ngjarjeve dhe programeve kulturore.
- Promovimi i mësimin të gjuhës.
- Mbështetja e bashkëpunimeve kërkimore e shkencore ndërkombëtare.

Edhe Shqipëria mund të kontribuojë në konceptin e komunitetit të fateve të përbashkëta të njerëzimit, duke promovuar në mënyrë aktive bashkëpunimin dhe solidaritetin ndërkombëtar. Duke u përqendruar fillimisht te ndërtimi i lidhjeve më të forta në veçanti me fqinjët e saj dhe për më tepër, me komunitetin më të gjerë ndërkombëtar, duke mbështetur në mënyrë aktive iniciativat që promovojnë paqen, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Meqenëse rajoni i Ballkanit Perëndimor është përballur vazhdimisht me sfida esenciale, duke përfshirë paqëndrueshmërinë politike, mos zhvillimin ekonomik dhe tensionet etnike, ajo duhet të luajë një rol të rëndësishëm dhe të dalluar në promovimin e stabilitetit dhe integritetit rajonal. Në këtë mënyrë, ne mund të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për të gjithë njerëzit, si në Shqipëri, në rajon ashtu edhe në mbarë botën.

4. Përplasja e vlerave të sigurisë kombëtare, ndërkombëtare dhe asaj njerëzore

Siguria kombëtare, ndërkombëtare dhe njerëzore përfaqësojnë një “përplasje vlerash” për të cilën nuk mund të ketë zgjidhje të përhershme, pavarësisht se secila nga këto siguri mund të jetë më bindëse. Gjithsesi ato mbeten reciprokisht të papërputhshme, kërkesat e një paradigme do të bien ndesh me kërkesat e një tjetre dhe ne detyrohemi të zgjedhim mes tyre. Siguria kombëtare ka qenë një fjalë kyç në gjuhën politike dhe zakonisht i jepet përparësi kryesore në politikat shtetërore, mbi dimensionet ekonomike, sociale dhe të tjera të mirëqenies. Por siguria dhe mirëqenia e individit është më e rëndësishme se shqetësimi i ngushtë elitare për sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit komb.

Studimet e sigurisë si një nën disiplinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, mund të thuhet se ndodhen në qendër të tyre. Kjo disiplinë u jetësua në Aberystwyth¹⁹ (1919) me qëllim të nxirreshin mësimet dhe të mos përsëriteshin ngjarjet e Luftës së Parë Botërore. Siguria është një ndër çështjet më shumë të diskutuara sa i përket politikave në nivele të larta, por edhe në debatet e qytetarëve. Mbijetesa e aktorëve kryesorë, që në pjesën më të madhe janë shtetet, ka bërë të mundur të

¹⁹ *Aberystwyth University, UK*

shpjegohet sa më thjesht sjellja e tyre. “Asnjë koncept tjetër në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk mund të mbledhë grushtin metafizik, e as të komandojë fuqinë disiplinare të “sigurisë”.²⁰ Arritja e një konsensusi mbi përmbajtjen e studimeve të sigurisë ka të bëjë me kërcënimet ndaj mbijetesës. Megjithatë lufta dhe kërcënimet për të përdorur forcën janë pjesë e ekuacionit të sigurisë por ato nuk janë ekskluzive, përkufizimi i tij ka ndryshuar meqë në rreziqe hyjnë edhe pandemitë, si HIV/AIDS, COVID19, degradimi mjedisor, dhuna e drejtpërdrejtë, terrorizmi dhe konflikti ndërshtetëror.

Konflikti ndërshtetëror dominoi në studimet e sigurisë për një kohë të gjatë (gjatë Luftës së Ftohtë), ndërsa tani konsiderohet si nëndegë e tyre, e njohur si studime strategjike. Shteti tradicionalisht ka qenë objekt referues që të mund të ofrojë siguri me forcë ushtarake, por kjo mënyrë ka edhe qasje alternative në të cilat studiohen rreziqet ndaj sigurisë dhe zgjerojnë gamën e referuesve të sigurisë. Kjo krijon një mjegullnajë midis këtyre studimeve dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila vjen dhe si rrjedhojë e globalizimit. “Një komb konsiderohet i sigurt kur nuk ekziston asnjë rrezik që ta detyrojë atë të sakrifikojë vlerat e tij themelore nëse do të shmangte luftën, dhe është i aftë që, nëse sfidohet nga një luftë e tillë, t’i mbajë ato nëpërmjet fitores”.²¹ Siguria kombëtare është aftësia për t’u përballur me agresionet e jashtme dhe për të rezistuar ndaj atyre. Qasjet tradicionale se si shtetet janë përpjekur për sigurinë mbeten shpesh dominuese, kjo do të thotë se nuk janë zëvendësuar me të reja, por vazhdimisht ka hulumtime teorike sfiduese të reja. Ato konsiderohen bindëse, jo duke injoruar qasjet e reja, por duke i njohur dhe konsideruar plotësisht ato. Ndërsa qasjet alternative ndaj sigurisë bazohen si në natyrën e kërcënimeve apo pasojat, ashtu edhe në mundësinë e gjetjes së zgjidhjeve ndaj tyre.

Evoluimet nga çështjet tradicionale të sigurisë në ato jotradicionale në shumicën e rasteve janë të lidhura me strategjinë e ndjekur nga perëndimi pas Luftës së Ftohtë, duke zbatuar përdorimin “parandalues të forcës”, politikën parandaluese të shtrëngimit e në veçanti përdorimin e diplomacisë imponuese. Kjo e shoqëruar dhe nga roli i inteligjencës, i cili ka qenë shumë më i madh në përcaktimin e problematikës dhe produkteve të sigurisë sidomos lidhur me Irakun 2003; veprimet pas 11 shtatorit; armët e shkatërrimit në masë, terrorizmin (fetar, etnik, ideologjik). Ndërsa çështjet e tjera si pandemitë, HIV/AIDS (çdo ditë mesatarisht vdesin tri herë më shumë njerëz nga AIDS se sa numri i të vrarëve më 11 shtator 2001), identifikimi i drogës si kërcënim i sigurisë kombëtare, trafikimi i qenieve njerëzore, pastrimi i parave, lidhjet mes

²⁰ James *Der Derian*, profesor në Universitetin e Sidney, Australi.

²¹ Walter Lippmann, Enciklopedia Britanica; shkrimtar, reporter dhe komentator politik amerikan.

krimit të organizuar dhe terrorizmit, si dhe roli i fëmijëve në luftë janë sot në agjendat e sigurisë kombëtare të shumë shteteve. Këto ndikojnë në ndryshime jo vetëm të agjendës së sigurisë në shumë vende, por edhe në legjislacion dhe objektiva të organizatave ndërkombëtare.

Përfundime

Hartimi i strategjive të sigurisë përbëjnë akte të rëndësishme institucionale, në kuadër të përpjekjeve për të shfrytëzuar maksimalisht të gjithë kapacitetet në funksion të përmbushjes së misioneve për sigurinë. Ndryshimet e vazhdueshme në mjedisin e sigurisë, të cilat ndikojnë në kohë prioritarizimin e sfidave, me të cilat përballemi, kërkojnë gjithashtu një qasje tjetër ndaj tyre. Synimi i organizmave të sigurisë duhet që në mënyrë të vazhdueshme të jetë fleksibël dhe i adaptueshëm në gjetjen e formave dhe metodologjive të punës, që sigurojnë avantazhe në aktivitetet dhe veprimtaritë e tyre. Për të përballuar problemet komplekse të sigurisë në sistemin e ri ndërkombëtar dhe për një kuptim të përgjithshëm të konceptit analitik të sigurisë, duhet të përcaktohen qartë aktorët e sigurisë që në të njëjtën kohë janë viktima të kërcënimeve të lidhura me nivelet e sigurisë:

- Siguria për individin (siguria individuale).
- Siguria për grupin shoqëror, komunitetin, “kombin”, entitetin (siguria shoqërore).
- Siguria për shtetin ose “kombin”, (siguria kombëtare).
- Siguria për rajonin, domethënë një rajon koherent i sigurisë, (siguria rajonale).
- Siguria për shoqërinë e kombeve ose “shoqërinë ndërkombëtare”, (siguria ndërkombëtare).
- Siguria për globin ose planetin, (siguria globale).

Strategjitë e reja përfshijnë të gjitha aspektet e veprimtarisë së organizmave dhe institucioneve të sigurisë dhe të mundësojnë vlerësime e planifikime të kapaciteteve për realizimin e misionit dhe objektivave të përcaktuara në dokumentet përkatëse të sigurisë kombëtare, ndërkombëtare, njerëzore dhe strategjitë e lidhura ngushtë me objektin dhe prioritetet.

Në përmbushje të misionit, organizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë duhet të sigurojnë në kohë informacion objektiv, cilësor dhe të dobishëm për të mundësuar një vendimmarrje për rreziqet dhe kërcënimet nga jashtë dhe brenda, ndaj interesave dhe sigurisë kombëtare të vendit, vendeve aleate, rajonale dhe ndërkombëtare. Mbështetur në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare hartohen gjithë strategjitë e kombëtare dhe ndërinstitucionale, angazhimet

ndërkombëtare të vendit, përgjegjësitë në përmbushje të misionit, në përputhje me nevojat e vendimmarrjes politike dhe kontributit të institucioneve ligjzbatuese, për sigurinë kombëtare, si dhe angazhimeve në kontributin për sigurinë ndërkombëtare.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 103/2014.
2. J. Jackson-Preece, *Security in international relations*, 2011.
3. William Bain, *The Empire of Security and the Safety of the People*, London, 2006.
4. Cathal J. Nolan, *Greenwood Encyclopedia of International Relations*, Westport, CT: Greenwood Pub, 2002.
5. Sasson Sofer, *The Courtiers of Civilization*, Albany : State University of New York Press, 2013.
6. Radomir Compel&Rosalie Arcala-Hall, *Security and Safety in the Era of Global Risks*, 2021.
7. Adam Winkworth, *Is the Security Dilemma Still Relevant in International Relations?*, 2012.
8. <https://www.nato.int/>
9. <https://www.osce.org/>
10. <https://www.dcaf.ch/publications/documents>
11. <http://www.un.org/secureworld/report2.pdf>
12. <https://www.london.ac.uk>
13. <https://www.rug.nl/masters/international-security>
14. <https://hdr.undp.org/doc/training/oxford/reading/fukuda>
15. <https://www.id21.org>.
16. <https://www.humansecurity-chs.org>

RUBRIKA E DYTË

ARSIMIMI DHE STËRVITJA

Ndërtimi i marrëdhënieve publike online nga Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelenskyy

Msc. Edlira Prendi

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Lufta që po zhvillohet në Ukrainë ka marrë vëmendjen e opinionit publik ndërkombëtar. Prej datës 24 shkurt të vitit 2022 Ukraina është ulur në krye të titujve kryesorë të mediave anëmbanë globit. Kjo, falë angazhimit të mediave për të raportuar situatën në Ukrainë, por edhe prej faktit që Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy zgjodhi të komunikojë me publikun në mënyrë të drejtpërdrejtë, të menjëhershme, përmes të gjitha kanaleve të komunikimit.

Marrëdhëniet publike kanë marrë një karakter ndërkombëtar dhe liderët botërorë po i japin një rëndësi tejet të veçantë komunikimit publik mbarëbotëror. Komunikimet ushtarake janë më shumë se kurrë prezent në skenën ndërkombëtare që nga prej Luftës së Ftohtë. Është e rëndësishme të kuptojmë si kanë ndryshuar MP-të në arenën ndërkombëtare. Në çfarë forme realizohen ato, kujt i drejtohen, pse synojnë audiencat e huaja dhe pse është i rëndësishëm mendimi i publikut në kohë lufte.

Ky studim synon të sjellë rezultatet e një hulumtimi lidhur me komunikimin publik të Presidentit të Ukrainës, i cili është personi më prezent sot në diskursin publik ndërkombëtar.

* Rast studimor i ndërtimit të imazhit ndërkombëtar dhe marrëdhënieve me publikun në kohë lufte.

Ky studim u bë i mundur falë kërkimit cilësor dhe analizës së gjetjeve të ndërthurur me kërkimin sasior për shkak se është kryer monitorim dhe analizë e hollësishme në të gjitha kanalet e komunikimit të Presidentit Zelenskyy dhe të institucionit të Presidencës.

Punimi evidenton faktin se zhvillimi i teknologjisë dhe mediave sociale kanë rol thelbësor për ndërtimin e imazhit të suksesshëm ndërkombëtar.

Fjalët kyçe: V. Zelenskyy, komunikimi publik ndërkombëtar, marrëdhënie me publikun, soft power, diplomaci e mediave digjitale.

Hyrje

Ky studim synon të sjellë rezultatet e një hulumtimi lidhur me komunikimin publik të Presidentit të Ukrainës, i cili është personi më prezent sot në diskursin publik ndërkombëtar. Volodymyr Zelenskyy është personi më unifikues jo vetëm për popullin e Ukrainës që po përballlet me pushtuesin por edhe për shumicën e opinionit publik ndërkombëtar. Ai shihet si njeriu që personifikon një luftë globale ndërmjet demokracisë dhe regjimeve totalitare.

Që prej datës 24 shkurt të vitit 2022, Ukraina është ulur në krye të titujve kryesorë të mediave ndërkombëtare. Kjo, falë angazhimit të mediave për të raportuar situatën në Ukrainë por edhe prej faktit që Presidenti Volodymyr Zelenskyy zgjodhi të komunikojë me publikun në mënyrë të drejtpërdrejtë, të menjëhershme, përmes të gjitha kanaleve të komunikimit. Për herë të parë një lider dhe konkretisht kreu i Ukrainës tenton të ndërtojë komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët e shteteve të ndryshme të botës duke folur në gjuhët e tyre respektive. Në anglisht, Zelenskyy i flet elitës apo gazetarëve, por ai tenton t'u flasë të gjithëve edhe në gjuhët e tyre respektive.¹ Që në ditët e para të luftës ai ka ndërmarrë një agjendë intensive dhe të mirë organizuar komunikimi strategjik me të gjitha audiencat, përfshirë popullin rus, me qëllim sigurimin e mbështetjes për Ukrainën dhe dënimin e Ruisë për sulmin.

Vetëm 38 orë pas sulmit ai zgjodhi të përgjigjet me strategji ballore, të drejtpërdrejtë të komunikimit.² Ai e bëri këtë në mënyrë specifike për të dhënë mesazhin se Ukraina do të luftojë dhe nuk do të dorëzohet përballë ofensivës ushtarake të Ruisë. Ky ishte një mesazh i rëndësishëm për popullin e Ukrainës, pikë së pari, për Ruisë që kishte menduar se Zelenskyy do të largohej nga kryeqyteti, por edhe për botën perëndimore, ekspertët të ndryshëm të së cilës kishin parashikuar se Ukraina do të kapitullonte brenda pak orësh.³

¹ Referoju videove në kanalin YouTube.

² Zelenskyy iu drejtua kombit dhe botës me një video-fjalim nga Kievi në oborrin e një godine qeveritare dhe e siguronte popullin se qeveria nuk kishte kapitulluar.

³ Intervistë me ambasadorin e Ukrainës në Tiranë.

Jo më pak i rëndësishëm ishte një tjetër lajm që qarkulloi me shpejtësi në të gjithë botën e që përforcoi mesazhin se Ukraina do të luftojë. Përmes këtyre mesazheve, Zelenskyy u kthye në figurën më përfaqësuese të luftës që po zhvillohej në këtë anë të Evropës.

Lufta që po zhvillohej në Ukrainë, ndryshoi dhe agjendën e qeverive të tjera, të organizatave shumëkombëshe në fushën e sigurisë e mbrojtjes si dhe në fushën e të drejtave të njeriut.

Duke qëndruar fizikisht në Ukrainë, Volodymyr Zelenskyy nisi ofensivën më të fuqishme që një lider kishte ndërmarrë ndonjëherë për të komunikuar me të gjithë botën. Zelenskyy përdori teknologjike për të qenë prezent në të gjitha takimet ndërkombëtare, për të drejtuar fjalime në shumë parlamente të botës dhe për të pushtuar hapësirën e rrjeteve sociale. Duhet pranuar që teknologjia dhe përdorimi i saj ka fituar një dimension të ri gjatë zhvillimit të luftës në Ukrainë.

Presidenti Zelenskyy përdori çdo mënyrë të mundshme komunikimi për t'i treguar botës atë që po ndodh në vendin e tij. Me veshje ushtarake, me fytyrë të lodhur dhe i pagjumë, i parruar, ai përdori komunikimin jo verbal për të përthithur vëmendjen, mbi të gjitha në hapësirën e rrjeteve sociale.

Qëllimi i studimit.

Qëllimi i këtij studimi është për të kuptuar si po ndryshon komunikimi publik për shkak të mediave sociale. Sot marrëdhëniet me publikun po zhvillohen *online* duke i kaluar si dytësore format e vjetra të komunikimit. Ky studim na ndihmon të kuptojmë se ku e ka çuar teknologjia marrëdhënien publike në kohë krizash të mëdha ndërkombëtare, siç është lufta në Ukrainë.

Afro 30 vjet më parë ishte media tradicionale ajo që raportonte për luftën dhe zhvillimet në terren. Komunikimi publik nuk kishte këtë përmasë. Marrëdhëniet publike kanë nevojë për median dhe teknologjinë për të qenë të suksesshme dhe sot të dy këto elemente kanë ndryshuar drastikisht duke u bërë më të shpejtë, më të pranishëm dhe lehtësisht të përdorshëm. Marrëdhëniet publike kanë marrë një karakter ndërkombëtar dhe liderët po i japin rëndësi gjithnjë e më të madhe komunikimit publik të huaj. Është e rëndësishme të kuptojmë si kanë ndryshuar marrëdhëniet publike në arenën ndërkombëtare. Në çfarë forme realizohen ato, kujt i drejtohen, pse synojnë audiencat e huaja dhe pse është i rëndësishëm mendimi i publikut në kohë lufte. Komunikimet ushtarake janë kthyer në diskursin publik.⁴ Ato janë më shumë se kurrë prezente në skenën ndërkombëtare që prej Luftës së Ftohtë dhe disi më specifikisht që

⁴ Shënim: Autorja e këtij studimi përgjatë viteve 2013-2017 ka qenë e angazhuar në Ministrinë e Mbrojtjes të RSH, në detyrën e Këshilltarit të Komunikimit. Kjo ka qenë një ndër shtysat për të ndërmarrë këtë studim.

nga lufta e Kosovës. Komunikimet ushtarake në Shqipëri nuk studiohen. Që në vitin 2008 kur Shqipëria u bë vend anëtar i aleancës më të madhe politiko-ushtarake në botë (NATO), vihet re se një vëmendje e madhe i është kushtuar bashkëpunimit civilo-ushtarak në kohë paqeje.

Studime të tilla janë të rëndësishme për t'u kryer edhe në vendin tonë. Pavarësisht largësisë gjeografike, Shqipëria është vend anëtar i NATO-s, e cila ndikohet në mënyrë direkte nga secila krizë. Udhëheqësit shqiptar, ndryshe nga vende të tjera në Ballkan (Serbi, Bosnjë e Hercegovinë), reaguan menjëherë me sanksione ndaj Rusisë.

Punimi u vjen në ndihmë praktikuesve të marrëdhënieve me publikun dhe medias për të kuptuar se komunikimi ushtarak është i rëndësishëm të njihet dhe të kuptohet si duhet sidomos në një hapësirë si Ballkani ku konfliktet ende nuk janë tejkaluar plotësisht. Në kohë lufte, ndërtimi i imazhit ndërkombëtar të vendit merr rëndësi jetike për të ardhmen e tij. Gjithashtu ai analizon si janë ndërtuar marrëdhëniet publike *online* nga Presidenti i Ukrainës, me çfarë strategjie dhe taktikash është kryer komunikimi dhe çfarë roli ka luajtur teknologjia në ndërveprimin mes tyre.

Baza teorike.

Në kuadër të këtij punimi, janë vizituar autorë të huaj dhe shqiptar. Ky studim është bazuar mbi këndvështrimet cilësore të tyre. Baza e tij janë librat e studiuesit katalanas Manuel Castells dhe veçanërisht libri *Fuqia e Komunikimit*.

Joseph Nye me nocionin e tij *Soft Power* ndonëse një nocion i marrëdhënieve ndërkombëtare, por gjen shpjegim në Ukrainë.

Akademiku shqiptar Artan Fuga është sjellë në këtë studim në funksion të shpjegimit të Propagandës si një nga sfidat me të cilat parashikohet të përballet Ukraina.

Studiuesi Alban Tartari ka ardhur me ndërtimin e fushatave të komunikimit dhe studiuesi Hasan Saliu sa i takon koncepteve dhe ushtrimit të Diplomacisë Publike.

Metodologjia.

Metodologjia e përdorur në këtë studim është kërkimi cilësor dhe analiza e këtyre gjetjeve. Ka një ndërthurje me kërkimin sasior për shkak se është kryer monitorim dhe analizë e hollësishme në të gjitha kanalet e Presidentit dhe të institucionit. Duke qenë se studimi fokusohet te komunikimi *online* i Presidentit Zelenskyy, janë kryer monitorime të hollësishme të faqes zyrtare të Presidencës së Ukrainës me një kohëzgjatje prej 10 muajsh (shkurt-dhjetor 2022) duke u përqendruar te takimet, vizitat dypalëshe dhe shumëpalëshe të zhvilluara në Kiev, Ukrainë gjatë kësaj periudhe. Është monitoruar edhe

agjenda e fjalimeve të mbajtura nga Presidenti Zelenskyy në parlamentet e ndryshme të botës dhe intervistat për mediat ndërkombëtare.

Në kuadër të këtij studimi, janë monitoruar rrjetet sociale *Facebook* dhe *Instagram* në periudha të njëjta kohore gjatë vitit 2022, është bërë krahasimi mes tyre, si dhe është evidentuar trendi i interaktivitetit në secilin rrjet sipas periudhave monitoruese. Në platformën *YouTube* janë monitoruar dy llogari, njëra që i korrespondon zyrës së Presidentit të Ukrainës dhe një tjetër llogari e krijuar nga ekipi i Presidentit. Ky studim përmban gjashtë intervista të cilat janë kryer me ekspertë të fushës. Pjesë e këtyre intervistave janë ekspertë të komunikimit ndërkombëtar, ish-ministra të jashtëm, gazetarë që kanë pasqyruar luftën nga vendngjarja, përfaqësues të trupit diplomatik në Kiev dhe Tiranë. Intervistat kanë pasur qëllim të sjellin një këndvështrim profesional dhe personal në lidhjen me objektin e këtij studimi nisur nga eksperiencia dhe njohuritë e tyre në këtë fushë.

Pyetjet kërkimore dhe hipoteza.

Për të kuptuar më mirë mënyrën si komunikon Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy, me qeveritë e tjera të vendeve të botës, me institucionet ndërkombëtare, e cila është strategjia dhe taktikat e tij në komunikimin publik ndërkombëtar, janë ngritur pyetjet kërkimore dhe hipoteza paraprake, të cilat gjenden në ankesat e punimit.

Marrëdhënie publike në kohë lufte.

Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelenskyy përdor çdo kanal të mundshëm komunikimi për të përcjellë mesazhet politike dhe ushtarake. Zelenskyy ka ndërtuar një agjendë intensive komunikimi drejtuar: -komunitetit ndërkombëtar, -popullit dhe ushtrisë së Ukrainës, -popullit dhe qeverisë ruse. Me qëllim që mesazhi të depërtojë si duhet dhe të arrijë impaktin e dëshiruar, Zelenskyy përdor çdo formë dhe çdo kanal të mundshëm komunikimi.

Takimet ballë për ballë janë shumë të rëndësishme në marrëdhënie publike.

Takime të kësaj natyre kanë pasur gjithmonë rëndësi,⁵ pasi ato përcjellin mesazhe të rëndësishme verbale por mbi të gjitha komunikojnë përmes gjuhës joverbale. Aftësitë e njerëzve për të përcjellë mesazhe nëpërmjet sjelljeve joverbale dhe për të dekoduar mesazhet që përcillen nëpërmjet komunikimit joverbal, përcaktohen edhe nga lloji i profesionit dhe shkalla e aftësive profesionale. “Politikanët dhe diplomatët i përdorin dendur përparësitë e komunikimit joverbal për të shprehur orientime politike të padokumentuara zyrtarisht dhe

⁵ Mjafton të kujtojmë romanin e shkrimtarit Ismail Kadare “Dimri i Vetmisë së Madhe”, ku flitet mbi takimin e E. Hoxhës me Nikita Hrushovin. Romanit në fjalë i referohet edhe filmi “Ballë për Ballë”.

sidomos për të përcjellë mesazhe me dy ose më shumë kuptime, mesazhe të paqarta për politika që pritet të kristalizohen në rrjedhën e kohës.”⁶ Për rëndësinë e gjuhës joverbale ka folur edhe studiuesi Manuel Castells për të cilin “shumica e komunikimit ndërtohet rreth metaforave sepse kjo është mënyra për të hyrë në tru, duke aktivizuar rrjetet e duhura të trurit që do të stimulohen në procesin e komunikimit.”⁷ Presidenti i Ukrainës ka shfrytëzuar në mënyrë mjeshtërore teknologjinë për të komunikuar virtualisht me qytetarët në mbarë botën dhe udhëheqësit e shumë vendeve, duke mbajtur fjalime në parlamentet kombëtare. Më shumë sesa për parlamentarët, mesazhet më të rëndësishme të Zelensky-t i drejtohen popullit të atij shteti.

Empatia dhe emocionit është një element shumë i rëndësishëm në marrëdhënie me publikun dhe Zelensky ka tentuar ta fitojë këtë ndjesi përmes fjalimeve të tij. Gjatë fjalëve në parlamentet kombëtare, në shumicën e rasteve, ai ka hequr paralele mes historisë së vendit të tij dhe vendit të cilit i drejtohet.

Marrëdhëniet publike duhen të jenë sa më të vërteta dhe të besueshme në mënyrë që të arrijnë impaktin e dëshiruar. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe bashkëshortja e Presidentit, Olena Zelenska. Përfshirja e qëllim të bashkëshortes bën që mesazhi të depërtojë më thellë dhe më fort tek opinioni publik. Gratë tentojnë të qëndrojnë larg luftës, por kur ajo ndodh, ato e përcjellin më shumë si nëna, si motra dhe si bashkëshorte.

Komunikimi diplomatik.

Presidenti i Ukrainës ka shfrytëzuar çdo mjet diplomatik dhe çdo kanal komunikimi për të përcjellë mesazhin tek audienca ndërkombëtare. Në këtë pikë ai ka shfrytëzuar në maksimum teknologjinë në funksion të agjendës së tij komunikative. Ai e ka organizuar agjendën diplomatike në mënyrë që të kapë edhe publikun më të pa interesuar. Boshti i komunikimit diplomatik të Zelensky-t kryhet në tre drejtime specifike:

- Vizita diplomatike në Kiev të udhëheqësve të ndryshëm. Gjatë vitit 2022, në Kiev janë kryer 59 vizita zyrtare.
- Diskutime në parlamentet e shteteve të ndryshme. Presidenti Zelensky ka udhëtuar virtualisht në 31 parlamente të botës gjatë vitit 2022, pa lëvizur asnjë ditë nga Ukraina.
- Prezenca në aktivitetet të organizatave ndërkombëtare, në forume sigurie, mjedise akademike, festivale muzike dhe kinematografie anë e mbanë botës. Secila prej këtyre platformave i ka dhënë mundësinë Zelensky-t t'i drejtohet audiencave specifike me mesazhin përkatës.

⁶ Zyhdi Dervishi, *Lente të ndërveprimit simbolik: analizë sociologjike e rolit të simboleve kulturore, të komunikimit joverbal*. Tiranë: ERMAL, 2016, faqe 134.

⁷ Manuel Castells, *Communication Power*. New York: Oxford University Press, 2009, faqe 143.

Komunikimi *online*.

Volodymyr Zelenskyy ka ardhur në politikë nga bota e spektaklit dhe si i tillë ai është pa diskutim një komunikues i jashtëzakonshëm, aftësitë e të cilit janë përmirësuar gjatë dekadave në industrinë e argëtimit. Presidenti i Ukrainës ka ndërtuar një industri të tërë të komunikimit me botën, të cilën e ka perfeksionuar gjatë luftës. Zelenskyy përdor në mënyrë mjeshtërore avantazhet që të krijon:

- bota *online*, teksa komunikon me parlamentet e vendeve të ndryshme, me organizata ndërkombëtare, me botën akademike, me botën e biznesit, etj.;
- rrjetet sociale, përmes të cilave komunikon me audiencë specifike;
- platforma të shpërndarjes së videove për të dërguar mesazhin në gjuhën e audiencave që synon.

Volodymyr Zelenskyy e përqendron komunikimin e tij kryesisht në raportimet ditore për luftën, komunikimet telefonike apo virtuale me homologët ndërkombëtare, vizitat në terren pranë trupave ushtarakë në Kiev por dhe jashtë tij, në mbledhjet e stafit etj. Në komunikimet e Zelenskyy-t mungojnë të dhëna në lidhje me dëmet që pëson Ukraina në jetë njerëzore. “E vetmja gjë që kanë bërë është mbajtja lart e moralit të Ukrainës duke dhënë çdo ditë një informacion të detajuar. Ka informacion të detajuar për humbjet e Rusisë me numrin total. Ndërkohë që nuk jepet informacion për humbjet e Ushtrisë Ukrainase,”- evidenton gazetari Kasapi nga qëndrimi i tij mbi dyjavor në Ukrainë.

Studiuesi Alban Tartari vëren se “Bazuar në publikun që i flet, ndërtohet edhe mesazhi. Rregulli i artë i MP-së është që mesazhi duhet të jetë i ndërtuar në atë mënyrë që të kuptohet që herën e parë nga publiku që është shënjestruar.”⁸ Zelenskyy është shembulli më i mirë sesi e ka ndërtuar në mënyrë strategjike mesazhin varësisht nga audiencë së cilës i drejtohet. Në komunikimin e tij në rrjetet sociale Zelenskyy mban në konsideratë edhe numrin e ndjekësve, preferencat, moshën dhe e pakton mesazhin bazuar në këto specifika.

Dy autorët e librit “The Zelenskyy effect”, Olga Onuch, profesore e Politikës në Universitetin e Manchesterit dhe Henry E. Hale, profesoreshë i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin “George Washington”, studiojnë aftësitë e komunikacionit të Zelenskyy-t dhe ndikimin e tyre në luftë. Studiuesit pohojnë se fjalimet e tij janë të dizajnuara që të kuptohen lehtësisht nga ukrainasit e zakonshëm dhe mbajtja e tyre përmes videove të shkurtra në rrjetet sociale i bën ato edhe më efektive. Komunikimi përmes videove nga presidenti Zelenskyy është një formë e cila i shkon për shtat kërkesave që të imponojnë rrjetet sociale. Në librin “The Hype Machine”,

⁸ Alban Tartari, *Marrëdhëniet me Publikun*. Tiranë: LUIS PRINT, 2021, faqe 179.

Sinan Aral⁹ shprehet se “rrjetet sociale në internet, mesazhet e çastit, njohuritë kolektive të prodhimit të materialeve dhe teknologjitë e grumbullimit të lajmeve kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si informacioni prodhohet, shpërndahet, konsumohet, përdoret dhe vlerësohet.”

Për studiuesin e marrëdhënieve me publikun, A. Tartari, “ajo që ka ndryshuar është media dhe teknologjia, pra dy mjete përmes të cilave MP-ja aplikohet dhe që mundësojnë shpërndarjen e mesazheve, përmbajtjeve dhe kuptimeve të kësaj fushe. Krahas kësaj kanë ndryshuar dhe ata që i konsumojnë mesazhet, publikët, të cilët çdo ditë përballen, marrin dhe procesojnë më shumë informacione, shumë herë më tepër se gjyshërit e tyre.”¹⁰

Volodymyr Zelenskyy nuk i ka lënë asgjë rastësisë kur vjen fjala te tërheqja e vëmendjes ndërkombëtare. Presidenti komunikon jo më pak se 3 herë në ditë, ndërkohë që ka pasur ditë kur në rrjetin e tij social Instagram, janë bërë deri në 19 publikime.¹¹ Vlen për t’u theksuar se Zelenskyy është më shumë prezent në rrjetin social Instagram me një mesatare nga 8-10 postime në ditë në kohën e monitoruar.

Përmbajtja e mesazheve.

Presidenti i Ukrainës e ka ndërtuar komunikimin e tij publik rreth pesë temave, të cilat mund të konsiderohen mjaft të rëndësishme në impaktin që kanë pasur në opinionin publik. “Së pari, Zelenskyy gjithmonë u drejtohet të gjithë qytetarëve të Ukrainës, qytetarëve të një vendi të madh. Së dyti, ai bën deklarata të shpeshta për unitetin e Ukrainës. Së treti, ai kritikon vazhdimisht elitën se nuk po bën mjaftueshëm. Së katërti, ai thekson vazhdimisht vlerat ukrainase, të cilat sipas tij janë evropiane, demokratike, qytetare, liberale dhe gjithëpërfshirëse dhe i vendos ato përballë sistemeve të vlerave të Kremlinit ose oligarkëve. Së pesti, ai lidh vazhdimisht përgjegjësinë personale kombëtare.”¹²

Përzgjedhja e mesazheve që përcjell për audiencën merr një rëndësi specifike në kushtet kur kërkon që vëmendjen e saj ta orientosh sipas interesit për të cilin kryhet komunikimi. Del në pah koncepti i Frame, i cili sipas Castells është një veprim që kryhet përmes proceseve që ndodhin në media. “Frame si veprim i zgjedhur nga dërguesi i mesazhit është herë i rastësishëm dhe herë intuitiv, por ai vendos një lidhje të drejtpërdrejtë mes mesazhit, marrësit (trurit) dhe veprimit që pason.”¹³

⁹ Sinan Aral, *The Hype Machine*. New York: Penguin Random House LLC., 2020, faqe 17.

¹⁰ Alban Tartari, *Marrëdhëniet me Publikun*, Tiranë: LUIS PRINT, 2021, faqe 39.

¹¹ Publikime në Instagramin e presidentit Volodymyr Zelenskyy në datën 3 shkurt 2022.

¹² Olga Onuch & Henry E. Hale, *The Zelensky Effect*, United Kingdom: Hurst & Company, London, 2022, faqe 247-248.

¹³ Manuel Castells, *Comunication Power*, Oxford: Oxford University Press Inc., 2009, f. 158.

Në librin e shkruar nga Volodymyr Zelenskyy “Një mesazh nga Ukraina”¹⁴ përmbledhen disa nga fjalimet e tij më të rëndësishme në vitet 2019-2022. Libri është i organizuar në katër kapituj, ku i pari flet për vlerat që përfaqëson Ukraina, i dyti përmban fjalime për luftën, kapitulli i tretë i referohet kërkesave, pra zërit të Ukrainës dhe kapitulli i fundit, kombit të Ukrainës.

Më 8 mars 2022, Volodymyr Zelenskyy mban fjalën e tij përmes një video-fjalimi në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar. Ky është momenti kur Zelenskyy hapi një front tjetër në luftën me Rusinë, luftën e komunikimit. Në gjashtë muajt që pasuan, Zelenskyy do të jepte qindra fjalime rreth e qark botës. Në çdo platformë komunikimi, Zelenskyy nënvizoi nevojën që bota të ofrojë mbështetje ushtarake për Ukrainën si dhe të vendosë sanksione ndaj Rusisë, si mbështetje “për vlerat e demokracisë dhe të lirinë”.¹⁵

Konsulli shqiptar në Ukrainë, Shakhin Omarov mendon se “thelbi i komunikimit të tij nuk janë vetë kanalet apo pajisjet teknike - por përmbajtja dhe mënyra e komunikimit: ai flet nga emri i tij me formulime të thjeshta për gjërat thelbësore dhe nuk ndahet nga njerëzit.”¹⁶

Studiuesi Artan Fuga në veprën e tij “Mediamorfozë dhe Metakomunikim”¹⁷ i referohet filozofit italian të shekullit XIX, i cili duke parë vendin dhe italianët disi të çoroditur, të ndarë, pa ndjenjën e një përkatësie kolektive, shtronte nevojën se duhet një luftë që të kompaktësohemi dhe njëherë, psikologjikisht si komb. “Nuk ka rëndësi nëse do ta fitojmë këtë luftë, bile më mirë le ta humbasin, sepse me ndjenjën e poshtërimin nga të huajt, me ndjenjën e turpit të përbashkët, do të forcojmë lidhjet tona dhe do të ndjehemi pjesë e një kombi të përbashkët.” I pajisur me ndjesinë që të jep forca e një kombi të bashkuar, qysh në muajin prill 2022 e më tej, Presidenti i Ukrainës bën një kthesë të madhe në komunikimin publik dhe mbi të gjitha në mesazhet që u përcjell liderëve politikë, veçanërisht Rusisë. Kështu, ndryshon dhe retorika e Zelenskyy-t, e cila kalon nga kërkesa për paqe, te kërkesa për fitore.

Komunikimi i Zelenskyy-t vlerësohet si formë interesante edhe nga ish-ministri i Jashtëm Ditmir Bushati, i cili flet për gërshetimin e dy elementeve, “rezistencë dhe viktimizim”, të cilat përçojnë mesazh solidariteti anë e mbanë botës. Bushati mendon se “qëllimi kryesor i Zelenskyy-t ka qenë që këtu nuk është një luftë për mbrojtjen e Ukrainës nga agresioni rus, por është për mbrojtjen e vlerave dhe parimeve me të cilat qëndron Evropa e Bashkuar.”¹⁸

¹⁴ Volodymyr Zelenskyy, *A message from Ukraine*, Londer: Hutchinson Heinemann, Penguin Random House UK, 2022.

¹⁵ Po aty, faqe 63.

¹⁶ Referoju intervistës me Konsullin shqiptar në Ukrainë.

¹⁷ Artan Fuga, *Mediamorfozë dhe Metakomunikim*, Tiranë: PAPIRUS, 2017, faqe 405.

¹⁸ Intervista me z. Ditmir Bushatin.

“Narrativa se Ukraina po mbron Evropën është një narrativë e fuqishme, të paktën në vende si Polonia fqinjë e cila ndjen rrezikun real të luftës. E në këtë drejtim mjafton të përmendim intensifikimin e vizitave dhe komunikimeve mes qeverisë ukrainase dhe polake gjatë luftës”, thotë Adam Richardt, kryeredaktor i “New Eastern Europe”, ekspert komunikimi dhe njohës i medias, në një intervistë për këtë studim.¹⁹ Ky është një mesazh i rëndësishëm, i cili e vendos Presidentin e Ukrainës në pozicionin e një lideri që kërkon vendin e tij në histori, si njeriu që i dha fund njëherë e mirë synimeve ruse mbi Ukrainë.

Këtu vijmë te një dimension tjetër që synon komunikimi i Presidentit Zelenskyy: ndërtimi i një “brandi” personal dhe kombëtar. Zelenskyy shihet sot si një politikan i cili ka ndërtuar “brandin” e tij në arenën ndërkombëtare. Në këtë pikë, Ditmir Bushati thotë se “Nuk ka diskutim që Zelenskyy është një lloj “brandi” politik dhe një lloj modeli përgjithësisht për botën demokrate dhe për botën që beson te vlerat e lirisë”. Të njëjtin mendim ndan edhe Adam Richardt, i cili beson se Ukraina ka një markë politike si një vend i bashkuar për mbrojtjen nga agresioni dhe luftën për liri dhe mbijetesë.

Përfshirja e qëllimshme e bashkëshortes së Presidentit ukrainas, Olena Zelenska.

Beteja për vëmendjen e opinionit publik nuk ka kursyer as bashkëshorten e Presidentit të Ukrainës. Olena Zelenska po “lufton” në vijën e parë të frontit që në javët e para të fillimit të luftës. Përfshirja e qëllimshme e bashkëshortes tregon për rëndësinë që i kushton Zelenskyy komunikimit publik. Aq është vlerësuar roli dhe impakti që ka pasur Zonja e Parë në komunikimin publik ndërkombëtar, saqë ndonjëherë është konsideruar edhe si “arma sekrete e Ukrainës.”²⁰

Marrëdhëniet publike kanë nevojë për origjinalitet dhe emocione, në mënyrë që të japin impaktin e dëshiruar. Në këtë drejtim, përfshirja e Olena Zelenska në komunikimin publik ndërkombëtar synon të prekë emocionet më të forta njerëzore. Ukraina po përballet me Rusinë në planin ushtarak, e cila njihet si “hard power” dhe në të njëjtën kohë po zhvillon fuqi të butë “soft power” me një agjendë agresive të diplomacisë publike, e cila “nënkupton komunikimin e aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë, organizatave joqeveritare, korporatave, individëve, - me publikun e jashtëm, me qëllim informimin, ndikimin dhe angazhimin e tyre për të realizuar objektiva politikë e ekonomike të vendit.”²¹

¹⁹ Intervista është realizuar në datën 29 maj 2023.

²⁰ Peter Dickinson, 2022. *Atlantic Counsel*. 28 korrik. Qasja prill 8, 2023. Burimi elektronik: <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/ukrainealert/vogue-diplomacy-first-lady-olena-zelenska-is-ukraines-secret-weapon/>.

²¹ Hasan Saliu, *Komunikimi në Diplomacinë Publike*, Prishtinë: Kolegji Universitar AAB, 2015.

Gjetjet

Ky studim pohon hipotezën mbi të cilën u ngrit se “Një lider i zgjedhur, si produkt i ndikimit nga media tradicionale (aktor filmash serialë), sot po ndërton imazhin e tij të suksesshëm ndërkombëtar falë zhvillimit të mediave sociale”.

Zelenskyy përdor në mënyrë mjeshtërore avantazhet që të krijon:

- bota *online*, teksa komunikon me parlamentet e vendeve të ndryshme, me organizata ndërkombëtare, botën akademike, me botën e biznesit, etj.;
- rrjetet sociale, përmes të cilave komunikon me audiencën specifike;
- platforma e shpërndarjes së videove për të dërguar mesazhin në gjuhën e audiencës që synon.

Presidenti i Ukrainës ka ndërmarrë një agjendë “agresive” komunikimi publik ndërkombëtar. Ai ka shfrytëzuar çdo platformë, takim dhe mundësi për të diskutuar mbi situatën në Ukrainë dhe për të kërkuar ndihmë.

Komunikimi i Zelenskyy-t fokusohet në disa elemente të rëndësishme si: rezistenca, viktimizimi, kufiri ndarës me të keqën, liritë dhe të drejtat, në virtyte si: trimëria, drejtësia dhe më tej, në vlerat e shoqërisë në tërësi si: nderi, lavdia, frika. Mesazhet e tij i drejtohen audiencës në tërësi, por në mënyrë të targetuar ai komunikon me:

- komunitetin ndërkombëtar,
- popullin dhe ushtrinë e Ukrainës,
- Putinin dhe ushtrinë ruse dhe sidomos me popullin rus.

Zelenskyy po përpiqet të ndërtojë imazhin e tij historik. Retorika ka ndryshuar me kalimin e kohës. Qysh në muajin prill 2022 e më tej, Zelenskyy kalon nga kërkesa për paqe, te kërkesa për fitore në luftën me Rusinë. Mes dy bashkëshortëve ka pasur një ndarje të qartë rolesh.

Presidenti fokusohet më shumë te mesazhi politik i luftës, nevoja për mbështetje dhe përkrahje dhe forca motivuese për ushtrinë. Në rastin e zonjës së parë, narrativa kryesore është dhimbja dhe humbjet njerëzore që po përjeton kombi i Ukrainës. Imazhi i gruas ka gjithmonë ndikim të madh në botën perëndimore. Olena Zelenska i drejtohet publikut ndërkombëtar si grua dhe si nënë.

Të dy bashkëshortët kanë zgjedhur të komunikojnë përmes veshjes, simboleve dhe mesazheve të pazëshme.

Literatura e shfrytëzuar.

1. Zyhdi Dervishi, *Lente të ndërveprimit simbolik: analizë sociologjike e rolit të simboleve kulturore, të komunikimit joverbal*. Tiranë: Ermal. 2016.

2. Manuel Castells, *Communication Power*. New York: Oxford University Press, 2009.
3. Alban Tartari, *Marrëdhëniet me Publikun*. Tiranë: Luis Print, 2021.
4. Sinan Aral, *The Hype Machine*. New York: Penguin Random House LLC., 2020.
5. Olga Onuch & Henry E.Hale, *The Zelensky Effect*, United Kingdom: Hurst&Company, London, 2022.
6. Manuel Castells, *Comunication Power*, Oxford: Oxford University Press Inc., 2009.
7. Volodymyr Zelensky, *A message from Ukraine*, Londer: Hutchinson Heinemann, Penguin Random House UK, 2022.
8. Artan Fuga, *Mediamorfozë dhe Metakomunikim*, Tiranë: Papirus, 2017.
9. Peter Dickinson, 2022. *Atlantic Counsel*. 28 korrik. Qasja prill 8, 2023. Burimi elektronik: <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/ukrainealert/vogue-diplomacy-first-lady-olena-zelenska-is-ukraines-secret-weapon/>.
10. Hasan Saliu, *Komunikimi në Diplomacinë Publike*, Prishtinë: Kolegji Universitar AAB, 2015.

Kontraktorët civilë, roli i tyre në mbështetjen e veprimtarisë së FA të RSH

Nënkolonel (R) Dr. Enrik Ago
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Mbështetja me shërbime nga kontraktorët civilë (pala e tretë), është një term që lidhet me mbështetjen nga burimet e jashtme, jo organike të strukturave të FASH dhe mund të sigurohet nga një apo disa operacione të ofruar nga kompani apo agjenci të specializuara, ku shërbimet e përfituara nga të tretët përfaqësojnë shërbime jokryesore të përfituesit.

Sigurimi i shërbimeve të ndryshme nëpërmjet tyre është pranuar si një komponent i rëndësishëm i praktikave moderne tregtare, ekonomike dhe menaxhuese, si dhe duke pasur parasysh efektivitetin e kostos, përfitimet ekonomike afatgjata, burimet e shumta, ekspertizën dhe cilësinë e shërbimeve që ato mund të ofrojnë, do të ishte mjaft efektive në qoftë se FASH delegonin kërkesat e tyre apo funksionet jokryesore (shërbim mbështetës që ndihmon në përmbushjen e misionit/ detyrave kryesore) tek ofruesit e këtyre shërbimeve.

Ndryshimet e mjedisit të sigurisë, roli i FASH, politikat e reja të mbrojtjes dhe faktorë të tjerë kanë çuar në një plotësim të sasisë së personelit dhe buxhetit të mbrojtjes në dispozicion, për përmbushjen e misionit dhe detyrave të tyre, e cila ishte një sfidë për FASH duke kërkuar rrugët e mundshme të zgjidhjes, ndaj zbatimi i praktikave të ngjashme me biznesin privat dhe FA aleate të NATO-s duke u mbështetur në palët e treta, ishte një nga mënyrat që filloi të aplikohet për mbështetje me shërbime të ndryshme edhe në strukturat e FASH.

Në strukturat e FASH sigurimi me produkte dhe shërbime nga palët e treta ka

sjellë përmirësim të disa funksioneve mbështetëse, por duke pasur parasysh fondet, burimet dhe personelin organik që mund të racionalizohen nga angazhimi në këto shërbime, duke i kaluar organikisht në detyrat kryesore si stërvitja dhe gatishmëria, pa dëmtuar cilësinë e shërbimit, përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve, shërbimet në përgjithësi të ofruara nga palët e treta përfaqësojnë një tendencë që duhet të merret parasysh.

Fjalët kyçe: Autoritet kontraktor, ofruer i palës së tretë, mbështetje me shërbime, burime të jashtme, reduktim kostoje, efektivitet i shpenzimeve.

Hyrje

Mbështetja në përgjithësi nga një “palë e tretë”, apo nga “burimet e jashtme” (jo organike), është një model mbështetje që u promovua dhe u zhvillua nga biznesi privat që në fillim të viteve 1980. Nevoja për të mbështetur aktivitetin e tyre, për të rritur prodhimin, përballuar konkurrencën, zgjeruar tregun, ulur shpenzimet, rritur cilësinë dhe shumë faktorë të tjerë, sollën orientimin e bizneseve private drejt sigurimit të shërbimeve nga palët e treta.

Çështja më e rëndësishme për të siguruar mbështetje të suksesshme nga palët e treta është përcaktimi i funksioneve mbështetëse që mund të transferohen drejt palës së tretë, prandaj është e nevojshme analizimi i funksioneve që duhet të mbështeten me to dhe vlerësimi i përfitimeve që do të arrihen nga transferimi drejt tyre. Procesi i identifikimit, përcaktimit, analizimit dhe vlerësimit të funksioneve mbështetëse që mund të sigurohen nga burimet e jashtme është i vështirë dhe kërkon studime specifike sipas fushave, nisur dhe nga misioni i strukturave mbështetëse, që është sigurimi i shërbimeve në kushtet e racionalizimit të kapaciteteve të brendshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturore.

Zhvillimi i FARSH drejt një force profesionale dhe me një buxhet të mjaftueshëm, kërkon rritjen dhe ruajtjen e nivelit operacional, nëpërmjet aplikimit të sistemeve dhe modeleve të mbështetjes funksionale efikase, të mirë organizuar dhe ndërvepruese me strukturat e sigurisë kombëtare dhe FA të Aleancës. Kjo e bën të nevojshme kërkimin e modeleve të suksesshme të mbështetjes së forcës, ndaj mbështetja nga palët e treta është parë si një mënyrë e aplikueshme dhe e leverdishme në strukturat ushtarake.

Aktualisht në strukturat e FASH ka një përvojë pozitive në raport me aplikimin e palëve të treta, por nuk ka një analizë të plotë për përcaktimin e strategjisë së qasjes drejt modeleve të përparuara të mbështetjes së përgjithshme, sipas fushave përkatëse për të realizuar në një shkallë më të gjerë këtë tendencë, ku e ardhmja e mbështetjes së forcës është përfaqësuar drejt modeleve të sektorit privat të mbështetjes, ndaj sfida është aplikimi me sukses i këtyre modeleve.

FASH kanë kaluar në një proces të gjatë ristrukturimi dhe zhvillimi drejt një force profesioniste duke synuar rritjen e kapaciteteve operacionale. Këto sfida kërkojnë struktura më efikase mbështetëse, të cilat duhet të analizojnë dhe krahasojnë modelet e mundshme të mbështetjes. Modelet e zbatuara të sektorit privat dhe të forcave të armatosura të NATO-s kanë nxjerrë në pah suksesin e modelit të mbështetjes nga palët e treta, ku problemi kryesor për FA tona është evidentimi i funksioneve që mund të transferohen drejt mbështetjes me të tretë dhe përzgjedhjen e marrëdhënieve midis palëve.

1. Mbështetja nga të tretët, një histori zhvillimi dhe përvoja e sektorit privat

Bazuar në historinë ushtarake, që në sistemin feudal dhe më larg dëshmon faktin se perandorët apo mbretërit siguronin ushtarët/ luftëtarët nga burime të jashtme, siç ishin lordët apo zotëruesit e mëdhenj lokal apo rajonal.¹ Zgjerimi i këtyre lloj shërbimesh ndodhi në një kohë që përdoruesit e logjistikës po kërkonin mbështetje të pjesshme të kompanive të tyre nga të tretët, ku ofruesit si palë e tretë, mundësonin shërbime logjistike më të lira për shkak se shkalla e fitimit rritej, si rezultat i numrit të madh të klientëve.²

“Një ofrues i palës së tretë është një kompani e cila furnizon/ koordinon funksionet e logjistikës përgjatë linjave të shumta në zinxhirin e furnizimit. Kështu, kompania vepron si një “palë e tretë” ndërmjetëse midis shitësit/ prodhuesit (si palë e parë) dhe blerësit/përdoruesit (si palë e dytë).”³

Mbështetja që sigurohet nga të tretët mund të jetë funksion, material, produkt apo shërbim, që organizata mund t'i realizojë vetë me asetet e saj, por që preferon t'i blejë nga të tjerët për shkak të përfitimeve dhe bëhet pas studimeve dhe vlerësimeve të detajuara mbi përfitimet e mundshme, ku cilësia, besueshmëria, shanset për sukses, aftësia për bashkëpunim dhe më i rëndësishmi çmimi, janë disa nga faktorët që duhet të vlerësohen gjatë këtij procesi. Ulja e kostos apo minimizimi i shpenzimeve varet nga analizimi i funksionit që kërkohet të blihet, e cila ndikohet që nga faza e projektimit, bashkëpunimit midis furnizuesit dhe blerësit, deri në prodhimin e produktit apo sigurimin e shërbimit final. Kur planifikohet ose projektohet një strategji për mbështetje nga burime të jashtme, identifikimi dhe vendosja e objektivave që duhet të arrihen, si dhe faktorët që ndikojnë në përmbushjen e tyre kanë rëndësi të veçantë.

Kontraktimi i shërbimeve mbështetëse synojnë sigurimin e specializuar, që përfshijnë furnizimin me produkte, transportin, magazinimin, mirëmbajtjen,

¹ V Gopal, *Are the Armed Forces Game for 3P*, 2012.

² Po aty, 51.

³ Arnold B. Maltz, Robert C. Lieb, *The Third Party Logistics Industry: Evolution, Drivers and Prospects*, 1995, 45.

si dhe shërbimet e kohëve të fundit si, ndjekja e dërgesave dhe operacione të tjera.⁴ Tre synimet kryesore që kompanitë përpiqen të marrin shërbime nga pala e tretë janë: a. reduktimi e kostos, b. përmirësimi i shërbimit dhe c. fleksibiliteti.⁵ Në vijimësi mjedisi strategjik i sigurisë ka sjellë përkufizime të reja të rreziqeve dhe kërcënimeve, ndryshime në politikat e mbrojtjes apo ndryshime në rolin e FA, por edhe ndryshimet e ndodhura në fushën ekonomike dhe financiare kanë ndikuar në zhvillimin e strukturave ushtarake, e cila imponoi reforma në planifikimin e mbrojtjes thuajse në shumë vende.

Për të përmbushur sfidat, forcat e ndryshme ushtarake kanë zhvilluar tre objektiva në lidhje me shërbimet e mbështetjes së forcave: a. ulja e kohës së përgjigjes për të dërguar furnizimet sa më shpejt tek konsumatori; b. zhvillimi i një sistemi të rrjedhshëm logjistik për të përmirësuar funksionet përkatëse që duhet të funksionojnë së bashku; dhe c. riorganizimi i infrastrukturës logjistike për të rikuperuar ndryshimin e forcave dhe buxhetit. Në kohën kur shoqëria sot është shndërruar në një shoqëri konsumi, detyra kryesore e logjistikës është të “dërgojë materialet dhe prodhimet në kohën, vendin e duhur me kosto të ulët dhe cilësi të mirë.”⁶ Theksi në menaxhim vendoset te kostoja e ulët, koha e lëvizjes së mallrave dhe cilësia e tyre, kërkesa të cilat përbëjnë problemet kryesore të mbështetjes së operacioneve ushtarake.

Gjatë viteve të fundit, përveç eksperiencës ushtarake, një ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e logjistikës ka dhënë edhe sektori privat nëpërmjet eksperiencave në fushat e ekonomisë, industrisë dhe biznesit, etj., ku globalizimi i shoqërisë i kanë dhënë një dimension dhe “rol të ri” logjistikës, që ka ndryshuar në atë që tani ajo luan një pjesë kryesore në suksesin e shumë operacioneve dhe organizmave të ndryshëm.⁷ Në Forcat e Armatosura, sistemet logjistike koordinohen nga strukturat përkatëse dhe për të përmbushur objektivat e tyre, në shumicën e vendeve të Aleancës është zhvilluar koncepti “logjistikë e dobët”, e cila është një koncept “ombrellë” që përshkruan aplikimin dhe adaptimin e praktikave më të suksesshme të biznesit publik dhe privat, në sistemin e logjistikës”.⁸

Kjo lloj logjistike synon të zvogëlojë koston e ciklit të jetës së sistemit, duke ruajtur disponueshmëri të lartë.⁹

⁴ Yosef Sheffi, “Third Party Logistics: Present and Future Prospects”, Journal of Business Logistics, 1990, 27.

⁵ Arnold B. Maltz, *The Outsourcing Decision: What the Data Say*, 1994, 124.

⁶ Raymond A. Pyles, I. K. Cohen, *Using Emerging Business Practices to Meet New Logistics Challenges*, Rand, 1996, 6.

⁷ Alan Rushton, John Oxley, Phil Croucher, *Logistics and Distribution Management*, The Institute of Logistics and Transportation, UK, Kogan Page, second edition 2002, 7.

⁸ HQ USAF, USAF Baseline Lean Logistics Master Plan and Road Map, 1995, 17.

⁹ Po aty, 13.

Ashtu si operatorët privatë, edhe strukturat ushtarake kanë zgjedhur kontraktimin e një pjese të konsiderueshme të shërbimeve mbështetëse nga palët e treta, por problemi është përcaktimi i funksioneve që mund të sigurohen nga këta, duke mos cenuar suksesin e operacioneve. Rezultatet e deritanishme të arritura nga ushtri të vendeve të ndryshme konsiderohen të suksesshme, ku nga aplikimi i tyre shumë funksione kanë pasur rezultate pozitive, si dhe rastet ku janë evidentuar probleme janë rishikuar për fizibilitetin, duke e zhvilluar më tej atë mënyrë ose duke e mbajtur atë funksion si burim të brendshëm të forcës.

2. Roli i palëve të treta në sigurimin e shërbimeve të ndryshme në forcat e armatosura të vendeve të NATO-s

Bizneset prodhuese dhe tregtare përfaqësojnë konkurrimin e palëve të treta për kontrata shtetërore, të cilat rrisin efikasitetin, ulin kostot dhe përqendrohen në nevojat e konsumatorit, e cila çon në ofrimin më të shpejtë të produkteve më të mira në FA. Fleksibiliteti lidhet me dhënien e një hapësire më të madhe personelit që menaxhon mbështetjen e FA, për t'iu përgjigjur llojit dhe madhësisë të burimeve të nevojshme duke ndryshuar nivelet e “blerjes” nga palët e treta.

Ekonomia e shkallëzuar dhe e specializuar lidhet me atë që kompanitë e mëdha në një treg të caktuar kanë shumë klientë të shpërndarë në nivele të ndryshme të mbështetjes dhe aktivitetit të tyre. Kështu, ato kanë zhvilluar një ekonomi të shkallëzuar që për operatorët e vegjël dhe të vetëm është e paarritshme, ndaj kontraktimi i këtyre firmave i mundëson FA, të përfitojnë për çdo nivel mbështetje, produkte dhe shërbime që mund të jenë të pamundur për t'u blerë ose shumë të kushtueshme për t'u prodhuar organikisht. FA-të, të ndikuara nga ecuria dhe zhvillimet e suksesshme të mbështetjes nga palët e treta të sektorit privat, e shikojnë këtë model mbështetje si një nga mënyrat më të mira për përmbushjen e objektivave kryesore të tyre në fushën e planifikimit të mbrojtjes, ku nëpërmjet tyre arrijnë të ruajnë kapacitetet operationale me një forcë të mjaftueshme dhe e mbështetur nga një buxhet i pranueshëm.

Në mënyrë të ngjashme, Campbell shprehet se “përdorimi i tyre për të mbështetur operacionet ushtarake nuk është më një e mirë për ta pasur ...është një pjesë thelbësore, jetike e projektimit të aftësive të forcës tonë”.¹⁰ Sipas statistikave të Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-ve, mars 2013, në Afganistan ishin rreth 108.000 personel kontraktor, të cilët përfaqësonin 62% të forcës së përgjithshme.

Vendet kryesore që shfrytëzojnë shërbimet e ofruara nga palët e treta janë SHBA (që konsiderohet si një nga pionierët në këtë fushë), Britania e Madhe, Kanadaja, Franca, Gjermania, Zelanda e Re, Izraeli, Australia etj. Në fakt, ka

¹⁰ G. L. Campbell, *Contractors on the Battlefield: The Ethics of Paying Civilians to Enter Harm's Way and Requiring Soldiers to Depend on Them*, 2000, 1.

më shumë se 150 kompani të mëdha me shtrirje ndërkombëtare që ofrojnë shërbimet e tyre në mbi 50 vende të botës. Shumë vende kanë zgjedhur mbështetjen e FA nga palët e treta dhe janë duke u fokusuar në ripërcaktimin dhe mbulimin e funksioneve jokryesore nga burimet e jashtme. Kjo është provuar të jetë një alternative me kosto shumë efektive, ku vendet që aplikojnë palët e treta, deklarojnë se kanë arritur të ulin shpenzimet me 15-40 %.

“Kontraktorët janë persona apo biznese, që përfshijnë nënktraktorët e autorizuar, që ofrojnë produkte apo shërbime për kompensim monetar ... Në një operacion ushtarak, një kontraktues mund të përdoret për të siguruar mbështetje logjistike, ... dhe shërbime të tjera teknike.”¹¹

Britania e Madhe është përballur me probleme gjeopolitike, demografike dhe ekonomike, duke mbështetur pikëpamjen se, “... sektori privat është ... më i aftë se organet e sektorit publik në gjenerimin e mallrave, shërbimeve dhe menaxhimin e operacioneve dhe projekteve”.¹² Forcat e armatosura britanike ka ndjekur një politikë agresive për përdorimin e kontraktorëve dhe megjithëse në doktrinën e tyre nuk ka një përcaktim të qartë të përkufizimit për ta, cilësohet si, “... një term i përgjithshëm që lidhet me të gjithë personelin civil të kontraktuar në mbështetje të operacioneve ushtarake. Ky personel do të mund të dislokohet në mbështetje të një shumëllojshmërie kontratash, duke përfshirë dhe prodhuesin origjinal të pajisjeve”.¹³ Objektivi i MM Britanike është përfshirja e sektorit privat në operacionet e dislokimit, duke siguruar elementët mbështetës nga palët e treta, e cila ka sjellë shtimin e numrit të kontraktorëve. Pranohet se “personeli ushtarak nuk i posedon të gjitha aftësitë e specializuara të nevojshme për të mbajtur një sasi në rritje të pajisjeve të avancuar teknologjike”¹⁴ ... ndaj këto lloj sistemesh mund të mbështeten nga palët e treta që ofrojnë këto shërbime.

Në Librin e Bardhë thuhet se Kanadaja “... duhet të mbajë një nivel të kujdesshëm të forcës ushtarake” dhe se “shumë fusha të mbrojtjes do të shkurtohen më tej”. “Privatizimi i mbrojtjes” shikohej si rruga kryesore për ruajtjen e kapaciteteve të FA”.¹⁵ Marrja e pajisjeve dhe sistemeve të teknologjisë së re krijoi një mungesë të personelit të aftë për mbështetjen e tyre dhe kjo i drejtoi FA-të drejt kontratave të shërbimit, ndaj kontraktori konsiderohet “... një njësi ekonomike me të cilët FA ka hyrë në kontratë për të

¹¹ FM 3-100.21, *Contractors on the Battlefield*, Washington D.C. Department of the Army, USA, 2003.

¹² Trevor Taylor, *Contractors on Deployed Operations and Equipment Support*, Defence Studies, 2004, 185.

¹³ UK MoD, JDP 0-01.1, United Kingdom Glossary of Joint and Multinational Terms and Definitions 7th ed., 2006, c-22.

¹⁴ United Kingdom Ministry of Defence, *Operations in Iraq: Lessons for the Future*, 2003, 45.

¹⁵ <http://www.forces.gc.ca/admpol/newsite/defence.pdf>.

ndërtuar ose krijuar dhe dhënë një të mirë, shërbim ose pajisje.”¹⁶ Për të gjitha vendet, mbështetja e palës së tretë synon të çlirojë logjistikën nga funksione dhe detyra që mund të ofroheshin në mënyrë më cilësore, më të lirë dhe më shpejt nga të tretët, duke rritur tempin e operacionit, megjithatë mbështetja nga palët e treta konsiderohet “zgjidhje e zgjuar”, por ndërkohë edhe “propozim i rrezikshëm”.

Forcat e armatosura të Zelandës së Re e përdorin palën e tretë për funksionet si mirëmbajtje, furnizimin me uniforma, armatim, municione, menaxhimin e objekteve, akomodimin e ushtarakëve etj., duke deklaruar se ka kursyer rreth 8.5 % të shpenzimeve të tyre totale.¹⁷

Forcat e armatosura të Izraelit kanë transferuar te palët e treta shërbime vizuale të zbulimit, kujdesin shëndetësor parësor dhe spitalor të ushtarakëve, i cili ka rezultuar i suksesshëm në drejtim të nivelit të shërbimit, infrastrukturës, cilësisë dhe disponueshmërisë.¹⁸

Gjenerali H. Bentegeat, kreu i Komitetit Ushtarak të BE, në konferencën e Agjencisë së Mbrojtjes Evropiane për mbështetjen nga pala e tretë, deklaroi se “do të ekzistojë gjithmonë një nevojë për t’u mbështetur nga këto operatorë në operacionet shumëkombëshe për shkak se, shtetet anëtare nuk e mbulojnë të gjithë zinxhirin mbështetës”.¹⁹

3. Aplikimi i mbështetjes logjistike me të tretë në strukturat e FARSH

Në dallim nga shumë vende të tjera, Shqipëria ka lëvizur në një trajektore të ndryshme, për sa i përket zhvillimit të mjedisit ekonomik për mbështetjen me shërbime nga palët e treta/ kontraktorët. Para viteve 1990, Shqipëria si karakteristikë kryesore kishte ekonominë shtetërore të centralizuar, mungesën e iniciativës private, si dhe mungesën e të gjitha koncepteve kryesore për ekonominë e tregut dhe fitimin.

Në legjislacionin e RSH termi “*Autoritet kontraktor*” është *..çdo Ent që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. Këto ente janë: a. institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore; b. çdo ent: i themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm dhe me karakter joekonomik apo tregtar; i cili ka personalitet juridik; i financiar kryesisht nga shteti; c. organizatat e formuara nga një ose disa nga këto autoritete apo nga një ose disa nga këto organe publike*²⁰.

¹⁶ Department of National Defence of Canada; <http://dgmssc.ottawahull.mil.ca/ma.Lexicon>.

¹⁷ J. Woon Leanne, *New Zealand Defence-How Does It Stack Up*, Army Logistician, 2004.

¹⁸ *Outsourcing Primary Medical Care in Israeli Defence Forces*, <http://www.sciencedirect.com/science>.

¹⁹ E. U. Mulls, *Increasing Outsourcing for Logistics*, <http://www.defencenews.m/story>

²⁰ Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 3, 4.

Vitet 1990 konsiderohen fillimi i zhvillimit të iniciativës së lirë ekonomike dhe bizneseve të para private, ku vitet e para ishin një luftë midis mbijetesës dhe dështimit të bizneseve, ku për një periudhë mbi 10-vjeçare biznesi nuk arriti të ngrihej në nivelin e ofrimit të shërbimit ndaj të tjerëve, ndaj fokusi kryesor i tyre ishte kryesisht tek tregtimi i mallrave dhe jo i shërbimeve, si dhe akoma mbaheshin në këmbë mjaft ndërmarrje shtetërore, të cilat tentonin të ofronin shërbime të veçanta me synim, sigurimin e fitimeve minimale apo mbijetesës. Këto shërbime nuk kanë pasur asnjë lidhje me cilësinë e shërbimit, koston e ulët, efektivitetin, fleksibilitetin, sigurimin e fitimeve me qëllim zhvillimin e kapaciteteve.

Dekada e dytë konsiderohet më pozitive në drejtim të zhvillimit të kompanive të para të suksesshme, që jo vetëm filluan të siguronin fitime dhe të investonin, por filluan dhe të konkurronin në treg për shërbime dhe mallra të caktuar, si rezultat i eksperiencës së fituar nga kompanitë e huaja, kooperimi me to, etj.

Ashtu si në të gjithë vendet e zhvilluara edhe në Shqipëri zhvillimet e para pozitive në drejtim të ofrimit të shërbimeve ndaj të tretëve konstatohen tek iniciativat private në shërbimin e transportit, në kuadrin e “shoqërive”, të cilat u zhvilluan dhe u konsoliduan duke krijuar kompanitë e para të transportit. Fillimisht këto konsistuan në fushën e transportit të mallrave, e cila më vonë u shtri edhe në transportin e pasagjerëve dhe sot në vendin tonë operojnë kompani të cilat sigurojnë transport inter-modal dhe janë konkurruese brenda vendit, dhe në tregun ndërkombëtar.

Në mesin e viteve 2000 lindën dhe u zhvilluan bizneset që ofronin edhe shërbime të tjera të logjistikës, si shërbimet e “kateringut” (ushqimit) dhe shërbime të përkujdesjes së trupave, që nisën fillimisht si nevoja të kompanive të huaja që kishin investuar në Shqipëri dhe më pas për sigurimin e fitimeve nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve, ndërsa sot kompanitë e “kateringut” ofrojnë shërbimin e tyre për bizneset private dhe institucionet shtetërore.

Aktualisht, në vendin tonë operojnë në treg kompani kombëtare dhe ndërkombëtare me një gamë të konsiderueshme biznesesh që ofrojnë shërbime cilësore, me kosto të pranueshme, transparente në mënyrën e ofrimit dhe procedurat e ekzekutimit, por kërkohet më shumë sigurim i cilësisë dhe standardeve të përcaktuara, por një tjetër element që akoma mund të konsiderohet i dobët është sigurimi i vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit.

Konkretisht, për herë të parë Forca Ajrore Shqiptare lidhi marrëveshje me NSPA (Agjencia e NATO-s për mbështetjen dhe prokurimet) për mirëmbajtjen e nivelit të 2-të dhe 3-të të helikopterëve. Kjo erdhi si pasojë e kërkesave në rritje për gatishmërinë operacionale të helikopterëve, kapaciteteve organike të pamjaftueshme për mirëmbajtje dhe vështirësitë e hasura në vazhdimësi me disa kompani të kontraktuara, të cilat nuk i përgjigjeshin kërkesave të FA-ve,

nuk respektonin afatet e përcaktuara në kontratë, si dhe nuk kishin asetet e nevojshme për t'iu përgjigjur nivelit të shërbimeve.

NSPA ofron mbështetje logjistike dhe shërbime të ndryshme për operacionet dhe misionet e NATO-s, si dhe për partnerët e saj. Bashkëpunimi me NSPA sjell shumë përfitime për vendet anëtare dhe partnerë si: reduktimi i kostove dhe rritja e efikasitetit nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve të përbashkëta dhe të ndara; përmirësimi i aftësive dhe kapaciteteve ushtarake për të përballuar sfidat e sigurisë; rritja e ndërveprueshmërisë dhe koordinimit midis forcave të ndryshme të NATO-s dhe partnerëve, si dhe zgjerimi i mundësive për bashkëpunim dhe dialog në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.²¹

Gjithashtu në Forcën Detare, mirëmbajtja e nivelit të 3-të dhe 4-t për teknikën detare realizohet nëpërmjet Kantierit të Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve (KNRA), Pashaliman, Vlorë.²²

4. Rëndësia dhe interesi i mbështetjes me shërbime të FA-ve nga palët e treta

Ashtu si shumë forca të armatosura të vendeve të Evropës Lindore dhe Juglindore që ndërmorën procese rrënjësore për anëtarësimin në NATO, edhe FA të RSH kaluan në një rrugë ndryshimesh dhe reformash si, reduktimi i numrit të personelit dhe njësisë, kalimi nga një mision i lidhur me mbrojtjen dhe përgatitjen për përballimin e një agresioni “të gjithanshëm” tek operacionet në përgjigje të krizave, reduktimi i numrit të aseteve mbrojtëse dhe rritja e përdorimit të teknologjisë bashkëkohore, si dhe shumë ndryshime të tjera.

FA-të ka si mision krijimin dhe ruajtjen e gatishmërinë operacionale të përcaktuar dhe duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, kompletimi me sisteme dhe pajisje moderne, kërkesat e larta për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sigurimin e kapaciteteve të kërkuara, e bëjnë të domosdoshme kërkesën për mbështetje të gjithanshme cilësore të integruar dhe specifike. Kërkesat për investime dhe rritje të buxhetit do të jenë gjithmonë objektiva në zhvillim, ndaj me qëllim krijimin e hapësirave për efikasitetin e shpenzimeve është e rëndësishme të shqyrtohen mundësitë e mbështetjes nga palët e treta e funksioneve jo operacionale dhe shërbimeve të aktivitetit rutinë.

Mbështetja te palët e treta do të ndihmojë në racionalitetin e shpenzimeve të mbrojtjes, përmirësojë efikasitetin, krijimin e mundësive për t'u përqendruar në funksionet kryesore, duke siguruar gatishmëri operacionale, zhvilluar burimet njerëzore dhe reduktuar burimet e brendshme jo të domosdoshme.

²¹ <http://www.nspa.nato.int>, 2024

²² VKM nr. 397, datë 11.05.2015 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”.

Për FARSH kërkohet orientimi drejt praktikave më të mira të sektorit privat dhe FA aleate, për rritjen e shpejtësisë së sigurimit me shërbime dhe furnizime, përmirësimin e cilësisë së tyre, kosto të pranueshme, zhvillimin e sistemeve efikase për të përmirësuar funksionet logjistike, riorganizimin e infrastrukturës, ndaj këto masa i imponojnë FA-ve përcaktimin e funksioneve që mund t'i transferojë drejt palëve të treta, proces i cili është i nevojshëm për orientimin e investimeve drejt modernizimit të forcës. FARSH prej vitesh kanë investuar në sisteme dhe pajisje të reja dhe moderne, por mungesa e analizave, planeve dhe përcaktimeve të qarta të burimeve që do të konsiderohen organike dhe burimeve të jashtme apo funksioneve që do të sigurohen nga të tretët, kanë bërë që disa investime mund të konsiderohen jo efektive, si dhe disa funksione nga palët e treta janë realizuar gradualisht dhe me studime pjesore, gjithashtu gjatë procesit të planifikimit nuk janë marrë në konsideratë eksperiencat e sektorit privat apo FA të vendeve të zhvilluara.

Është më se e nevojshme efikasiteti i shpenzimeve ushtarake dhe mbajtja e kapaciteteve të përcaktuara dhe termi “kosto” duhet të përfshihet në çdo planifikim. Sekretari i Shtetit për Mbrojtjen i SHBA-ve në “Strategic Defence Review Introduction” ka cituar se *“Shtytja e vazhdueshme për një efektivitet më të madh është një pjesë e integruar e planeve tona për të ulur koston që duhet të paguajmë për modernizimin e forcave tona.”*²³ Kjo është një thënie kyçe brenda rishikimit të mbrojtjes strategjike. “Efektivitet më i madh” nuk barazohet me “reduktim të koston”, por më tepër ajo ka kuptimin “të bësh më shumë, ta bësh atë më mirë, ta bësh për më lirë”, ku ulja e koston do të arrihet duke adoptuar praktikat më të mira dhe duke kombinuar “mendimin ushtarak” dhe “mendimin e ekonomisë së tregut”. Tom McGuffog, Drejtor Ekzekutiv i Organizimit Logjistik (J4) të Mbretërisë së Bashkuar ka thënë se *“Një Zinxhir Furnizimi efikas i cili ofron shpejtësinë, sigurinë dhe kosto të ulët në kapacitetet e ekonomisë së tregut brenda aftësive ushtarake ... duhet të zgjatë dhëmbët (kapacitetet ushtarake) dhe të shkurtojë bishtin (proceset burokratike).”*²⁴

5. Funksionet që mund të transferohen për t'u mbështetur nga të tretët dhe përfitimet.

FASH kanë filluar transferimin e funksioneve logjistike tek palët e treta në vitin 2006, me sigurimin e shërbimit të ushqimit për disa njësi të caktuara, i cili ka qenë një i mbuluar nga burimet e brendshme organike të FA. “Në njësitë dhe repartet ku nuk ekzistonte infrastruktura dhe kapacitetet njerëzore të afta për sigurimin e këtij shërbimi, ushqimi jepej në formën e kompensimit”²⁵

²³ Tom McGuffog, Clay Brendish, *An Electronic Business Strategy for Def. Acquisition*, DLO, UK, 2006, 11.

²⁴ Po aty, 36.

²⁵ Ligji nr. 9210, neni 21, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të FA të RSH”.

Në vitet e para të sigurimit të këtij shërbimi nga palët e treta, përfitimet ndaj cilësisë, kostos, shpejtësisë të sigurimit të shërbimit ishin pozitive, por humbja e kontrollit mbi procesin, planifikimi jo real dhe në disa raste realizimi i procedurave të “dobëta” të konkurrimit, solli që në disa njësi, cilësia të ishte larg kërkesave sipas kontratës, ndaj shërbimi mbi bazën e kalorive ditore, krijon hapësira për abuzim, pasi është e vështirë të transferosh kaloritë në sasi ushqimi dhe më pas në vlerë monetare.

Në vitin 2008, nga J-4 në SHPFA është analizuar mundësia e transferimit të palët e treta e shërbimit të transportit të përditshëm të personelit të FA, ku analiza është bërë mbi bazën e tarifave të transportit të personelit të FA me mjetet organike (nga burimet e brendshme, që janë krijuar nëpërmjet donacioneve të vendeve aleate), tarifave që përfitohen në kuadrin e modernizimit të FA dhe kompletimit me teknikë të re, tarifave që aplikohen në shërbimin urban dhe interurban në vendin tonë, si dhe normave të përcaktuara nga Ministria e Transportit dhe Ministria e Financës.²⁶ Nga analiza, rezulton se transferimi i këtij shërbimi të palët e treta është me përfitime për FA, ndërsa funksioni i transportit operacional duhet të mbahet si burim i brendshëm organik, i cili pavarësisht se mund të përcaktohet funksion jokryesorë, ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e operacioneve dhe në veçanti në operacionet e emergjencave civile dhe humanitare.

Riparimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe pajisjeve është përgjegjësi e njërive dhe reparteve të FASH, ndaj për sigurimin e këtij shërbimi të kushtueshëm, kërkohen burime të konsiderueshme financiare, personel teknik i aftë dhe infrastrukturë e përshtatshme, prandaj mbështetja nga palët e treta me këtë lloj shërbimi është një opsion i preferuar, kështu ky funksion duhet të analizohet i veçuar për sistemet dhe pajisjet tokësore, ajrore, detare, komunikimit dhe vëzhgimit, etj.

Burimet e brendshme për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve tokësore janë të zhvilluara në nivele të pranueshme, të cilat duhet të mbahen si burim organik për mjetet taktike-logjistike dhe të transferohet te të tretët shërbimet e mirëmbajtjes të mjeteve speciale dhe atyre që nuk ekziston kapaciteti i plotë teknik dhe profesional. Modernizimi i FA me teknikë moderne e bëjnë të domosdoshme analizimin e të gjithë faktorëve për përcaktimin e funksionit të mirëmbajtjes si shërbim që duhet të transferohet te të tretët apo duhet të krijohen burime të brendshme, ndaj investimi në infrastrukturë mirëmbajtje dhe personel të aftë për kryerjen e këtij shërbimi është shumë e kushtueshme.

²⁶ VKM nr. 66, datë 7.2.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr. 146, datë 26.2.1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar dhe Udhëzimin e përbashkët të MF nr. 99/3, datë 4.3.1998 dhe Ministrisë së Transportit nr. 878/1, datë 4.3.1998, “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”.

Stërvitja, përgatitja, testimi, kualifikimi dhe certifikimi i personelit specialist në strukturat e FASH në përgjithësi janë aktivitete që sigurohen nga burimet e brendshme organike, mirëpo disa specialitete që kërkojnë stërvitje, përgatitje, testim, kualifikim dhe certifikim të specializuar, që nuk mund të sigurohen nga FASH, aktet ligjore i përcaktojnë si atribut të disa institucioneve të veçanta.

Pra, sa më shumë të analizosh funksionet jo kryesore të FA, aq më shumë mundësi do të gjenden për transferimin e funksioneve te palët e treta, ndaj procesi i përcaktimit të funksioneve të transferueshme dhe organike është një proces shumë i rëndësishëm për reduktimin e shpenzimeve ushtarake dhe rritjen e përfitimeve në operacionalitetin dhe organizimin e FA.

Kështu, gjatë transferimit të shërbimit të ushqimit drejt palëve të treta, ndodhën disa ndryshime të rëndësishme që në themel shkurtuan shpenzimet e tepërta. Fillimisht pati shkurtim të personelit, shpenzimeve për krijimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe personelit të angazhuar me magazinimin dhe shpërndarjen. Pra, përfitimet ishin në uljen e numrit të personeli, reduktimin e shpenzimeve për asete, për kualifikim, eliminimin e shpenzimeve të magazinimit dhe shërbime të tjera sekondare.

Në drejtim të ruajtjes së nivelit operacional, përfitimi është në rritjen e shpejtësisë së furnizimit, cilësisë dhe orientimit të personelit drejt detyrave kryesore si (operacione, stërvitje etj.). Transferimi i funksioneve tek këto palë sjell efekte pozitive në drejtim të reduktimit të strukturave mbështetëse, por problem mbetet kontrolli i procesit, pasi mund të ndikojë në operacionalitetin e forcës, prandaj për të minimizuar këtë ndikim në FA të NATO-s është krijuar një strukturë menaxhuese e këtij procesi, e cila siguron kontrollin hap pas hapi.

Përfundime.

Një forcë e armatosur profesioniste dhe operacionale, për t'iu përgjigjur rreziqeve, kërcënimeve dhe sfidave, duhet të jetë në gjendje të ruajë aftësitë e kërkuara luftarake; për këtë duhet të ketë burime të mjaftueshme njerëzore, ekonomike, financiare, infrastrukturore dhe mbështetje të vazhdueshme, të cilat sigurohen nga burime organike dhe të jashtme.

Mbështetja nga palët e tretat është një mënyrë efektive e kujdesshme dhe me kosto të lirë për një kategori funksionesh jo kryesore. Nëpërmjet këtij modeli, FA mund të tërheqin ofruesit më të mirë civilë për të siguruar shërbime cilësore, që synojnë të reduktojnë shpenzimet e tepërta. Kjo lloj mbështetje është pranuar si një shtyllë e menaxhimit modern dhe praktikë ekonomiko-financiare, gjithashtu nëpërmjet kontrollit të procesit, komunikimit të hapur, transparencës ajo mund të ndihmojë forcën të rrisë efikasitetin e saj.

FARSH duhet të kërkojnë mënyra për të përmirësuar shërbimet dhe ulur

shpenzimet, objektiva të cilat duhet të plotësohen duke ofruar mbështetje të plotë dhe të vazhdueshme për forcën, si dhe evidentimi i funksioneve logjistike që mund të transferohen drejt të tretëve është një proces i vështirë dhe kërkon një analizë të hollësishme.

Forcat e Armatosura, pavarësisht aplikimit të mbështetjes nga të tretët për disa funksione, duhet të vlerësojë mundësitë për një mbështetje më të gjerë, sepse përvoja ka treguar se ushtritë e vogla si FA-të tona, kanë arritur të krijojnë më shumë kapacitete operacionale dhe mbështetëse cilësore për strukturat vartëse dhe personelin, kundrejt shpenzimeve më të vogla.

Transferimi i funksioneve mbështetëse tek të tretët duhet të jetë pjesë e një analize të detajuar që ka për bazë përfitimet e shërbimit/produktit, reduktimin e shpenzimeve, sigurimin e mbështetjes cilësore dhe afatgjatë, rritjen e shpejtësisë së përfitimit të mbështetjes dhe shumë lehtësive të tjera.

Strukturat planifikuese të FASH duhet të analizojnë në mënyrë të detajuar, duke iu referuar operacionalitetit, kostos, fizibilitetit dhe përfitimeve strukturore, për të përcaktuar funksionet që mund të transferohen drejt palëve të treta dhe atyre që duhet të mbahen brenda burimeve organike.

Literatura e shfrytëzuar.

1. Alan Rushton, John Oxley, Phil Croucher, Logistics and Distribution Management, The Institute of Logistics and Transportation, UK, Kogan Page, second edition, 2002.
2. Venu Gopal, Are the Armed Forces Game for 3PL, 2012.
3. Sheffi Yosef, "Third Party Logistics: Present and Future Prospects", Journal of Business Logistics, 1990.
4. Maltz, Arnold B., Robert C. Lieb. "The Third Party Logistics Industry: Evolution, Drivers and Prospects", 1995.
5. Pyles, Raymond A, I. K. Cohen, "Using Emerging Business Practices to Meet New Logistics Challenges", Rand Issue Paper JP-108, 1996.
6. Joe Fortner, Doctrine Division USACASCOM, Army Doctrine WORKING Group Conference, 2008.
7. G. L. Campbell, "Contractors on the Battlefield: The Ethics of Paying Civilians to Enter Harm's Way and Requiring Soldiers to Depend on Them", 2000.
8. Armin Krishnan, War as Business: Technological Change and Military Service Contracting, 2008.

9. Mark Cancian, *Contractors: The New Element of Military Force Structure*, 2008.
10. Trevor Taylor, “Contractors on Deployed Operations and Equipment Support”, *Defence Studies*, 2004.
11. Keith Hartley, *UK Defence Spending*, Lancaster and York: Defence Research Institute, 2001.
12. J. Woon Leanne, “New Zealand Defence-How Does It Stack Up”, 2004.
13. Tom McGuffog, Clay Brendish, “An Electronic Business Strategy for Defence Acquisition”, DLO, UK, 2006.
14. USA, FM 3-100.21, *Contractors on the Battlefield*, Washington D.C. Department of the Army, USA, 2003.
15. Logistic NATO HQ, *NATO Logistics handbook*, Brussels, 2007 ed.
16. UK MoD, “Operations in Iraq: Lessons for the Future”, London: Directorate General Corporate Communications, 2003.
17. Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
18. Ligji nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të FA të RSH”.
19. VKM nr. 66, datë 7.2.2007 “Për disa ndryshime në vendimin nr.146, datë 26.2.1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar.

Sfidat ligjore të BE për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe aksesin në drejtësi, harmonizimi dhe implementimi në legjislacionin shqiptar

Dr. Entela Abdul

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti “Luarasi”

Trajtesë e shkurtuar.

Aksesi në drejtësi është një nga parimet themelore të shtetit të së drejtës, parim ky mjaft i rëndësishëm i evidentuar në të drejtën evropiane dhe parashikimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Harmonizimi me direktivat e BE, sjell si nevojë emergjente dhe detyrim të shtetit shqiptar, krijimin e mundësive të barabarta të qytetarëve, për t’u dëgjuar dhe për t’iu drejtuar gjykatave në mënyrë efçente, transparente, jo diskriminuese dhe në mënyrë profesionale. Qëllimi dhe objektivat e këtij studimi konsistojnë në evidentimin dhe domosdoshmërinë e harmonizimit midis parashikimeve ligjore formale të ndihmës juridike falas, me ofrimin praktik dhe material të kësaj ndihme, si dhe aksesit në drejtësi pa kosto financiare, për kategori të caktuara qytetarësh referuar parashikimeve ligjore.

Në bazë të studimit të literaturës, parashikimeve ligjore vendase dhe direktivave evropiane, si dhe jurisprudencës gjyqësore, lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti, lind pyetja: Nëse kushtet e barabarta dhe mos diskriminuese si dhe aksesin në drejtësi, është një mundësi ligjore, që parashikohet për kategori të caktuara qytetarësh referuar gjendjes së tyre financiare dhe interesit të drejtësisë, apo është një detyrim i shtetit, për ta garantuar materialisht dhe jo vetëm formalisht këtë të drejtë?

Fjalë kyçe: Akses në drejtësi, këshillim ligjor falas, ndihmë juridike e garantuar nga shteti, parimi i barazisë së armëve, gjykim i drejtë, trajtim jodiskriminues.

Hyrje

Ndihma juridike konsiston në shërbimin juridik, këshillimin ligjor falas, përfaqësimin ligjor, si dhe në shërbime të tjera, që ofrohen nga shteti pa asnjë kosto, sipas kriterëve të përcaktuara ligjore, për kategori të caktuara subjektësh. Ndihma juridike e garantuar nga shteti ndahet në¹:

- Ndihmë juridike parësore e cila konsiston në këshillimin ligjor në lidhje me interpretimin e kuadrit ligjor të Shqipërisë, këshillimin në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, në dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme drejtuar administratës shtetërore, përfaqësimin përpara organeve administrative.

- Ndihmë juridike dytësore konsiston në përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën, ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislationit procedural penal.

- Këshillim është dhënia e informacionit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike.

Ndihma juridike parësore referuar marrëveshjeve të bëra me Ministrinë e Drejtësisë, ofrohet edhe nga Klinikat Ligjore Universitare, që janë ngritur dhe funksionojnë pranë fakulteteve të drejtësisë². Klinikat ligjore funksionojnë si një laborator i vogël për zhvillimin praktik të studentëve të fakultetit të drejtësisë nën udhëheqjen dhe monitorimin e pedagogëve të tyre. Nga ana tjetër, Klinika ofron shërbime publike pa kosto financiare për kategoritë në nevojë, duke dhënë këshillim ligjor në lidhje me aktet normative, të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe mënyrën e ushtrimit të këtyre të drejtave. Referuar mënyrës së funksionimit të klinikave ligjore vihet re, se ato japin një ndihmesë të madhe në trajtimin e rasteve të ndihmës juridike parësore, edhe pse nuk financohen nga buxheti shtetëror dhe nuk marrin asnjë stimul financiar nga shteti³.

Metodologjia dhe shqyrtimi i literaturës.

Për realizimin e këtij punimi është përdorur metodologji e kombinuar analiza cilësore e legjislationit dhe ndryshimeve ligjore për sa i përket ndihmës juridike dhe shërbimeve sociale, parë në këndvështrimin e dualizmit, krahasimit dhe

¹ Neni 3 i ligjit 111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”.

² Marrëveshja midis Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Universitetit “Luarasi” nr. 906 Prot., datë 12.11.2021, “Për ngritjen dhe funksionimin e Klinikës Ligjore “Luarasi”.

³ Referuar relacioneve të Klinikës Ligjore “Luarasi”, konkretisht Nr.175 Prot, datë 18.07.2022, Nr. 30 Prot, datë 08.03.2023, Nr. 64 Prot, datë 18.05.2023 nga kjo Klinikë janë trajtuar 20 raste të ndihmës juridike parësore.

harmonizimit me ligjin e Bashkimit Evropian dhe direktivave ndërkombëtare. Gjithashtu është analizuar edhe praktika universitare e klinikave ligjore si hallka të ofrimit të ndihmës juridike falas në vendin tonë, për shtresat në nevojë dhe kategori të ndryshme subjektsh të parashikuara nga ligji shqiptar. Është analizuar dhe shqyrtuar literatura, e cila përfshin studime, dhe materiale të ndryshme, si dhe praktika gjyqësore Evropiane, trajtuar në aspektin krahasimor dhe harmonizues me praktikën gjyqësore vendase.

Gjetjet e konstatuara nga shqyrtimi i literaturës, ligjit, ndryshimeve ligjore, manualeve të ndryshme si dhe praktika gjyqësore, mundësojnë një trajtim të detajuar të problematikës dhe objektivave të punimit, duke dalë me përfundime dhe rekomandime, për sa i përket zhvillimit dhe përmirësimit praktik dhe ligjor të ofrimit të ndihmës juridike falas.

1. Ndihma juridike e garantuar nga shteti në vendet e BE-së

Referuar të drejtës evropiane, e konkretisht parashikimeve të Kartës së të Drejtave Themelore të BE⁴ dhe KEDNJ-së, Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka arsyetuar dhe disponuar se, parimi i kushteve të barabarta është element integral i parimit të mbrojtjes efektive gjyqësore të të drejtave, që garanton ligji i BE-së për individët. Parimi i “barazisë së armëve” është një nga parimet themelore të ligjit të BE-së, për sa i përket garantimit dhe mbrojtjes të së drejtave të individit, i cili konsiston në nocionin procedural të mbajtjes së një “ekuilibri të drejtë” ndërmjet palëve. Secilës palë duhet t’i ofrohet një mundësi, brenda një afati të arsyeshëm, për të parashtruar rastin e saj si dhe provat dhe fakte, duke mos u vendosur në dizavantazh krahasuar me palën tjetër. Jurisprudenca evropiane e lidh këtë parim edhe me parimin e kontradiktoritetit dhe balancën e të drejtave dhe privilegjeve procedurale, duke synuar, që të ketë një ekuilibër të drejtë midis mundësive, që u ofrohen palëve gjatë procesit gjyqësor (p.sh. secila palë duhet të jetë në gjendje të thërrasë dëshmitarë dhe të marrë në pyetje dëshmitarët e thirrur nga pala tjetër).

Ndihma juridike falas në BE, ashtu sikundër është parashikuar dhe në legjisllacionin shqiptar, është e garantuar në proceset civile, administrative dhe penale. Referuar Kushtetutës Evropiane dhe legjisllacionit evropian, palëve në proces iu garantohet gjykimi nga një gjyqtar i paanshëm. Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga ligji i Bashkimit Evropian, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv para gjyqtarit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë nen. Secili ka të drejtë, që çështja e tij të dëgjohet në mënyrë të drejtë, publike dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjyqtar i pavarur dhe i paanshëm, i përcaktuar me ligj. Çdo person ka të drejtë për t’u

⁴ Neni 47, 48 e në vijim i Kartës të të Drejtave Themelore të BE.

këshilluar, mbrojtur dhe përfaqësuar.⁵ Ata që nuk kanë mjete të mjaftueshme, u jepet ndihma juridike, nëse është e nevojshme për t'ju siguruar akses efektiv në drejtësi. Aksesit në ndihmën juridike të garantuar nga shteti, në vendet Evropiane përbën një element thelbësor për një gjykim të drejtë.⁶ E drejta për ndihmë juridike të shtetit, garanton akses efektiv në drejtësi për ata, që nuk kanë burime të mjaftueshme financiare, për të mbuluar shpenzimet, si shpenzimet gjyqësore ose shpenzimet e përfaqësimit ligjor.⁷

E drejta për të marrë pjesë aktive në gjykim (që lind nga e drejta për një gjykim të drejtë dhe publik), duhet të jetë efektive për të gjithë personat, pavarësisht nga burimet e tyre financiare. Kjo kërkon që shtetet të marrin masa për të siguruar akses të barabartë në procedura, (p.sh., nëpërmjet krijimit të sistemeve adekuate të ndihmës juridike). Ndihma juridike gjithashtu mund të lehtësojë administrimin e drejtësisë, pasi palët e përfshira shpesh nuk përfaqësohen. Palët nuk janë në dijeni të rregullave procedurale dhe kanë nevojë për ndihmë të konsiderueshme në gjykatat, gjë që mund të shkaktojë vonesa.

- Aksesit të ndihmës juridike falas për proceset civile, personat juridikë dhe personat e huaj.

Ndryshe nga legjislacioni shqiptar, i cili nuk e parashikon ndihmën juridike falas për personat juridikë, nga shqyrtimi i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, arrihet në përfundimin se dhënia e ndihmës juridike për personat juridikë, nuk përjashtohet në parim, por duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke iu referuar rregullave të zbatueshme dhe situatës financiare të personit juridik. Parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore, siç përcaktohet nga neni 47 i Kartës, duhet të interpretohet në kuptimin që, personat juridikë mund të përjashtohen nga pagesa e një paradhënie, shpenzime gjyqësore ose për asistencë ligjore.

Për sa më sipër, në lidhje me personat juridikë, gjyqtari vendas, mund të marrë parasysh formën dhe qëllimin e krijimit (të fitimit ose jo), aftësinë financiare të anëtarëve të tij ose aksionerëve dhe mundësinë, që këta të fundit të ndërmarrin

⁵ Jurisprudence e GJEDNJ, nr. 6289/73, 1979 Airey kundër Irlandës, kërkesja donte të divorcohej nga bashkëshorti i saj, por nuk e kishte të mundur ti drejtohej gjykatës sepse pa ndihmë juridike, ajo nuk mund të përballonte shpenzimet e një avokati. GJEDNJ-ja konfirmoi se, edhe pse neni 6(1) i GJEDNJ nuk parashikon shprehimisht ndihmën juridike në procedurë civile, shtetet mund të detyrohen ta japin atë, nëse ndihma është thelbësore për të garantuar akses efektiv në drejtësi. Kjo gjë nuk zbatohet për të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e natyrës civile, pasi varet nga rrethanat specifike të secilit rast. Në rastin në fjalë elementet përkatës në favor të dhënies së ndihmës juridike, ishin kompleksiteti i procedurës si dhe fakti i një mosmarrëveshjeje martesore, që implikonte përfshirje emocionale. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ.

⁶ Neni 6 i KEDNJ.

⁷ Neni 47 i Kartës të së Drejtave Themelore të BE.

veprime për t'iu drejtuar gjykatës.⁸

Referuar legjislacionit evropian, shtetasve të çdo vendi anëtar në BE, iu garantohet ndihma juridike dhe akses i drejtësi edhe për problematika të konstatuara jashtë shtetit të tyre. Çdo person, që ka vendbanimin e tij të zakonshëm në territorin e njëres prej palëve kontraktuese dhe që dëshiron të kërkojë ndihmë juridike civile, tregtare ose administrative në territorin e një pale tjetër kontraktuese, mund të paraqesë kërkesën e tij në shtetin e banimit të zakonshëm. Ky shtet duhet t'ia përcjellë kërkesën shtetit tjetër, të cilit i kërkohet ndihma juridike.⁹ Shteti, të cilit i është transmetuar kërkesa duhet t'ia ofrojë kërkuarit ndihmën e tij. Autoriteti në fjalë do të duhet të ndihmojë gjithashtu kërkuarin në lidhje me përkthimet e nevojshme të dokumenteve.

Shteti pranues duhet t'ia përcjellë kërkesën autoritetit kompetent për trajtim. Ai gjithashtu duhet të mbajë të informuar shtetin dërgues, për të gjitha vështirësitë, që lidhen me shqyrtimin e kërkesës dhe më pas duhet t'ia komunikojë vendimin e marrë nga autoriteti kompetent. Në proceset civile kanë të drejtë të përfitojnë nga ndihma juridike falas personat si më poshtë:

- Shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.
- Të huajt që banojnë ligjërisht në territorin e BE-së në kohën e ndodhjes së faktit, që është objekt i gjykimit.
- Shtetas jo anëtar i BE-së, që synon të kundërshtojë urdhrin e dëbimit ose vendimet në lidhje me kërkesën për azil, mbrojtjen ose revokimin e statusit të refugjatit.
- Personat pa shtetësi.
- Shoqatat që ndjekin qëllime jofitimprurëse dhe nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike.

⁸ Rasti: DEB Deutsche Energiehandels-und Beratungsgesellschaft mbh v. Bundesrepublik Deutschland 186 DEB, Furnizuesi i energjisë apeloj kundër shtetit gjerman për zbatimin e vonuar të dy direktivave, si rezultat i të cilave ai pretendoi se ka pësuar humbje financiare. Ishte shprehur se, për shkak të një humbjeje të tillë, nuk kishte burimet e nevojshme për të paguar shpenzimet, procedurat dhe as avokatin. Ankuesi kërkoi të siguronte përfaqësim ligjor, por ndihma juridike për personat juridikë, jepej vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Gjykata gjermane e referoi çështjen në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë. GJED-ja mori parasysh jurisprudencën e GJEDNJ-se. Ajo vuri në dukje se dhënia e ndihmës juridike për personat juridikë nuk përjashtohet në parim, por që duhet të vlerësohet, duke iu referuar rregullave në fuqi dhe situatës së shoqërisë. Shpenzimet gjyqësore mund të përbëjnë një pengesë të pakapërcyeshme për aksesin në drejtësi. Në lidhje me personat juridikë, gjykatat mund të marrin në konsideratë: (i) formën e personit juridik në fjalë dhe nëse është apo jo për fitim; (ii) kapacitetin financiar të anëtarëve ose aksionarëve; dhe (iii) aftësinë e këtij të fundit për të marrë shumat e nevojshme për të ndërmarrë veprime ligjore.

⁹ Marrëveshja evropiane mbi transmetimin e kërkesave për ndihmë juridike, STCE nr. 92, 1977.

Personi, të cilit i pranohet kërkesa për ndihmë juridike, mund të caktojë një avokat të zgjedhur nga lista e avokatëve për ndihmë juridike. Mbrojtësi i emëruar mund të ketë një zëvendësues edhe nëse nuk është i regjistruar në listën e avokatëve të autorizuar, për të ofruar ndihmë juridike falas.

Dokumentacioni i nevojshëm për të përfituar ndihmë juridike falas në BE është si më poshtë:

- Vërtetim për gjendjen familjare dhe vendbanimin (të marra nga zyra e gjendjes civile të komunës së vendbanimit).
- Kopje të kartës së kodit tatimor (ose kartës shëndetësore nëse është përfshirë kodi tatimor).
- Kopje të dokumentit të identitetit (kartë identiteti, leje drejtimi).
- Kopje të deklaratës së fundit tatimore.
- Dokumente dhe prova për të mbështetur kërkesën.

Në mungesë të deklaratës tatimore, për shkak të mungesës së të ardhurave të një viti më parë, aplikanti duhet të paraqesë një vetë deklaram, që vërteton të ardhurat (ose mungesën e të ardhurave) në lidhje me vitin paraardhës.

Shtetasit e BE-së mund të vetë certifikojnë ekzistencën e kërkesave ligjore, ndërsa shtetasit e shteteve, që nuk i përkasin Bashkimit Evropian, duhet të bashkëngjisin një vërtetim nga konsullata e vendit të origjinës, që konfirmon vërtetësinë e të ardhurave të deklaruara, me përjashtim të përdorimit të vetëdeklarimit, nëse provon pamundësinë e paraqitjes së dokumentacionit. Shtetasit e shteteve, që nuk i përkasin Bashkimit Evropian, ndaj masave që kufizojnë lirinë personale, mund të dorëzojnë certifikatën konsullore brenda 20 ditëve, edhe nëpërmjet avokatit të tyre ose një anëtari të familjes.

Në rastin e azilkërkuësve dhe personave pa shtetësi, ekziston një praktikë e mirë në BE sipas së cilës mjafton të prodhohet një kopje e emailit, në të cilin kërkohet nga konsullatat të provojnë vërtetësinë e kushteve ekonomike.

- Ndihma juridike falas për proceset penale.

Dhënia e ndihmës juridike i nënshtrohet vlerësimit të burimet financiare dhe interesave të drejtësisë.¹⁰ Subjektet duhet të provojnë se nuk kanë burime të mjaftueshme financiare edhe pse nuk ekziston një përkufizim i “burimeve të mjaftueshme”.¹¹ Vlerësimi i “interesave të drejtësisë”¹² përfshin, shqyrtimin

¹⁰ KEDNJ neni 6, paragrafi 3, germa c dhe neni 48, paragrafi 2, i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së.

¹¹ Jurisprudencë për vlerësimin financiar/burimet e mjaftueshme. GJEDNJ-ja, Tsonyo Tsonev c. Bullgarisë (n.2), n.2376/03, 2010. GJEDNJ-ja, Twalib c. Greqisë, n.24294/94, 1998.

¹² Jurisprudencë për vlerësimin e “interesit të drejtësisë”. GJEDNJ-ja, Zdravko Stanev c. Bullgarisë, n.32238/04, 2012.

dhe analizën e rëndësisë së veprës si dhe ashpërsisë së dënimit të parashikuar, kompleksitetit të çështjes dhe gjendjes personale të të akuzuarit. Kur liria është në rrezik, interesat e drejtësisë kërkojnë patjetër përfaqësimin ligjor.

2. Sfidat ligjore dhe rëndësia e ndihmës juridike dhe aksesit në drejtësi në BE

Legjislacioni evropian dhe direktivat evropiane synojnë fuqizimin dhe garancitë mbrojtëse të të pandehurve dhe të dyshuarve në procedimet penale, me qëllim që t'u sigurohet një standard minimal dhe i unifikuar mbrojtjeje në territorin e shteteve anëtare.¹³ Këto parashikime u zhvilluan dhe u përfshinë në Rezolutën e Këshillit të Bashkimit Evropian të 30 nëntorit 2009 dhe më vonë në Programin e Stokholmit “*Një Evropë e hapur dhe e sigurt në shërbim dhe mbrojtje të qytetarëve*”. Kjo nismë parashikonte hartimin e një sërë masash dhe rregullash, që do të zbatoheshin gradualisht në mënyrë të unifikuar nga shtetet anëtare.

Vlen për t'u theksuar se, ky akt rregullues ka parashikuar në mënyrë të hollësishme të drejtën dhe procedurën për konsulencë e për ndihmë juridike falas, si për të akuzuarin edhe për të dyshuarin në një procedim penal.

Direktiva 2016/1919/BE, përshtatet në kontekstin e udhërrëfyesit për forcimin e të drejtave minimale procedurale të të dyshuarve apo të akuzuarve të procesin penal, të miratuar në bazë të rezolutës së Këshillit të Bashkimit Evropian të 30 nëntorit 2009. Programi Evropian nuk mund të shpërfillte një të drejtë themelore, siç është ajo, që synon garancinë e mbrojtjes ndaj të dyshuarit ose të akuzuarit, i cili nuk ka burimet e nevojshme financiare ose është shtresë në nevojë. Rregullat e parashikuara në këtë direktivë në lidhje me ndihmën juridike, duhet të veprojnë në sinkroni me ato të përfshira në Direktivën 2013/48/EU¹² “mbi të drejtën e aksesit në drejtësi”.

Si në fillim të procesit penal dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij, personit i jepet mundësia të përfaqësohet nga një avokat. Kjo pasi avokati falë aftësive dhe njohurive profesionale, është i vetmi, që mund të sigurojë për personat në pamundësi financiare një mbrojtje efektive dhe cilësore, duke shmangur vendosjen e palës në një situatë inferiore, në lidhje me palën tjetër në proces, çka mund të ndikojë në drejtësinë e këtij procesi.

Pra, Direktiva 2016/1919/BE, siguron garancitë procedurale për një gjykim të drejtë evropian dhe rëndësinë e tij, për sa i përket aspekteve, që kanë të bëjnë me ndihmën juridike, duke integruar dhe garantuar efektivitetin e të drejtave të parashikuara në Direktivën 2013/48/BE, specifikisht të drejtën e aksesit të një avokati në procesin penal ashtu dhe atë civil.

¹³ Direktiva 2016/1919/BE “Për ndihmën juridike për të dyshuarit e të akuzuarit në procesin penal dhe për personat e kërkuar në kuadër të procedimeve për ekzekutimin e fletë-arrestit evropian”.

Referuar parashikimeve të legjislacionit Evropian, ndihma juridike falas, konsiston në financimin nga çdo shtet anëtar i BE, i tarifave të përfaqësimit të avokatit, duke mundësuar ushtrimin e një të drejte themelore, siç është e drejta e mbrojtës me avokat.

Ky parashikim ka si qëllim rritjen e rolit të rëndësishëm, që ka mbrojtësi i thirrur për të ofruar ndihmë juridike “falas” në funksion të parimit të barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjit, pasi cilado qoftë gjendja e tyre financiare, ata duhet të kenë mundësi të veprojnë dhe të mbrojnë të drejtat e tyre para gjykatave.

Kërkesat evropiane konsistojnë në faktin se, forcimi i ndihmës juridike mund të konkretizohet në një akses më të madh në drejtësi, i cili është i disponueshëm për të gjithë, edhe për shtresat në nevojë. Bashkësia e akteve evropiane dhe harmonizimi i tyre, ka si qëllim bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare në shkallë evropiane, duke rritur efektivitetin e instrumenteve të përbashkëta, për sa i përket ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

3. Adresimi i sfidave sociale të legjislacionit të BE-së dhe harmonizimi e aplikimi i tij në Shqipëri

E drejta e BE-së në legjislacionin shqiptar përbën një burim të rëndësishëm të së drejtës, përsa i përket integritit dhe harmonizimit të parashikimeve ligjore për ndihmën juridike falas. Konkretisht, referuar edhe parashikimeve të Nenit 47 të Kartës të së Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, qëllimi i legjislacionit vendas, qëndron në faktin se personat, të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme, iu jepet ndihmë juridike, në masën që kjo ndihmë është e nevojshme, për të garantuar në mënyrë të efektshme aksesin në gjykatë.

Vlen të theksohet gjithashtu se, referuar të drejtës evropiane, në legjislacionin shqiptar për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, janë implementuar dhe harmonizuar parimet kryesore të së drejtës evropiane, si:¹⁴

- Akses i barabartë.
- Mosdiskriminimi.
- Profesionalizmi dhe barazia.
- Efikasiteti dhe efektiviteti i kostos.
- Konfidencialiteti.
- Mbrojtja e personave që nuk gëzojnë mbrojtje.
- Shmangia e konfliktit të interesit.

Referuar Nenit 6 të KEDNJ-së, si burim i së drejtës, çdo i akuzuar për një vepër penale, ka të drejtë të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i

¹⁴ Manual ligji i ri për ndihmën juridike, Janar 2021.

zgjedhur prej tij, dhe nëse nuk ka mjetet e mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, ti mundësohet ndihma ligjore falas, kur këtë e kërkon “interesi i drejtësisë”. Pra, neni 6 i KEDNJ-së ka sanksionuar ndihmën juridike në të drejtën penale, por jo në atë civile. Në legjislacionin tonë referuar edhe të Drejtës Evropiane, e drejta e aksesit të një avokat në procedimet penale, zbatohet gjatë gjithë procedimit nga marrja në pyetje nga policia deri te gjykimi.

Gjithashtu parashikimi i ndihmës juridike falas në funksion të përcaktimit të “Interesit të drejtësisë”, konsiston në shqyrtimin e rëndësisë së veprës penale, kompleksiteti i çështjes dhe situatë shoqërore e personale e të pandehurit. Gjithsesi edhe në procedurat civile, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në rrethana të caktuara, duhet të sigurohet ndihma juridike falas. Ndhma juridike në çështjet civile është e domosdoshme për të pasur një qasje efektive në drejtësi, konkretisht kur procedura ose çështja është e ndërlikuar, ose përfaqësimi ligjor është i detyrueshëm.¹⁵

Konventa e Gjenevës e 1951 neni 16 i saj, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm si burim i së drejtës, përse i përket parashikimeve në legjislacionin shqiptar për ndihmën juridike falas të shtetasve të huaj/refugjatë. Konkretisht, në legjislacionin vendas është parashikuar se disa nga kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas janë:¹⁶

- Qytetarët e huaj, të cilët hyjnë ilegalisht në Shqipëri dhe përfitojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ose bazuar në parimin e reciprocitetit,
- Disa refugjatë ose azilkërkues.

Përfundime dhe rekomandime

1. Parimi i “barazisë së armëve” është një nga parimet themelore të ligjit të BE dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së e Gjykatës Evropiane e Drejtësisë, i cili konsiston në vendosjen e një “ekuilibri të drejtë” ndërmjet palëve. Secilës palë duhet t’i ofrohet një mundësi, brenda një afati të arsyeshëm, për tu mbrojtur nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, duke parashtruar provat dhe fakte, si dhe duke mos u vendosur në disavantazh krahasuar me palën tjetër. Jurisprudenca Evropiane e zhvillon këtë parim, duke e lidhur me parimin e kontradiktoritetit dhe balancën e të drejtave dhe privilegjeve procedurale, kur cenohet interesi në drejtësi, për kategori që janë në pamundësi financiare, për të garantuar mbrojtje profesionale vetë.
2. Ndhma juridike falas në BE, ashtu sikundër është parashikuar dhe harmonizuar dhe në legjislacionin shqiptar, është e garantuar në proceset

¹⁵ Jurisprudencë e GJEDNJ-së, Airey k. Irlandës, 1979.

¹⁶ Manual “Ligji i ri për ndihmën juridike”, janar 2021.

civile, administrative dhe penale. Çdo personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga ligji i Bashkimit Evropian, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv para gjyqtarit, dhe duhet ti garantohet kjo e drejtë nga legjislacioni shqiptar.

3. Referuar këtij studimi, si dhe analizës së jurisprudencës së GJEDNJ dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, rekomandojmë që, në legjislacionin shqiptar dhe praktikën institucionale, duhet të përfshihet dhe të garantohet ndihma juridike falas edhe për personat juridikë, në raste përjashtimore referuar kushteve të veçanta. Referuar Kushtetutës Evropiane dhe legjislacionit Evropian, palëve në proces qofshin ata fizikë apo juridikë duhet t’ju garantohet nga buxheti i shtetit shqiptar, gjykimi efektiv nga një gjyqtar i paanshëm si dhe ndihma juridike falas.
4. Duke qenë se referuar këtij studimi, roli i klinikave ligjore universitare është mjaft i rëndësishëm për ofrimin e ndihmës juridike parësore, rekomandojmë se shteti shqiptar duhet të investoj në zhvillimin dhe ngritjen e klinikave të ligjit, si ofruer efektiv të ndihmës juridike falas dhe shërbimeve publike, krahas mësimdhënies dhe mësimnxënies. Si laboratorë të vërtetë të ofrimit dhe garantimit të ndihmës juridike falas dhe si zyra të mirëfillta avokatie dhe praktike për juristët dhe avokatët e ardhshëm, gjykojmë se, një pjesë e buxhetit shtetëror, duhet të llogaritet në funksion të klinikave të ligjit.

Literatura e shfrytëzuar.

1. Ligji nr. 111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”.
2. Manual “Ligji i ri për ndihmën juridike”, janar 2021.
3. “Manual si të përfitojmë ndihmë juridike falas”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, 2020.
4. Ligji “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe “Për tarifat gjyqësore”, Tiranë: 2020.
5. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
6. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
7. Marrëveshja midis Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Universitetit Luarasi nr. 906 Prot. datë 12.11.2021, “Për ngritjen dhe funksionimin e Klinikës Ligjore “Luarasi”.
8. Direktiva 2016/1919/BE “Për ndihmën juridike për të dyshuarit dhe të akuzuarit në procesin penal dhe për personat e kërkuar në kuadër të procedimeve për ekzekutimin e fletë arrestit Evropian”, tetor 2016.

9. Direktiva 2013/48/EU12 “Mbi të drejtën e aksesit në drejtësi”, qershor 2013.
10. Konventa e Gjenevës, “Marrëveshja për të drejtat e refugjatëve”, korrik 1951.
11. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, dhjetor 2009.
12. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nëntor 1950.
13. Agenzia dell’Unione europea per i diritti fondamentali e Consiglio d’Europa, “Manuale di diritto europeo in materia di accesso alla giustizia”, 2016.
14. Open Society, “Norme europee e internazionali sul diritto al gratuito patrocinio”, 2014.
15. Selanec.G, “Il diritto al patrocinio nell’ordinamento giuridico dell’UE”, 2020.
16. Peloso. C “L’approvazione Della Direttiva 2016/1919 Sul Patrocinio a Spese Dello Stato: La Battuta Finale Nel Cammino Verso La Mappatura Dei Diritti Procedurali Fondamentali”, 2017.
17. Canestrini. N “Patrocinio a spese dello stato (ex gratuito patrocinio), 2018.
18. Corte Costituzionale, “Lo straniero può accedere al gratuito patrocinio anche senza certificazione consolare”, 2021
19. Jurisprudencë e GJEDNJ-së, Airey k. Irlandës 1979.
20. Jurisprudencë e GJEDNJ-së, Tsonyo Tsonev c. Bullgarisë (n.2), n.2376/03, 2010.
21. Jurisprudencë e GJEDNJ-së, Twalib c. Greqisë, n.24294/94, 1998.
22. Jurisprudencë e GJEDNJ, Zdravko Stanev c. Bullgarisë, n.32238/04, 2012.
23. Jurisprudencë e GJEDNJ, DEB Deutsche Energiehandels-und Beratungsgesellschaft mbh v. Bundesrepublik Deutschland 186 DEB, 2010.

RUBRIKA E TRETË

MBROJTJA KIBERNETIKE DHE ZHVILLIMET INOVATIVE

Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike: mjet politikash për të forcuar mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë kibernetike të IKI

Nënkolonel Msc. Dashnor Beta
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Në dekadat e fundit, inovacioni, ndryshimet në teknologji dhe përdorimi gjerësisht i internetit kanë sjellë ndryshime rrënjësore dhe sfida në çdo shoqëri në mbarë botën. Përditshmëria, të drejtat e njeriut, ekonomia, ndërveprimet shoqërore, ndikohen thellësisht nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Hapësira e përbashkët dhe e lirë kibernetike promovon përfshirjen sociale dhe politike, kapërcen barrierat e komunikimit mes vendeve, komuniteteve e qytetarëve, siguron transparencë, lejon ndërveprim, shkëmbim informacioni dhe idesh në kohë reale në të gjithë globin. Zhvillimet dhe përdorimi në rritje i TIK sjellin përfitime të mëdha, por nga ana tjetër sjellin edhe kërcënime, prandaj mbrojtja kibernetike dhe siguria janë vendimtare. Në hapësirën kibernetike ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme nga individë dhe grupe të ndryshme me interesa keqdashëse, të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e shteteve.

Një problem në rritje dhe shumë shqetësues për gjithë shoqërinë sot po bëhet ndërhyrja në privatësi dhe vjedhjet e identitetit. Nga njëra anë, qeveritë po investojnë gjithnjë e më shumë në infrastrukturën digjitale që t'u ofrojnë shërbime qytetarëve, nga ana tjetër qytetarët po e përdorin internetin gjithnjë e më shumë për arsye të avantazheve që ai ofron. Një nga sfidat aktuale dhe të vazhdueshme për të gjitha vendet është ndërtimi i një shoqërie të

zhvilluar digjitale, të mbrojtur kibernetikisht, të pajisur me njohuri dhe aftësi të nevojshme, për të maksimizuar përfitimet dhe për të minimizuar e menaxhuar rreziqet. Qasja gjithëpërfshirëse kombëtare e sigurisë kibernetike nuk mund të bëhet duke përdorur vetëm teknologjitë dhe shërbimet, por duhet të shoqërohet me një kornizë ligjore të kompletuar dhe aktuale, me fokus në natyrën dinamike të mjedisit të TIK dhe në natyrën në evoluim të kërcënimeve kibernetike.

Një hap i rëndësishëm në zhvillimin e legjislacionit dhe të masave kundër krimit kibernetik vlerësohet strategjia kombëtare për krimin kibernetik. Strukturat kombëtare e ndërkombëtare hartojnë dhe realizojnë fushata ndërgjegjësimi për grupe të ndryshme interesi, me qëllim mbrojtjen nga krimi kibernetik dhe sulme të tjera të sigurisë në internet. Një kuadër ligjor dhe rregullator që mbron format e ndryshme të abuzimit dhe krimit elektronik është thelbësor për krijimin e një ambienti të besueshëm për komunikimet dhe transaksionet elektronike.

Fjalë kyçe: Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike, Infrastrukturë Kritike, Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike, Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike e Informacionit, rrezik kibernetik, hapësirë kibernetike, etj.

Hyrje

Shqipëria, si dhe vende e tjera, në shumë raste është viktimë e veprimtarisë Skeqdashëse kibernetike, e cila kryhet nga aktorë kriminalë, përfshirë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë, që mund të përdorin infrastrukturën e rrjetit në Shqipëri dhe jashtë saj. Vendi ynë, si një vend në zhvillim, mbështetet gjithashtu në TIK, duke synuar rritjen e nivelit të jetesës dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Krahas përfitimeve nga përdorimi i teknologjive të reja digjitale, përdorimi i internetit sjell problematikat e veta në lidhje me sigurinë kibernetike. Kërcënimet kibernetike, duke përfituar nga dobësitë teknologjike ose mungesa e njohurive në përdorimin e mirë të këtyre mjeteve, janë gjithnjë e më shumë në rritje, duke cenuar sigurinë e sistemeve të informacionit.

Aktualisht vërehen mungesa të mjeteve të nevojshme për marrjen dhe krijimin e inteligjencës kibernetike, për përdorimin e burimeve njerëzore e logjistike të duhura për të ushtruar veprimtarinë ligjzbatuese. Rritja e kapaciteteve për t'u përballur me sfidat kibernetike është thelbësore dhe si pasojë kjo kërkon ndryshime strukturore, qasje, kapacitete teknike, logjistike etj.

Përmirësimi i internetit, në vendin tonë ka bërë të mundur që krimi kibernetik të shfaqet në forma të ndryshme, ku nga më të zakonshmet janë mashtrimet që lidhen me internet *banking*, si *phishing* dhe *spam*. Edhe kur veprimtari kriminale kibernetike kundër vendit tonë identifikohen, shpeshherë është e vështirë për agjencitë tona ligjzbatuese apo organizatat ndërkombëtare, që t'i ndjekin ata individë që i kryejnë ato. Shqipëria ka ndërmarrë hapa të

rëndësishëm, në përmirësimin e situatës së sigurisë kibernetike. Krahas zhvillimeve në fushën e TIK dhe revolucionit mbi digjitalizimin e shërbimeve publike, është plotësuar dhe përmirësuar kuadri ligjor për sigurinë kibernetike, por vendi ynë ende nuk ka arritur në shkallën dhe ritmin e ndryshimit të nevojshëm për të qëndruar, përpara lëvizjes dhe evolucionit të shpejtë, që vjen nga kërcënimet e ndryshme kibernetike.¹ Pa dyshim, sulmet kibernetike janë ndër kërcënimet më të rëndësishme të sigurisë për botën moderne dhe për këtë arsye siguria kibernetike është bërë pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare.

1. Rishikimi i SKSK - domosdoshmëri, për rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në vend

Në koherencë të plotë me vendet e zhvilluara, për një mjedis kibernetik sa më të sigurt, strategjia duhet të mbështetet në parimet themelore të mëposhtme: zbatimi i vlerave të njëjta themelore në botën fizike e digjitale; mbrojtja e të drejtave themelore, lirisë së shprehjes, të dhënave personale dhe privatësia; qasja për të gjithë; qeverisje demokratike dhe efikase; përgjegjësi e përbashkët në garantimin e sigurisë kibernetike. Vende të ndryshme mund të kenë arsye të ndryshme për të forcuar aftësitë e tyre kombëtare të sigurisë kibernetike të tilla si:

- a. iniciativa nga organizmat rajonalë (p.sh., B. Afrikan-BA, Organizata e Shteteve Amerikane-OAS),
- b. iniciativa nga rrjetet e ofruesve të IKI (p.sh., Organizata e T/komunikacionit e Commonwealthit),
- c. iniciativa nga organizatat ndërkombëtare (p.sh., Banka Botërore-BB, Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit-ITU, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut-NATO dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik-OECD, të cilat mund të rekomandojnë apo t'u bëjnë presion vendeve që t'i kushtohet më shumë vëmendje çështjeve kombëtare të sigurisë kibernetike, përfshi Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike të Informacionit (MIKI) si:
 - një masë reaktive nga sulmet sistematike kibernetike ndaj shërbimeve kritike kombëtare;
 - masë parandaluese që rezulton nga një vlerësim kombëtar i rrezikut kibernetik;
 - thirrje nga sektorë të ndryshëm ekonomikë për të forcuar kapacitetet kombëtare të sigurisë dhe qëndrueshmërinë kibernetike.

Në këtë kontekst, vendet fillojnë diskutimet në nivel kombëtar (*qasja me shumë*

¹ Strategjia e Sigurisë Kombëtare, 2014-2020.

palë), me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë (p.sh., ITU, BB, BA, OAS), për të identifikuar boshllëqet, rreziqet kibernetike kombëtare dhe sektoriale, nevojat e brendshme si dhe prioritetet në fushën e sigurisë kibernetike. Të dhënat e grumbulluara nga procesi i konsultimit publik dhe vlerësimet e ndryshme ushqejnë dhe formësojnë përmbajtjen e SKSK. Kjo strategji në thelb është udhërrëfyese që përcakton një sërë objektivash strategjike kombëtare që duhen zbatuar (dhe vlerësuar rregullisht) në një kornizë kohore specifike (fig. 1).




Fig. nr. 1. Cikli i jetës së një Strategjie Kombëtare të Sigurisë Kibernetike²

E para SKSK, trajton aktivitete të shumta të MIKI, përfshi identifikimin e IK-ve dhe IKI-ve kombëtare, zhvillimin e politikës dhe kornizës ligjore të MIKI, si dhe aktivitete të tjera strategjike si: krijimi i strukturës qeverisëse dhe programit të koordinimit të sigurisë kibernetike (me role, përgjegjësi të qarta, buxhet, burime, plan veprimi), krijimi i Ekipit Kombëtar të Reagimit ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike (CSIRT), miratimi i planit të veprimit për sigurinë kibernetike dhe aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit, miratimi i kornizave legjislativ (p.sh., krimi kibernetik dhe/apo legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave), miratimi i mekanizmave të bashkëpunimit të brendshëm e ndërkombëtar (fig.2). Një udhëzues për zhvillimin e një SKSK-je sugjeron praktikata e mira dhe aktivitetet e lidhura me MIKI që kjo strategji duhet të trajtojë për të siguruar mbrojtjen e shërbimeve të IK-ve dhe të shërbimeve thelbësore si:

- miratimi i një qasjeje të menaxhimit të rrezikut kibernetik (kombëtar dhe sektorial),
- përcaktimi i një modeli qeverisjeje me role e përgjegjësi të ndara dhe të qarta, buxhete, burime,
- përcaktimi minimal legjislativ, bazat rregullatore dhe kërkesat teknike,

² Burimi elektronik: <https://ncsguide.org/the-guide/lifecycle/>

- miratimi i një game të gjerë stimujsh për të siguruar që operatorët e IK/IKI të përmbushin kërkesat minimale teknike dhe ligjore,
- vendosja e partneriteteve të qëndrueshme dhe formale publike-privatë dhe marrëveshje të tjera bashkëpunimi joformal.

Qeverisja	Menexhimi i Risikut në Sigurinë Kibernetike Kombëtare	Përgatitja dhe Qëndrueshmëria	Shërbimi i Infrastrukturaës Kritike dhe Shërbimet Thelbësore	Ndërtimi i Aftësive dhe Kapaciteteve dhe Ngritja e Ndërgjegjësimit	Rregullat dhe Logjistika	Bashkëpunimi Ndërkombëtar
<p>Siguro nivelin më të lartë të mbështetjes</p> <p>Ndërto/ngri autoritetet kompetente të Sigurisë kibernetike</p> <p>Siguro bashkëpunimin brenda qeverisë</p> <p>Siguro bashkëpunimin e brendshëm sektorial</p> <p>Aloko burime dhe buxhet të dedikuar</p> <p>Zhvillo planin e zbatimit/ implementimit</p>	<p>Përcakto qasjen ndaj menaxhimit të riskut</p> <p>Identifiko metodologjinë për menaxhimin e riskut kibernetik</p> <p>Zhvillo profilin sektorial të rrezikut të sigurisë kibernetike</p> <p>Ndërto politika të sigurisë kibernetike</p>	<p>Ndërto kapacitetet për përgjigje të incidenteve cyber</p> <p>Harto planet e kontingjenës për menaxhimin e krizës kibernetike</p> <p>Promovo ndarjen e informacionit</p> <p>Zhvillo stërvitje për sigurinë kibernetike</p>	<p>Ndërto qasje për menaxhimin e riskut</p> <p>Adopto modelin e qeverisjes me përgjegjësi të qarta</p> <p>Përcakto linjat bazë minimale të mbrojtjes kibernetike</p> <p>Përdor një gamë të gjerë levash të tregut</p> <p>Ndërto partnershipin publik-privat</p>	<p>Zhvillo kurikula të sigurisë kibernetike</p> <p>Stimulo aftësitë zhvilluese dhe trajno fuqinë punëtore</p> <p>Implemento programe të sigurisë kibernetike për rritjen e ndërgjegjësimit</p> <p>Nxit inovacionin për sigurinë kibernetike dhe R&D (forcimin e mbrojtjes)</p>	<p>Ndërto logjistikën cybercrime</p> <p>Njih dhe mbro të drejtat dhe liritë individuale</p> <p>Krijë mekanizma pajtueshmërie</p> <p>Promovo ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e ligjit</p> <p>Ndërto një proces ndërgjegjësimit</p> <p>Mbështet b/punimin ndërkombëtar për të luftuar krimin kibernetik</p>	<p>Njihë sigurisë kibernetike si prioritet të politikës së jashtme</p> <p>Angazhohu në diskutime ndërkombëtare</p> <p>Promovo b/punimin formal dhe informal në hapësirën kibernetike</p> <p>Bashko përpjekjet e brendshme & të jashtme të sigurisë kibernetike</p>

Fig. nr. 2. Fushat ku fokusohen Strategjitë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike³

2. Identifikimi i sektorëve kombëtarë të IK dhe IKI

Duke marrë parasysh praktikën më sipër dhe qasjen e përgjegjësive së përbashkët, qeveritë nëpërmjet autoriteteve koordinuese përgjigjen për udhëheqjen dhe koordinimin e procesit të identifikimit të IK/IKI.

Hapi i parë: Identifikimi i sektorëve dhe i shërbimeve të IK e më pas i sektorëve e shërbimeve të IKI. Theksojmë se jo të gjitha vendet e ndjekin këtë rend. Të dyja proceset e identifikimit kërkojnë veç aktorëve kryesorë dhe pjesëmarrjen aktive të operatorëve të IK/IKI të sektorit publik dhe privat.

Procesi i identifikimit të IK-ve mund të përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

- Miratimi i aktiviteteve të planifikimit paraprak për të përcaktuar qëllimin

³ Burimi elektronik: <https://ncsguide.org/the-guide/lifecycle/>

e procesit të identifikimit të IK-ve, rolet, përgjegjësitë dhe burimet.

- Identifikimi i palëve kryesore të interesuara që duhet të përfshihen në gjithë procesin e MIK/MIKI, duke përfshirë vlerësimin kombëtar të rrezikut dhe konsultimet për identifikimin e IK-ve. Ky aktivitet ndihmon në përcaktimin e strukturës së qeverisjes së MIK dhe të roleve e përgjegjësive të aktorëve kryesorë të IK-ve, përfshi agjencitë koordinuese dhe palët e interesuara publike dhe ato private.
- Përcaktimi i profilit të rrezikut të vendit në tërësi (vlerësimi kombëtar i rrezikut) duke ndjekur metodologjitë e ndryshme që përshkruhen më poshtë.
- Miratimi/përcaktimi zyrtarisht i sektorëve të IK-ve përmes një politike të MIK (p.sh., Kanada) ose kuadrit ligjor (p.sh., Serbia, Mali Zi). Pas identifikimit rekomandohet që lista e sektorëve dhe shërbimeve kombëtare të IK të shpërndalet gjerësisht.

Si pjesë e procesit të identifikimit të IK-ve, disa vende miratojnë politika/korniza ligjore që përcaktojnë metodologjinë e identifikimit dhe kërkesa të tjera të sigurisë (p.sh., Mali i Zi), ndërsa vende të tjera zbatojnë metoda vlerësimi të rrezikut të ofruara nga partnerët ndërkombëtarë. Vendet caktojnë gjithashtu një organ koordinues që të udhëheq procesin e identifikimit të IK/IKI-ve dhe aktivitetet e mëtejshme të MIK. Meqë peizazhi i kërcënimeve kibernetike ndryshon me shpejtësi, rekomandohet që autoritetet koordinuese të kryejnë çdo vit vlerësime kombëtare të rrezikut kibernetik për të identifikuar rreziqe të reja dhe për rrjedhojë, shërbime apo asete të reja kritike.

Hapi i dytë: Identifikimi i sektorëve dhe shërbimeve të IKI. Për këtë mund të ndiqen hapa, procese e metodologji të ngjashme; megjithatë identifikimi i IKI shpesh është më kompleks se ai i IK-ve.

Hapi i tretë: Identifikimi i nënsektorëve dhe shërbimeve të IKI, brenda sektorëve IK/IKI dhe aseteve specifike të IKI që mbështesin shërbimet IK (fig. 3).




Fig. 3. Hapat e identifikimit të IKI (ENISA - 2014)⁴

⁴ Burimi elektronik: ENISA - 2014 (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32008L0114>)

BE-ja ka miratuar Direktivën 2008/114/KE, e cila ka përcaktuar procedurën për identifikimin dhe përcaktimin e Infrastrukturave Kritike Evropiane (IKE) në sektorët e transportit dhe energjisë që kishin ndikime të rëndësishme ndërkufitare. Ajo ofron një qasje të përbashkët duke vlerësuar nevojën për të përmirësuar mbrojtjen e IKI-ve të caktuara. Mali i Zi ka miratuar një ligj për përcaktimin dhe mbrojtjen e IK në vitin 2020 për të vendosur kriteret dhe kërkesat e identifikimit të IKI-ve sipas standardeve të Direktivës NIS (Network and Information Security).

Palët kryesore të interesit IK/IKI.

Identifikimi i palëve kyçe të interesit të IK/IKI-ve që duhet të përfshihen në të gjithë procesin e MIK/MIKI është jetik. Nuk ka një listë shteruese të palëve të interesuara të IK/IKI-ve pasi vende të ndryshme mund të adoptojë qasje të ndryshme. Disa vende kanë përfshirë organizata të sektorit publik dhe privat (p.sh., operatorët IK/IKI), akademinë, grupe të shoqërisë civile, organe teknike, agjenci ligjzbatuese, partnerë ndërkombëtarë etj. (lista 1 më poshtë).

Lista 1: Lista (jo shteruese) e palëve të interesuara të IK dhe IKI⁵.

- ✓ Agjencitë koordinuese MIKI: e Brendshme, e Drejtësisë, TIK; e Mbrojtjes, zyra e Kryeministrit.
- ✓ Ministritë e TIK: Komunikimi, Media, departamentet e TIK.
- ✓ Ministritë përgjegjëse për IK specifike: Departamenti i Ekonomisë, Energjetikës, Shëndetësisë.
- ✓ Rregullatorët për fusha specifike të IK: Rregullatori i TIK, ai Financiar, i Energjisë.
- ✓ Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe ato të ngjashme.
- ✓ Agjencitë e sigurisë kombëtare dhe ato të inteligjencës.
- ✓ Agjencitë e menaxhimit të krizës dhe të sigurisë.
- ✓ Operatorët (dhe pronarët) publikë dhe privat të IK dhe IKI të shoqërive përkatëse.
- ✓ Politikanët dhe partitë.
- ✓ Kompanitë e sigurisë së TIK, shitësit e programeve kompjuterike, prodhuesit SCADA (Supervisory Control And Data Acquisition - një arkitekturë e sistemit të kontrollit që përfshin kompjuterët, komunikimet e të dhënave në rrjet dhe ndërfaqet grafike të përdoruesit për mbikëqyrjen e makinerive e proceseve të nivelit të lartë), integruarit e sistemit dhe kompanitë e mirëmbajtjes së palëve të treta.
- ✓ Organizatat ndërsektoriale.

⁵ Burimi: TNO 2017. https://www.tno.nl/publish/pages/4267/tno_annualreport_2017.pdf

- ✓ Ekipet e CSIRT si ato kombëtare dhe ato sektoriale.
- ✓ Qendrat Kombëtare të Sigurisë Kibernetike.
- ✓ Akademikë, kërkues dhe zhvillues.

3. Vlerësimi kombëtar i rrezikut kibernetik

Metodologjitë efektive të vlerësimit të rrezikut janë themeli i një programi kombëtar të suksesshëm MIK dhe MIKI. Miratimi i një qasjeje për menaxhimin e rrezikut është i domosdoshëm për të identifikuar kërcënimet aktuale, për të vlerësuar dobësitë dhe ndikimin e tyre në asetet, sistemet ose rrjetet IK dhe IKI, duke marrë parasysh probabilitetin e shfaqjes së këtyre kërcënimeve.

Udhëzuesi për zhvillimin e një SKSK dhe raporti GFCE-Meridian mbi MIKI⁶ rekomandojnë kryerjen e profileve të rrezikut kombëtar/sectorial për të identifikuar rrezikun e dështimit të sektorëve/shërbimeve IK dhe IKI. Qëllimi i këtyre profileve është krijimi i një kuptimi të përbashkët i faktorëve të rrezikut me të cilët përballet një vend/sector specifik ekonomik, përmes vlerësimit sistematik të kërcënimeve dhe pasojave të dështimit të IK dhe IKI. Vlerësimi sistematik i kërcënimeve nënkupton që të gjitha kërcënimet vlerësohen bazuar në ndikimin e tyre dhe gjasat e shfaqjes së tyre. Rezultati i këtij vlerësimi rreziku është një pasqyrë e faktorëve të rrezikut dhe pozicionit të tyre në lidhje me ndikimin dhe shpeshhtësinë e shfaqjes. Çdo rrezik që trajtohet si një profil rreziku kombëtar/sectorial mund të përbëjë bazën e një qasjeje të integruar kombëtare/sectoriale për parandalimin, gatishmërinë dhe reagimin ndaj tij. Marrja në konsideratë e rreziqeve të lidhura me IK-të dhe IKI-të në kontekstin e një profili rreziku kombëtar / sectorial mund të ndihmojë në zhvillimin e një qasjeje të integruar dhe të balancuar të menaxhimit të rrezikut që mbështet MIK dhe MIKI.⁷

Fushat e vlerësimit të rrezikut:

- a. *Qasja organizative e sistemeve të TIK* (p.sh., Korniza për Përmirësimin e Sigurisë Kibernetike të IK-ve nga Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë i SHBA dhe Standardi Nr. 1 i Vlerësimit të Rrezikut Teknik në Mbretërinë e Bashkuar (UK));
- b. *Qasja në nivel sectorial* (p.sh., metodologjia e rrezikut të infrastrukturës dhe elasticitetit).
- c. *Qasja në nivel kombëtar* (p.sh., vlerësimi kombëtar i kërcënimeve kibernetike 2020 - Kanada, dhe vlerësimi kombëtar i rrezikut kibernetik i zbatuar nga Zyra e Jashtme e Komonuelthit dhe Zhvillimit të UK si dhe në shumë vende të Komonuelthit në Afrikë e Karaibe).

⁶ Burimi: https://www.tno.nl/publish/pages/4267/tno_annualreport_2017.pdf

⁷ Burimi: https://www.tno.nl/publish/pages/4267/tno_annualreport_2017.pdf

d. Qasja e nivelit rajonal (p.sh., udhëzimet e BE-së për vlerësimin e aftësisë për menaxhimin e rrezikut (**Risk Management Capability Assessment Guidelines-RMCA**), të cilat mbështesin autoritetet kombëtare për përcaktimin e profilit të rrezikut kombëtar. RMCA është metodologji, jo detyruese, gjithëpërfshirëse dhe fleksibël, që u mundëson autoriteteve kombëtare të vetëvlerësojnë aftësinë e tyre për menaxhimin e rrezikut).

Sipas Agjencisë së BE-së për Sigurinë Kibernetike (The European Union Agency for Cybersecurity-ENISA) janë dy qasje themelore për vlerësimin e rrezikut në nivel kombëtar ⁸:

a. Vlerësimi i centralizuar/qasja e drejtuar nga shteti: Ky është një model i vetëm për të gjithë; autoriteti koordinues kërkon që aktorët e identifikuar (operatorët e IK) të zbatojnë një standard të veçantë ose të unifikuar për vlerësimet e rrezikut. Kjo lloj qasje është zbatuar nga UK.

b. Vlerësimi i decentralizuar/qasja e drejtuar nga operatori: Në këtë qasje çdo aktor i identifikuar (operator IK) përgatit vlerësimin e vet të rrezikut për t'u integruar nga një autoritet koordinues. Kjo qasje është zbatuar nga vendet nordike, Suedia, Danimarka, Japonia, Zvicra.

Përveç sa më lart, mund të përdoren gjithashtu metodologji/qasje të ndryshme, si:

- **Qasja e bazuar në skenar:** Sipas saj, aktorët e identifikuar mblidhen për të shqyrtuar skenarët në formë rrethore; skenarë të tillë i përshkruajnë rreziqet si një narrativë dhe i etiketojnë ato duke aplikuar kategori të thjeshta të gjasave dhe ndikimeve (të ulëta, të mesme, të larta). Këtë qasje vlerësimi të rrezikut e përdor sektori i telekomunikacionit në Danimarkë.
- **Qasja cilësore:** Ku vendet me një teknikë specifike të modelimit të kërcënimit prirën të përdorin modele cilësore. Vlerësimet cilësore janë qasja e zakonshme e përdorur nga vendet kur vendosin për rëndësinë e një kërcënimi. Ky model, ku ka një gamë të gjerë kërcënimesh, është i zakonshëm në vendet nordike.
- **Qasja sasiore:** Kjo qasje zbaton pragjet rendore (p.sh., rreziqet specifike klasifikohen si të rënda nëse prek 200 në 20,000 ose ndërprerjet e shërbimeve për pesë ditë ose më shumë). Japonia është një nga vendet që e ka zbatuar këtë qasje.
- **Qasja hibride:** kombinon të gjithë elementët e mësipërm (duke përdorur skenarë dhe më pas metoda cilësore dhe sasiore). Holanda është një nga vendet që ka zbatuar këtë model.

⁸ Burimi: (ENISA 2014): <https://www.enisa.europa.eu/>

4. Politika e MIKI dhe kornizat ligjore

Themelet e politikës dhe të kornizave ligjore të MIK/MIKI janë:

- (i) udhëheqja dhe angazhimi i qeverisë, i cili vendos një koordinim efektiv midis qeverisë dhe operatorëve publikë dhe privatë të IK/IKI,
- (ii) qasje e përbashkët e përgjegjësisë, ku qeveria, publiku dhe operatorët privatë IK/IKI janë bashkëpërgjegjës për mbrojtjen e sektorëve/aseteve të IK/IKI. Pra, qeveria është përgjegjëse për sigurinë e vijimësisë së sektorëve dhe shërbimeve kritike, ndërsa operatorët IK/IKI janë përgjegjës për sigurinë e infrastrukturës së tyre të nevojshme për të ofruar shërbimin kritik.

Çdo shtet, të paktën, duhet të zhvillojë e miratojë një kuadër rregullator bazë MIKI që përfshin këto aktivitete:

- a) identifikimin dhe rivlerësimin e rregullt të sektorëve dhe të shërbimeve të IKI;
- b) caktimin e një agjencie koordinuese me mandat, role e përgjegjësi të qarta ligjore dhe burime të mjaftueshme për të vepruar si e tillë;
- c) kërkesa sigurie dhe detyrime ligjore, si vlerësime të rregullta të menaxhimit të rrezikut, mekanizma auditimi, mekanizma të zbulimit të cenueshmërisë, shkëmbimit të informacionit, detyrime të raportimit të incidenteve, kërkesa sigurie për zinxhirin e furnizimit të IK/IKI;
- d) partneritete të qëndrueshme publiko-private;
- e) mekanizma bashkëpunimi me organet rregullatore, agjenci qeveritare, partnerë ndërkombëtarë;
- f) fushata ndërgjegjësuere publike.

Nëse nuk ka CSIRT-e, autoritetet koordinuese duhet të konsiderojnë krijimin e një CSIRT kombëtar me udhëzime të qarta për të mbështetur IK dhe IKI, ose të kërkojnë mbështetje teknike nga ekipe të tjera vendase të reagimit ndaj incidenteve (p.sh., CSIRT ushtarake/mbrojtëse), deri në krijimin e CSIRT kombëtare.

Modelet e kornizave rregullatore MIKI.

Zakonisht, vendet ndryshojnë qëndrimin e tyre rregullator të MIKI për të mbajtur ritmin në mjedisin që ndryshon me shpejtësi. Kështu SHBA-të, fillimisht miratuan qasjen “larg duarve” dhe më pas zgjodhën një qasje vetërregulluese. Autoritetet koordinuese mund të marrin në konsideratë një gamë të gjerë opsionesh, politikash dhe ligjore për të siguruar që sektorët dhe shërbimet vendase të IKI-ve janë të mbrojtura në mënyrën e duhur. Miratimi i çdo politike dhe opsioni ligjor varet nga faktorë si; nevojat dhe prioritetet e

brendshme, niveli i pjekurisë së sigurisë kibernetike të vendit në përgjithësi dhe ekosistemi IK/IKI-ve, lloji i kërcënimeve me të cilat ato përballen, lloji i palëve të interesuara të përfshira në MIKI, si dhe qëndrimi i qeverisë.

Ndërhyrja e qeverisë dhe vijimësia rregullatore janë dy komponentët kryesorë që përcaktojnë opsionet e kuadrit rregullator të MIKI. Nga një këndvështrim teorik, raporti GFCE-Meridian mbi MIKI si dhe organizata e studiuës të tjerë sugjerojnë që zgjedhjet e kuadrit rregullator të MIKI të përfshijnë: (fig. 4) ⁹:

- ✓ Mekanizmat dhe stimujt e tregut (të njohura si qasja “larg duarve”).
- ✓ Vetërregullimin, i cili përfshin dy nënkategori: vetërregullim vullnetar dhe atë të detyrueshëm.
- ✓ Kuadrin ligjor dhe rregullator, i cili përfshin dy nënkategori: rregulloren e komandim-kontrollit dhe programin e detyrueshëm të qeverisë.
- ✓ Pronësinë e qeverisë.




Fig. nr. 4. Modelet e kornizave rregullatore MIKI.

Kornizat e qeverisjes dhe rregullatore të MIK/MIKI.

Shembuj të këtyre kornizave janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

⁹ Burimi elektronik: https://www.researchgate.net/figure/Regulatory-continuum_fig1234050880.

Tab. 1. Qeverisja dhe kornizat rregullatore të MIK/MIKI në BE¹⁰

Përkufizimi i IK/IKI	“Shërbime Thelbësore” referuar “Shërbimeve Thelbësore të Operatorëve” – entitete publike ose private përfshi energjinë, transportin bankat, infrastrukturën e tregut financiar, shëndetësinë, ujin e pijshëm furnizimin dhe shpërndarjen dhe sektorët e infrastrukturës digjitale dhe ato që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 5 (2).
Autoriteti udhëheqës	Agjencia për Mbrojtjen Kibernetike e BE (ENISA) mund të mbështesë e lehtësojë bashkëpunimin strategjik midis vendeve anëtare të unionit në lidhje me sistemet e sigurisë së informacionit dhe përputhjen me funksionet e tjera të përcaktuara në direktivën NIS (Network and Information Security).
Qasja rregullatore Struktura qeverisëse	Direktiva NIS ishte pjesa e parë e detyrueshme e sigurisë kibernetike e BE. Direktiva duhet të bëhet pjesë e legjislacionit të brendshëm të çdo vendi anëtar. Agjencia për Mbrojtjen Kibernetike e BE është autoritet udhëheqës. Nga çdo vend anëtar kërkohet të krijohen direktiva strategjike dhe rregulloret NIS, një ose më shumë CSIRT-e, caktimi i autoritetit kompetent si dhe pika e kontaktit.
Sektorët Kritikë	Energjia, transporti, bankat, infrastruktura e tregut financiar, shëndetësia, mbështetja dhe shpërndarja e ujit të pijshëm dhe infrastruktura digjitale.
Politikat dhe rregullat e përshtatshme	Strategjia e Sigurisë Kibernetike e BE-së. Direktiva e Sigurisë së Rrjeteve dhe Informacionit të BE - 08 gusht 2016. Akti i Mbrojtjes Kibernetike, 2019.

¹⁰ Burimi: <https://ec.europa.eu/jrc/en/research-topic/critical-infrastructure-protection>.

Tab. 2. Qeverisja dhe kornizat rregullatore të MIK/MIKI në Serbi ¹¹

<p>Përkufizimi i IK/IKI</p>	<p>Sistemet TIK të rëndësisë së veçantë janë sisteme që përdoren për;</p> <p>(i) Kryerjen e detyrave në autoritetet publike.</p> <p>(ii) Përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale sipas kuptimit të ligjit që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>(iii) Kryerjen e aktiviteteve me interes të përgjithshëm dhe aktiviteteve ekonomike në fushat: (a) energji, (b) transport, (c) sektori shëndetësor, (d) tregu bankar dhe financiar, (e) infrastruktura digjitale, (f) të mirat publike, (g) shërbimi shoqëror i informacionit, (h) fusha të tjera ...</p> <p>(iv) Entitetet legale dhe institucionet e ngritura në Serbi dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale për performancën e aktiviteteve të detajuara në seksionin (iii) më lart.</p>
<p>Autoriteti udhëheqës</p>	<p>Ministria e Brendshme (MB) (autoritetet kompetente) dhe Ministria e Tregtisë, Turizmit dhe Telekomunikacionit (autoritetet kompetente për mbrojtjen kibernetike).</p>
<p>Qasja rregullatore Struktura Qeverisëse</p>	<p>Kornizat legale dhe rregullatore ekzistuese janë të detyrueshme për IK-të dhe operatorët IKI.</p> <p>Ministria e Brendshme koordinon dhe mbikëqyr operatorët e IK-ve ndërsa operatorët e sistemeve TIK të rëndësisë së veçantë mbikëqyren nga Ministria e Tregtisë, Turizmit dhe Telekomunikacionit.</p>
<p>Sektorët kritikë</p>	<p>Sektorët kritikë kombëtarë: energjia, trafiku, mbështetja me ushqime dhe ujë, kujdesi shëndetësor, telekomunikacioni dhe teknologjia e telekomunikacionit, mbrojtja e ambientit, funksionimi i entiteteve qeveritare.</p>
<p>Politikat dhe rregullat e përshtatshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji për Sigurinë e Informacionit (2016) - Ligji për Infrastrukturën Kritike (2018) - Strategjia për Zhvillimin e Informacionit - Strategjia e Sigurisë 2017-2020.

¹¹ Burimi: Interview with Natalija Radoja, February 19, 2021.

Tab. 3. Qeverisja dhe kornizat rregullatore të MIK/MIKI në SHBA ¹¹

Përkufizimi i IK/IKI	“... sistemet dhe asetet, fizike apo virtuale, kaq jetësore për SHBA sa që paaftësia /shkatërrimi i tyre mund të kenë impakte dobësuese në siguri, në sigurinë ekonomike kombëtare, sigurinë kombëtare të shëndetit publik, ose në ndonjë kombinim të tyre”.
Autoriteti udhëheqës	Agjencia e Mbrojtjes së Infrastrukturës dhe Mbrojtjes Kibernetike (CISA) është pjesë e Departamentit të Mbrojtjes Kombëtare dhe koordinon përpjekjet për forcimin e sigurisë duke përdorur partner të besueshëm përmes sektorëve publik e privat dhe shpërndan asistencë teknike e bën vlerësime të aktorëve federal ashtu sikurse të pronarëve dhe operatorëve të infrastrukturës në gjithë vendin.
Qasja rregullatore	Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë lëshon Kornizën për Përmirësimin e Mbrojtjes Kibernetike të IK. “Korniza” është si një grup standardesh dhe praktikash më të mira vullnetare, të bazuara në rrezik, në mënyrë që të ndihmojë organizatat e të gjitha madhësive që të menaxhojnë mbrojtjen kibernetike në ndonjë sektor. Agjencitë specifike të sektorit kanë adoptuar një qasje të shumanshme që përfshin aktivitetet për mbrojtjen kibernetike; të detyrueshme dhe ato vullnetare.
Struktura Qeverisëse	Departamenti i Mbrojtjes Kombëtare është përgjegjës për 10 nga 16 sektorët e identifikuar. Departamenti i Energjisë, Mbrojtjes, i Thesarit, Agrikulturës, Shëndetit dhe Shërbimit Njerëzor, Administrimi i shërbimeve të përgjithshme dhe mbrojtja e ambientit janë përgjegjës për sektorë të tjerë. Zyra për mbrojtjen e infrastrukturës përfshi Agjencinë e Mbrojtjes së Infrastrukturës dhe Mbrojtjes Kibernetike është përgjegjëse për koordinimin e mbrojtjes së IK në nivel kombëtar.
Sektorët Kritikë	Kimik, objektet tregtare, komunikimi, prodhimi kritik, digat, bazat e industrisë së mbrojtjes, shërbimet e emergjencës, energjia, shërbimet e financës, ushqimi dhe agrikultura, ndërtesat qeveritare, kujdesi shëndetësor dhe shëndeti publik, TIK, reaktorët bërthamorë, materialet dhe plehrat, transporti, uji dhe ujërat e zeza. Në vitin 2020, SHBA-të identifikuan dhe fuqinë punëtore thelbësore të IK-ve.
Politikat dhe rregullat e përshtatshme	<ul style="list-style-type: none"> - Direktiva Politike Presidenciale 21 (Siguria dhe Qëndrueshmëria e IK-ve). - Akti për Forcimin e Sigurisë Kibernetike 2014. - Akti për Avancimin e Mbrojtjes Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2015. - Akti për Ndarjen e Informacionit për Sigurinë Kibernetike 2015. - Akti i Agjencisë së Sigurisë së Infrastrukturës dhe Mbrojtjes Kibernetike 2018. - Korniza për Mbrojtjen Kibernetike dhe Ruajtjen e IK-ve.

¹¹ Burimi: Interview with Paul Rosenzweig, February 25, 2021.

Koordinatorët Kombëtarë / Sektorialë të MIKI-it.

Baza e të dhënave rregullatore të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit e Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit tregojnë se 89 nga 195 vende në botë kanë miratuar programe MIKI dhe kornizat rregullatore që lidhen me to. Në 51 vende, rregullatori i TIK-ut është përgjegjës për MIKI, duke qenë kryesisht në Afrikë dhe Evropë, ku rregullatorët e TIK-ut kanë një rol aktiv në mbrojtjen e IKI¹². Këto statistika po kështu tregojnë se 38 vende kanë programe MIKI dhe korniza rregullatore; megjithatë, roli kombëtar koordinues i MIKI luhet nga agjenci të tjera qeveritare. Gjithashtu, 106 nga 195 vende nuk kanë asnjë program MIKI ose kornizë rregullatore, gjë që është ende e rëndësishme duke marrë parasysh peizazhin aktual të kërcënimit kibernetik dhe rëndësinë e mbrojtjes së sektorëve dhe shërbimeve të IKI.

Statistikat më lart tregojnë se ekzistojnë të paktën dy profile kryesore të koordinatorëve të MIKI:

- a) **Rregullatorët e TIK-ut** dhe
- b) **Agjencitë e tjera qeveritare** (p.sh., një agjenci e pavarur qeveritare ose një ministri e qeverisë).

Megjithëse vendet mund të miratojnë qasje të ndryshme në këtë drejtim, koordinimi kombëtar ose sektorial i MIKI mund të jetë brenda mandatit të entiteteve të mëposhtme:

- a) **Rregullatori i TIK** Autoriteti Rregullator i Komunikimeve (Malawi) dhe Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (E.B. Arabe), janë koordinatori MIKI në nivel kombëtar. Autoriteti Rregullator i Komunikimit Finlandez dhe Autoriteti Suedez i Postës dhe Telekomit janë agjencitë kryesore qeveritare përgjegjëse për MIKI - koordinator MIKI në nivel sektorial).
- b) **Një agjenci, qendër ose komitet i pavarur qeveritar**, p.sh., Qendra Kombëtare për Mbrojtjen e IK në Spanjë (MIK/MIKI), Agjencia e Sigurisë Kibernetike dhe Sigurisë së Infrastrukturës në SHBA (MIK/MIKI), Agjencia e Sigurisë së Informacionit në Estoni, dhe Agjencia Kombëtare për Sigurinë e Sistemeve të Informacionit (MIKI) në Francë.
- c) **Një nga ministrinë e qeverisë**: Ministria e Punëve të Brendshme ose ministria e TIK. Në Serbi, Ministria e Brendshme merret me MIK, ndërsa Ministria e TIK është përgjegjëse për MIKI,
- d) **Një ekip i reagimit ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike**, - në Letoni ky institucion është përgjegjës për funksionimin rutinë ditor të MIKI.

¹² Burimi: ITU World Telecommunication/ICT Regulatory Database.

Në disa vende, roli kombëtar i koordinimit të MIKI-it luhet nga një ose disa autoritete qeveritare. P.sh., në Republikën Çeke CSIRT-i kombëtar dhe Agjencia e Sigurisë Kombëtare kanë përgjegjësi të përbashkët për mbrojtjen e sektorëve e shërbimeve MIKI. Në Francë, Agjencia e Mbrojtjes Kibernetike Kombëtare franceze (ANSSI) është agjencia kryesore qeveritare që merret me MIKI. Në nivel ministror, Ministria e Brendshme (p.sh., Gjermania, Hungaria) ose Ministria e Mbrojtjes (Danimarka, Letonia) zakonisht përfshihen në aktivitetet e MIKI. Kryesisht kjo ndodh në vendet evropiane dhe afrikane. Kur ka një politikë të përcaktuar dhe kornizë rregullore të MIKI-it, koordinatori kombëtar i MIKI do të ketë mandat, funksione e përgjegjësi specifike ligjore për të bashkëvepruar me komunitetin IKI. Ky mandat ligjor mund të jetë i gjerë-nivel kombëtar (Malawi), ose i kufizuar-nivel sektorial (Finlanda) dhe duhet të ketë burime të mjaftueshme teknologjike, financiare dhe njerëzore për të operuar si i tillë. Koordinator kombëtar MIKI duhet të sigurojë që operatorët IKI të jenë në përputhje me politikën dhe kuadrin rregullator të MIKI, duke përfshirë kërkesat e sigurisë dhe detyrimet ligjore si standarde minimale. Ky koordinator duhet gjithashtu të zhvillojë dhe promovojë marrëveshjet e bashkëpunimit në vend dhe ato ndërkombëtare midis aktorëve kryesorë të IKI dhe partnerëve ndërkombëtarë. Aktualisht shumica e vendeve nuk kanë akoma një kuadër rregullator MIKI në fuqi. Në fig. nr. 5 paraqiten vendet me SKSK që adresojnë MIKI dhe plane elasticiteti (plane të aftësive ripërtëritëse).




Fig. nr. 5. Vendet me një SKSK që adresojnë MIKI dhe planet e qëndrueshmërisë kibernetike ¹³.

Në këtë kontekst, a duhet që rregullatorët sektorialë, përfshi rregullatorët e TIK-ut, të miratojnë një qëndrim proaktiv të sigurisë kibernetike për të siguruar që sektorët dhe shërbimet IK/IKI janë të mbrojtura në mënyrën e duhur? Nëse autoritetet kompetente, përfshi rregullatorët e TIK, nuk ndërmarrin asnjë

¹³ Burimi: ITU 2021.

veprim, sektorët dhe shërbimet kombëtare të IKI nuk janë të sigurta; dhe për këtë arsye, IKI dhe sektorët IK janë shumë të ekspozuar ndaj rreziqeve e dobësive kibernetike.

Në këto vende, rekomandohet që të paktën rregullatorët e TIK të miratojnë një qëndrim proaktiv të sigurisë kibernetike dhe të gjejnë mënyrën e duhur ligjore për të detyruar operatorët IKI të plotësojnë disa kërkesa bazë të sigurisë (p.sh., vlerësime të rregullta të rrezikut kibernetik dhe standarde të njohura ndërkombëtarisht) dhe detyrime ligjore (p.sh., raportim të incidentit) për të siguruar që IKI është i sigurt. Rregullatorët e TIK zakonisht nuk kanë burime dhe kapacitete për të ofruar mbështetje teknike (p.sh., menaxhimi në përgjigje ndaj incidentit) kur ndodhin incidente kibernetike, përveç nëse ekziston një CSIRT sektorial (p.sh., COMM-CSIRT Botswana,¹⁴ NCSC-FI në Finlandë. Rregullatorët e TIK duhet të konsiderojnë krijimin e kanaleve formale të komunikimit për të shkëmbyer informacion me operatorët e IKI dhe aktorë të tjerë përkatës në kohë krize. Po kështu rregullatorët e TIK duhet të konsiderojnë krijimin e mekanizmave të komunikimit dhe bashkëpunimit me CSIRT-et kombëtare, ato vendase ose sektoriale, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe partnerët ndërkombëtarë. Meqë operatorët e IKI janë zakonisht të zellshëm, veçanërisht kompanitë shumëkombëshe, kërkesat e tyre minimale të sigurisë dhe detyrimet ligjore do t'i ndihmojë operatorët e IKI të zbulojnë dhe të zbusin ndikimin negativ të incidenteve kibernetike. Në të njëjtën kohë autoritetet kompetente duhet të zhvillojnë programe MIKI, të ngrenë struktura qeverisëse, si dhe të hartojnë politika e korniza ligjore.

Përfundime

1. Sulmet kibernetike janë ndër kërcënimet më të rëndësishme të sigurisë për botën moderne dhe për këtë arsye siguria kibernetike është bërë pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare.
2. SKSK është në thelb udhërrëfyese që përcakton një sërë objektivash strategjike kombëtare që duhen zbatuar (dhe duhen vlerësuar rregullisht) në një kornizë kohore specifike.
3. SKSK vlerësohet si hap i rëndësishëm në zhvillimin e legjislacionit dhe të masave kundër krimit kibernetik dhe ajo duhet të mbështetet në disa parime parimet themelore të trajtuara më lart.
4. Për shkak të mungesave të mjeteve të nevojshme, burimeve njerëzore e logjistike të duhura për të ushtruar veprimtarinë ligjzbatuese, rritja e kapaciteteve për përballjen me sfidat kibernetike është thelbësore dhe kërkohen ndryshime strukturore, qasje, kapacitete teknike, e logjistike.

¹⁴ BW-CIRT. <https://www.bocra.org/bw/bw-cirt>

5. Në vendin tonë dhe pse kanë ndodhur zhvillime në fushën e TIK dhe digjitalizimit të shërbimeve publike, si dhe janë bërë përmirësime në kuadrin ligjor për sigurinë kibernetike, ende nuk kemi arritur shkallën dhe ritmin e ndryshimit të nevojshëm për të qëndruar përpara lëvizjes dhe evolucionit të shpejtë, që vjen nga kërcënimet e ndryshme kibernetike.
6. Vende të ndryshme adoptojnë një qasje të ndryshme lidhur me listën e palëve të interesuara të IK/IKI ku përfshijnë organizata të sektorit publik dhe privat, akademinë, grupe të shoqërisë civile, organe teknike, agjenci të zbatimit të ligjit, partnerë ndërkombëtarë etj.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Assaf, Dan, "Models of Critical Information Infrastructure Protection." International Journal of Critical Infrastructure Protection 1: 6-14, 2008. Burimi elektronik: https://www.academia.edu/2114887/Models_of_critical_information_infrastructure_protection.
2. Boyens, Jon, and others. 2021. NIST. Key Practices in Cyber Supply Chain Risk Management: Observations from Industry. NISTIR 8276. Burimi elektronik: <https://doi.org/10.6028/NIST.IR.8276>.
3. Brunner, Elgin M., and Manuel Suter. 2008. International CIIP Handbook 2008/2009. Center for Security Studies, ETH Zurich. Burimi elektronik: <https://css.ethz.ch/content/dam/ethz/special-interest/gess/cis/center-for-securities-studies/pdfs/CIIP-HB-08-09.pdf>.
4. Burnett, Peter. 2016. The Critical Importance of CIIP to Cybersecurity. Burimi elektronik:
5. https://www.itu.int/en/ITU-D/Regional_Presence/Europe/Documents/Events/2016/Cybersecurity%20Forum%20Bulgaria/GFCE-MERIDIAN%20CIIPv2%20REV.pdf.
6. CSA (Cyber Security Agency of Singapore). 2019. Guide to Conducting Cybersecurity Risk Assessment for Critical Information Infrastructure. Burimi elektronik: https://www.csa.gov.sg/-/media/csa/documents/legislation_supplementary_references/guide_to_conducting_cybersecurity_risk_assessment_for_cii.pdf
7. DCMS (Department for Digital, Culture Media and Sport). 2018. Security of Network and Information Systems. Burimi elektronik:
8. https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/677065/NIS_Consultation_Response_-_Government_Policy_Response.pdf

9. Duane, Verner, Frederic Petit, and Kibaek Kim. 2017. "Incorporating Prioritization in Critical Infrastructure Security and Resilience Programs." *Homeland Security Affairs* 13, Article 7. Burimi elektronik: <https://www.hsaj.org/articles/14091>.
10. ENISA (European Agency for Cybersecurity). n.d. *Baseline Capabilities of National Governmental CERTs. Part 2: Policy Recommendations*. Burimi elektronik:
 11. https://www.enisa.europa.eu/publications/baseline-capabilities-of-national-governmental-certs-policy_recommendations/at_download/fullReport#:~:text=Therefore%20a%20national%20%2F%20governmental%20CERT,the%20public%20and%20private%20sectors.
12. ENISA (European Agency for Cybersecurity). 2014. *Methodologies for the Identification of Critical Information Infrastructure Assets and Services*. Burimi elektronik:
 13. https://www.enisa.europa.eu/publications/methodologies-for-the-identification-of-ciis/at_download/fullReport.
14. ENISA (European Agency for Cybersecurity). 2019. *Study on CSIRT Landscape and IR capabilities in Europe 2025*. Burimi elektronik: <https://www.enisa.europa.eu/publications/study-on-csirt-landscape-and-ir-capabilities-in-europe-2025>.
15. Garcia Zaballos, Antonio and Inkyung Jeun. 2016. *Best Practices for Critical Information Infrastructure Protection. Experiences for Latin America and the Caribbean and Selected Countries*. Inter-American Development Bank. Burimi elektronik:
 16. [https://publications.iadb.org/publications/english/document/Best-Practices-for-Critical-Information-Infrastructure-Protection-\(CIIP\)-Experiences-from-Latin-America-and-the-Caribbean-and-Selected-Countries.pdf](https://publications.iadb.org/publications/english/document/Best-Practices-for-Critical-Information-Infrastructure-Protection-(CIIP)-Experiences-from-Latin-America-and-the-Caribbean-and-Selected-Countries.pdf).
17. Giannopoulos, Georgios, Roberto Filippini, and Muriel Schimmer. 2012. *Risk Assessment Methodologies for Critical Infrastructure Protection. Part I: A State of the Art*. Ispra: European Commission, Joint Research Centre, Institute for the Protection and Security of the Citizen. Burimi elektronik: <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/bitstream/JRC70046/lbna25286enn.pdf>.
18. INSA (Intelligence and National Security Alliance). 2018. *Managing a Cyber Attack on Critical Infrastructure: Challenges of Federal, State, Local and Private Sector Collaboration*. Burimi elektronik: <https://www>.

insaonline.org/wp-content/uploads/2018/08/INSA-Managing-Cyber-Attack-Critical-Infrastructure.pdf.

19. INTERPOL. 2020. COVID-19 Cybercrime Analysis Report. Burimi elektronik: <https://www.interpol.int/en/News-and-Events/News/2020/INTERPOL-report-shows-alarming-rate-of-cyberattacks-during-COVID-19>.
20. ITU (International Telecommunication Union). 2021. Global Cybersecurity Index v4. Geneva: ITU. <https://www.itu.int/en/ITU-D/Cybersecurity/Pages/global-cybersecurity-index.aspx>.
21. ITU, World Bank and partners. 2021. Guide to Developing a National Cybersecurity Strategy. <https://ncsguide.org/the-guide/lifecycle/>.

Analizimi i fushës shkencore të menaxhimit në Shqipëri: Një studim bibliometrik

Dr. Gentian Hoxhalli

Akademia e Forcave të Armatosura

Gentjan Ulaj

Universiteti “Luarasi”

Nives Lamce

Universiteti “Luarasi”

Iris Kruja

Universiteti “Luarasi”

Trajtesë e shkurtuar.

Metodat bibliometrike po bëhen një pjesë e rëndësishme e rishikimit të literaturës në ditët e sotme, me kontributin e madh e bazës së të dhënave të disponueshme dhe softuerëve që ofrojnë mundësi për kërkuesit. Vërejmë përdorimin e analizës bibliometrike në shumë mënyra, siç është rishikimi i një fushe të caktuar, ndjekja e zhvillimit të një fushe kërkimore, analiza e artikujve në një revistë të caktuar dhe madje publikimet në vende të veçanta. Duke ndjekur këtë logjikë, ne do të kryejmë një analizë bibliometrike të kërkuesve shqiptarë në fushën e biznesit dhe menaxhimit. Baza e të dhënave është mbledhur nga baza e të dhënave Scopus dhe përdorimi i softuerit R për analizën e të dhënave. Rezultatet identifikojnë autorët më të rëndësishëm, artikujt, revistat dhe se si janë të lidhura ato përmes analizës së performancës dhe analizës së bashkautorëve. Ne gjithashtu do të ofrojmë udhëzime për kërkime të ardhshme.

Fjalët kyçe: Shqipëria, metoda bibliometrike, studim, baza e të dhënave, biznes dhe menaxhim

Hyrje

Studimet në fushën e biznesit dhe menaxhimit janë një pjesë e rëndësishme të jetës ekonomike, pasi konsiderohen motorët e përparimit ekonomik. Prandaj, hulumtimi në fushën e menaxhimit po rritet vazhdimisht. (Zupic and Čater 2015). Ndërsa menaxhimi është një fushë e gjerë, shumica e studimeve adresohen në tema të caktuara si biznesi ndërkombëtar (Knight and Kim 2009), menaxhimi strategjik (Teece, Pisano et al. 1997), marketingu (Kotler 1993) dhe sipërmarrja (Stevenson and Jarillo 2007). Shumica e këtyre studimeve kryhen në vendet e zhvilluara, ndërkohë që kërkimet në vendet në zhvillim po marrin një vull. Në studimin tonë synohet të pasqyrohet situata aktuale e studimeve të menaxhimit dhe biznesit në Shqipëri. Konteksti është shumë i rëndësishëm sepse Shqipëria ishte një nga vendet e fundit komuniste që mbeti deri në vitin 1991 dhe tregu i lirë është i disponueshëm vetëm për 30 vitet e fundit me boshllëqet e tij institucionale dhe kërkimet e menaxhimit në këto vite janë të kufizuara. Është e rëndësishme të përmendet se sipas Instat.com në Shqipëri janë 18 universitete që kanë Fakultetin Ekonomik dhe pothuajse 21 programe, të cilat janë të lidhura ngushtë me menaxhimin si Administrimi i Biznesit. Produktiviteti nga këto institucione është në rritje dhe nevoja për të vlerësuar progresin është e evidente.

1. Rishikim i literaturës dhe metodologjia

Analiza bibliometrike po bëhet më e popullarizuar në shkencë, kryesisht nga përfitimi i dy zhvillimeve kritike, siç është sasia e të dhënave që është shumë e lartë, dhe softuerët e bëjnë më të lehtë analizimin e të dhënave dhe marrjen e njohurive. (Donthu, Kumar et al. 2021). Analiza bibliometrike konsiston në aplikimin e teknikave sasiore si bashkëcitimi në të dhënat bibliometrike si autorët, institucionet ose punimet (Broadus 1987). Analiza bibliometrike në përgjithësi përdoret për të hartuar strukturën intelektuale të një fushe specifike studimi (Guerra Fernandes, Marques et al. 2022), një revistë shkencore (Ramos-Rodríguez and Ruíz-Navarro 2004) ose publikimeve në një rajon të caktuar (Bilir, Güngör et al. 2020). Hulumtimi i bazuar në metoda bibliometrike konsiston në dy shtylla kryesore, analizën e performancës dhe strukturën intelektuale. Analiza e performancës synon të vlerësojë botimet me dimensione të ndryshme si autori më i cituar, letra më e cituar, rritja vjetore e kontributit akademik etj... ndërsa struktura intelektuale synon të identifikojë marrëdhëniet midis autorëve, punimeve, institucioneve, fjalë kyçe dhe të japë informacion rreth dinamikës dhe kompleksitetit të një fushë specifike (Van Eck and Waltman 2010). Zupic dhe kolegjet shqyrtuan punimet bibliometrike të botuara në fushën e menaxhimit, dhe arritën në përfundimin se analiza bibliometrike më e preferuar është analiza e bashkëcitimit, të cilën do ta

kryejmë gjithashtu në këtë punim. Ne ndoqëm me përpikëri procedurën e hulumtimit të propozuar nga (Donthu, Kumar et al. 2021) me katër hapa për të kryer analizën tonë.

Ata rekomandojnë që hapi i parë duhet të jetë përcaktimi i qëllimit dhe objektivit të studimit. Në rastin tonë, ne synojmë të vlerësojmë gjendjen aktuale të kërkimit në fushën e menaxhimit në një ekonomi në zhvillim siç është Shqipëria. Hapi i dytë është zgjedhja e teknikave të duhura për të përmbushur këtë objektiv. Ne kryejmë analiza të performancës për të vlerësuar rritjen vjetore të punimeve me autorë shqiptarë, duke identifikuar më të rëndësishmet dhe teknikat e ngjashme të aplikuara më parë në literaturë. (García-Lillo, Claver-Cortés et al. 2017, Dzikowski 2018). Në të njëjtën kohë, ne aplikojmë gjithashtu analizën e bashkëcitimit për të identifikuar strukturën intelektuale të studiuesve nga Shqipëria dhe analizën e bashkëcitimit të fjalëve për të identifikuar temat e tendencës që na lejojnë të bëjmë rekomandime të ardhshme për komunitetin akademik, qasje e ngjashme e përdorur në studime të tjera bibliometrike. (Akhavan, Ebrahim et al. 2016). Hapi tjetër përfshin mbledhjen e të dhënave bibliometrike nga bazat e të dhënave akademike si Scopus ose Web of Science. Ne e konsiderojmë bazën e të dhënave Scopus si më të përshtatshme për qëllimin tonë të kërkimit për fusha të vogla kërkimore (Aria and Cuccurullo 2017), sepse baza e të dhënave Scopus mbulon më shumë revista. Ne kërkuam në shtetin përkatës për Shqipërinë, duke na çuar në 9233 dokumente deri në nëntor 2023 kur u nxor baza e të dhënave. Ne i kufizojmë këto dokumente në fushën e biznesit, menaxhimit dhe kontabilitetit dhe konsiderojmë vetëm këto artikuj, që na lënë vetëm me 404 punime shkencore në total.

2. Rezultatet

Numri i punimeve të botuara nga autorë të një vendi të caktuar është tregues i rëndësishëm për të vlerësuar një fushë studimi (Bilir, Güngör et al. 2020). Në studimin tonë kemi konstatuar se numri i publikimeve nga Shqipëria është në rritje të vazhdueshme, sidomos pas vitit 2014. Duke iu referuar figurës 1, duhet të sqarojmë se rënia në vitin 2023 është për shkak se kemi mbledhur të dhëna në nëntor 2023, duke na lënë edhe 2 muaj deri në fund të vitit pa marrë në studim. Rritja e publikimeve shkencore është një hap pozitiv për Shqipërinë dhe tregon për popullaritetin në rritje të fushës së studimit.




Fig. nr.1 Publikimet shkencore vjetore

Ndërkohë që numri i botimeve është në rritje nga autorët shqiptarë, vërejmë se vetëm katër revista përmbajnë më shumë se 10 botime. Në të vërtetë, këto revista përbëjnë pothuajse 30% të të gjithë publikimeve që mund të konsiderohet një përqindje e lartë që reflekton përqendrim. Përkatësisht *Academic Journal of Interdisciplinary Studies* është më e preferuara nga autorë shqiptarë, me 64 botime, e ndjekur nga *Wseas Transactions on Business and Economics*, *Quality-Access to Success* dhe në fund *Administrative Science* (fig. nr. 2).




Fig. nr. 2 Burimet më të rëndësishme

Ne analizuam gjithashtu autorët, duke i renditur ata sipas publikimeve të artikujve në bazën e të dhënave Scopus. Ne kemi identifikuar vetëm katër autorë, të cilët kanë publikuar 10 ose më shumë artikuj në fushën e menaxhimit

dhe të biznesit. Autori kryesor është Drini Imami me 20 botime. Puna e tij është përqendruar në preferencat e konsumatorëve (Chan-Halbrendt, Zhllima et al. 2010, Skreli and Imami 2012, Imami, Zhllima et al. 2013) dhe ekonominë bujqësore (Skreli and Imami 2012). Eglantina Hysa është një tjetër emër i njohur në komunitetin akademik shqiptar me 10 punime të botuara në Scopus. Puna e saj është e përqendruar në inovacion (Hysa, Kruja et al. 2020) dhe zhvillimin ekonomik (Hysa, Kruja et al. 2020). Edvin Zhllima dhe Gentjan Cera janë autorë të tjerë të cilët plotësojnë listën me punën e tyre të fokusuar përkatësisht në preferencat e konsumatorëve. (Chan-Halbrendt, Zhllima et al. 2010) dhe sipërmarrje (Cera, Mlouk et al. 2020).




Fig. nr. 3 Autorët më të rëndësishëm

Për të pasur një pasqyrë më të mirë të studimeve të menaxhimit dhe biznesit nga autorë shqiptarë, ne analizojmë edhe numrin e botimeve për sa i përket institucioneve. Vërehet se Universiteti i Tiranës është institucioni më i rëndësishëm me 60 punime të botuara. Universiteti Bujqësor i Tiranës renditet i dyti me 53 punime dhe Universiteti “Epoka” renditet i treti dhe është universiteti privat më produktiv në Shqipëri. Ajo që është interesante është se botimet e Universitetit të Tiranës janë shumë të larmishme për sa i përket autorëve, gjë që nuk ndodh në Universitetin Bujqësor të Tiranës ku Imami, Zhllima dhe Cera janë qartësisht që kontribuojnë më shumë dhe Universiteti “Epoka” në të cilin Hysa është autori kryesor.




Fig. nr. 4 : Përkatësitë më të rëndësishme

Gjithashtu identifikua dhe analizuam fjalët më të rëndësishme të përdorura nga autorë shqiptarë. Shqipëria është identifikuar si fjala më e përdorur, gjë që na bën të besojmë se shumica e studimeve janë kontekstuale. Në të njëjtën kohë vërehet dominimi i Tiranës si qytet në Shqipëri ku zhvillohen më së shumti studimet. Vendimmarrja dhe cilësia e shërbimit janë tema të rëndësishme ku përqendrohet kërkimi. Është interesante prania e fjalëve si mashkull dhe femër që tregojnë fokusin në studimet gjinore (figura 5). Ne rekomandojmë studiuesit të përqendrohen në tema si vendimmarrja dhe cilësia e shërbimit.




Fig. nr. 5 : Fjalët më të rëndësishme

Gjithashtu ne kryem analiza shtesë për të identifikuar bashkëpunimet që autorët shqiptarë kanë bërë në punimet e tyre shkencore. Italia është vendi ku shumica e autorëve shqiptarë bashkëpunojnë, gjë që nuk është befasi për shkak të marrëdhënieve të ngushta në shumë fusha, përfshirë arsimin që këto vende

Gjetjet e studimit tonë konfirmojnë një tendencë në rritje të botimit në Scopus nga autorë shqiptarë dhe pas vitit 2016 ky trend është eksponencial, duke treguar një progres të madh të mjedisit akademik në vitet e fundit.

Revista Academic Journal of Interdisciplinary Studies është revista më e preferuar për botim nga autorë shqiptarë në bazën tonë të të dhënave. Pothuajse 10% e punimeve të botuara janë në këtë revistë, ndërsa më shumë se 30% e punimeve janë publikuar në 4 revista. Ne do t'i rekomandonim komunitetit akademik të diversifikojë burimet.

Drini Imami autori më i rëndësishëm në studimin tonë me 20 botime. Ai zë një vend të veçantë në kërkimin e biznesit dhe menaxhimit në Shqipëri dhe është një shembull për t'u promovuar nga institucionet.

Universiteti i Tiranës ka punimet më të botuara krahasuar me universitetet e tjera në Shqipëri, ndërsa universiteti "Epoka" renditet i treti në përgjithësi dhe i pari në universitetet private në Shqipëri.

Përsa i përket fjalëve kyçe më të shpeshta, dalim në përfundimin se Shqipëria është fjala kyçe më e përdorur, duke treguar se shumica e studimeve janë kontekstuale dhe lokale. Prania e Tiranës si një nga fjalët kyçe më të përfaqësuara dëshmon rolin e kryeqytetit në ekonominë shqiptare. Frekuenca e lartë e fjalëve që përshkruajnë gjinitë u gjet interesante në studimin tonë.

Gjithashtu, konstatojmë se Italia është një vend me më shumë botime të përbashkëta me autorë shqiptarë dhe interesant se bashkëpunimet me Serbinë janë më të larta se me Kosovën.

Analiza e bashkëcitimit të autorit tregon se kërkimi në Shqipëri është shumë i fragmentuar në grupe të vogla.

Studimi ynë ka kufizimet e veta. Do të ishte shumë interesante që studiuesit të vlerësonin bazën e të dhënave më të gjerë, jo vetëm Scopus si në rastin tonë. Një dimension tjetër që meriton kërkime të mëtejshme është krahasimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor me njëri-tjetrin. Përveç kësaj, analiza bibliometrike mund të kryhet edhe në fusha të tjera si mjekësia apo teknologjia.

Ne gjithashtu kemi disa rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve të biznesit dhe menaxhimit në Shqipëri. E para dhe më e rëndësishmja është nevoja për të forcuar bashkëpunimin me njëri-tjetrin. Ndoshta një shoqatë e studiuesve të menaxhimit dhe biznesit do të rriste produktin. Për më tepër, unifikimi i agjendës kërkimore dhe prioritizimi i fushave do t'i ndihmojë akademikët të punojnë më shumë së bashku. Është shumë e rëndësishme rritja e studimeve të doktoratës në fushën e Menaxhimit. Vlerësimi i performancës duhet të bazohet në meritokraci dhe shembujt e mirë duhet të promovohen publikisht.

Literatura e shfrytëzuar.

1. Akhavan, P., et al. (2016). "Major trends in knowledge management research: a bibliometric study." *Scientometrics* 107: 1249-1264.
2. Aria, M. and C. Cuccurullo (2017). "bibliometrix: An R-tool for comprehensive science mapping analysis." *Journal of informetrics* 11(4): 959-975.
3. Bilir, C., et al. (2020). "Operations research/management science research in Europe: A bibliometric overview." *Advances in Operations Research* 2020: 1-14.
4. Broadus, R. N. (1987). "Toward a definition of "bibliometrics"." *Scientometrics* 12: 373-379.
5. Cera, G., et al. (2020). "The impact of entrepreneurship education on entrepreneurial intention. A quasi-experimental research design." *Journal of Competitiveness*.
6. Chan-Halbrendt, C., et al. (2010). "Consumer preferences for olive oil in Tirana, Albania." *International Food and Agribusiness Management Review* 13(1030-2016-82871).
7. Donthu, N., et al. (2021). "How to conduct a bibliometric analysis: An overview and guidelines." *Journal of Business Research* 133: 285-296.
8. Dzikowski, P. (2018). "A bibliometric analysis of born global firms." *Journal of Business Research* 85: 281-294.
9. García-Lillo, F., et al. (2017). "Exploring the intellectual structure of research on 'born globals' and INVs: A literature review using bibliometric methods." *Journal of International Entrepreneurship*: 1-29.
10. Guerra Fernandes, J. A., et al. (2022). "Ethnic entrepreneurship: A bibliometric review and future research agenda." *Strategic Change* 31(4): 397-413.
11. Hysa, E., et al. (2020). "Circular economy innovation and environmental sustainability impact on economic growth: An integrated model for sustainable development." *Sustainability* 12(12): 4831.
12. Imami, D., et al. (2013). "Segmenting Albanian consumers according to olive oil quality perception and purchasing habits." *Agricultural Economics Review* 14(389-2016-23484): 97-112.
13. Knight, G. A. and D. Kim (2009). "International business competence and the contemporary firm." *Journal of international business studies* 40: 255-273.

14. Kotler, P. (1993). "The major tasks of marketing management." *Marketing Management* 2(3): 52.
15. Ramos-Rodríguez, A. R. and J. Ruíz-Navarro (2004). "Changes in the intellectual structure of strategic management research: A bibliometric study of the *Strategic Management Journal*, 1980–2000." *Strategic management journal* 25(10): 981-1004.
16. Skreli, E. and D. Imami (2012). "Analyzing consumers' preferences for apple attributes in Tirana, Albania." *International Food and Agribusiness Management Review* 15(1030-2016-82810): 137-157.
17. Stevenson, H. H. and J. C. Jarillo (2007). *A paradigm of entrepreneurship: Entrepreneurial management*. *Entrepreneurship: Concepts, theory and perspective*, Springer: 155-170.
18. Teece, D. J., et al. (1997). "Dynamic capabilities and strategic management." *Strategic management journal* 18(7): 509-533.
19. Van Eck, N. and L. Waltman (2010). "Software survey: VOSviewer, a computer program for bibliometric mapping." *Scientometrics* 84(2): 523-538.
20. Zupic, I. and T. Čater (2015). "Bibliometric methods in management and organization." *Organizational research methods* 18(3): 429-472.

Avioni pa pilot i tipit TB-2 “Bayraktar” në mbështetje të operacioneve në nivel force të bashkuar dhe komponenti (ajror, tokësor, detar)

Nënkolonel Msc. Eduart Pllaha
Forca Ajrore

Trajtesë e shkurtuar.

Avioni pa pilot i tipit TB-2, i cili shumë shpejt do të jetë pjesë e kapaciteteve të Forcës Ajrore të RSH, mund të përdoret për shumë detyra si: p.sh.: Inteligjencë, Vëzhgim dhe Rikonicion (ISR), zbulim, sulm ajror, mbështetje të afërt me zjarr të trupave (CAS), Luftim-Kërkim-Shpëtim (CSAR) etj.

Ky punim ka për qëllim të japë në mënyrë të përgjithshme informacion mbi operacionet që mund të realizojë avioni pa pilot në nivel force të bashkuar (joint) dhe në nivel komponenti, duke marrë në konsideratë veçoritë për realizimin e detyrave në zonën e operacionit për secilin, kundrejt kapaciteteve dhe mundësive që ai ofron, si dhe eksperiencën më të mirë të fituar gjatë konflikteve të fundit në të cilën ka qenë pjesëmarrës. Në nivel Force të Bashkuar do të shohim operacionet ISR (Inteligjencë, Mbikëqyrje dhe Rikonicion), koordinimin, korrigjim dhe drejtimin, shenjëstrimin për artilerinë, luftë elektronike dhe në fund, do të ilustrimet me një shembull sukcesi nga konflikti në Ukrainë si një “Shumëzues Force/Force Multiplayer”, në të cilin ai (avioni pa pilot i tipit TB-2) integroi shumë sisteme zjarri të komponentëve pjesëmarrës drejtpërdrejt ose jo në operacion.

Për të vazhduar në nivel komponenti, me operacionet tipike që realizon komponenti ajror si sulme ajrore, kundër mbrojtjes ajrore të kundërshtarit me bazë në tokë dhe Mbështetje të Afërt Ajrore (CAS). Komponenti tokësor me

aksionet kinetike dhe jokinetike, kërkim dhe shpëtim (SAR)/ Luftim-Kërkim-Shpëtim (CSAR) me bazë në tokë. Ndërsa komponenti i marinës me veçantitë që duhet të përballojnë sensorët e TB2 si, korrozioni i ujit të kripur, lagështia e lartë, etj., do të shikojmë detyrat në mbështetje dhe kryerje të operacioneve nënujëse, kundër mjeteve detare dhe SAR. Çështjet e trajtuara do të shoqërohen me sugjerime se si mund të realizohen me efektivitet dhe efikasitet detyrat e përshkruara, por dhe disa masa që duhen të merren si nevoja për kontrollorë të përparuar ajrorë, koordinatorë të zjarrit apo dhe kodifikim e rregullave për sinkronizim dhe dekonfliktim me mjetet e tjera ajrore dhe me ato të artilerisë.

Fjalët kyçe: TB2, aksion kinetike dhe jokinetik, ISR (inteligjencë, mbikëqyrje, rikonicion) nivel joint, nivel komponenti, SEAD, CAS, sulm ajror.

1. Përshkrim i përgjithshëm i detyrave të avionit pa pilot i tipit TB-2 “Bayraktar”

Avioni pa pilot i tipit TB-2 është avion pa pilot (fig. nr. 1), i cili përfshihet në klasën III¹ (sulmi/strategjik) dhe operohet në fushëbetëje e në teatrin e operacioneve: në nivel operacional dhe strategjik, si dhe bën pjesë në “kategorinë” e shenjëzuar si: MALE “Medium Altitude Long Endurance/ Lartësi Fluturimi të Mesme dhe Kohëzgjatje të Madhe Fluturimi”. Ky UAV është një mjet shumë efektiv dhe i provuar në fushën e luftimit pasi mund të mbajë municione në katër bombë mbajtëset e tij deri në një peshë prej 150 kg dhe fluturon në lartësi maksimale e fluturimit është 8.000 metra me kohëzgjatjen e fluturimit deri në 27 orë, si dhe shpejtësi maksimale 250 km/h. Gjithashtu në bordin e tij janë të instaluar një sërë sensorësh: Elektro-optikë “kamera të cilat prodhojnë imazhe me ngjyra ose bardh e zi në modelin HD”, Laser: “të cilët janë për shenjëstrimin (designator), tregues (pointer) dhe distancë matës (range finder)”. Gjithashtu është i montuar edhe sensori me infra të kuq: “kamera e cila përdor nxehtësinë e lëshuar nga trupat për të prodhuar imazhin”.

Ky UAV mund të kryejë detyra në mbështetje të aksioneve kinetike² dhe jokinetike dhe ushtrimi i tyre me kompetencë dhe profesionalizëm nga kjo teknike me sukses do të sillte dhe ushtrimin e elementëve të Fuqisë Ajrore të cilat janë pjesë e misionit për të ushtruar nga Forca Ajrore. Por më kryesorja do sillte një rritje të shtuar të “efekteve të dëshiruara” nga këto sisteme nga komponentët e tjerë të Forcave të Armatosura në një skenar/konflikt ose

¹ NATO fixed-wing UAS Classification (AEP-4671).

² Oliver Rochford, *Cyberwar: Breaching the Kinetic Barrier*. Burimi elektronik: www.securityweek.com. April 16, 2019. *Aksione kinetike janë veprime/sulme në të cilën përdoret forcë vdekjeprurëse ndaj objektivave gjatë një konflikti të armatosur ndërsa jokinetike janë operacione të cilat përdoren kundër kundërshtarit e nuk përdorin forcë vdekjeprurëse si p.sh. sulme kibernetike, lufta elektronike.*



dhe krize. Gjithashtu përdorimi i tyre në mënyre profesionale dhe agresive (duke zbatuar rregullat e sigurisë dhe të Procedurave Standarde), si dhe eksplorimi i plotë i kapacitetit të tyre si një “Shumëfishues Force” do të sillte një rritje të efektivitetit për të cilin ky sistem ka potencial për të ushtruar. Këto sisteme i përkasin domenit të ajrit dhe janë

kapacitet kryesorë në të cilat Forca Ajrore/FARSH mund të ushtrorë nëpërmjet tyre elementët kryesorë të Fuqisë Ajrore. Përdorimi i plotë i kapaciteteve të tyre në operacione të ndryshme si elementë kryesorë të Fuqisë Ajrore në mbështetje të Aksioneve Kinetike ofron mbështetjen me zjarr, Mbështetje të Afërt Ajrore (CAS), Koordinimin, Korrigjim dhe Drejtimin/Shenjëstrimin për artilerinë dhe atë reaktive, Dëmtim ose Neutralizimin e MKA të kundërshtarit. Në aksione jokinetike si p.sh.: ISTAR (Inteligjencë/Mbikëqyrje/Shenjëstrimin të Objektivave të Sulmit/Zbulim), Repetitor Komunikimi, SAR, etj. Gjithashtu ky sistem ka mundësi të ofrojë pamje ajrore/informacion nga fusha e betejës të cilat ndihmojnë komandantët në nivele të ndryshme atë që quhet “situata e përnjohjes/situational awareness”³ por dhe informacione të tjera rreth pozicionit të trupave, artilerisë, dislokimit të kundërshtarit të cilat mund t’i transmetohen njësisive të tjera për të kryer procesin e shenjëzimit dhe shenjëstrimin të tyre.

TB2 mund të përdoren të integruara për të kryer disa detyra gjatë një misioni, si ato kinetike dhe jokinetike p.sh gjatë një misioni mund të kryejë operacione ISTAR (Inteligjencë/Mbikëqyrje/Shenjëstrim të Objektivave të Sulm/zbulim), si dhe duke qenë i armatosur me bomba inteligjente mund të angazhohet në operacionet e ashtuquajtura SEAD (Suppression of Enemy Air Defences) për të dëmtuar ose neutralizuar MKA të kundërshtarit. Gjithashtu mund të kryejë dhe koordinimin e zjarrit të artilerisë të komponentit tokësor. Pra vendosja e tyre në një formacion të integruar me elementë të tjerë mund të ofrojnë një prezencë domethënëse në fushën e betejës.⁴ Ky sistem nuk duhet të operojë i vetëm në fushën e betejës por i integruar dhe i strukturuar me sisteme të tjera mbështetëse për të rritur eficiencën dhe efektivitetin, kapacitetin dhe mbi të

³ Përnjohje e situatës ajrore (Situation of Awareness) - koncept i cili ka të bëjë me të qenit i vetëdijshëm se çfarë është duke ndodhur në hapësirën ajrore në të cilën do të operojë ky UAV dhe të ofrojë informacion të vlershëm për vendimmarrje në kohë reale.

⁴ J. Paloski, “UAVs need to cooperate with Other Systems. Artillery and Electronic Warfare are Key”, December 24, 2021 “They can be employed for ISTAR (Intelligence, Surveillance, Target Acquisition and Reconnaissance operations, they can augment artillery and rocket unit as we have seen in Syria. They can be deployed in information operations/warfare by providing significant footage of the battlefield. They can be used in SEAD missions too.”

gjitha sigurinë e tij nga armët kundërajrore dhe të luftës elektronike.

1. Detyra në nivel force të bashkuar (*Joint Force*) në operacionet e përbashkëta⁵

Si edhe më sipër, TB-2 është shumë rolësh dhe kryen shumë funksione gjatë realizimit të detyrave dhe për të përshkruar disa nga detyrat që ky mjet realizon në nivel të Force të Bashkuar do e nisim me ISR⁶ (Inteligjencë, vëzhgim dhe rikonicion) dhe në fund të kësaj çështje do japim një rast studimi (shembull) të një operacioni të përbashkët në këtë nivel.

a. Inteligjencë, Mbikëqyrje dhe Rikonicion (ISR): është dhe një nga detyrat primare të TB2 si një funksion i mbështetjes luftarake⁷. Nëpërmjet realizimit të kësaj detyre, i krijon mundësi komandantëve të marrin pamje reale nga terreni i operacionit në të cilin po fluturon. Kjo detyrë realizohet më së miri në sajë të sensorëve elektro-optike dhe infra të kuq (EO/IR) që ka në bord dhe mund të ofrojë pamje të drejtpërdrejta për të punuar mbi ato dhe kthimit e tyre në “produkte inteligjence”. Gjithashtu në sajë të avantazhit të qëndruarit në ajër për një kohë të gjatë mund të kryejë detyrën e *mbikëqyrjes* të objektivit/*objektivave* për t’i dhënë mundësi drejtuesve të operacionit për të qenë të azhurnuar në çdo kohë me situatën në zonën e operacionit. Zbulimi i pozicioneve të kundërshtarit dhe përqendrimet e trupave, mjeteve dhe sistemeve të zbulimit nëpërmjet sensorëve në bord mund të kryhet deri në një distance prej 75 km. Për të realizuar këtë detyrë kërkohet bashkëpunim, koordinim, strukturim i përpjekjeve dhe procedural nëpërmjet një plani të përbashkët operacional dhe procedura standarde (SOP) për të arritur efektin e dëshiruar. Gjithashtu integrimi i koncepteve bashkëkohore si p.sh., “Kill Chain”⁸ që është një metodikë për përdorimin e UAV në operacionet ISR dhe realizohet me sukses për të rritur efektivitetin e tyre, nëpërmjet tre hapave: *hapi I*: Të kuptohet çfarë po ndodh, *hapi II*: Të marrësh vendim se çfarë duhet bërë, *hapi III*: Të realizosh veprime të cilat krijojnë efekte për të arritur objektivat.

Pjesë e kësaj detyre janë dhe ato që mund të kryen në Operacione të Përbashkëta në mbështetje të Emergjencave Civile si p.sh zbulimi, monitorimi i zjarreve, përmbytjeve, etj. Në këto operacione janë pjesëmarrës komponentët e tjerë të FARSH si p.sh në rastin e përmbytjeve për të cilat mund të bëhet ndjekja, monitorimi, verifikimi i nivelit dhe efektet që ka shkaktuar kjo fatkeqësi.

⁵ Operacionet e përbashkëta janë operacione të integruara ku marrin pjesë të paktën dy lloje forcash. Bashkëveprimi ndërmjet llojeve të forcave në një operacion të përbashkët merr përparësi në nivelin strategjik dhe sidomos në atë operativ.

⁶ “*Strategic Concept of Employment for Unmanned Aircraft Systems in NATO*” NATO, JAPCC, 2010, fq 14.

⁷ Doktrina e Forcës Ajrore (DFA-1), Tiranë, 2013, fq-6

⁸ Ch. Brose “*The Kill Chain, Defending America in the Future of High-Tech Warfare*”, USA, 2020

Transmetimi i pamjeve reale për një kohë të gjatë rreth 27 orë është një faktor i rëndësishëm, me qëllim reagimin dhe realizimin e operacioneve ndaj fatkeqësive si nga FARSH por dhe nga emergjencat civile.

b. Koordinim, korrigjim dhe drejtim/shenjëstrim për artilerinë: Pjesë e detyrave në këtë nivel force të bashkuar (apo dhe në operacione të përbashkëta me Forcat e Armatosura të vendeve të tjera) që po shohim janë dhe koordinimi, drejtimi i zjarrit të palëve të treta (Komponentit Detar dhe Tokësor) p.sh artilerisë të tipave dhe kalibrave të ndryshme e cila realizohet nëpërmjet shënjesit me laser dhe më pas këtë shenjëzim e ndjek predha inteligjente për të goditur objektivin. Nëpërmjet këtij koordinimi artileria mund të godasë objektiva në afërsi dhe në thellësi të frontit si komanda



drejtuese, përqendrim të trupave, sisteme artilerie, fortifikime, depo karburanti dhe municionesh etj. Drejtimin e predhave reaktive të precizionit të lartë të lëshuara nga artileria reaktive e tipit *TRLG-230* (fig-2) është një risi e këtij sistemi. Këto predha reaktive të kalibrit 230 mm, janë me rreze veprimi nga 20 deri në 150 km dhe drejtohen drejt objektivit duke ndjekur shenjëzimin laser të kryer nga TB-2. Ky drejtim realizohet duke shenjëzuar/ndriçuar objektivin me laser të montuar në kullën e “TB-2”. Predha reaktive në të cilën janë të instaluar sistemet e drejtimit laser ndjekin këtë shenjëzim duke e kthyer në shenjëstrim e më pas e goditjen e tij⁹. Këto predha reaktive janë të ngjashme me ato të tipit “Himmars” të USA. Ndërsa nëpërmjet sensorëve elektro-optikë dhe infra të kuq (EO/IR) që ka në bord mund të zbulojë pozicionet e kundërshtarit dhe përqendrimet e trupave, mjeteve dhe sistemeve të zbulimit nëpërmjet sensorëve në një distancë të madhe përafërsisht 75 km¹⁰ dhe më pas komanda drejtues e operacionit kalon koordinatat e artilerisë/mortajave për t’i sulmuar ato. Ndërkohë TB-2 ndjek sulmin dhe transmeton në mënyrë direkte efektivitetin e sulmit dhe nga komanda mund të bëhet vlerësimi i sulmit për të mbyllur me sukses.

Për të pasur sukses në operacione të përbashkëta nevojitet krijimi i “Ekipit të Koordinimit të Zjarrit” në Qendrën Operacionale ku drejtohen këto operacione. Ky ekip duhet të përbëhet me efektiv të komponentëve për të koordinuar zjarrin e artilerisë, murtaja, dronë kamikazë, TB2, etj. për të arritur efektin e dëshiruar dhe zvogëluar rrezikun për trupat tona në afërsi të zonës të operacionit.

⁹ Burimi elektronik: <https://www.overtdefense.com/2023/04/26/ukraine-officially-confirms-that-it-has-turkish-laser-guided-trlg-230-missiles/>

¹⁰ S. Mitzer/ J. Oliemans “Baltic Bayraktars Lithuania Eyes Buying TB2 UCAVs”, Oryx, 16, 06.2022

Gjithashtu, ky ekip do të reduktojë shumë kohën e ndërhyrjes, vlerësimin e situatës për të marrë vendim, koordinim dhe më tej për t'u angazhuar për t'i sulmuar sipas rregullave të caktuara. Ky proces do të ndiqte parimin “centralizmin në vendim marrje dhe në kontrollin e tyre” në fazën e planëzimit, dhe “autonomi dhe decentralizim” në zbatimin e operacioneve, zbulimit dhe të ndjekjen e objektivave dinamike (të pa planëzuar) dhe ato të planëzuar (Deliberate Target). Pa harruar dhe rolin e rëndësishëm të cilët kanë efektivat të cilët përcaktojnë objektivat për të sulmuar (Targetier)¹¹ në operacionet e përbashkëta (Joint) por dhe në nivel komponenti. Shenjzuesit/Targetier kanë për synim të sigurojnë se mënyrat dhe burimet janë përdorur në mënyrë efektive dhe efikase, nga vlerësimi dhe planifikimi tek reagimi dhe vlerësimi i efekteve të arritura apo dhe për të rinisur këtë proces përsëri¹².

c. Luftë elektronike: Ngarkesat speciale të luftës elektronike të cilat mund të vendosen në bombë-mbajtëset apo dhe të montuara në bisht të tij¹³ mund të përdoren si komponentë të luftës elektronike për të mbrojtur platformën nga këto sulme, ose për të sulmuar spektrin elektromagnetik të kundërshtarit. Gjithashtu sistemet e komunikimit të avionëve pa pilot të kundërshtarit mund të sulmohen nëpërmjet këtyre aparaturave “payload cyber” të Luftës Kibernetike të montuara në platformat ajrore dhe nëpërmjet tyre sulmohet komunikimi midis stacionit të komunikimit dhe UAV¹⁴. Për të sjellë dhe humbjen e kontrollit të tyre nga qendra e drejtimit në tokë dhe më pas shkatërrimi i tyre.

d. Repetitor komunikimi: Sistemet e transmetimit të TB2 mund të bëhen dhe urë komunikimi midis një mjeti si helikopter/avion por dhe një UAV tjetër (apo dhe TB2) i cili nuk ka komunikim pasi është në një zonë e cila nuk mbulohet nga valët radio. Nëpërmjet kësaj teknike arrihet komunikimi midis drejtimit dhe mjetit i cili nuk ka komunikim duke plotësuar detyrat e caktuara.

e. Luftim-Kërkim-Shpëtim (CSAR): Këto mjetë mund të përdoren për të mbështetur operacionet e luftim-kërkim-shpëtimit gjatë një konflikti. Nëpërmjet sensorëve të cilët kanë në bord, realizojnë ISR dhe si urë komunikimi në të gjithë procesin e rikuperimit¹⁵ midis mjeteve të cilat janë pjesë e këtij operacioni dhe

¹¹ Modele të ngjashme të përdorura brenda NATO-s dhe agjencive të tjera perëndimore të inteligjencës dhe forcave të mbrojtjes përfshijnë “Gjetjen, rregulloni, përfundimi, shfrytëzimi, analizoni, shpërndarja” (F3EAD-Find, fix, finish, exploit, analyse, disseminate) dhe “vendosja, zbuloni, dorëzoni, vlerësoni” (D3A-Decide, detect, deliver, assess).

¹² ADFP 3-60, Targeting, fq 2

¹³ “Mountain Drones: Kyrgyzstan’s Bayraktar TB2s”, ORYX Blog, Tetor, 2022 “Kyrgyzstan’s examples feature a number of improvements over earlier versions of the drone, including a second tail-mounted camera for night operations and an anti-jamming device on top of the fuselage”

¹⁴ Ch. M. Thiessen, B. Hale “Blocking UASs with Bytes, Not Bullets” U.S. Marine Corps, 2022 Vol. 148/9/1,435

¹⁵ “Strategic Concept of Employment for Unmanned Aircraft Systems in NATO” NATO, JAPCC, 2010, fq 14

komandës drejtuese. Sensoret e tij (EO/IR) ofrojnë aftësi të jashtëzakonshme për kërkim-shpëtimin p.sh nëpërmjet realizimit të fotografive me kalimin e kohës mund të shfaqin ndryshime në mjedis duke treguar pozicionin dhe/ose synimet e ekuipazhit ajror të rrëzuar. Ky informacion mund të përdoret nga komandanti për të zhvilluar planin e tij të rimëkëmbjes, si dhe të mbajë të informuar në vazhdimësi forcat e shpëtimit dhe ato politike vendimmarrëse. Këtyre të fundit u nevojiten për të gjykuar implikime më të gjera në aspektin politik. Gjithashtu me municionet e tij TB2 mund të realizojë dhe mbështetjen e afërt me zjarr të personelit që do rikuperohet dhe atyre të përfshirë në operacion që do të kryejnë tërheqjen e të rrëzuarve në tokë duke sulmuar apo penguar mjetet dhe forcat e kundërshtarit. Atësia për të qëndruar në ajër për rreth 25 orë në zonën të operacionit duke vazhduar të kryejë dhe detyra të tjera si i pamë më lart i bën këtë mjet të jenë shumë rolesh dhe shumë të vlefshëm.

2. Një “shumëzues force/ force multiplier” në nivel force të bashkuar (JOINT)

Integrimi tipik¹⁶ i këtij sistemi si një “shumëzues force/ force multiplier¹⁷” me sukses të plotë dhe mund të merret si një shembull për studim është në konfliktin “Ukrainë-Rusi” në muajin maj të 2022 për shkatërrimin e garnizonit rus në ishullin e Gjarprit në Detin e Zi. Në këtë operacion, TB-2 u integrua në nivel operacionale brenda komponentit me sisteme të tjera të forcës ajrore ukrainase, ndërsa në nivel të bashkuar “joint” me asete të Forcës Detare dhe asaj Tokësore. Si parathënie e këtij operacioni ishte fundosja e kryqëzorit rus të quajtur “Moska” në prill 2022 që ishte dhe anija kryesore ruse në Detin e Zi e cila kishte për detyrë mbrojtjen ajrore të mjeteve të tjera detare dhe tokësore përfshirë dhe ishullin e Gjarprit. Operatorët e TB2 bashkëpunuan me operatorët e raketave të baterive bregdetare të tipit “Neptunë” në nivel komponentësh në operacion të përbashkët duke shkëmbyer inteligjencë për gjetjen dhe goditjen e objektivit (Moskovën) me këto të fundit. Gjithashtu sipas shumë brumimeve mendohet se fluturimet e TB2 tërhoqën vigjilencën e operatorëve të kryqëzorit¹⁸ të cilët ndiqnin kursin e fluturimit të tij por ndërkohë raketat u drejtuan drejt tyre. Kjo humbje bëri që Rusia të tërheqë mjetet e tjera detare nga afërsia e ishullit jashtë rrezes së veprimit të raketave bregdetare duke e lënë ishullin të ekspozuar ndaj sulmeve të mundshme dhe në vështirësi furnizimi me kapacitete dhe trupa shtesë nëpërmjet rrugës detare, si dhe një boshllëk në mbrojtjen ajrore të tij. E në ditët në vazhdim TB-2 sulmoi

¹⁶ D. Hambling “*New Turkish Bayraktar Drones Still Seem To Be Reaching Ukraine*”, Forbes, maj, 2022

¹⁷ S. Mitzer/ J. Oliemans “*Baltic Bayraktars-Lithuania Eyes Buying TB2 UCAVs*”, Oryx, 16, 06.2022 “*Integration of reconnaissance drones with these artillery systems would maximise their effect on target; a UCAV thus constitutes something of a force multiplier for several weapons systems...*”

¹⁸ D. Hambling, “*Revista, Forbes,*” 2022

me bomba inteligjente anijet patrulluese të tipit “Raptor” duke i fundosur ato. Ndërsa ajo që theksuam më sipër ishte operacioni i përbashkët, i cili u krye në datë 7 maj në të cilën TB-2 kreu detyra si rikonicion, zbulim nëpërmjet sensorëve elektro-optikë “për prodhim imazhi” të cilat i transmetoi në qendrat e komandim-kontrollit të komponentëve pjesëmarrës por dhe në qendrën kryesore atë të drejtimit të Operacionit të Bashkuar. Nëpërmjet mbajtjes në vëzhgim të objektivave ndihmoi në procesin e zbulimit duke mbledhur të dhëna të drejtpërdrejta mbi gjendjen dhe objektivat në ishull. Ndërsa në qendrën e komandim-kontrollit u morën vendime për të sulmuar këto objektiva me asetet e tjera. Në fillim u sulmuan mjetet detare zbarkuese nga TB-2 me bomba inteligjente duke e nxjerrë jashtë luftimit e më pas ai realizoi detyra të ashtuquajtura SEAD (Suppression of Enemy Air Defences) për të neutralizuar MKA të kundërshtarit pasi goditi dy sisteme kundër ajrore të tipit “Tor”. Angazhimi i fundit i TB-2 kundrejt sistemeve “TOR” realizoi neutralizimin e mbrojtjes ajrore me rreze të mesme të ishullit¹⁹. Më pas komanda drejtoi avionët e tipit Su-27 për të bombarduar ishullin në lartësi të ulët. Ndërkohë TB-2 dërgonte informacione të vazhdueshme (ISR Inteligjencë, Surveillance dhe Reconnaissance) të drejtpërdrejta mbi objektivat dhe mbrojtjen ajrore të ishullit të cilat lejonin pilotët e avionëve Su-27 të kishin një situatë të përnjohjes (situation of awareness) në vazhdimësi të rifreskuar.

Gjatë sulmit të avionëve Su-27, ky UAV dërgoi pamje reale të bombardimit të objektivave nga avioni luftarak në qendrat e komandim-kontrollit nëpërmjet të cilave komandantët bënë vlerësimin e menjëhershëm mbi realizimin e objektivave të sulmit. Ndërkohë ata mund të urdhëronin rikryerjen e detyrës nga avionët nëse nuk ishin goditur ato ose dhe nëse do kishte dhe objektiva të reja për të goditur. Më vonë TB-2 sulmoi me bomba inteligjente një helikopter të tipit Mi-8 të ushtrisë ruse që po zbarkonte trupa në ishull, duke realizuar kështu shkatërrimin e parë të një mjeti ajror nga një avion pa pilot i tipit TB-2. Ndërkohë përveç detyrave të mësipërme ai koordinoi dhe zjarrin e artilerisë vetëlëvizëse të tipit “Bogdan” dhe “Cesar” me kalibër 155 mm të forcave tokësore. Gjithashtu koordinoi dhe mbështeti Forcën Detare e cila mori pjesë me mjete detare zbarkuese me produkte të zbulimit të dërguara nga sensorët e saj Infra të Kuq dhe Elektro-Optike²⁰.

Përdorimi me sukses i TB-2 në këtë operacion “JOINT” në detyra të ndryshme që pamë më lart solli ushtrimin e elementëve të Fuqisë Ajrore por më kryesorja solli një rritje të shtuar të “Efekteve të Dëshiruara” nga këto sisteme të

¹⁹ M. L Khan “*The Crowdfunded Drone War in Ukraine*” National Inters, 25.08.2022

²⁰ Elektro-optikë “kamera të cilat prodhojnë imazhe me ngjyra ose bardh e zi në modelin HD”, Laser: “të cilët janë për shënjestrën (designetor), tregues (pointer) dhe distancë matës (range finder)”. Gjithashtu është i montuar edhe sensori me Infra të Kuq: “kamera e cila përdor nxehtësinë e lëshuar nga trupat për të prodhuar imazhin”.

komponentëve të integruara në një operacion të përbashkët. Gjithashtu përdorimi me sukses dhe në mënyre kompetente dhe agresive të kapaciteteve që ky sistem posedon solli dhe vendosjen e tij në qendër të këtij operacioni duke u kthyer në një “shumëzues force/ force multiplier”.

3. Detyra në nivel komponenti

3.1 Forca Ajrore: Këto sisteme moderne të cilat kanë kapacitet të madh për ushtrimin e elementëve të Fuqisë Ajrore nëpërmjet ushtrimit të operacioneve ajrore (me aksione kinetike dhe jo kinetike) për të arritur “Efektet e Dëshiruara” të planëzuara nga ky komponent në një skenar/konflikt. Ky mjet ka një gamë të gjerë detyrash të cilat mund të kryejë për Forcën Ajrore. Më poshtë do japim tre detyra të cilat janë parësore për Forcën Ajrore për të ushtruar elementët e Fuqisë Ajrore atë të Sulmeve Ajrore (mësymjes dhe mbrojtëse), Shtytjes së Mbrojtëse Ajrore (SEAD)²¹ të kundërshtarit²² dhe Mbështetje të Afërt Ajrore (CAS). Gjithashtu nëpërmjet këtyre operacioneve mund të shohim se këto mjete i ofrojnë Forcës Ajrore të ashtuquajturat “Trupa të Luftimit”.

a. Sulme ajrore: janë operacione ajrore²³ të kryera nga Forca Ajrore në tokë ose në det për të devijuar, ndërprerë, vonuar ose shkatërruar potencialin ushtarak të armikut përpara se ai të mund të përballet në mënyrë efektive kundër forcave miqësore, ose për të arritur objektivat e komandantit të Forcës së Bashkuar (JFC) ose të Forcës Ajrore. Këto operacione mund të jenë sulmuese dhe mbrojtëse²⁴ kenë për qëllim për të goditur objektiva strategjike, operacionale apo dhe taktike. Sipas tematikës së objektivave të përzgjedhura janë dhe tipat e sulmeve ajrore (strategjike, operacionale dhe taktike). Objektivat e sulmeve ajrore mund të jenë të planëzuara (p.sh., objektivat të cilat janë pjesë e fazës së planëzimit “Deliberate Target”²⁵ dhe gjithashtu janë përfshirë në Urdhërin Luftarak Ajror “Air Tasking Order”) por dhe Dinamikë të menjëhershëm²⁶. Këto të fundit janë objektiva të cilat kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme nga komanda drejtuese për të arritur efektin e dëshiruar pasi mund të shfaqin p.sh rrezik për trupat miqësore ose dhe ndikojnë në realizmin e detyrave të caktuara, si dhe nuk kanë qenë përfshirë në fazën e planëzimit dhe daljes së urdhrit. TB2 nëpërmjet kapaciteteve me armatim, si; bomba inteligjente, raketa të pa

²¹ “Strategic Concept of Employment for Unmanned Aircraft Systems in NATO”, JAPCCC, 2010, fq 14

²² “Remotely Piloted Aircraft Systems in Contested Environments” JAPCCC, September 2014, fq 73

²³ Joint Publication 3-09.3, Close Air Support, 21 October 2020, fq 6 dhe ADFP 3-60, fq2

²⁴ Doktrina e Forcës Ajrore (DFA-1), Tiranë, 2013, fq-29-30

²⁵ “US Air Force Doctrine AFDP 3-60, Targeting” 2021, “Deliberate targeting applies when there is sufficient time to include a target in a plan or an air tasking order (ATO)” Fq-3

²⁶ “US Air Force Doctrine Publication 1” 2021 “Dynamic targets are identified too late, or not selected for action in time to be included in deliberate targeting”

drejtuar, raketa ajër-ajër, raketa të tipit Cruiss, etj., mund të kryejë dhe sulme ajrore sipas tematikës të mësipërme në zonën operacioneve. Sulmet Ajrore mund të kryhen në sinkronizim me pjesëmarrësit si: artilerinë, forcat speciale, forcat tokësore etj., por dhe shfrytëzimit të kapaciteteve që ka TB2 pasi me sensorët e tij mund të bëjmë planëzim, sulmin dhe vlerësimin e efektit të arritur ndaj objektivit/objektivave në vazhdimësi gjatë operacionit. Gjithashtu në këtë kategori janë dhe sulmet e tipit mbështetje e afërt ajrore (CAS) të cilat janë sulme ajrore në mbështetje të komponentit tokësor (miqësore) si do e shohim më poshtë. TB2 mund të kryejë dhe detyra për dëmtimin, neutralizimin e MKA të kundërshtarit SEAD (Suppression of Enemy Air Defences). Sulmi ndaj objektivave në thellësi të frontit me rëndësi operacionale apo dhe strategjike mund të kryhen në distanca 10-50-100 km²⁷ në varësi të armatimit që përdor dhe sensorëve në bord. Kjo kategori është shumë e gjerë dhe komplekse dhe më kryesorja e Forcës Ajrore si do e shikojmë më poshtë.

b. Shtytja e mbrojtjes ajrore (SEAD)²⁸: Shtytja (shuarja/ shtypja) e mbrojtjes ajrore të armikut (SEAD/ DEAD) janë veprime ushtarake kundër mbrojtjes ajrore të kundërshtarit me bazë në tokë, të cilat përfshijnë raketat tokë-ajër, artilerinë kundërajrore dhe sisteme të ndërlidhura si radarët e paralajmërimit të hershëm, funksionet e komandim, kontrollit dhe komunikimit (C3), si dhe objektiva të tjerë që do të shkatërrohen nga një sulm ajror. Dëmtimi i mbrojtjes ajrore të kundërshtarit ka për qëllim krijimin e një ambienti operacional të kontestueshëm dhe më pas të kontrolluar, për të ushtruar fuqinë ajrore për të arritur efektin e dëshiruar, si dhe për të zvogëluar kërcënimet ndaj këtyre sistemeve. TB-2 janë mjete luftarake të provuara dhe të besueshme, në shumë fushëbeteja nga Afrika e Veriut deri në Kaukaz. Sulmet kundrejt këtyre kërcënime moderne kundërajrore si p.sh SA-15 “Tor”, Kub M2, Pantsir-S1, S-300, HQ-22 ishin të suksesshme. Madje këto sisteme ishin të shtresëzuara dhe të integruara dhe me sistemet e luftës elektronike. Objektivat e operacioneve SEAD mund të sulmohen nëpërmjet armatimit të cilat TB-2 mund të mbajë në bord si bomba inteligjente të drejtuar me lazer, raketa ajër-tokë, raketa të tipit “Cruiss” por dhe nëpërmjet koordinimit dhe drejtimit të artilerisë, mortajat, artilerinë reaktive të Komponentit Tokësor. Rëndësia e realizimit të këtyre operacioneve qëndron se nëpërmjet dëmtimit ose neutralizimit të MKA së kundërshtarit do sillte një hapësirë më të madhe të kontrollit të hapësirës ajrore në zonën e operacionit dhe rrjedhimisht realizimin e detyrave të tjera nga komponentët e tjerë të FA. Moslejimi për të pasur qasje, apo kontroll të hapësirës ajrore të zonës së operacionit ndaj kundërshtarit është parësore dhe kjo gjë është bërë e dukshme në luftën në Ukrainë në të cilën fuqia ajrore e

²⁷ “Bayraktar Kemankes intelligent mini cruise missile” International Defence Analysis, 23.04.2023

²⁸ “Joint Air Power Following the 2016 Warsaw Summit-Urgent Priorities”, JAPCCC

Federatës Ruse nuk rezultoi efektive për të krijuar një superioritet ajror²⁹ në hapësirën ajrore të Ukrainës nëpërmjet dëmtimit të mbrojtjes ajrore të saj. E kjo gjë rezultoi në humbjen e shumë mjeteve ajrore, tokësore, detare të Forcave të Armatosura Ruse dhe më e rëndësishmja ishte mosrealizimi i objektivave të cilat kishte Federata Ruse në këtë konflikt pasi nuk arriti të kontrollonte dhe të vendoste superioritet ajror. Avionët pa pilot luajnë një rol të rëndësishëm pasi zvogëlojnë rrezikun e efektivave (pilotëve) të avionëve apo dhe helikopterëve të cilët do të kryejnë detyrën për shuarjen e MKA të kundërshtarit. Ndërsa më TB2 realizohen këto detyra më kosto zero njerëzore dhe me efektivitet të lartë pasi ka një gamë të gjerë armatimi si e pamë më lart.

Gjithashtu bashkëpunimi, planëzimi dhe koordinimi, e më pas ekzekutimi i operacioneve të përbashkëta me sisteme të luftës elektronike si ai i tipit Koral të cilat janë të prodhuara nga kompania turke “Alsosan” dhe sinkronizohen shumë mirë së bashku. Këto sisteme mbështetëse realizojnë verbimin e radarëve të zbulimit dhe të drejtimit të MKA-së të kundërshtarit duke sjellë rrjedhimisht rritjen e efektivitetit të TB-2 ndaj objektivave të përcaktuara nga planëzuesit ushtarakë, si dhe arritjen e “efektit të dëshiruar” në fushën e betejës. Bashkëpunimi dhe koordinimi për kryerjen e operacioneve së bashku me sistemet e Luftës Elektronike për të goditur spektrin elektromagnetik të kundërshtarit është shumë i rëndësishëm pasi nëpërmjet këtij bashkëpunimi dhe posedimit të sistemeve Koral do krijonte që këto sisteme të bëheshin Shumëfishues Force/ “Force Multiplayer”. TB2 ka mundësi dhe kapacitete për të kryer me sukses këtë detyrë në bashkëpunim dhe sinkronizim me sisteme të tjera në një ambient operacional të kontestueshëm dhe më pas për ta kontrolluar atë përkohësisht ose plotësisht për të ushtruar fuqinë ajrore me qëllim arritjen e efektit të dëshiruar ndaj mbrojtjes kundërajrore të kundërshtarit.

c. Mbështetja e Afërt Ajrore (CAS Close Air Support)³⁰: përkufizohet si *veprime ajrore të mjeteve ajrore me krah fiks dhe jo krah fiks* ³¹ kundër objektivave armiqësore që janë në afërsi të forcave miqësore dhe që kërkojnë integrim të detajuar të çdo misioni ajror me zjarrin dhe lëvizjen e forcave (miqësorë)³². Këto misione mund të jenë të pa-planëzuara dhe të planëzuara dhe realizohen nga komponenti ajror në mbështetje të komponentit tokësor. Ndryshimi midis tyre qëndron se këto të fundit janë pjesë e planit operacionale ajror të miratuar nga komanda përgjegjëse dhe kanë produkte të inteligjencës rreth objektivave. Ndërsa ato të pa planëzuara janë të menjëhershme dhe

²⁹ J. Bronk, N. Reynolds, J. Watling “The Russian Air War and Ukrainian Requirements for Air Defence” RUSI, fq-37

³⁰ Doktrina e Forcës Ajrore (DFA-1), Tiranë, 2013, fq-33.

³¹ Ltc O, Aksu “Close Air Support Command and Control Digitally Enhanced CAS Operations”, JAPCC, Vol-34, 2022.

³² Joint Publication 3-09.3 “Close Air Support”, 21 October 2020.


kërkojnë ndërhyrjen e mjeteve ajrore për të goditur objektiva të kundërshtarit në afërsi të frontit. TB-2 (dhe jo vetëm ai) mund të sigurojë zjarr mbështes në operacionet sulmuese dhe mbrojtëse për të shkatërruar, dëmtuar, shtytur objektivat në operacion dhe rrjedhimisht krijimin e efekteve të dëshiruara nëpërmjet forcave në tokë. Gjatë realizimit të detyrës të sulmit të afërt (CAS), TB2 mund të transmetojë dhe pamje të drejtpërdrejta në komandën e operacionit për të vlerësuar nivelin e rrezikut në zonën e operacionit, vlerësimin e dëmeve të kryera (nga TB2 ose tjetër sistem zjarri) dhe më pas korrigjimin e zjarrit e për të marrë masa shtesë, apo dhe për tu përgjigjur situatave të krijuara të cilat kërkojnë reagim të menjëhershëm dhe dinamik. Gjithashtu u jep mundësi komandës të marrin vendime të shpejta dhe në kohë reale në sajë të sensorëve të cilat transmetojnë pamjen ajrore nga operacioni në qendrën e operacioneve. Mbështetja e Afërt Ajrore është një nga detyrat parësore të FA-s për t'u realizuar në operacionet e përbashkëta me komponentët e tjerë. Koordinimi me pjesëmarrësit është gjithashtu shumë i rëndësishëm pasi në sajë të tij arrihen objektivat e misionit në një kohë të shpejtë dhe efektive, si dhe ofrojnë siguri për trupat (në tokë) pjesëmarrëse në operacion por dhe të mjeteve ajrore të cilat realizojnë sulmin. Ky sinkronizim për CAS të planëzuar mund të realizohet në kohë, nëpërmjet planit të përbashkët operacionale dhe në hapësirë nëpërmjet krijimit të korridoreve ajrore për operimin e tyre. Gjithashtu dekonfliktim në lartësi me mjetet e tjera ajrore (avionë, helikopterë dhe UAV të komponentëve të tjerë). Për rastet e “CAS të pa planëzuar” të cilët thirren me urgjencë për mbështetjen e trupave do kemi dekonfliktim në lartësi dhe në hapësirë por dhe në kohë për të përcaktuar mbërritjen në pikën futjes³³ e më pas realizimit të detyrës. Avionë pa Pilot në afërsi dhe në front do të kenë dhe komponentë të tjerë të cilët kryejnë detyra në nivel taktik³⁴. Koordinimi midis TB2 të FA-s të cilët kryejnë detyra në nivel operacional dhe të UAV e tjerëve (nivel taktik) kërkon një bashkërendim dhe bashkëpunim, së pari për të ditur dhe shmangur rrezikun e përplasjes me UAV të tjerë. Së dyti, për të shmangur goditjen nga zjarri miqësor i MKA duke njohur korridoret e hyrjes dhe daljes nga zona e operacionit. Së treti, ekonomizimi i përdorimit të UAV duke shkëmbyer pamjen ajrore nëpërmjet sinkronizimit midis pjesëmarrësve për një situatë më të mirë të përnjohjes/(situational awareness) të zonës të operacionit. Për të realizuar funksionet e mësipërme një rol të rëndësishëm kryejnë skuadra/njësia e Kontrollorëve të Përparuar Ajror³⁵ në terren të cilët janë të vendosur në afërsi të vijës së frontit, pilotët e UAV, si dhe struktura e komandim-kontrollit të Forcës Ajrore dhe pjesëmarrësve në operacion. Kjo

³³ Doktrina e Forcës Ajrore (DFA-1), Tiranë, 2013, fq-34.

³⁴ Joint Publication 3-09.3 “Close Air Support”, 21 October 2020 fq 31.

³⁵ NATO Standard ATP-3.3.2.1 “Tactics, Techniques and Procedures for Close Air Support and Air Interdiction”2019.

gjë mund të arrihet nëpërmjet komunikimit me radio ose mënyra të tjera midis tyre, urdhrat operacional dhe atyre koordinues, si dhe procedurave standarde



të përbashkëta. Detyrat kryesore të Kontrollorëve të Përparuar Ajror janë identifikimi i forcave miqësore, lokalizimi i pozicioneve të armikut³⁶, të reduktojë gabimin njerëzor, të ndajë informacionin rreth objektivit/objektivave në kohë reale midis pjesëmarrësve në operacion CAS³⁷ dhe operatorëve të TB2. Po ashtu ata mund të shenjëzojnë me aparaturat e tyre të ndriçimit me lazer objektivat dhe më pas pilotët e TB2 e kthejnë këtë shenjëzim në shënjestrim për ta sulmuar me bombat inteligjente që ka në bord ky UAV. Gjithashtu të koordinojë edhe me njësi të tjera që ofrojnë mbështetje me zjarr si artileria, mortajat, artileria reaktive gjatë operacionit dhe situatave që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme nëpërmjet ekipit të Koordinimit të Zjarrit të cilët janë në qendrën operationale të operacionit, si e pamë më sipër. Theksojmë se koordinimi midis tyre (trupat në zonën e operacionit, kontrollorëve të përparuar, pilotëve të UAV, si dhe Koordinatorët e Zjarrit) është organizuar dhe strukturuar në planin operacional të përbashkët dhe atë të zjarrit midis komponentëve.

3.2 Komponenti tokësor³⁸; TB-2 ka mundësi dhe kapacitete për të mbështetur operacionet e Komponentit Tokësor dhe kryesisht është në përputhje me ato që cituam më sipër por edhe disa të veçanta. Gjithashtu duhet theksuar se TB-2 është i ndërveprueshëm edhe me sisteme të tjera të dronëve të cilat i posedon Forca Tokësore si p.sh Raven. Të dy këta UAV kanë karakteristika dhe detyra

³⁶ Doktrina e Forcës Ajrore (DFA-1), Tiranë, 2013, fq-35
³⁷ “NATO Concept of Employment (Conemp) Digitally Aided Close Air Support (DACAS)” NATO NCIA, Ver 1.5.4,2021.
³⁸ “Strategic Concept of Employment for Unmanned Aircraft Systems in NATO” JAPCC, 2010, fq 15

të ndryshme në nivel operacional dhe mund të përdoren të integruara apo dhe në detyra të veçanta në operacionet JOINT të FARSH.

Operacionet e përbashkëta të UAV me komponentin tokësor janë më të komplikuar dhe kërkojnë bashkëpunim midis ofruesve të aseteve (Forca Ajrore) dhe përdoruesve (Forca Tokësore). Bashkëpunimi me Komponentin Tokësor ka dhe sfida për t'u përballuar dhe për t'u dhënë zgjidhje të strukturuar dhe të mirë-planëzuar si p, sh në operacionet në mjedisin urban, apo dhe koordinimi i zjarrit në operacionet e përbashkëta etj.³⁹. Kjo e fundit kërkon bashkëpunim për krijimin e ekipit të Koordinimit të Zjarrit e cila do të ekzekutojë operacionet e përbashkëta për ofruar zjarrin e të dy komponentëve në kohë, hapësirë dhe të sinkronizuar, si dhe siguri e efektivitet. Realizimi i objektivave të caktuara nga komanda e operacionit të përbashkët për të sulmuar do të jenë të Planëzuara (objektiva të cilat janë vlerësuar të rëndësishme për t'u sulmuar dhe për këtë janë përgatitur plane), si dhe objektiva të pa planëzuara të cilat kërkojnë ndërhyrje të Menjëhershme (DT/TST-Dinamic Target and Time Sensitive Target)⁴⁰. Ky ekip do të jetë i organizuar dhe i trajnuar për të ofruar oficerë koordinatorë në Nivel të Bashkuar, në nivel komponenti në Forcën Ajrore me njësitë e saj, si dhe asaj Tokësore (brigada, regjiment, batalion ...). Kjo skuadër do të këtë mjet pune Planin e Zjarrit (të njësisive), Listën e Prioriteteve të Objektivave, si dhe procedurat e sinkronizimit për të ndjekur, raportuar dhe marrë vendim nga Komanda e Operacionit për objektiva të cilat kërkojnë ndërhyrje të Menjëhershme (DT/TST Dinamic Target and Time Synsetive Target), si dhe atyre të pa lëvizshme (Deliberate target). Më poshtë do të shohim disa operacione në mbështetje të komponentit tokësor.

Mbështetje dhe kryerje të aksioneve kinetike dhe jokinete⁴¹: TB2 mund të mbështesë operacionet kundër mjeteve të blinduara, vijave të furnizimit, fortifikatave, kapaciteteve njerëzore të kundërshtarit e tej, përmes përdorimit të bombave inteligjente të drejtuara me laser (familja e quajtur MAM me MAM-C dhe MAM-L, të cilat janë me peshë të vogël), raketa kundërtanke, raketa të drejtuara me laser. Bombat dhe raketat ofrojnë mbështetje ajrore nëpërmjet sulmit ajror me precizon të lartë në lartësi të ulëta dhe të mesme të operimit të tyre ndaj objektivave. Për këto operacione është e rëndësishme dhe prezenca e *Kontrollorëve të Përparuar Ajror* të cilët mund të kontrollojnë dhe/ose të koordinojnë sulmin e municioneve në këtë mjedis. Këta të fundit së

³⁹ OF-4 Sarah Fortin, OF-4 Pasquale Masone "Air-Land Integration-Bridging the Gaps in Joint with Force Education and Training Practical Solutions for Air-Land Interoperability in NATO" JAPCC, Journal Edition, 2021

⁴⁰ Joint Publication 3-09 "Joint Fire Support", 10 April 2019, fq 78

⁴¹ Kol B. Mignot "Non-Kinetic Operations: Information Operations, Air Force Style" Air Power Review, UK, Centre for air and space power studies, Vell-15, 2023

bashku me TB-2 mund të realizojnë mbështetjen e afërt me zjarr(CAS) të trupave në fushën e luftimit duke realizuar sulme me precizion të lartë dhe afër vijës së frontit, si dhe duke koordinuar me Ekipin e Zjarrit të përbashkët për të cilin e folëm më sipër. Në aspektin e *operacioneve jo-kinetike* mund të citojmë p.sh mbështetja me pamje ajrore të drejtpërdrejta për njësinë e CIMIC, realizimin e Luftës Elektronike nëpërmjet aparaturave në bordin e UAV, ndjekja e objektivave të cilat nevojiten të identifikohen dhe të shenjëzohen si potencialisht të rrezikshme e më pas të sulmohen. E për këto operacione ndikojnë shumë aparaturat, sensorët e tipit elektro-optikë, infra të kuq, lazer të cilat mund të kryejnë detyrën dhe në kushte jo të mira të motit.

Kërkim dhe Shpëtim (SAR)/ Luftim-Kërkim-Shpëtim (CSAR) në tokë: Këto mjete mund të përdoren për të mbështetur operacionet e Kërkim-Shpëtimit (SAR) në tokë, nëpërmjet sensorëve të cilët kanë në bord realizojnë ISR (Inteligjencës, Mbikëqyrjes dhe Rikonicion). Në ndihmë të mjeteve të cilat kanë probleme apo janë në kushte të jashtëzakonshme si p.sh në aksidente, fatkeqësi natyrore etj. Gjithashtu për të mbështetur rikuperimin e efektivave të ndodhur pas vijave të frontit p.sh., pilotët e rrëzuar pas dëmtimit të mjetit ajror, apo dhe mbështetje për tërheqjen e efektivave të plagosur të forcave speciale të cilët kryejnë operacione në thellësi të frontit. Nëpërmjet sensorëve ata mund të transmetojnë pamje drejtpërdrejt në qendrat e drejtimit të operacionit si dhe t'u japin mundësi drejtuesve për të marrë vendime të shpejta dhe të sakta.

3.3 Marina⁴². Si fillim duhet të themi se mjedisi në fushën detare të cilin do të operojë TB-2 ndryshon nga ai i mjedisit mbitokësor. Ky mjedis ofron sfida për ngarkesën dhe sensorët si nga gjendja e detit, korrozioni i ujit të kripur, lagështia e lartë, hapësira e madhe detare në të cilën duhet të operojë ndërkohë do t'i kërkohet të mbështesë platformat detare(anijet) me produkte të zbulimit (pamje ajrore) por dhe të kryejë detyra kinetike me armatimin të cilin e ka në bord. Përdormi i municioneve ndaj objektivave detare ka dhe kjo vështirësitë e veta ndaj sensorëve të cilët realizojnë shënjestrim me lazer dhe më pas atë shënjestrim do e ndjekin municionet inteligjente. Gjithashtu në aspektin taktik operatorët duhet të jenë në gjendje të kryejë ngjitje dhe zbritje të shpejtë të nivelit të fluturimit për të realizuar detyrën e caktuar, si dhe për të shmangur motin e pafavorshëm. Prandaj sensorët e tij kërkojnë kushte dhe procedura standarde të ndryshme nga ato mbi tokë për të operuar.

a. Mbështetje dhe kryerje të operacioneve nënujës: TB2 mund të mbështesë operacionet kundër nëndetësive dhe kundër minave përmes përdorimit të radarëve të tipit SAR⁴³ (Synthetic Operature Radar) dhe Multi

⁴² "Strategic Concept of Employment for Unmanned Aircraft Systems in NATO" JAPCC, 2010, f. 15

⁴³<https://www.airbornedrones.co/detecting-humans-sar>/<https://www.airbornedrones.co/detecting-humans-sar/>

mode AESA radar⁴⁴, si dhe sensorëve të tipit EO, IR, Laser të vendosura në kullën e tipit “Wscam MX-15D”⁴⁵ për të zbuluar dhe klasifikuar mjetet ujore (p.sh. nëndetëset) të kundërshtarëve dhe mjeteve nënujorë shpërthyes (p.sh mina).

b. Mbështetje dhe kryerje të Operacioneve kundër mjeteve detare në sipërfaqe: TB2 mund të bëhet pjesë e operacioneve kinetike dhe jo kinetike kundër mjeteve detare të cilat operojnë në sipërfaqe si në operacione të Komponentit Detar por dhe në operacione të përbashkëta të organizuara dhe drejtuara nga ky komponent. Nëpërmjet këtyre operacioneve synohet edhe për t’i mohuar kundërshtarit përdorimin e detit në një zonë të caktuar apo dhe për t’i penguar dhe prishur aktivitetin e mjeteve në hapësirën detare të caktuar si pjesë e zonës operacionale. Sensorët e tij mund të përdoren për zbulimin dhe klasifikimin e aktiviteteve të mundshme kundërshtarë në zonën e operacionit. Gjithashtu në mbështetje të operacione si ato kundër piraterisë, ushtrimit të ligjshmërisë në det etj.

c. Sulme ajrore: Në këtë aspekt TB2 mund të realizojë detyra kinetike nëpërmjet armatimeve të ndryshme të cilat montohen në bordin e tij duke sulmuar objektiva detare në të njëjtën mënyrë si në misionet mbi tokë. Për këto do të sjellim shembuj nga konflikti në Detin e Zi midis Ukrainës dhe Rusisë ku TB-2 sulmoi me bomba inteligjente anijet sulmuese dhe zbarkuese të tipit “Raptor”⁴⁶ fig. 4, si dhe zbarkuese të tipit “Serna”⁴⁷ duke i fundosur ato. Gjithashtu gjatë vitit 2023, TB-2 sulmoi dhe shkatërroi mjete detare të tjera në deltën e lumit Dnieper.



d. Kërkim dhe Shpëtim (SAR) në det: Këto mjete mund të përdoren për të mbështetur operacionet e Kërkim-Shpëtimit (SAR) në det dhe nëpërmjet sensorëve të cilët kanë në bord realizojnë ISR (Inteligjencë, Mbikëqyrje dhe Rikonicion) të njëjta si në tokë. Në ndihmë të anijeve të cilat kanë probleme apo dhe të cilat janë në kushte të jashtëzakonshme si p.sh në flakë apo janë

⁴⁴ https://en.wikipedia.org/wiki/Active_electronically_scanned_array

⁴⁵ <https://en.wikipedia.org/wiki/Wscam>

⁴⁶ <https://www.thedrive.com/the-war-zone/ukraine-claims-tb2-drones-sunk-russian-patrol-boats-off-snake-island>

⁴⁷ R. Hannah, “Ukrainian drone destroys Russian patrol ships off Snake Island, says defense ministry”. CNN.2022

duke u mbytur etj. Gjithashtu monitorimi i tyre për një kohë të gjatë dhe transmetim të pamjes ajrore në Qendrën e Drejtimit të Operacionit.

e. Në mbështetje të emergjencave civile dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese: Në këto operacione është pjesëmarrëse dhe Komponenti detar si p.sh në rastin e përmbytjeve për të cilat bëhet verifikimi i nivelit dhe efektet që ka shkaktuar kjo fatkeqësi. Gjithashtu në mbështetje të Policisë Kufitare për zbatimin e ligjshmërisë në det etj. Në mbështetje të institucioneve studimore në lidhje me detin apo për peshkimin nga Ministria e Bujqësisë etj.

Literatura e shfrytëzuar.

- 1) Oliver Rochford “Cyberwar: Breaching the Kinetic Barrier” SecurityWeek. Com”, April 16, 2019.
- 2) J. Paloski “UAVs need to Cooperate with Other Systems. Artillery and Electronic Warfare are Key” Defence24, 2021.
- 3) “Strategic Concept of Employment for Unmanned Aircraft Systems in NATO” NATO Joint Air Power Competence Centre (JAPCC), 2010.
- 4) Joint Publication 3-09.3, Close Air Support, 21 October 2020.
- 5) Mark Pomerleau “How Army leaders envision non-kinetic capabilities enabling traditional forces” September 19, 2023.
- 6) “Bayraktar Kemankes intelligent mini cruise missile” International Defence Analysis, 23.04.2023.
- 7) S. Mitzer/ J. Oliemans “Baltic Bayraktars-Lithuania Eyes Buying TB2 UCAVs”, Oryx Blog, 16, 06.2022.
- 8) Mountain Drones: Kyrgyzstan’s Bayraktar TB2s. Oryx Blog, Tetor, 2022.
- 9) Ch. M. Thiessen-B. Hale “Blocking UASs with Bytes, Not Bullets” U.S. Marine Corps, 2022 Vol. 148/9/1,435.
- 10) New Turkish Bayraktar Drones Still Seem To Be Reaching Ukraine”, Forbes, Maj, 2022.
- 11) S. Mitzer/ J. Oliemans “Baltic Bayraktars-Lithuania Eyes Buying TB2 UCAVs”, Oryx Blog, 16, 06.2022.
- 12) Hambling, David, Revista, Forbes, 2022.
- 13) M. L Khan “*The Crowdfunded Drone War in Ukraine*” National Inters, 25.08.2022
- 14) Ritchie, Hannah, “Ukrainian drone destroys Russian patrol ships off

- Snake Island, says defense ministry”. CNN. 05.2022
- 15) OF-4 Sarah Fortin, OF-4 Pasquale Masone “Air-Land Integration– Bridging the Gaps in Joint with Force Education and Training Practical Solutions for Air-Land Interoperability in NATO” JAPCC, Journal Edition, 2021.
 - 16) Joint Publication 3-09 “Joint Fire Support”, 10 April 2019.
 - 17) Colonel Bruno Mignot “Non-Kinetic Operations: Information Operations, Air Force Style” Air Power Review, UK, Centre for air and space power studies, Vell-15, 2023.
 - 18) “Remotely Piloted Aircraft Systems in Contested Environments” JAPCCC, September 2014.
 - 19) “Joint Air Power Following the 2016 Warsaw Summit–Urgent Priorities”, Joint Air Power Competence Centre.
 - 20) J. Bronk, N. Reynolds, J. Watling “The Russian Air War and Ukrainian Requirements for Air Defence”, RUSI-Royal United Services Institute for Defence and Security Studies, 2022
 - 21) Ltc Osman Aksu “Close Air Support Command and Control Digitally Enhanced CAS Operations”, JAPCC, Volume 34, 2022
 - 22) NATO Standard ATP-3.3.2.1 “Tactics, Techniques and Procedures for Close Air Support and Air Interdiction” 2019
 - 23) NATO Concept of Employment (CONEMP) Digitally Aided Close Air Support (DACAS)’, NATO Communication and Information Agency, Version 1.5, 4 May 2021
 - 24) STANAG 4671 ”UAV System Airworthiness Requirements”
 - 25) US Air Force Doctrine AFDP 3-60, “Targeting” 2021
 - 26) Christian Brose “The Kill Chain, Defending America in the Future of High-Tech Warfare”, USA, 2020.
 - 27) NATO fixed-wing UAS Classification (AEP-4671)
 - 28) Doktrina e Forcës Ajrore (DFA-1), Tiranë, 2013
 - 29) <https://www.overtdefense.com/2023/04/26/ukraine-officially-confirms-that-it-has-turkish-laser-guided-trlg-230-missiles/>
 - 30) <https://www.airbornedrones.co/detecting-humans-sar/>
 - 31) 5. <https://www.thedrive.com/the-war-zone/ukraine-claims-tb2-drones-sunk-russian-patrol-boats-off-snake-island>

RUBRIKA E KATËRT

STUDIME HISTORIKE

Aleanca ushtarake e Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë

Kolonel (R) Dr. Ahmet Leka
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Siguria, integriteti dhe fuqizimi i vendit garantohet kur përmbushet me efektivitet mbrojtja e interesave dhe vlerave kombëtare në shtrirje kohore dhe në vështrimin perspektiv. Historia e një populli, prejardhja, pozita gjeostrategjike, kultura, gjuha, tradita, veçoritë kombëtare, predispozita e tij për të qenë një faktor i rëndësishëm në rajon, janë elemente për të treguar sa i rëndësishëm është një vend në arenën ndërkombëtare dhe rolin që mund të luajë ai në familjen e madhe të popujve të qytetëruar dhe përparimtarë.

Paslufta e Dytë Botërore e gjeti Shqipërinë një vend të brishtë nga të gjitha drejtimet, si në pikëpamjen ekonomike, politike ashtu edhe në atë strategjike - ushtarake. Shqipëria ishte thjesht një vend i vogël, me ekonomi krejt të prapambetur, pa kurrfarë infrastrukture dhe, si i tillë, aspak joshës. Udhëheqja e shtetit e shihte si domosdoshmëri njohjen e Shqipërisë nga blloku komunist.

Pavarësisht nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike Shqipëri - BS, lidhjet e Moskës me Tiranën, deri më 1948, realizoheshin vetëm nëpërmjet Beogradit. Ky ishte një nga faktorët që intensifikuan rritjen e ndikimit jugosllav në Shqipëri. Në atë kohë, vendi ynë kishte probleme të theksuara në lidhje me marrëdhëniet me vendet fqinje. "Miqësia" me Jugosllavinë kishte filluar të merrte një thyerje të madhe. Ndërsa forcat guerile greke shfaqeshin rrezikshëm

në kufirin me Shqipërinë, duke provokuar shpesh incidente. Kështu, vendi ynë ndodhej në “zjarrin” e pashpërthyer të fqinjëve të saj. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja në një koalicion të tillë si, Traktati i Varshavës, e bënte Shqipërinë që të ishte më e mbrojtur.

Fjalët kyçe: Traktati i Varshavës, marrëdhënie diplomatike, konflikt, Bashkimi Sovjetik, Shqipëri,

1. Konferenca e Jaltës dhe Shqipëria

Para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në shkurt 1945 në Jalta të Krimesë u zhvillua takimi mes presidentit të SHBA-ve, Ruzvelti¹, udhëheqësit të Bashkimit Sovjetik, Stalini² dhe Kryeministrit të Anglisë, Çerçilli³. Në këtë konferencë, këta tre burra shtetesh diskutuan për rrjedhën e mëtejshme të luftës. Para se të gjithash, ata vërtetuan vendimin e bërë në Teheran për ndarjen e Gjermanisë dhe Polonisë si dhe ndarjen e sferave të ndikimit mbas përfundimit të luftës.

Në konferencën e Jaltës nuk kishte rend dhe pika të ditës të rregulluara. Asnjë pikë diskutimi nuk ishte e përgatitur dhe asnjë pyetje nuk ishte shqyrtuar si duhet. Si pikë kryesore diskutimi ishte kapitullimi i Gjermanisë. Ata vendosën ta mposhtnin nazizmin dhe fashizmin, duke dhënë një kontribut për të siguruar fitoren e “demokracisë”. Më në fund, Çerçilli arriti të miratonte që Perandoria Gjermane të zaptohej dhe futej nën administrimin e fuqive fituese. Principi për ndarjen e Gjermanisë në katër zona u vërtetua në Jaltë.

Debatet për Poloninë morën një kohë të madhe në konferencë. Bashkimit Sovjetik iu premtua pjesa lindore e Polonisë, deri në vijën Kurson. Polonia duhej të kompensohej me pjesën gjermane Oder-Niesen. Me këtë Polonia u bë shtet satelit i Moskës dhe shërbente si mbrojtës kundër Perëndimit. Në këtë kohë, Bashkimi Sovjetik kishte pushtuar një pjesë të madhe të shteteve Lindore, por edhe të Ballkanit. Në këtë mënyrë ishin me qindra milionë evropianë të shpërndarë në Perandorinë Sovjetike. Vendet të tilla si: Polonia, Çekosllovakia, Hungaria, Rumania, Bullgaria dhe Jugosllavia dhe pjesa lindore e Gjermanisë, u çliruan nga Ushtria e Kuqe, ndërsa Shqipëria u çlirua

¹ Franklin Delano Roosevelt (30 janar 1882-12 prill 1945) ishte President i SHBA-ve prej vitit 1933 deri në vitin 1945. Ai hartoi një program të qartë reformash për të nxjerrë vendin nga kriza.

² Jozef ose Josif Visarionoviç Stalin (18 dhjetor 1878 - 5 mars 1953), mbiemri lindjes Xhugashvilli, ishte udhëheqës i Bashkimit Sovjetik nga mesi i viteve 1920 deri në vdekjen e tij në vitin 1953. Ai doli fitimtar në Luftën e Dytë Botërore.

³ Sir Winston Leonard Spencer Churchill (30 nëntor 1874 - 24 janar 1965) ishte burrë shteti, politikan, diplomat, ushtar dhe shkrimtar britanik, i cili shërbeu dy herë si Kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar, nga viti 1940 deri në vitin 1945 gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe përsëri nga viti 1951 deri në vitin 1955.

nga ushtria Nacionalçlirimtare, natyrisht pasi forcat aleate, si nga Lindja, ashtu edhe nga Perëndimi po i jepnin goditjen përfundimtare Gjermanisë naziste. Ndryshe, pushtuesit nazistë nuk dihet se sa gjatë do ta mbanin të pushtuar vendin tonë.

Në fakt, pas Luftës së Dytë Botërore nuk ishin shqiptarët që vendosën se në cilën zonë të influencës do të qëndronin, por ishte Jalta, Konferenca e tre të mëdhenjve të Luftës, Stalinit, Ruzveltit dhe Çërçillit, e cila e la Shqipërinë (pa e përmendur fare), në zonën e sovjetikëve.

Kompromisi në Jaltë nuk u bë në formën e një kontrate, por më së shumti në formë deklarative. Nuk mund të shmanget edhe fakti se interesat e SHBA-ve dhe Bashkimit Sovjetik ishin më të rëndësishme se ato të Evropës. Është me të vërtetë për t'u çuditur se si në vendimet e Konferencës së Jaltës, mbajtur në shkurt të vitit 1945, pra më pak se tre muaj pasi komunistët shqiptarë uzurpuan pushtetin për ta mbajtur më dhunë për gati 45 vjet, Shqipëria nuk është përmendur në këtë konferencë, thua se nuk ekzistonte fare në këtë botë?! Mirë që Stalini, siç do të shohim më poshtë, nuk kishte fare haber për këtë vend, i cili nuk kishte pasur kurrë të bënte më sllavët, por si është e mundur që të “harronin” Ruzveltin dhe Çërçillin, ndryshe nga presidenti Uilson, i cili mbrojti me këmbëngulje interesat territoriale të Shqipërisë, duke përcaktuar në Konferencën e Paqes në Versajë, (1919-1920), se “në Evropë është një vend i vogël por me histori dhe tradita të lashta, që ka gjithashtu kulturë të lashtë, që prej 500 vjetësh ka qenë e pushtuar nga Perandoria turke dhe, megjithatë, ka arritur të ruajë gjuhën që nuk ngjan me asnjë gjuhë tjetër të Ballkanit ose Evropës, traditat, kulturën...”

Kjo mund të shpjegohet me faktin se ishte pasojë e “ndarjes” së zonës së influencës në Jaltë që bënë Çërçilli me Stalinin dhe, kur flitej për Jugosllavinë, mbase Shqipëria konsiderohej pjesë e Jugosllavisë. Është një tjetër e vërtetë tragjike që dëshmon edhe njëherë se Evropa, madje me keqardhje, duke përfshirë këtë radhë edhe Amerikën, nuk tregoi vëmendje për këtë vend dhe për këtë popull, duke na kujtuar kështu vargjet njohura të Fishtës⁴, të shkëputura nga “Lahuta e malcis”: “Uh, Evropë, ti kurva e motit,/Qi t’rae mohit besës e Zotit,/ Po ky a shenji i gjytetnis,/Me da tokën e Shqypnis,/Për me mbajt klysh’ e Ruisis?”⁵ Pra, ashtu si dhe Kongresi i Berlinit, më 1878, ku Kancelari gjerman Bismark mohonte ekzistencën e kombit shqiptar, kongres që me vendimet e tij arbitrare shkëpuste nga trungut shqiptar vise të tëra të Veriut, si Plava dhe Gucia,

⁴ Gjergj Fishta (23.10.1871-30.12.1940), ishte një françeskan, arsimtar, shkrimtar, përkthyes poet, dramaturg, prozator, por edhe si kritik, historian i letërsisë dhe estet, i cili për një gjysmëshekull ishte figura mbizotëruese e letërsisë shqipe, madje sa ishte gjallë u kurorëzua “poet kombëtar”.

⁵ Gjergj Fishta, *Lahuta e malcis*.

për t'ia dhënë Malit të Zi, kurse Serbisë toka të tjera me popullsi shqiptare, në krahinat e Vranjës, Nishit etj., deri në afërsi të Gjilanit, ashtu si Konferenca e Londrës, më 1913 që i dhuronte Serbisë Kosovën, këtë radhë “tre të mëdhenjtë e mësipërm” vepronin në Jaltë akoma më keq, sepse, pa asnjë vendim, e nënkuptonin Shqipërinë pjesë të Jugosllavisë. Pra, i jepnin asaj të drejtën që një ditë ajo edhe ta gllabëronte atë...

Në Jaltë, midis Çerçillit dhe Stalinit u vendos që Rumania dhe Bullgaria të ishin 80 për qind nën influencën e Bashkimit Sovjetik, ndërsa 20 për qind nën influencën e Perëndimit. Jugosllavia 50 për qind nën influencën e BS dhe 50 për qind në atë të Perëndimit. Greqia 80 për qind nën influencën e Perëndimit dhe 20 për qind në atë të BS. “Për Shqipërinë nuk është folur fare konkretisht, por ajo, siç duket qartë nga zhvillimet e mëvonshme, është përfshirë në kuadrin e Jugosllavisë, e cila kaloi plotësisht nën ndikimin rus.”⁶

Ky fat pra, i ra “për hise” Shqipërisë. Ç’do të ndodhte sikur “tre të mëdhenjtë” të merrnin në Jaltë një vendim posaçërisht për vendin tonë, pra që ai të mos konsiderohej në mënyrë trashamane pjesë e Jugosllavisë, sepse nuk ishte vend sllav, por të ishte 80 për qind nën influencën e Perëndimit dhe 20 për qind e BS? Ose, që Shqipëria të ishte e lidhur njëjloj si me Lindjen, ashtu dhe me Perëndimin, sepse në këtë luftë kishin marrë pjesë edhe forca që nuk ishin komuniste dhe përfaqësonin edhe drejtime të tjera politike.

2. Blloqet politike pas Luftës Dytë Botërore dhe Shqipëria

Ashtu siç pritej, paslufta e dytë botërore rezultoi jo vetëm në fitimtarë dhe humbës, por edhe në një ndarje të thellë midis vetë fitimtarëve. Aleatët u tërhoqën në llogoret e veta, tashmë jo si aleatë, po si kundërshtarë. Dy blloqe politike dhe ushtarake u vunë përballë një lufte të re, e cila, në terma historike dhe politike është quajtur “Lufta e Ftohtë”, emërtim ky i përdorur për herë të parë nga gazetari amerikan Valter Lipman.

Shqipëria, pas Luftës së Dytë Botërore, ishte e lidhur politikisht me Bashkimin Sovjetik. Menjëherë pas luftës, në këndvështrimin e BS-së, Shqipëria ishte thjesht një vend i vogël, me ekonomi krejt të prapambetur, pa kurrfarë infrastrukture dhe, si e tillë, aspak joshëse. BS-ja ishte i interesuar për Shqipërinë, vetëm në kontekstin e interesave strategjike ushtarake për ta pasur Shqipërinë në sferën e vet të influencës. Përkrahja sovjetike në OKB për problemet shqiptare kishte pikërisht këtë synim. Deri më 1948, pavarësisht nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike Shqipëri - BS, lidhjet e Moskës me Tiranën realizoheshin vetëm nëpërmjet Beogradit. Ky ishte një nga faktorët që intensifikuan rritjen e ndikimit jugosllav në Shqipëri. Deri më 1948 ajo u la

⁶ Ramiz Alia, *Jeta ime*, faqe 136.

nën influencën jugosllave. Më pak se katër vjet, (1944-1948), vazhdoi “besa e përjetshme” me fqinjët kufitarë veri-lindorë.

Shqipëria hyri në perimetrin e interesave sovjetike vetëm pas thyerjes sovjeto-jugosllave. E vërteta është se jugosllavët, në vend që ta ndihmonin ekonomikisht Shqipërinë, e panë atë si një lopë për t’u mjellë, duke përvetësuar stoqet e mallrave që kishin mbetur në Shqipëri për shkak se Italia fashiste, për interesat e saj propagandistike kishte sjellë furnizime të mëdha në Shqipëri. Lidhur me këtë, Petro Marko⁷ sjell ankimin e një tregtari shkodran në vitin 1945, kur ishte kryeredaktor i gazetës “Bashkimi”⁸, e vetmja e përditshme në vend: “Pse zoti Petro, sllavët po na zhveshin. Të paktën të marrin një pjesë e një pjesë ta mbajmë dhe ne, se ku t’i gjejmë tërë këto mallra të çdo kategorie: që nga lënda e ndërtimit, te manufaktura, te makineritë, te pijet, madje deri te furçat e nevojtove?”

Stalini e braktisi Jugosllavinë pasi krijoi një zonë-tampon mes kufirit sovjetik dhe Perëndimit, duke dashur të thotë se ai nuk kishte synime ekspansioniste, por vetëm siguri për Bashkimin Sovjetik. Braktisja e Jugosllavisë ishte në fakt një gjest vetëpërmbytjeje e Moskës dhe paralelisht me këtë erdhi duke e ulur në minimum ndihmën derisa e ndërpreu fare ndihmën, duke fajësuar për këtë gjë tradhtinë e Titos. Pas braktisjes së Jugosllavisë, Stalini e mbajti Shqipërinë si një post të avancuar, diçka si Kaliningradin pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, kjo dhe falë faktit që udhëheqja shqiptare zgjodhi që të mbajë anën e Stalinit në konfliktin mes tij dhe Titos. Pas prishjes së marrëdhënieve të Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë mori fund kujdestaria mbytëse jugosllave për Shqipërinë dhe ndihmat që Bashkimi Sovjetik i jepte Shqipërisë filluan të vijnë drejtpërdrejt në Shqipëri. Pra, tashmë, kishte një simetri në marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, si në rrafshin politik ashtu dhe në atë ekonomik.

Në dokumentet amerikane ka një numër të madh rekordesh që dëshmojnë për të kundërtën. Qeveria amerikane tradicionalisht dhe në mënyrë konstante e ka afishuar veten në përkrahje të pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit. Shqipëria për Amerikën nuk kishte ndonjë rëndësi strategjike, por mbetej me rëndësi në kontekst të interesave më madhore të saj ndaj Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë. Sipas SHBA-ve këto shtete kishin konflikte interesash në Shqipëri, ndaj ishin të vëmendshme që ato të mos agravoheshin duke prishur *status quo*-në politike në Ballkan, gjë që do të çonte në një konflikt më të gjerë dhe të pakontrolluar. Qëllimi i SHBA-ve duket se ka qenë ta izolonte sa të mundte këtë konflikt dhe Shqipërinë ta shkëpuste nga blloku komunist pa komplikacione ndërkombëtare.

⁷ Petro Marko (25 nëntor 1913 - 27 dhjetor 1991) ishte arsimtar, publicist, gazetar, poet, prozator e shkrimtar shqiptar i shquar.

⁸ Gazeta “Bashkimi”, drejtuar nga Petro Marko, në vitet 1945-1947.

Kështu, vitet 1948-1960 mund të konsiderohen vite normale në marrëdhëniet sovjeto-shqiptare, kuptohet në kuadrin e anormalitetit të orientimit të Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik. Por, është interesant fakti se, derisa marrëdhëniet sovjeto-shqiptare fituan dimensionin ekonomik, veç atij politik, ato mbetën pa dimensionin në fushën ushtarake, edhe pse nga udhëheqja komuniste e kohës ishte bërë një një kërkesë e tillë.

Me vdekjen e Stalinit, më 5 mars të vitit 1953, askush nuk e dinte se çka do të ndodhte në Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së tij. Me vdekjen e Stalinit u shfaq një liberalizim në politikën e pasardhësve të tij dhe gjendja e brendshme dhe e jashtme e Bashkimit Sovjetik ndryshoi tërësisht. Udhëheqësit e rinj u distancuan nga metodat e udhëheqjes staliniste dhe vendosën të sjellin ndryshime të cilat premtinin përmirësim të gabimeve që ndodhën gjatë qeverisjes së Stalinit. Paralel me këto zhvillime u morën edhe masa kundër shtypjes masive si dhe pati një liberalizim në shtetet socialiste që ishin nën suaza të Bashkimit Sovjetik (përveç Shqipërisë). Ishte ky një proces i cili zgjati deri në fund të vitit 1955 dhe solli mjaft përmirësime në kushtet jetësore në atë kohë.

Para se të vijmë në këtë kohë, që me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik filloi që të lidhë marrëveshje me shtetet që ishin në sferën e interesit të saj. Kur Bashkimi Sovjetik ishte kundër anëtarësimit të Gjermanisë në NATO, ajo bëri një marrëveshje me shtetet e bllokut lindor për përkrahje të plotë dhe për mbrojtje të shumanshme. Marrëveshja për shoqëri, bashkëpunim dhe mbështetje reciproke, u nënshkrua më 14 maj 1955 në Varshavë. Në këtë forum socialist merrnin pjesë këto shtete: Bashkimi Sovjetik, Polonia, Çekosllovakia, RDGJ, Rumania, Hungaria, Bullgaria dhe Shqipëria.

3. Pakti i Varshavës, anëtarësimi i Shqipërisë në këtë pakt

Me vendosjen e regjimeve të demokracive popullore në zonat e influencës së BS në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, linden dhe dyshimet se si do të organizohej mbrojtja dhe siguria kombëtare e këtyre vendeve. “..Në këtë pikëpamje detyra mbrojtëse e socializmit iu besua forcave të armatosura, të cilat udhëhiqeshin nga ideologjia marksiste-leniniste. Ky transformim ushtarako-ideologjik do të bënte bazën për lindjen e një aleance shumëpalëshe për t’iu kundërvënë perëndimit”.⁹ Pakti i Varshavës ishte një lidhje e shteteve komuniste të Evropës, e udhëhequr nga Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike, i nënshkruar më 14 maj 1955 në Varshavë, me qëllim të miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke në mes të Shqipërisë, Bullgarisë, Republikës Demokratike të Gjermanisë, Polonisë, Rumanisë, Bashkimi të Republikave Socialiste Sovjetike, Republikës Socialiste të Çekosllovakisë dhe Hungarisë. Pakti i obligonte anëtarët e saj për konsultime mbi çështjet e

⁹ Etleva Smaçi, *Shqipëria në Traktatin e Varshavës 1955-1968*, (Monografi), viti 2023, fq.11.

interesit të përbashkët dhe për ndihmë të menjëhershme ushtarake në rast të ndonjë sulmi në Evropë mbi një apo më shumë anëtarë të paktit. Të gjitha shtetet anëtare të Paktit të Varshavës sipas kontratës ishin të barabarta dhe vlente principi i mos ndërhyrjes në çështjet e tyre të brendshme. Kontrata ishte për 20 vjet e kufizuar dhe dalja nga ky forum nuk merrej parasysh. Kjo mënyrë e zgjedhjes së konflikteve në mes shteteve shihet si një mekanizëm që nuk paraqiti ndonjë ndikim të madh në politikën këshilluese por solli vetëm një distancim mes këtyre shteteve. Marrëveshjet dypalëshe mes Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të bllokut lindor që nga viti 1944 deri në vitin 1947 ishin mjaft të rëndësishme për kooperimin ushtarak.

Pakti i Varshavës u zhvillua si një instrument politik në duar të BRSS-së, si fuqi udhëheqëse e bllokut lindor. Përpjekjet e qeverisë kryengritëse hungareze I. Nagy¹⁰, në tetor/nëntor 1956, për të tërhequr anëtarësimin e Hungarisë nga Pakti i Varshavës, ishin vendimtare për marshimin e trupave sovjetike në Hungari në nëntorin e vitit 1969. Përpjekjet e reformave komuniste në Çekosllovakia, në 1968, BRSS-së, iu duken jo vetëm si një devijim nga ideologjia komuniste, por edhe si rrezik i mbajtjes së përbashkët të Lidhjes.

Pas marshimit të trupave sovjetike në Çekosllovakia, në gusht të 1968, Shqipëria tërhiqet nga Pakti i Varshavës.

Në dallim nga strategjia e Organizatës së Kombeve Transatlantike, Pakti i Varshavës nuk ka publikuar asnjë koncept mbrojtës kundër sulmeve. Rrethet e ndryshme ushtarake perëndimore, në lidhje me këtë, pohojnë se sipas udhëheqjes komanduese, organizimit, stërvitjeve dhe armatimit, Pakti i Varshavës punonte në një strategji ushtarake ofensive/sulmuese. Nisur nga shpërndarja hapësinore e trupave sovjetike dhe gjendja gjithnjë në gatishmëri e tyre, mund të thuhet se Pakti i Varshavës mendohej të siguronte gatishmërinë për konflikte të mundshme, pa ndonjë parapërgatitje të posaçme dhe pa ndonjë manovër. Përmirësimi i përditshëm i armatimit konvencional dhe atij bërthamor i Paktit të Varshavës, le të kuptohet se ishin të gatshme për çdo lloj lufte të mundshme të asaj kohe. Me këtë strategji, Pakti i Varshavës ndiqte barazinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe dominimin konvencional në Evropë. Po ashtu në disa vende perëndimore të Evropës mendohej se armatimi, i cili i tejkalonte nevojat vetëmbrojtëse të Paktit të Varshavës, përdorej edhe për të shtypur interesat e Evropës perëndimore. Shqipëria u bë anëtar i Paktit të Varshavës në vitin 1955, ndërsa në 24 tetor 1957, sovjetikëve iu dha baza e Vlorës. Natyra dhe pozita gjeografike e Shqipërisë konsiderohet në mjaft raste

¹⁰ Imre Nagy ishte një politikan komunist hungarez që shërbeu si Kryetar i Këshillit të Ministrave (de facto Kryeministër) i Republikës Popullore Hungareze nga viti 1953 deri në vitin 1955. Në vitin 1956 Nagy u bë udhëheqës i Revolucionit Hungarez të vitit 1956 kundër qeverisë së mbështetur nga Sovjetikët, për të cilën ai u dënua me vdekje dhe u ekzekutua dy vjet më vonë.

komponent substancial identiteti kombëtar dhe faktor kyç për imazhin. Shqipëria njihet e konsiderohet ndërkombëtarisht një perlë natyrore e pazbuluar, e pashfrytëzuar. Shqipëria dhe natyra e saj përbëjnë një simbiozë vlerash identiteti unik. Natyra dhe pozita tejet e favorshme e Shqipërisë janë komponentë objektivë pozitivë që vetë Zoti u ka ofruar atyre.

Pozita gjeografike, në rastin e Shqipërisë përbën në vetvete një element me rëndësi të madhe gjeostrategjike. Ajo ndodhet në kryqëzimin e rrugëve me të shkurtra që kalojnë nga Mesdheu perëndimor për në Ballkan e Azinë e vogël, duke pasur nën kontroll një pikë shumë kyçe që është kanali i Otrantos. Pra ka një lidhje të brendshme të Ballkanit me detin Adriatik e të Azisë së vogël me viset e Mesdheut. Në Shqipëri kalon korridori i 8-të dhe i 10-të që dhe këta janë dy korridore shumë të rëndësishme. Korridori i 8-të—ruga e vjetër Egnatia dhe korridori 10-të—korridori i veriut të Shqipërisë. Kjo pozitë gjeografike e Shqipërisë është e favorshme për një integrim strategjik në rajon dhe Evropë, duke qenë se rrugët për rëndësinë që përfaqësojnë, luajnë funksionin e arterieve. Perspektiva strategjike politiko-ushtarake e një vendi përgjithësisht bazohet në pozicionin gjeostrategjik, kapacitetet ushtarake, burimet e mbrojtjes, ndërveprimi me aleatet, por edhe reagimi me armiqtë e mundshëm dhe sigurisht me peshën në marrëdhëniet ndërkombëtare”¹¹

Klima është një element tjetër shumë i favorshëm, duke qenë se Shqipëria bën pjesë në brezin subtropikal dhe përfshihet në zonat klimaterike mesdhetare me dimër relativisht të shkurtër dhe të butë, me verë te nxehtë dhe të thatë. Bukuritë dhe burimet tona natyrore mund të ngjallin interesin e investitorëve të huaj dhe të brendshëm për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit, duke sjellë zhvillim ekonomik, social-shoqëror dhe kulturor.

“Futja e Shqipërisë në këtë Pakt dhe më vonë dhënia e ofertës për t’u ndërtuar në Vlorë një bazë ushtarake e përbashkët me sovjetikët dhe vendet e tjera komuniste nuk ishte e kollaj, pasi udhëheqja komuniste ruse (Stalini, Molotovi, etj.) kishin qenë kundër, me argumentin se, në rast se do të sulmohej Shqipëria, Bashkimit Sovjetik do t’i duhej që të luftonte për të”.¹² Kërkesa nga shteti shqiptar për tu pranuar në Traktatin e Varshavës në vitin 1955 dhe vënia në dispozicion të Bazës së Pashalimanit (1957) ka qenë konsistente, pasi në këtë mënyrë ndreqej anomalia që Shqipëria ishte i vetmi vend komunist në Evropën Lindore, i lidhur me Bashkimin Sovjetik, ku nuk kishte forca ushtarake sovjetike, gjë që shihej si një pasiguri të madhe për kohën reale.

Nga ana tjetër, këtë anomali “strategët ushtarakë sovjetikë donin ta shfrytëzonin

¹¹ Hans Morgenthau, *Politics among nations, The struggle for Power and Peace*, 5th Edition (New York: 1985).

¹² Arkivi Qendror i PPSH, fondi 14, lista 1, dosja 24.

në aspektin e avantazhit strategjik që u jepte Shqipëria. Baza ushtarake e Pashalimanit shihej si një nga bazat më adekuate për afrimin e flotës së Detit të Zi në brigjet shqiptare për asgjësimin e flotës 6-të amerikane”.¹³

Siç theksuam më lart, Stalini e kundërshtoi këtë ide, në të dy rastet: si kur ia paraqiti udhëheqja shqiptare në vitet 1949-1952, ashtu dhe kur atë ia paraqitën gjeneralët sovjetikë, me argumentin se mbrojtja e Shqipërisë do të ishte një aventurë e kotë nga pikëpamja strategjike, pasi Shqipëria nuk kufizohej me vendet e tjera anëtare të Traktatit të Varshavës, duke qenë se ndahej prej tyre nga dy vende të lidhura me SHBA-t, Greqinë dhe Jugosllavinë. Në rast të tensionimit të situatës, kur sigurisht që Turqia do të mbyllte Dardanelet dhe Spanja Gjibraltarin, duke nxjerrë pretekste të kota, por në realitet për mos të lejuar flotën sovjetike që të hynte në Mesdhe, Bashkimi Sovjetik nuk do të qe në gjendje që të furnizonte Shqipërinë dhe forcat e veta atje me armatime dhe sendet e tjera të nevojshme. Pra, Stalini ende e shihte Shqipërinë si një send të vënë në tryezën e shkëmbimeve me Perëndimin, të cilën mund ta lëshonte në këmbim të diçkaje tjetër.

Nga ana tjetër duhet thënë se Stalini nuk dallohej për tendenca të bashkëpunimit shumëpalësh. Ai ishte për besnikëri në marrëdhëniet dypalëshe në të gjitha fushat përfshi edhe ato ushtarake. “Moska parapëlqente të ishte e hapur dhe te kishte marrëdhënie me çdo klient të veçantë dhe jo në grup”¹⁴.

Marrëdhëniet ushtarake sovjeto-shqiptare morën fuqi dhe simetri të plotë në prill 1957, kur BS iu ofrua ishulli i Sazanit për ta përdorur atë si bazë ushtarake, një ishull i vogël, 5,5 km katrorë, por një pikë e favorshme në hyrje të kanalit të Otrantos, 5 km nga bregdeti shqiptar dhe pika më e afërt me Italinë, 65 km. Ky akt u nënshkrua në tetor, kur në Shqipëri erdhi për vizitë ministri i Mbrojtjes, Zhukovi i cili nënshkroi vendimin që të dislokonte flotën ushtarake ruse në bazën e Vlorës.

Shqipëria ishte bazë me rëndësi të madhe strategjike për mbrojtjen e kampit komunist pasi për Flotën e Detit të Zi një pengesë e madhe ishin Dardanelet, Bosfori dhe ishujt e shumtë të Greqisë. Në të njëjtën kohë u formuluan kërkesat se nga BS-ja nuk kërkonin aq e kaq armatime, por mbrojtja e Shqipërisë të konsiderohej si mbrojtje e çdo pike të BS-së dhe se nëse Sevastopoli është i rëndësishëm, Vlora të bëhej kështjellë para Sevastopolit. Në të vërtetë, kjo kërkesë nuk ishte e re. Edhe më parë ishte ofruar Sazani për t’u kthyer në bazë ushtarake ndërkombëtare për kampin socialist, por ai nuk kishte pranuar. Këtë status preferencial Shqipëria e pati kur marrëdhëniet sovjeto-jugosllave u ringjallën dhe kur filloi ndryshimi i kursit politik me ardhjen e Hrushovit në

¹³ Po aty.

¹⁴ Wolker Laker, *Evropa në kohën tonë 1945-1952*, Tiranë: Dituria, 1996.

fuqi. Duket pra, se gjiri i Vlorës bashkë me Sazanin, në pikëpamje ushtarake, ishte një nyje delikate në ekuilibrin e brishtë politik dhe ushtarak të rajonit të Ballkanit.

Por jo thjesht e vetëm për siguri ushtarake, por, sidomos për siguri prestigji e pushteti, udhëheqja e kohës ka këmbëngulur dhe ka realizuar ngritjen e kësaj baze ushtarake në kuadrin e marrëveshjeve përkatëse me Traktatin e Varshavës. Nga ana tjetër legjitimimi i Pashalimanit si një baze ushtarake e Bashkimit Sovjetik, përbënte një hap tepër provokativ jo vetëm për sovranitetin e Shqipërinë, por edhe interesat e vendeve fqinje ne pikëpamje strategjike dhe perëndimit në tërësi. Dislokimi i flotës sovjetike në Vlorë shkaktoi alarmin e madhe të Perëndimit dhe Hrushovi u detyrua ta tërhiqte duke e përdorur si kartë në negociatat me Perëndimin për Berlinin dhe duke i prerë fare marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, për t'i dhënë Perëndimit një provë shtesë të tërheqjes nga Shqipëria. “Shmangia e këtij konflikti me gjasa të mundshme në zonën ku NATO kishte vendosur Floten e 6-të amerikane u be me hapa te kujdesshëm përmes termave të marrëveshjes”¹⁵. Është interesant fakti se prishja sovjeto-shqiptare ishte një *deja vu* e prishjes sovjeto-jugosllave, kur ishin sovjetikët ata që e kërkuan prishjen, duke e projektuar për alibi tek pala tjetër. Në fakt, hapja e arkivave në shume vende të Evropës Lindore dhe Qendrore, si dhe deklasifikimi i shume dokumenteve sekrete te CIA-s janë një ndihmese e madhe për te treguar se hyrja dhe dalja e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës nuk ka qene një zgjedhje e palës shqiptare¹⁶.

Shqipëria as brenda e as jashtë Traktatit të Varshavës (1961-1968). As marrëveshjet e 1957-ës dhe 1959-ës dhe as vizita e Hrushovit në Shqipëri nuk e konsoliduan prestigjin dhe statusin e Shqipërisë si shteti më i devotshëm ndaj BS-së dhe Paktit të Varshavës. Madje, në analizat që CIA amerikane i bënte vizitës së Hrushovit në Shqipëri, vihej në dukje se Hrushovi ishte larguar nga Shqipëria dy ditë përpara kohës së planifikuar.

Në 28-29 mars 1961 u mbledh në Moskë Komiteti Politik Konsultativ i Paktit të Varshavës. Kjo mbledhje ishte thirrur në nivelin më të lartë të sekretarëve të parë të komiteteve qendrore dhe kryetarëve të këshillave të ministrave, ministrave të punëve të jashtme, ministrave të mbrojtjes, përfaqësuesve të komisioneve të planeve shtetërore dhe komandantit të përgjithshëm të Forcave Ushtarake të Bashkuara. Njoftimin për mbledhjen e bënte vetë Hrushovi. Në përgjigjen e KQ të PPSH-së, pasi miratohej vendi dhe data e propozuar, shprehej keqardhja se në mbledhjen e mësipërme “për arsye shëndetësore”, nuk mund të merrte pjesë as E. Hoxha, por as edhe M. Shehu.

¹⁵ AQFA, fondi 100/1, V.1957, D23, f3, Marrëveshja nr. 39.

¹⁶ Etleva Smaçi, *Shqipëria në Traktatin e Varshavës 1955-1968*, (Monografi), viti 2023, fq.7.

Sigurisht, siç shprehet vetë E. Hoxha vite me vonë në kujtimet e tij, ajo ishte një “sëmundje diplomatike”. Pas kritikave të ashpra në Moskë nga krerët kryesorë të partive komuniste e punëtoresh, Enver Hoxha nuk preferonte të vihej edhe përballë kritikave të homologëve të Paktit të Varshavës. Delegacionin shqiptar në Moskë do ta kryesonte ministri i Mbrojtjes, Beqir Balluku. Ashtu siç parashikohej, mbledhja ishte e ashpër. Qysh më 22 mars 1961, në KPK të Paktit të Varshavës, ishin depozituar një material shqiptar (24 faqe) dhe një sovjetik (6 faqe) për incidentet në bazën e Vlorës. Përfundimisht, komandanti i Komandës së Bashkuar, Greçko, i kërkoi qeverisë shqiptare që “në qoftë se është e interesuar për qëndrimin e mëtejshëm në Bazën e Vlorës të nëndetëseve sovjetike dhe të anijeve të tjera luftarake, do të duhej që ato të plotësoheshin vetëm me ekuipazhe sovjetike. ...Në të kundërtën ju duhet t’i raportoni për këtë çështje KPK-së (Këshilli Politik Konsultativ) dhe të shtroni para qeverisë sovjetike çështjen mbi tërheqjen nga Shqipëria të të gjitha anijeve sovjetike të luftës, të ushtarakëve e të specialistëve.” Beqir Balluku, në fjalën e tij theksoi se “likuidimi i bazës së Vlorës jo vetëm që është dukshëm në kundërshtim me marrëveshjet ekzistuese, por do të ishte një atentat i palejueshëm ndaj sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, shkelje e drejtpërdrejtë e parimeve marksiste-leniniste të marrëdhënieve ndërmjet shteteve të kampit socialist dhe Paktit të Varshavës”.

4. Çfarë ishte sulmi imagjinar mbi Shqipërinë?

Në kongresin IV të PPSH (Partisë së Punës së Shqipërisë), Enver Hoxha¹⁷ njoftoi për një inskenim të një sulmi ndaj Shqipërisë të përgatitur nga Flota VI amerikane, në bashkëpunim me grekët dhe jugosllavët dhe tradhtarët e vendit. Në takimin e 28-29 mars 1961 të Komitetit Politik Konsultativ (KPK) të Paktit të Varshavës, pjesëmarrësit si Hrushovi, Kadari, Ulbrihti, Gomulka dhe Dezhi shprehën shqetësimin se udhëheqësit shqiptarë me deklaratën e tyre për “sulmin kundër Shqipërisë”, shkaktuan një panik të kotë. Zhivkovi, Sekretari i Parë i Partisë Punëtoresh Bullgare, e konsideroi qëndrimin e qeverisë shqiptare si qëndrim “aventurier” dhe vuri në dukje se “shokët shqiptarë, në vend që të “na mësojnë” marksizëm-leninizmin, le të shohin udhëheqjen e partisë e të shtetit të tyre, le të zbulojnë dorën që i katandisi në këtë derexhe, le të zbulojnë Berian shqiptar”. Në mbledhje u mor dhe një vendim ku theksohej se “Luftanijet e flotës që ndodhen në gjirin e Vlorës të shërbehen vetëm nga ekuipazhet sovjetike dhe drejtimi i tyre të kryhet nga një komandë unike sovjetike, e cila të varet nga komandanti i përgjithshëm i forcave të armatosura të bashkuara të vendeve pjesëtare të Paktit të Varshavës” dhe, në

¹⁷ Enver Hoxha (16 tetor 1908 - 11 prill 1985) ishte politikani dhe udhëheqësi komunist shqiptar, i cili sundoi si diktatori i Shqipërisë nga viti 1944 deri në vdekjen e tij në vitin 1985.

rast se qeveria shqiptare nuk e pranon këtë masë, atëherë “pjesëtarët e Paktit të Varshavës... do të detyrohen të bien dakord me propozimin për tërheqjen e forcave ushtarake-detare të lartpërmendura nga Shqipëria”. Gjithashtu, i kërkohej qeverisë shqiptare, që në bazë të nenit 3 dhe 5 të Traktatit të Varshavës, të jepte informacion të plotë shpjegues për deklaratën e E. Hoxhës në Kongresin IV të PPSH-së për të ashtuquajturin sulm ndaj Shqipërisë. Ky dokument i KPK-së së Paktit të Varshavës duket më tepër si pretekst detyrues, për të penguar sa të ishte e mundur e jo për të ndihmuar pjesëmarrjen e ardhme të Shqipërisë në Pakt.

Qeveria shqiptare në disa letra radhazi dërguar qeverive të vendeve anëtare të Paktit të Varshavës, deklaroi se nuk pranonte kurrsesi që t’ua dorëzonte bazën ushtarake detare të Vlorës ekuipazheve sovjetike dhe se, në qoftë se qeveria sovjetike vendoste t’i largonte forcat e veta ushtarake nga baza, qeveria shqiptare nuk do të nxirrte pengesa. Sipas E. Hoxhës, në kushtet aktuale baza s’kishte më asnjë rëndësi. Përkundrazi, atë mund ta përdorte Hrushovi si pretekst për të futur divizione ushtarake në Shqipëri. Ndërkohë E. Hoxha mori masa serioze për t’u kërkuar miqve të rinj kinezë, armë, municione e veshmbathje për ushtrinë shqiptare. Ndërsa Byronë Politike e porosiste që “t’i bëhet e qartë popullit se, në rast se do të vinin ditë të këqija, deri në luftë, ai duhej të shtrëngoje rripin dhe të hajë bukë të racionuar”. Një muaj më vonë, në nëntor të vitit 1961, E. Hoxha do t’i drejtohej drejtpërsëdrejti popullit shqiptar me një fjalim patetik, ku midis të tjerash do të deklaronte se: “Ne i themi Hrushovit se populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës do të hamë edhe bar dhe parimet e marksizëm-leninizmit nuk do t’i shkelim”. Udhëheqja komuniste po e çonte kështu Shqipërinë drejt izolimit, militarizimit dhe varfërisë së skajshme.

5. Shkëputja e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës

Forcat ushtarake shqiptare nuk morën asnjëherë pjesë në manovrat e organizuara në kuadrin e Paktit të Varshavës, ndërkohë nga viti 1960, Shqipëria nuk mori më pjesë në asnjë aktivitet ose mbledhje të Paktit të Varshavës. Më 12 shtator 1968, pas pushtimit të Çekoslovakisë nga forcat e Paktit të Varshavës, Shqipëria deklaroi daljen nga Pakti i Varshavës.

Më 26 maj 1961, tetë nëndetëse dhe një anije lundruese, të drejtuara nga ekuipazh sovjetik, ushtarë dhe oficerë që shkatërruan dhe rrëmbyen çdo gjë që mundën, u larguan nga Baza e Vlorës. Në mbledhjen e KPK-së së Paktit të Varshavës të mbajtur më 3 - 4 gusht 1961, Ramiz Alia, sekretar i KQ të PPSH-së, që kryesonte delegacionin shqiptar, nuk u lejua të merrte pjesë, me pretekstin se mbledhja ishte e nivelit më të lartë, me sekretarët e parë. Në tetor 1961, u mbajt Kongresi XXII i PK të BS, nga tribuna e të cilit, Hrushovi bëri thirrje të hapur për përmbyshjen e udhëheqjes politike shqiptare. Një ditë më

pas, qeveria shqiptare mori vendim për ndalimin e të gjitha transmetimeve sovjetike në Shqipëri. Pas kësaj, aq të rënda dhe të shpeshta ishin akuzat e ndërsjella, sa ishte e vështirë të besoje se dikur midis Shqipërisë dhe BS-së kishte ekzistuar ndonjë miqësi. Më 3 dhjetor 1961, për të tretën herë qeveria sovjetike i komunikoi qeverisë shqiptare një notë verbale për largimin e personelit të ambasadës shqiptare nga Moska. Në fillim të 1962 u larguan dhe përfaqësuesit e Traktatit të Varshavës në Tiranë. Ndërkohë, përfaqësuesit shqiptarë në KPK dhe në Komandën e Bashkuar nuk u thirrën më në mbledhjet e radhës së Paktit të Varshavës. Hrushovi dhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë akuzuan udhëheqësit shqiptarë se ata vetë e kishin lënë veten jashtë Paktit të Varshavës. Pati një ftesë nga qeveria polake, për një mbledhje të KPK-së së Paktit në Varshavë, më 19 janar 1965, por udhëheqja shqiptare e refuzoi publikisht. Kurse një vit më vonë, në një letër drejtuar KPK-së së Paktit të Varshavës, qeveria shqiptare ankohej se përse nuk ishte thirrur në mbledhjen e këtij Komiteti të mbajtur në Bukuresht, me 4 - 6 qershor 1966.

Kjo situatë *de jure* në Paktin e Varshavës dhe *de facto* jashtë tij, vazhdoi deri në shtator 1968, kur me rastin e pushtimit të Çekosllovakisë nga trupat e Paktit të Varshavës, qeveria shqiptare e denoncoi atë publikisht. Në 5 shtator 1968, në Plenumin V të KQ të PPSH-së, Enver Hoxha do të tërhiqte këtë konkluzion për qenien apo mosqenien e Shqipërisë në Paktin e Varshavës: “Ekzistenca e Traktatit të Varshavës nuk luante asnjë rol pozitiv për mbrojtjen e vendit tonë, përkundrazi ishte një rrezik që vazhdon të mbetet edhe pasi ta revokojmë këtë Traktat... Kur ne revokojmë Traktatin e Varshavës, vendet e NATO-s nuk mund të vënë përpara arsyetimin se ”e sulmojmë Shqipërinë pse është anëtare e Traktatit të Varshavës”, por do të sulmojnë një vend që nuk është anëtar i Traktatit të Varshavës, kështu e heqim atë argument nga dora e tyre”. Traktati i Varshavës, si strukturë politike dhe ushtarake pati rolin e vet, si përballë aleancës atlantike, ashtu edhe në detyrat e angazhimet që mori brenda shteteve pjesëmarrëse. Në vështrimin e sotëm përgjithësisht ky ka qenë një rol regresiv dhe është përdorur më shumë si instrument ndërhyrës sa herë që qeveritë nuk kanë qenë të kolauduara me udhëheqjen politike sovjetike.

Më 4 qershor të vitit 1961, Flota Ushtarake Sovjetike pas një sërë konfliktesh mes dy Partive Komuniste të Shqipërisë dhe asaj të Bashkimit Sovjetik detyrohet që të lërë pikën më të rëndësishme strategjike detare në Mesdhe, atë të Pasha Limanit. Së bashku me këtë skalion të avancuar ata qenë të detyruar që të linin në duart e ushtrisë shqiptare një arsenal ushtarak nga më modernët të kohës, që përbëheshin prej 4 nëndetëseve, bazës lundruese “Nemcinov”, 10 anije të vogla mbiujëse, 22 anije ndihmuese dhe një sasi të madhe armatimesh e materialesh, të cilat pala sovjetike i cilësoi si të rrëmbyera nga ushtria shqiptare. Sovjetikët, kur ikën nga baza, kishin mundur që të merrnin me vete

në mënyrë të fshehtë pjesë të domosdoshme armatimi logjistik, me qëllim që vendasit të mos kishin mundësi që të realizonin detyrat luftarake me mjetet që ua kishin marrë forcërisht. Përveç pjesëve të armatimit, oficerët e asaj kohe sjellin ndërmend dhe madje kanë shkruar se si ish-kolegët i kishin sabotuar duke iu vjedhur detonatorët e silurëve, pjesë kryesore të realizimit të qitjeve për nëndetëset. Detonatorët janë pajisjet bazë, ndonëse në madhësi të vogla, për të realizuar plasjen e silurëve ose qitjen luftarake.

Siluri është instrumenti bazë që siguron fuqinë luftarake të një nëndetëse. Nëndetëset tona ishin të pajisura me nga 12 copë silurë luftarakë, të cilët ishin të pozicionuar 4 në bash, 2 në kiç dhe 6 të tjera mbaheshin rezervë në bash. Një nëndetëse kishte rreth 100 copë detonatorë, duke përfshirë edhe rezervën luftarake. Pas marrjes së plotë të kontrollit në këto mjete, rezultoi se përveç shumë dëmeve të tjera, ishin vjedhur edhe detonatorët.

Pas prishjes së marrëdhënieve me BS-në, mbështetja e Shqipërisë te Kina ngelet baza kryesore e pozitës së saj ndërkombëtare. Kina ishte shteti i vetëm nga ku Shqipëria pranon edhe ndihma ushtarake deri në vitin 1978. Shteti shqiptar dërgon misionarë ushtarakë në Kinë për sigurimin e pajisjeve ushtarake për rivendosjen e gatishmërisë luftarake të njësisve. Pas vitit 1978, Shqipëria, duke i konsideruar të gjithë rreth e rrotull “armiç”, zhvillimin e saj e mbështeti tërësisht në forcat e veta.

Situata e ndezur dhe historia e atyre ditëve janë të njohura gjerësisht, pasi edhe mjetet e fuqishme të propagandës totalitariste e kanë ngritur në apogje këtë histori konfliktesh, e cila, sipas analistëve ushtarakë, qe cilësuar si një nga humbjet më të mëdha strategjike të BS-së pas Luftës së Dytë Botërore... Rënia e murit të Berlinit, në tetor 1989, solli ndryshime drastike në balancat politike të krijuara dhe në të njëjtën kohë shtroi çështjen e transformimeve brenda Aleancës së Atlantikut të Veriut si dhe në drejtimin e marrëdhënieve të saj me partnerë të mundshëm jashtë Aleancës në kushtet e reja.

Në Samitin e Romës, në nëntor 1991, përveç adoptimit të një Koncepti të Ri Strategjik, NATO hodhi një hap vendimtar për një bashkëpunim të ri të institucionalizuar në çështjet e sigurisë dhe ato politike, ndërmjet Aleancës Atlantike dhe vendeve të ish-traktatit të Varshavës, nëpërmjet krijimit të një organizmi të ri konsultues të quajtur NACC (Këshilli i Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut). Shqipëria bëhet anëtare e NACC në qershor 1992.

Shqipëria kufizohet në veri nga Mali i zi, Kosova; në lindje me Maqedoninë; në jug kufizohet me Greqinë dhe në vijë bregdetare me Italinë duke e bërë kështu pozicionin e saj një vend kushinetë, meqë një pjesë e mirë e këtyre vendeve janë dhe ish-territore të saj. Kjo ka qenë dhe një arsye më shumë që e shtyn atë të synojë të jetë një faktor stabiliteti e paqeje në rajon, sepse nuk

shpreh armiqësi e pretendime territoriale për ndryshim kufijsh me përdorimin e forcës. Ajo është kundër krijimit të krizave e konflikteve rajonale dhe këtë e ka faktuar gjatë gjithë kohës dhe sidomos së fundi, në të gjitha krizat rajonale që lindën me prishjen e ish-Jugosllavisë.

Mjedisi dhe burimet natyrore janë elemente të pashtershme të gjenerimit të një kombi dhe Shqipëria është një vend shumë i pasur me minerale nëntokësore. Këto pasuri janë instrumente shumë të fuqishme të sigurisë, interesit dhe strategjisë kombëtare. Një tjetër pikë shumë e konsiderueshme që përbën një thesar të madh turistik të vendit tonë, është qytetërimi i lashtë që ne kemi. Ky qytetërim i lashtë dhe i ri përcaktohet qartë nga struktura e një shpirti kombëtar dhe e një tradite mijëvjeçare, si një veprimtari e gjallë, që tregon se si mund të qëndrojë një popull në histori.

Në botën e sotme janë ndryshimet e mëdha globale dhe nacionalizmat e rilindura si pasojë, të cilat shpesh udhëheqin sjelljen ekonomike financiare dhe ushtarake të shteteve apo grup shteteve në arenën ndërkombëtare. Prandaj lypset që lidhshipi politik shqiptar të vendosë prioritete të qarta dhe të miratojë një qëndrim pragmatist dhe konsensual për ruajtjen e interesave tona më të rëndësishme. Përveç kësaj duhet bindur kombi/ opinioni jonë publik për vlerat dhe interesat tona kombëtare, pasi kjo ndihmon në përgatitjen e terrenit për të dy palët (leadership-popull) që të shkohet në unifikim bindjesh dhe idesh, në mënyrë që të shfrytëzohen më së miri kapacitetet e nevojshme. Mbi të gjitha shqiptarët nuk duhet të harrojnë që shtetet e rajonit gjithashtu kërkojnë të afirmojnë pozicionet e tyre, me qëllim avancimin e tyre në fushën e sigurisë dhe të interesave të tyre vetjake kombëtare.

Shqipëria është një popull proatlantik, kjo tregon vlerat e një vokacioni perëndimor në këtë vend. Gjithashtu, ajo ka shfaqur vendosmëri gjatë këtyre viteve tranzicioni për të ecur dhe zhvilluar sipas modelit euroatlantik. Anëtarësimi në strukturat euroatlantike të sigurisë kolektive e ka ndërgjegjësuar atë tashmë për garantimin më së miri të forcimit të mëtejshëm të sigurisë së vendit, që i shërben interesave të paqes dhe stabilitetit në rajon.

Tashmë, Shqipëria si anëtare e NATO-s, në fokusin e saj ka detyrimin si partner real, në kontribute sigurie dhe ndërveprimi, nëpërmjet sigurimit të mbështetjes gjatë gjithë procesit të integritetit në NATO.

Disa përfundime:

1. Gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë, Shqipëria ishte e orientuar në pozicionimin e saj ideologjik, politik, ushtarak dhe ekonomik në krahun e vendeve me demokraci popullore.
2. Koncepti i sigurisë dhe dimensionit strategjik ushtarak në zhvillimet e tyre,

janë ndikuar nga zhvillimet ideologjike të kohës.

3. Traktati i Varshavës shërbeu më së shumti si një instrument politiko-ideologjik se sa ushtarak, ku nëpërmjet forcave të armatosura ruheshin dhe përjetësoheshin diktaturat.
4. Shqipëria nuk pati asnjë rol në Traktatin e Varshavës, por ajo që thjesht figurante dhe një manovër politike dhe *show* demagogjik vetëm për udhëheqjen.
5. Baza e Vlorës ishte më shumë si një manovër politike e BS për ekspansion në përballjen me perëndimin.
6. Largimi i Shqipërisë nga Traktati i Varshavës nuk ishte aspak një dëshirë e saj, por një pazar politik i BS me Perëndimin, për interesa të caktuara.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Erik Hobsbawm, *Epoka e Ekstreteve*, Tiranë, 1997.
2. Uellter Laker, *Evropa në kohën tonë, 1945-1992*, Tiranë-1996.
3. Leon Poliakov, *Totalitarizmat e shekullit XX*, Tiranë, 1987.
4. Henri Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë, 1999.
5. Karl Grimberg, *Historia Botërore dhe Qytetërimi*, Tiranë, 2005.
6. Studime politiko-shoqërore, Tiranë 1989.
7. Ramiz Alia, *Jeta ime*, “Rreth marrëdhënieve shqiptaro-jugosllavo-sovjeto-kineze (1944-1976).”
8. Kastriot Myftaraj, *Gazeta “Panorama” Paralele sovjeto-jugosllave dhe amerikano-greke për Shqipërinë*.
9. Ana Lalaj, “Panorama” një nga momentet më kyçe të historisë së Shqipërisë në vitet ’50.

Figura e Skënderbeut në studimet e historiografisë ushtarake, raporti i saj me studimet e Historisë Kombëtare

Dr. Etleva Smaçi
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Punimet e realizuara për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeun janë të shumta. Por së fundmi, disa nga kërkuesit shkencorë të Mesjetës, me të drejtë ngrenë sot çështjen se “duhet bërë një dallim i qartë midis hapësirës së veprimit ushtarak dhe hapësirës së veprimit politiko-diplomatik të Skënderbeut.”¹

Ky punim synon të shqyrtojë aspekte të figurës së Gjergj Kastriotit si figurë ushtarake, përmes analizës së disa nga botimeve kryesore dokumentare të publikuara nga studiues vendas, të cilat shërbejnë dhe do të jenë edhe për më vonë baza e literaturës së historiografisë ushtarake, një shkencë bazike në formimin e ushtarakëve të djeshëm e të sotëm.

Punimi është ndërtuar mbi një shqyrtim krahasues, duke i dhënë përparësi studimeve të cilat janë aplikuar në mësimdhënie në Akademinë e Forcave të Armatosura, por njëkohësisht edhe në një fakt tjetër shumë të rëndësishëm, në kontributin që katedra e Historisë Ushtarake para viteve 90-të ka dhënë në pasurimin e literaturës së historisë ushtarake, me punime origjinale mbi artin ushtarak të Skënderbeut.

¹ Gazeta “Mapo”, Prof. Dr. Dritan Egro “Për një perspektivë të re në studimet mbi Skënderbeun dhe kohën e tij”.

Në këtë vështrim krahasues, duke vendosur lidhje të qarta mes studimeve historike mbi Skënderbeun dhe punimeve të historianëve ushtarakë, padyshim mund të arrijmë në përfundimin se dega e historisë ushtarake ngelet e hapur për t'u pasuruar me dokumente dhe studime në lidhje me figurën e Skënderbeut, si strateg ushtarak.

Fjalë kyçe: Skënderbe, Histori Kombëtare, Histori Ushtarake, strateg

1. Një vështrim përgjithësues mbi figurën e Skënderbeut në historinë ushtarake

Pjesa më e madhe e punimeve që lidhen me figurën e Skënderbeut, edhe pse mund të mos kenë objekt parësor figurën e tij si strateg ushtarak, nuk mund t'i shpëtojnë kësaj qasje, e cila ka një domethënie jo vetëm kombëtare për edhe ndërkombëtare tepër të çmuar. Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborët e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Edhe sikur të mos kishim pasur fatin ta kishim heroin tonë kombëtar, gjykoj se përsëri ai do të kishte shërbyer si një model për edukimin ushtarak të oficerëve tanë, pasi sjellja e tij ushtarake në tërësi të elementeve përfshirës, dallon për gjenialitet.

Kërkimet arkivore, studimet dhe punimet e reja mbi të vënë theksin në faktin se hapësira e veprimit ushtarak të tij lidhej direkt me burimet e kufizuara njerëzore dhe ekonomike të qëndresës shqiptare duke e krahasuar me “hapësirën e veprimit diplomatik dhe politik të tij”² ndaj edhe hulumtimi në angazhimin e tij ushtarak mbetet një objekt i hapur kërkimi dhe diskutimi. Koha e zhvillimeve luftarake të drejtuara nga Gjergj Kastriot Skënderbeu përkon me kohën e veprimeve luftarake të një tjetër strategu ushtarak që gjithashtu është bërë i njohur për qëndresën antiosmane, Huniadit. Nëse ky i fundit ishte pozicionuar në frontin e Danubit, historianët në përgjithësi, por ata ushtarakë në veçanti e vënë qartë theksin se pozicionimi i Skënderbeut në frontin e Adriatikut ishte i një rëndësie strategjike. Marrja në kontroll ushtarak e segmentit të Adriatikut³ lidhej ngushtë me interesat e Perandorisë Osmane për të avancuar drejt Europës Qendrore, dëshmi këto të hershme që gjenden në burimet osmane por jo vetëm në to.⁴

² *Po aty.*

³ Segmenti i Adriatikut fillonte me Poloninë, shtrihej në Hungari, Bosnjë, Arbëri, Peloponez dhe mbërrinte në Mesdheun Lindor, deri në Qipro e Rodos.

⁴ Studiuesi Dritan Egro përmend si burime të tjera informacionet e marra nga Kalorësit e Urdhrit të Shë Gjonit të Rodosit, si dhe informacionet e marra nga Kodikët e manastireve ortodokse.

Pozicionimi strategjik dhe ushtarak i Skënderbeut në këtë rajon është tashmë një kontribut i padiskutueshëm në mbrojtje të krishterimit evropian. Ekzistenca e një fronti të ri lufte në trojet shqiptare në fillimet e viteve 1444, kur Perandoria Osmane kishte nën sundimin e saj gjithë Ballkanin është konsideruar një pengesë serioze në realizimin e qëllimeve strategjike ushtarake të Perandorisë Osmane për daljet në Itali dhe Europë.⁵ Kjo periudhë përkon edhe me formimin e një ushtrie të përbashkët shqiptare me komandant Skënderbeun, regjistrimin e ushtarëve⁶ dhe si moment zë një vend shumë të rëndësishëm në shqyrtimin e tij si strateg ushtarak në literaturën historike ushtarake.

Ajo çka synohet nga studiuesit është tashmë një kornizë më objektive. Marrja në shqyrtim e figurës së tij si strateg ushtarak, mendojmë se duhet të ndahet nga përfytyrimi popullor që është krijuar në mënyrë të veçantë nën ndikimin e veprave letrare të shkruara për të. Për një kohë të gjatë përshkrimi i cilësive luftarake të heroit tonë kombëtar është bazuar në gjuhën metaforike, emocionale si objekt i krenarisë kombëtare. Nuk mendoj se ka dokumente relevante që mund ta hedhin poshtë këtë imazh të tij, por mendoj se si për çdo strateg ushtarak duhet të kemi një objekt të qartë mes heroit të masave, prijësit të popullit dhe aftësive të tij luftarake, që e kthejnë në një model të admirueshëm, siç ka ndodhur rëndom në Historinë Ushtarake me figura të njohura që prej lashtësisë si p.sh., Hanibali, Aleksandri e deri tek strategët e ditëve të sotme.

2. Skënderbeu në literaturën historiografike ushtarake vendase

Në fillim të viteve 90-të, një ndër historianët ushtarakë, Prof. Dr. Shahin Leka, ndërsa përgatiste punimin e tij për Skënderbeun si strateg e komandant legjendar, do të shkruante se: “Mungojnë punimet përgjithësuëse e sintetizuese për vlerat ushtarake të Skënderbeu, vlera që e vendosin atë në vendin e një personaliteti krijues në fushën e artit ushtarak”.⁷ Një tjetër mendim i shprehur nga autori, që në hyrje të librit, është fakti se për natyrën e veprës së Skënderbeut është shkruar shumë⁸, por materialin ushtarak të përfshirë në këto vepra ai e konsideron “të sipërfaqshëm dhe rastësor”.⁹

Ky konstatim i studiuesit shihej i lidhur ngushtë me nevojën e historisë ushtarake për të ndërtuar një tablo më gjithëpërfshirëse strategjike dhe taktike të përvojës

⁵ Shahin Leka, *Strateg e komandant legjendar Skënderbeu*, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 1994, f.33.

⁶ K. Bozhori, “Kuvendi i Lezhës- bashkimi i parë i popullit shqiptar, *Skënderbeu dhe epoka e tij*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1967, f.45- 46.

⁷ *Po aty...*, f.6.

⁸ Autori e ka botuar librin në vitin 1994. Duke iu referuar asaj periudhe ai përmend një numër prej 1000 publikimesh në 21 gjuhë të botës.

⁹ *Po aty*.

ushtarake të Skënderbeut, në mënyrë që ajo të shërbente si bazë e mësimdhënies në rrafshin kombëtar, madje edhe përtej saj. Nxitje dhe pothuajse si një burim informacioni për këtë autor ka shërbyer vepra e të madhit Fan S. Noli “Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405 - 1468” si dhe vepra e Barletit. Që në hyrje të saj, gjejmë vlerësimin e bërë për artin ushtarak të Gjergj Kastriotit nga gjenerali i njohur anglez i shekullit të 18-të, James Wolfe se: “Skënderbeu shquhet mbi të gjithë ushtarakët e kohëve të lashta dhe moderne në drejtimin e një ushtrie të vogël mbrojtëse”.¹⁰

Shumë prej studiuesve duke iu referuar rolit të Skënderbeut si kryekomandant i Lidhjes së Lezhës, bien pothuajse dakord me faktin se si strateg ushtarak, ai ka gëzuar mbështetjen e pakufishme të popullit¹¹. Te studiuesit e historisë ushtarake dhe më konkretisht në rastin e punimit të Shahin Lekës, mbështetja te populli ka shërbyer edhe si tezë bazë në analizën e betejave të zhvilluara nga ai. Edhe pse mitizimi i Skënderbeut është i dukshëm (në këtë punim nuk do të marrim në shqyrtim arsyet pse. E.S), mendoj se autori si historian ushtarak është i vetëdijshëm për kufizimet në mjetet njerëzore dhe ekonomike të Skënderbeut në përballimin e sulmeve osmane. Prandaj edhe karakteri i luftës së zhvilluar nga Skënderbeu edhe pse has disa kontradikta brenda punimit, nënvizohet si luftë popullore kurse për ushtrinë e tij thuhet se “kishte karakter popullor përparimtar.”¹²

Të njëjtën ide për karakterin e luftës së zhvilluar nga Skënderbeu si “luftë popullore”, por jo me një pamje të plotë të kësaj të fundit, për shkak të kufizimit të forcave prodhuese dhe marrëdhënieve feudale në prodhim e gjejmë edhe në punime të tjera të cilat merren me analizën e artit ushtarak të këtij strategu.¹³ Punimi i Kadri Cenollit mbi artin ushtarak të Skënderbeut, vë theksin në përdorimin e mësymjes si forma më e përshtatshme e Luftës Popullore nisur nga ekzistenca e dy faktorëve të rëndësishëm:

- ekzistenca e shtetit të parë të përqendruar shqiptar dhe përpjekjet për konsolidimin e tij;

¹⁰ Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” Tiranë, 1967, f.3

¹¹ Po aty...shih parathënien e Aleks Budës. Gjithashtu shih Shahin Leka, f...34.

¹² Po aty ...f.42. Etiketimi i ushtrisë së Skënderbeut si ushtri me karakter përparimtar lidhet me mendimin ideologjik që shfaqnin studiuesit e kësaj periudhë nën diktatin e ideologjisë udhëheqëse në vend. Autori shfaq edhe një tjetër qëndrim kur shprehet se “ ushtria e Skënderbeut kishte tiparet e veta, që e dallonin rrënjësisht nga ushtritë feudale të armatosura rëndë të Evropës, ashtu edhe nga ushtria turke”, por nuk jep burime bindëse ku qëndronte ky ndryshim, duke sjellë si argumente të vetëm edukimin apo përgatitjen.

¹³ Kadri Cenolli, “*Arti ushtarak i popullit shqiptar nën udhëheqjen Skënderbeut*” Studime për epokën e Skënderbeut, Vol 2, Tiranë, 1989, f.542.

- qenia nën sundimin e huaj të disa principatave shqiptare, të cilat duheshin çliruar.

Në trajtesën që i bëhet figurës së Skënderbeut si strateg ushtarak natyra e luftës është një ndër objektet e debatit mes studiuesve. Edhe para viteve 90-të ka ekzistuar mendimi se Skënderbeu ishte një strateg i luftës guerile, “një komandant çetash të malësorëve”.¹⁴ Duke u mbështetur jo vetëm në punimin e vitit 1994, por edhe në prononcimet e mëvonshme të studiuesit Shahin Leka, ai i ngelet idesë se Skënderbeu kombinoi luftën e rregullt me luftën guerile, bazuar në faktin se ai ishte një njohës i artit ushtarak osman. Edhe në këtë rast burimi i përdorur si referencë ngelet vlerësimi i gjeneralit anglez Wolfe. Pa dashur aspak të bëhem përkrahëse e ideve të Shmidit, gjykoj që edhe vetë historiani ushtarak sjell në punimin e tij më shumë argumente në favor të tezës së luftës guerile. Skënderbeu konsiderohet si “mjeshtër i luftës me prita”¹⁵ dhe nga një shikim i kujdesshëm edhe i materialit mësimor që qarkullon tashmë në Akademinë e Forcave të Armatosura në modulin e Historisë Ushtarake, duket se ky mendim është mbizotërues. Befasia, lufta me prita, shfrytëzimi i terrenit konsiderohen si pika më vitale në artin ushtarak të kësaj periudhe.

Betejat e organizuara dhe të zhvilluara nga Skënderbeu si strateg ushtarak sipas studiuesve janë unike, pra secila është e dallueshme nga tjetra. Megjithatë nga pikëpamja e strategjisë duket se ato përbashkoheshin në natyrën e tyre mësimore.¹⁶ Duke u ndalur te betejat, konstatojmë se historianët ushtarakë, kur merren me shqyrtimin e tyre dhe në veçanti faktorët që çuan në fitoret e Skënderbeut edhe pse raporti i forcave nuk ishte aspak në favor të tij, mbajnë të njëjtin qëndrim. Ata, mbështetur kryesisht në dy burime kryesore, në Historinë e Skënderbeut të Marin Barletit dhe Historinë e Skënderbeut të Fan Nolit, shprehen në mënyrë të vendosur se kyçi i fitoreve nuk lidhet aspak me “karakterin malor e të papërshekueshëm të vendit dhe kështjellat e forta”¹⁷ një tezë e hedhur nga studiuesit e huaj para viteve 90-të dhe e rimarrë nga Shmidi.

Në literaturën e historisë ushtarake fitoret janë parë të lidhura ngushtë me faktorin njeri, duke e trajtuar raportin njeri - armë, njeri - terren, njeri - fortifikim si pjesë e strategjisë së luftës së Skënderbeut. Ky është një argument bindës, por që ka nevojë të rishikohet mbi burime dokumentare ushtarake, e mbi të gjitha të shmanget subjektiviteti emocional që lidhet natyrshëm me figurën e heroit.

¹⁴ Po aty...f.178. Voig, Jorg dhe së fundmi të njëjtin argument sjell edhe Shmid.

¹⁵ Po aty ...f.179.

¹⁶ Skënder Isaku, *Fitorja e madhe në betejën e Albulenës*, Skënderbeu dhe epoka e tij, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1967, f.53.

¹⁷ Shih, Shahin Leka “*Strateg...*” f.179. Po ashtu shih, Kadri Cenolli “*Arti ushtarak i ...*” Studime për epokën e Skënderbeut, Tiranë, 1989, f.547.

Kjo do të thotë që kur flitet për faktorin njeri, analiza duhet të bazohet në konceptet ushtarake dhe jo në figuracionin letrar që çon në përfundime të natyrës se “shkaku i fitore ishin njerëzit tanë, shpirti i atdhedashurisë”, etj. Edhe pse kundërshtojnë idenë që terreni dhe fortifikimet të kenë qenë një gur themeli në strategjinë e luftës së Skënderbeut, në të dy autorët mbi të cilët është mbështetur ky punim, terreni dhe fortifikimi janë dy veçori bazike mbi të cilat ata shtjellojnë idetë e tyre mbi arti ushtarak shqiptar të kësaj periudhe. Ky debat hap një dritare para çdo historiani, atyre ushtarak në veçanti, do të vazhdojmë t’i analizojmë veçoritë artit ushtarak të Skënderbeut bazuar në rrëfimet artistike të Naim Frashërit, apo në rastin më të mirë të Nolit e Barletit, apo duhet kthyer vëmendja tek arkiva, në mënyrë të veçantë arkivat e huaja.

Së fundmi, do të desha të ndalem te një element shumë i rëndësishëm i aktivitetit të Skënderbeut si strateg ushtarak, që gjen pak pasqyrim në studimet e historisë ushtarake. Gjergj Kastrioti drejtoi jo vetëm beteja të jashtëzakonshme, por ai diti t’i shërbente çështjeve ushtarake edhe përmes aleancave e në mënyrë të veçantë traktateve ushtarake që lidhi, ku Traktati i Paqes me Venedikun dhe Traktati i Gaetës me Alfonsin e Napolit janë pikat më kulmore. Në punimet ku trajtohet arti ushtarak i Skënderbeut ose figura e tij si strateg, dy traktatet e mësipërme përmenden si veprime strategjike “të llogaritura mirë nga Skënderbeu, ...”¹⁸

Aleancën ushtarake me Alfonsin e Napolit e shpjegon qartë edhe me argumente juridike profesor Aleks Luarasi, prej ku janë mbështetur në interpretimet e tyre edhe historianët ushtarakë.¹⁹ Pra Traktati i Gaetës ishte një traktat aleance për të luftuar me forca të përbashkëta kundër pushtimit osman të Shqipërisë, që mund ta konsideronim një përpjekje për “common defence”, parimi i njohur sot në aleancat ushtarake. Theksojmë se kjo përpjekje ishte më tepër favorizuese për mbretërinë e Napolit, pasi ndihma ushtarake që iu dha Skënderbeut është konsideruar minimale në lidhje me nevojat dhe kushtet në të cilat ndodhej vendi (pas vajtje së Skënderbeut në Napoli, më 1453, mbretëria e Napolit pranoi të dërgonte në Shqipëri 2000 ushtarë dhe 10 topa).²⁰

Po kështu, i një rëndësie të veçantë nga pikëpamja ushtarake, ishte edhe Traktati i Paqes me Venedikun. Ndër elementet ushtarake të traktatit, tërheq vëmendje mënyra e trajtimit të palëve të përfshira në luftë. “Falja reciproke për çdo dhunë e fyerje të kryer gjatë veprimeve luftarake”, shpjegon qartë

¹⁸ Po aty, f. 194.

¹⁹ Aleks Luarasi, “*Vështrim politico –juridik mbi disa traktate të Skënderbeut*”, Studime për epokën e Skënderbeut, Vol 3, Tiranë, 1989, f.58.

²⁰ J. Radoniç, Gj. K. Skënderbeg i Arbanija u XV veku, vep, cit, dok.248, botuar në *Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë*, vep.cit., f.333.

vlerësimin objektiv që Skënderbeu i bënte burimeve njerëzore për luftë. Ai nuk mund të lejonte që popullata shqiptare e cila ishte rreshtuar në luftë krah Venedikut, për motive që tashmë njihen, të mos përdorej në kushtet e paqeje si forcë ushtarake kundër osmanëve.

Edhe ky traktat në terma ushtarak ka tepër interes dhe pasqyron konceptin e mbrojtjes së përbashkët. Venediku zotohej që t'i jepte Skënderbeut ndihmë ushtarake dhe financiare “për mbrojtjen e shtetit të vet dhe të Venedikut”.²¹ Pra me veprime taktike tepër fine, Skënderbeu siguroi si ushtarak karriere në kohët e tij më të vështira aleatë në luftë. Po kaq domethënëse dhe të rëndësishme janë edhe dy armëpushimet me Perandorinë Osmane. Armëpushimet i shërbyen pikërisht veprimeve strategjike, për të mos ngelur i vetëm në një luftë të madhe. Ai në këtë mënyrë hodhi hapin për një angazhim të fuqive evropiane në luftë me osmanët.²² Është pikërisht kjo periudhë (1436), kur ai lidhi aleancë me Venedikun dhe pas kësaj i rifilloi veprimet ushtarake kundër Perandorisë Osmane.

Përfundime

Punimet e përgatitura për Skënderbeun, më gjerësisht në studimet historike kombëtare dhe ato në studimet historike ushtarake, përbashkohen në faktin se heroi ynë kombëtar krijoi artin e tij ushtarak. Një art ushtarak unik për vetë karakteristikat e luftës së organizuar nga Skënderbeu që zgjidhi në mënyrën më të mirë të mundshme përgatitjen e planit për çlirim kombëtar, zgjerimin e luftës së armatosur, përdorimin masiv të mundësive ushtarake për luftë, organizimin dhe realizimin e udhëheqjes strategjike të luftës.

Ishin pikërisht konteksti dhe mjedisi historik në të cilin ai veproi që e bën unik si udhëheqës ushtarak. Strategjia dhe taktika e tij u ndërtua mbi kushte pabarazie, e për rrjedhojë edhe paradigma që ndërtoi duket se theu të gjitha rregullat e shkruara të betejave. Fitorja sipas Skënderbeut nuk varej nga numri i ushtarëve²³.

Si përfundim, mund të pohojmë në mbështetje edhe të tezave të hedhura në Historinë e Shqipërisë, se heroi ynë kombëtar Skënderbeu ngelet i dallueshëm si mjeshër i artit ushtarak nga të gjithë bashkëkohësit e tij, mbretërit apo princat e Europës.

²¹ Po aty, f. 61.

²² Po aty, f. 71.

²³ Marin Barleti në veprën e tij, në një nga fjalimet e Skënderbeut i referohet këtij të fundit me shprehjen se “kush nuk është në gjendje të mundë armikun me një ushtri 8 deri në 12 mijë vetash, nuk do të mund ta bënte këtë edhe me një ushtri shumë më të madhe”.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Biçoku, K. “Populli shqiptar me Skënderbeun në krye, përballë fushatës së Mehmetit II në vitet 1466 – 1467, *Skënderbeu dhe epoka e tij*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1967.
2. Bozhori, K. “Kuvendi i Lezhës – bashkimi i parë i popullit shqiptar, *Skënderbeu dhe epoka e tij*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1967.
3. Cenolli, K. “Arti ushtarak i popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut”, *Studime për epokën e Skënderbeut*, Vol 2, Tiranë: 1989.
4. Frashëri, K. “Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në pragun e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443, *Studime për epokën e Skënderbeut*, Vol 2, Tiranë: 1989.
5. Leka, Sh. “*Strateg e komandant legjendar Skënderbeu*”, Tiranë, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, 1994.
6. Luarasi, A. “Vështrim politik – juridik mbi disa traktate të Skënderbeut”, *Studime për epokën e Skënderbeut*, Vol 3, Tiranë: 1989.
7. Noli S, F. “*Gjergj Kastriot Skënderbeu 1405 – 1468*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri, 1967.
8. Pulaha, S. “Nga lufta e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër turqve nën dritën e njoftimeve të dy kronistëve turq të shek. XV, *Skënderbeu dhe epoka e tij*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1967.

Ushtria kombëtare në shtypin e shkruar shqiptar në vitet 1912-1939

Prof. Asoc. Dr. Teki Kurti

Drejtor i Arkivit Qendror të FARSH

Që nga lindja dhe formimi i ushtrisë kombëtare, shtypi i shkruar shqiptar ka luajtur rol kryesor në njohjen e opinionin shqiptar të kohës me procesin dhe ecurinë e këtij institucioni. Pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar deri në fund të viteve '30 të shek. XX, në gazetat dhe revistat e kohës kishte një hapësirë thuajse të dedikuar për ushtrinë. Organizimi, legjisllacionin ushtarak, uniformat, strukturat përbërëse ushtarake, personalitete e drejtues të lartë, llojet e armëve e shërbimeve, buxhetimi, ruajtja e zonave apo qyteteve shqiptare ishin vetëm disa nga fushat e interesit që trajtoheshin ditë pas dite në shtypin e viteve 1912-1939.

Këto gazeta, edhe pse jo të specializuara për trajtimin profesional të tematikave të mirëfillta ushtarake, luajtën një rol të ndjeshëm informues për tema të organizimit dhe veprimtarisë së ushtrisë dhe ushtarakëve shqiptarë.

Për rrjedhojë, ishin të shumtë titujt e gazetave dhe të revistave që, në harkun e viteve 1912-1939, kanë bërë pjesë të trajtimit dhe pasqyrimin në faqet e tyre ngjarje dhe dukuri që kishin lidhje me ushtrinë shqiptare dhe të institucioneve të Luftës (Mbrojtjes) së Shqipërisë.

Ndër 70 gazeta e revista¹ që panë dritën e botimit në Shqipërinë e viteve 1912-1939, afro 20 prej tyre shkruanin për ushtrinë. Po kështu ishin edhe 3 revista

¹ “*Historia e popullit shqiptar*”, vëll. III, Toena, Tiranë, 2007, f.420.

që botoheshin brenda vendit. Ndërkohë edhe tri gazeta e një revistë botoheshin nga emigrantët shqiptarë që jetonin jashtë vendit.

Midis tyre më të njohurat qenë gazeta “*Përlindja e Shqipëniës*”, që dilte në Vlorë gjatë viteve 1913-1914 dhe vlerësohej si gazeta zyrtare e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, si dhe gazeta “*Populli*”, “*Mbrojtja Kombëtare*” (Vlorë); “*Hylli i Dritës*” (Shkodër, 1913 e pas); “*Taraboshi*” e “*Agimi*” (Shkodër), “*Besa Shqiptare*” (Shkodër); “*Zëri i Popullit*”, “*Koha*”(1920), “*Shqiptari i Amerikës*” (Korçë); “*Zani i Ri*”, “*Drita*”, “*Fletorja Zyrtare*” (Tiranë), “*Dit’e Re*” (Tiranë) etj.

Disa vite më vonë nisën të botoheshin edhe gazeta të tjera, që ndonëse të politizuara dhe më pranë qeverisë ose partive politike të kohës, në gjysmën e parë të viteve ‘40 pasqyruan jo rrallëherë edhe informacione në lidhje me tema ushtarake të vendit. Më të njohurat qenë gazetat “*Bashkimi i Kombit*”, “*Atdheu*”, “*Fashizimi*” etj. Ndërkaq jashtë Shqipërisë botoheshin gazeta “*Dielli*” (Boston, SHBA), “*Shqipëri e Re*” (Konstanca-Rumani) e ndonjë tjetër.

Krahas këtyre gazetave, ngjarje nga veprimtaria e Ushtrisë Shqiptare dhe e institucionit të Mbrojtjes Kombëtare (të Luftës) dhe organizimeve përbërës të tyre gjetën pasqyrim, shpesh të plotë, edhe nëpër faqet e disa revistave shqiptare. Më të shquarat ndër to qenë revista “*Zgjimi*” (Korçë, 1913-1914), “*Zana*” (Durrës, 1914), “*Minerva*” (Tiranë), si dhe revista “*Përparimi*”, që botohej në Boston të SHBA.

Ndër gazetat e para që dilte në Vlorë në vitin 1913 dhe që njihej edhe si gazeta zyrtare e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, ishte ajo me titullin “*Përlindja e Shqipëniës*”. Në faqet e kësaj gazete (që dilte dy herë në javë) janë pasqyruar shumë çështje që lidheshin ngushtë me të dhënat ushtarake të Shqipërisë së vogël, tashmë të pavarur, si: veprimet e komisioneve përkatëse; informacione e të dhëna për mbrojtjen e vendit; largimin e ushtrive të huaja dhe marrja në ruajtje e zonave dhe qyteteve shqiptare, kryesisht në Shqipërinë e Jugut, si dhe ruajtja e rendit publik.

Në harkun e viteve 1913-1914, gazeta “*Përlindja e Shqipëniës*” ka botuar disa dhjetëra shkrime për xhandarmërinë e Shqipërisë, ku përshkruhej veprimtaria e saj në qytetin e Korçës, boshatisur tanimë nga trupat pushtuese greke; veprimtarinë e kolonelit De Weer dhe majorit Thomson, si dhe e oficerëve të tjerë holandezë, të ardhur me mision në Shqipërinë e vitit 1913 për organizimin dhe përgatitjen e xhandarmërisë shqiptare. Kjo gazetë ka shkruar në faqet e saj edhe për veprimtarinë e reparteve dhe nënreparteve të xhandarmërisë² për kryerjen e detyrës në interes lokal ose edhe kombëtar.

² Në shtypin por edhe literaturën e kësaj periudhe, 1913-1939.

Një rast të tillë e përshkruan kjo gazetë në numrin e saj të datës 7 dhjetor 1913, kur xhandarmëria e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës nisej për në Korçë. Në një prej faqeve të gazetës shkruhej: *“Pas propozimit Ingles, Greqia duhet të lëshojë viset e zapëtuara, q’u njoh në Shqipënië, gjer më 18 të këtij. Qeveria jonë pra u përgatit për të marrë ato vise, me anë të gjindarmëriës saj, dhe dje shkoj për në Korçë dërgata e parë, e formuar prej një togu 250 vetësh, të veshur me petkat e rea, q’u apën aqë bukurië dhe madhështi burrave t’onë. Në ballë kishin Z. Ghilardi³, instruktorin e trumbës mitralazovet si dhe kolonelin Mustafa bej. Kur u përhap në qytet, lajmi i nisjes gjindarmërisë, bota u sul në shesh të qeverisë, për të parë të parën Ushtri Shqiptare që niset për udhëtim. Ora ish 10 para dreke, kur arrin trumba (njësi ushtarake e barabartë me batalionin,-TK), e pritur me një bërtitje të përgjithëshme: “Rroftë Shqipëria! Rroftë Ushtria Shqiptare!” Gjindarmët u radhuan (rreshtuan,-TK) qeveriës ku, pas pak ardhë oficerët Holandezë, cilët si i inspektuan, u uruan udhën e mbarë dhe si u shtërguan duart oficerëve, trumba u nis përpara kapedanit Ghilardi dhe kolonelit Mustafa Begut. Populli i mallëngjyer e përcolli, me përpjekje duarsh, duke thirrur: “Rroftë Shqipëria! Rrofshin ushtarët t’onë! Rroftë Korça Shqiptare!”⁴*

Qe po kjo gazetë që, në një numër të saj të muajit janar 1914, njoftonte se majori Tomson (Thomson) kishte përcjellë forca të një reparti ushtarakësh shqiptarë të krahinës së Leskovikut. Megjithëse gazeta nuk shkruan asgjë për drejtimin e marshimit dhe të detyrës që do të kryente, ajo bën me dije se komandanti i repartit është Mustafa Maksuti, që në vitet pasuese do të bëhej një oficer i njohur i Ushtrisë Shqiptare dhe më pas, në vitin 1921, zëvendësministër i Luftës.

Ndërsa në numrin e datës 14 mars 1914, *“Përlindja e Shqipëniës”* informonte për ardhjen nga Durrësi të një reparti me ushtarë shqiptarë, të cilët do të dërgoheshin në viset jugore të Shqipërisë, të liruara nga trupat pushtuese greke: *“Pardje të Prente (Premten-TK) erdhën këtu prej Durrësi 270 ushtarë për të marrë pjesë në të liruariat e viseve të Jugës. Më të shumtë ishin nga Malësia e Dibrës. Këta pasi të vishen me petkat ushtërore këtu në Vlonë dhe pas si të stërviten pak në ushtri do të dërgohen si thamë në viset e Jugës”⁵*

Ky përshkrim i gazetës hedh dritë dhe sjell të dhëna të vitit 1914 mbi Ushtrinë Shqiptare. Bën të ditur për publikun e kohës se ata 270 djem të mbledhur në

³ Leon de Gilardi (Ghilardy 1881-1935), oficer me origjinë italo-kroate. Hyri në shërbim të Ushtrisë Shqiptare në vitin 1913, me gradën toger i xhandarmërisë nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës. Në vitet 1920-1930 u ngarkua me detyra ushtarake më të larta deri komandant i grupit ushtarak të Beratit dhe fitoi gradën gjeneral. U vra në Fier në vitin 1935 nga një grup ushtarakësh shqiptarë që kishin ngritur krye kundër qeverisë së kohës.

⁴ *“Përlindja e Shqipëniës”*, 14 janar 1914, f.4,5.

⁵ Po aty, f.3.

Durrës ishin rekrutë të ardhur nga treva të Veriut të Shqipërisë, të cilët pasi visheshin ushtarë, do të stërviteshin dhe do të dërgoheshin në trevat e Shqipërisë së Jugut për kapjen dhe ruajtjen pas largimit të detyruar të trupave ushtarake greke. Po në këtë numër të kësaj gazete, në një faqe pasardhëse të saj, njoftohej mbërritja e trupave të Ushtrisë shqiptare të qeverisë së Vilhelm Vidit (Wilhelm von Wied), po në viset e Shqipërisë së Jugut, por kësaj here në Gjirokastrë.

Në faqet e gazetës “*Përlindja e Shqipëniës*” kanë gjetur pasqyrim edhe një mori informimesh dhe njoftimesh me shumë tema të tjera nga ushtria, oficerët dhe veprimtarinë e tyre ushtarake luftarake. Më 24 janar (kallënduer) u publikua shkrimi me titullin “*Oficerët e rinj, u-mveshnë*”. Në këtë artikull jepej informacion për një grup ushtarakësh të rinj shqiptarë që do të shërbenin në drejtimin e forcave të Ushtrisë Shqiptare. “*Para ca ditësh, dhanë provime, gjithë ata që ishin oficerë në Turqi, por s’ishin dalë a s’kishin mbaruar shkollën ushtërore (ushtarake-TK). Shpresojmë se, në numrin tjetër do të flasëm gjatë, duke i dhanë emrat e atyre që u pajisën për të shërbyer në Ushtrinë Shqiptare.*”⁶

Në disa numra të saj, gazeta “*Përlindja e Shqipëniës*” i ka kushtuar vend, madje në disa faqe, një personaliteti të njohur të ushtrisë dhe të politikës shqiptare të viteve 1913-1920, Esat Toptani.

Një artikull që i referohet gazetës së huaj “*Neue Freie Presse*”, përshkruan se si gjeneral Esat Toptani u gjend në jahtin “*Taurus*”, që do të sillte Princ Vidin në Durrës, me mendimin se mund të merrte një post të rëndësishëm në qeverinë e tij. Sipas gazetës, “*...kur Esad Toptani vajti në jahtin Taurus për të marrë Mbretin që të zdrypin në Durrës atëherë M.T. (Madhëria e Tij) i tha: Unë po të emënoj gjeneral*”⁷. Më tej shkruhet: “*...mundet të jetë që gjeneral Toptani t’emnohet Inspektor i përgjithshëm i Ushtrisë me qenë që është e vështirë që të mundet të marrë përsipër një ministri.*”⁸

Ndryshe nga ajo që njoftonte dhe përshkruante gazeta e huaj, Esat Toptani përfitoi dy portofole në qeverinë e Princ Vilhelm fon Vidit, kryesuar nga Kryeministri Turhan Përmeti. Esat Toptani u emërua ministër i Punëve të Brendshme dhe njëherësh ministër i Luftës. Ky fakt pohohet edhe në gazetën “*Përlindja e Shqipëniës*” në numrin e saj të 18 marsit 1914: “*Turhan Pasha (Përmeti, -TK) do të marrë përsipër kryesin’ e Punërat e jashtme. Esad Pasha, ministrin e Luftës.*”⁹

Ndërsa në një tjetër shkrim që i referohet gazetës “*Giornale d’Italia*” përshkruhet përplasja e ndodhur në qarkun e Elbasanit ndërmjet disa pasuesve të Esat

⁶ “*Përlindja e Shqipëniës*”, 24 janar 1914, f.3.

⁷ Po aty, 14 mars 1914, f.3.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty, 18 mars 1914, f. 3.

Toptanit dhe ushtarëve të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Sipas gazetës italiane, së cilës i referohet “*Përlindja e Shqipëniës*”, “*Esad Pasha prej shumë kohe sundon si të duan ay (si të dojë ai-T.K.) në Shqipërinë pa kurr një kontrol ndërkombëtar.*”¹⁰

Kjo gazetë është marrë edhe më herët (nga fundi i vitit 1913) me çështjen e Esat Toptanit dhe raportin e tij me pushtetin dhe Shqipërinë. Në faqet e kësaj gazete, e cila shërbente pothuajse edhe si një gazetë zyrtare e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, gjetën pasqyrim edhe shkrime me të dhëna për dukuri dhe aspekte të tjera ushtarake në Shqipëri dhe jo vetëm, gjatë viteve 1913-1914. Ndër to ishte edhe Gjykata Ushtarake, apo siç quhej në terminologjinë e atyre viteve “Gjykatorja ushtriake”. Në këtë shkrim njoftohej për publikun shqiptar jo vetëm themelimi i kësaj gjykate, por edhe qëllimi, arsyet dhe përbërja e trupës së saj. Në një prej faqeve të gazetës shkruhej: “Gjykatorja ushtarake, që do tregoj ata që kanë marrë pjesë në komplotin e Turqëve që u formua kështu: Kryetar koloneli Deveer; Anëtar Z. Maxhar Begu, Fevzi, Taip, Kristo Floqi, kapedan Kasem Gjirokastra, toger Xhavid Leskoviku dhe Leitenenti (togeri, -T.K.) G. A. Mallincrodt i dërgatës Hollandeze. Shkronjës (sekretar, -T.K.) do të jetë Kostë Çekrezi.”¹¹

“*Përlindja e Shqipëniës*” shkroi edhe për oficerët holandezë të ardhur në Shqipëri sipas vendimit të marrë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, më 29 korrik 1913, për organizimin dhe stërvitjen e xhandarmërisë shqiptare. Aty flitet për kthimin e majorit Tomson nga ishulli i Korfuzit në Greqi, ku ai kishte shkuar me miratimin e Princ Vidit. Ja si përshkruhet vajtja e Tomsonit në ishullin e Korfuzit: “*Sikundër diet komandantit organizator të xhandarmërisë Shqiptare, M. T. Mbreti i kish dhanë fuqi të plotë, që të bisedoi me sundimtarët grekë e t’u lehtësojë sa të mundet më shumë çështjen e vështirë e të lishuarit të Shqipërisë Jugore prej ushtrisë greke. Parëdie u-këthye nga Korfuzi dhe për së shpejti do të niset për në viset që janë për t’liruar. Shpresohet se të gjendurit e z. Thompson do t’i largojë gjithë ngatërrimet që munt të dalin në viset e poshtërme kur ushtria Greke, i lëshon këto vise në duart e gjendarmërisë Shqiptare.*”¹²

Edhe disa gazeta e revista i kishin përfshirë në rubrikat e tyre ngjarje apo dukuri të tjera që ceknin e trajtonin tema nga mjediset dhe veprimtaritë ushtarake në Shqipëri. Gazeta “*Populli*” që botohej në Vlorë, në disa numra të saj, përshkruante luftimet e kryera në Durrës midis reparteve ushtarake të qeverisë së Princ Vidit me forcat rebele që nuk donin qeverinë e drejtuar prej tij. Në një prej shkrimeve pasqyrohej goditja e shtëpisë të Esat Toptanit, i cili shihej si

¹⁰ Po aty, 21 janar 1914, f.6.

¹¹ “*Përlindja e Shqipëniës*”, 14 janar 1914, f.5.

¹² Po aty, 21 mars 1914, f. 4.

një e keqe për Shqipërinë. “Dita që u bombardis shtëpia e Esadit e që shpëtoj i shenjt i Atdhe nga ky mikrob murtaje...”¹³

Në një tjetër numër po të kësaj gazete, nën titullin “Kuxim dhe shpresë” përshkruhej me hollësi zhvillimi i veprimtarive luftarake në Durrës midis forcave kryengritëse dhe atyre që mbrojnë qeverinë e Princ Vidit. Lufta e Durrësit përshkruhej në gazetë në këtë mënyrë: “*Më nj’anë shqiptarët e çmëndur të cilët propaganda e të huajve, nga padituria, i bënë vegël për dëmin e Atdheut e të Fronit shtyhen me një kryengritje të turpshme mbanë kryeqytetit shqipëtar; m’anë tjetër, një tok nga djemt e vlyer të Shqipërisë, një tok prej atyre vëllezërve që s’kursejnë asgjë për nderin e fronit të Atdheut, marrën pushkën dhe përpiqen gjersa vdesën! Lufta e Durrësit do të mbetet një pik e zezë në faqet e historisë të intriganëve. Lufta e Durrësit do të lerë një kujtim të helmuar në zemërat atdhetare për ata intrigantët që shkakëtuan këtë punë.*”¹⁴ Kjo gazetë jepte gjithashtu edhe një pasqyrë mbi gjendjen e trupave ushtarake të qeverisë së Vidit në Durrës, si dhe ndihmat në forca ushtarake vullnetare, oficerë dhe ushtarë të huaj, të cilët i vinin në ndihmë për mbrojtjen e qeverisë së kërcënuar nga kryengritësit e Shqipërisë së Mesme, që donin rrëzimin e saj.¹⁵

Edhe gazeta “*Besa Shqiptare*” që botohej në Shkodër, në dy numra të saj të muajit korrik 1914, përmes shkrimeve trajtonte pjesëmarrjen e forcave mirditore në luftën kundër kryengritësve, që kishin sulmuar qeverinë e Princ Vidit në drejtimin e Shijakut.

Edhe gazeta “*Hylli i Dritës*” që botohej gjithashtu në Shkodër, trajtonte në faqet e saj edhe shkaqet që çuan në shpërthimin e sulmeve të kryengritësve kundër qeverisë së Princ Vidit. Sipas kësaj gazete, një ndër shkaktarët e lëvizjes kundër Vidit ishte një prej ministrave të tij të dyfishtë, Esat Toptani, të cilin e quan tiran! Ndër të tjera shkruhej: “*Esat Toptani, i cili bate për gatimin e msheftë e tmerët, për me shndrrue gjendjen e Shtetit n’nji Qeveriës fjesht tyrke e jo shqyptare...*”¹⁶

Një tjetër gazetë shqiptare, e cila botohej në Boston të SHBA dhe mbante titullin “*Dielli*” (The Sun), në numrin e datës 5 dhjetor 1914, njoftonte me emocion të qartë: “*Unifromat e oficerëve të ardhni, si oficerët organizatorë kanë veshur gjithë atë formë (uniformë - T.K.)*”¹⁷

Në Shqipëri botoheshin edhe një numër i kufizuar revistash në faqet e të cilave, jo rrallë gjenin vend edhe shkrime apo njoftime me tematikë ushtarake.

¹³ “*Populli*”, Vlorë, 23 maj 1914, f. 8.

¹⁴ Gazeta “*Populli*”, Vlorë, 30 maj 1914, f.1.

¹⁵ Po aty, 27 qershor 1914, f.2.

¹⁶ “*Hylli i Dritës*”, Shkodër, shkurt 1914, f.292.

¹⁷ Gazeta “*Dielli*” (The Sun), Boston-SHBA, 15 dhjetor 1914.

Ndër më të shquarat prej tyre ishte revista “Zgjimi”, e cila botohej në Korçë në vitet 1913-1914. “Zgjimi” ishte pikërisht organi i parë i shkruar që publikoi në numrin e saj të parë, në faqen e pestë, një fotografi me uniformat e tre ushtarakëve të Ushtrisë së Shtetit të Pavarur Shqiptar. Kjo fotografi mbart vlera të veçanta dokumentare, pasi përmes saj përcillet imazhi i parë i uniformave të oficerit, ushtarit dhe xhandarit, të miratuara nga Ministria e Luftës dhe Ministria e Brendshme, më 4 Dhjetor 1912. Këto ministri ishin dikastere të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës (1912 - janar 1914). Në shkrimin që shoqërohet me fotografinë e sipërpërmendur shkruhet: “Shikoni pakëz këtë fytyrë, e patë? Këto janë uniformat e Ushtrisë Shqipëtare! Këjo është ajo robë e Kombit Shqipëtar! Këjo është ajo robë (rrobë, veshje, -TK) që do të thotë se në këtë botë është një shtet që quhet Shqipëri!”¹⁸ Ky fragment është një tregues i qartë se sa shumë vlerësohej krijimi dhe roli i Ushtrisë Kombëtare në mbrojtjen e Shqipërisë, siç ndodhte edhe me shtetet e tjera.

Në numrin e dytë, revista “Zgjimi” ka cekur e trajtuar një çështje tejet të mprehtë edhe për ushtrinë e sapokrijuar, ashtu si dhe për gjithë administratën e shtetit dhe Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Në artikullin “Fjalët e ushtrisë në Shqip” krahas arritjeve, shtrohej nevoja e ngutshme e shqipërimin të fjalëve që përdorte ushtria në veprimtarinë e saj: “Më poshtë po shënojmë fjalët që përdorin ushtarët nëpër ushtëri. Këto fjalë sot për sot i kanë vendosur kështu, dhe ne siç i kanë vendosur ashtu i shkruajmë. Shpresojmë pra që të mbledhen ca filllologë të mirë, që të bisedojnë përmi këtë çështje, të jenë të mbaruar nga Universitete të mbëdhenj, të dinë gjuhën shqip mirë dhe at’herë të vendosin për të gjitha ato që ka nevojë gjuha shqip, si dhe për këto fjalë që ju shënojmë më poshtë t’i çkoqitin mirë, se për fat të keq gjuha shqip gjer më sot kish mbetur pa punuar se nuk shkruheshe dhe kështu gjithë fjalët që mbrojmë se do t’i kishin shqipëtarët luftëtarë në kohën e moçme kan’ humbur, se ranë në duart e Turqisë.”¹⁹ Më tej, revista ka pasqyruar në katër faqe një pjesë të fjalorit ushtarak, si për “Stërvitjen vetiake”, “Baritje”, “Radhim”, “Lëvizje krahësh”, “Lëvizje trupi”, “Ushtrim shtati me armë”, “Përdorim arme”, “Lëvizje kthimi”.²⁰

Në numrin pasues të “Zgjimit”, në gjashtë faqe të tjera vijohet me terma të tjerë që i përkisnin fjalorit ushtarak në gjuhën shqipe. Të tilla qenë “Lëvizje rrotullime”, “Ndrim forme”, “Komandë të shpërndarë”, “Skaje të rregullimit e të shtimit” (të qitjes – T.K.) etj.²¹

Në Durrës botohej revista “Zana”. Kjo revistë ishte ndër të parat në vend që pasqyroi përpjekjet e të rinjve shqiptarë që ëndërronin dhe provuan të bënin

¹⁸ Revista “Zgjimi”, Korçë, nr. 1, viti 1913, f.5.

¹⁹ Revista “Zgjimi”, Korçë, nr. 2, viti 1914, f.106.

²⁰ Po aty, f. 106-109.

²¹ Revista “Zgjimi”, Korçë, Nr. 3, viti 1914, f.166-171.

realitet ëndrën për t’u shkolluar dhe titulluar oficerë në shkollat dhe akademitë ushtarake në vendet e Europës Perëndimore. Në numrin e datës 15 qershor 1914 zbulohet, madje edhe përmes fotografisë, se një grup djelmoshash shqiptarë qenë nisur për të ndjekur mësimet ushtarake për oficerë karriere jashtë vendit.²² Ata do të kalonin detin Adriatik për të shkuar në Shkollën e Trupës pranë Regjimentit X të Ushtrisë Italiane me qendër në qytetin e Barit në Itali. Ky grup përbëhej nga 21 djem, të cilët i ndoqën programet mësimore në Shkollën e Trupës në vitin 1915. Pas kësaj ata u dërguan të shërbenin pranë disa njësisive të ushtrisë italiane, të vendosura në qytete të ndryshme të Italisë për një vit, për t’u titulluar pas kësaj oficerë. Kjo e dhënë vërtetohet edhe nga një burim dokumentar i besueshëm ushtarak italian i vitit 1923.²³

Revista “Zana” publikon asokohe krahas fotografisë edhe listën me emrat e oficerëve të cilët, pasi morën titullin oficer, hynë në shërbim të formacioneve ushtarake shqiptare, që u krijuan nga komanda italiane në zonën jugore të Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918).²⁴

Pas vitit 1920 shumë prej tyre u bënë pjesë e reparteve të ushtrisë shqiptare, ku shërbyen në detyra të niveleve të ndryshme. Mes tyre qenë oficerë të njohur si Mark Rakaj, Llesh Topallaj, Azis Çami, Mark Kodheli etj.²⁵ Në faqet e kësaj reviste përshkruheshin edhe dëshmorët e rënë në luftimet e Durrësit, ditën që u vra koloneli Tomson, më 15 qershor 1914. Të tillë ishin “...Kapedani Kamber Elbasani dhe Ajdin Beg Draga, emri i të cilëve do të mbetet i paharruar midis Shqipëtarëve sotmë dhe do të lihet si shëmbëll burrënie në brezat që vinë.”²⁶

Në vitet ‘20-‘30 të shek. XX ishin disa gazeta të njohura që pasqyronin në shkrimet e tyre tema edhe nga ushtria shqiptare. Ndër më të njohurat atë kohë ishin “Besa Shqiptare” e Shkodrës; “Dit’e Re”, që botohej në Tiranë; Fletorja Zyrtare, gazeta e botimeve shtetërore; gazeta “Zani i Ri” e Tiranës; “Shqipëri e Re”, që dilte në Konstancë të Rumanisë. Krahas tyre vijuan të dilnin gazetate e mëparshme “Koha” e Korçës, “Mbrojtja Kombëtare” e Vlorës e ndonjë tjetër.

Këto gazeta pasqyruan të dhëna mbi përpjekjet për ngritjen dhe formalizimin, modernizimin si dhe për mangësitë që e shoqëruan ushtrinë shqiptare në këtë rrugëtim, deri në rënien e saj më 7 prill 1939. Ndër temat e para që zuri vend në faqet e gazetave shqiptare në fillimin e vitit 1920, padyshim që ishin ato që nisnin me lindjen dhe krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare dhe ecurinë e saj.

²² Revista “Zana”, Durrës, 15 Qershor 1914, f.18.

²³ Proletar Hasani-Edit Kane, “Me fytyrë nga Perëndimi”, UEGEN, Tiranë, 2013, f. 100-123.

²⁴ Pietro Crociani, “Shqiptarët në Forcat e Armatosura Italiane, Zyra e Historisë”; Romë 2001 (Tiranë 2005), f. 17-19.

²⁵ “Me fytyrë nga Perëndimi”, f. 108.

²⁶ Revista “Zana”, f. 58.

Në vitin 1920, pasi ishte formuar qeveria e dalë nga Kongresi historik i Lushnjës, në Kuvendin Kombëtar u shtrua nevoja e rikrijimit të institucionit të mbrojtjes dhe të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, pasi ajo nuk ushtronte funksionet e saj prej shtatorit të vitit 1914 pas rënies së qeverisë së Vidit. Qenë pikërisht gazeta “Koha”, që dilte në Korçë, por edhe ajo e “Mbrojtjes Kombëtare” që pasqyruan realitetin e atyre ditëve.

Më 11 shtator 1920, gazeta “Koha” e Korçës botoi shkrimin me titull “Ushtri e rregullshme e Shtetit Shqiptar”. Në të, midis të tjerave shkruhej: “Pas burimeve të sigurta që dalin prej Kabinetit Shqiptar dhe që vinë prej Tirane, kuptohet lehtëzi që pas një kohe të shkurtër do të kemi një ushtri të rregullshme, dhe sa lumturi për kombin Shqiptarë, për Shqipërinë!”²⁷

Po sipas kësaj gazete, dita e krijimit të ushtrisë vlerësohej si një “festë kombëtare” dhe e “përjetshme”. Kjo ishte dita e parë “që edhe Shqipëria mbledh ushtri të rregullshme dhe hyn në radhën e Shteteve të tjerë.”²⁸

Ndërkohë, edhe një tjetër gazetë shqiptare e njohur për kohën “Besa Shqiptare” theksonte domosdoshmërinë e një ushtrie në rrethanat ku ndodhej Shqipëria e vogël dhe ende e pambrojtur. Lidhur me këtë nevojë gazeta shkruante: “...ne që jemi në fillim e me kaq mentalitet si s’kemi nevojë për ushtri sado e paktë që të jetë, për të mos u bërë lodër e armiqve tanë”.²⁹

Po në këtë rrjedhë, një tjetër gazetë, e cila botohej në Shkodër, me titullin “Besa Shqiptare” në një prej faqeve të saj ka shkruar: “Për me përba Shqypnin e me e majtë (mbajtë-TK) duhet një Qeveri, duhet një Gjindarmëri, duhet Ushtri.”³⁰

Njëherësh me këtë kërkesë, po përmes shtypit të kohës, pasqyroheshin edhe debatet dhe diskutimet që ishin ndezur në mjedisin shqiptar dhe midis drejtuesve të lartë ushtarakë shqiptarë lidhur me tipin dhe modelin e organizimit të kësaj ushtrie. Një ushtri e tipit lindor, me oficerë të shkolluar e titulluar në shkollat dhe akademitë ushtarake bashkëkohore perëndimore. Por natyrisht që ky model, si një alternativë e kohës, kërkonte afrimin e oficerëve të rinj të shkolluar e titulluar në shkollat dhe akademitë ushtarake të Europës Perëndimore.³¹

Pikërisht pas krijimit të Ministrisë së Luftës dhe të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, nisi vendosja e njësisë të saj, e tri regjimenteve përbërëse. Sipas gazetës “Besa Shqiptare”, 8 shkurt 1921, Ushtria Kombëtare vjen në Shkodër.

²⁷ Gazeta “Koha”, Korçë, 11 shtator 1920.

²⁸ Po aty.

²⁹ Gazeta “Mbrojtja Kombëtare”, Vlorë, 29.12.192.

³⁰ Gazeta “Besa Shqiptare”, Shkodër, 10 qershor 1920.

³¹ Gazeta “Koha”, Korçë, 11 shtator 1920.

Fjala është për Regjimentin III të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, që u vendos në Shkodër, në kohën kur Ministrinë e Luftës e drejtonte gjeneral brigade Ali Riza Kolonja.³² Gjithashtu, kjo gazetë ka pasqyruar në vazhdimësi ngjarje e dukuri që lidheshin me veprimtarinë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, si dhe të personaliteteve kryesore që drejtonin ushtrinë. Një ngjarje e tillë qe dorëzimi i Kalasë së Rozafës në Shkodër me gjithë rezervat në armatime e municione të lëna nga ushtria austro-hungareze aty. Tashmë kalaja që ishte në duart e ushtarakëve italianë iu dorëzua ushtarakëve shqiptarë të Regjimentit III të Ushtrisë Shqiptare.³³

Në një numër tjetër vijues po të muajit mars 1921, kjo gazetë përshkruan vizitën e ministrit të Luftës, kolonelit të Shtatmadhorisë Selahudin Said Shkoza në qytetin e Shkodrës: *“Të diel, me 28 të k.m. (këtij muaji-Red.), Ek.eT (Ekselencia e Tij-Red.) Ministri i Luftës, Z. Selahudin Shkoza, erdh prej Tirane në Shkodër, i pritun me nderime, qi i përkasin kambës së tij (rangut,-Red).”*³⁴

Ndërsa më tej përshkruhet pritja entuziaste që iu bë ministrit të Luftës edhe për shkak të vlerësimit që kishte për shkollimin, përvojën e komandimit, të kompetencës e profesionalizmit ushtarak, por edhe ndjenjës së atdhetarizmit të njohur e të dëshmuar prej tij! Vlerësimet për ministrin S. Shkoza shtoheshin edhe për arsye të vizionit dhe masave reformatore që ai kishte parashtruar dhe ndërmarrë së bashku me kabinetin e dikasterit të Luftës, për të reformuar vetë institucionin e Luftës dhe sidomos të Ushtrisë Shqiptare, të nisura nga ish-ministri Ali Kolonja. Siç shkruante kjo gazetë, *“Këtë e difton edhe puna vetë, tue pa ndrrimin e math qi ka ba ushtria e jonë ditës qi ka marrë Ek. e T. dikasterin e Luftës në dorë. Për veçse organizimevet tjera qi ka shestue e vu në zbatim Ek. e T. Z. Selahedin Shkoza po na diktojnë se ka ba gati edhe një tubë (tufë-Red.) rregulloresh e ligjësh të nevojshme për një ushtri të rregullshme.”*³⁵ Disa radhë më poshtë gazeta vinte në pah vendosmërinë e ministrit të Luftës S. Shkoza për t’u prerë rrugën ndërhyrjeve të politikës në ushtri, për shkak të rrezikut të politizimit, gjë që çonte deri në shkatërrimin e ushtrisë dhe për më keq, në rrënimin e vetë shtetit. Për të gjitha këto në gazetë shkruhej: *“Ndër këto ligjë ushtrijake po na thohet se ishte caktue dhe shtrëngesa e domosdoshme qi ushtria mos me u përzi ndër punët politike, punë qi na pëlqen jashtzakonisht tue kenë se të përziemit e ushtris në politikë jo vetëm asht shkak shrregullimi e shkatrimi i ushtrisë vetë sjellë edhe rrënimin e shtetit.”*³⁶ Duke e përmbyllur shkruhet: *“Përveç kësaj ndër ne, ku mbretnonin orientalizmi, në politikë*

³² Gazeta “Besa Shqiptare”, 8 shkurt 1921, f. 385.

³³ Gazeta “Besa Shqiptare”, 14 mars 1921, f. 405.

³⁴ Po aty, 31 mars 1921, f. 416.

³⁵ Gazeta “Besa Shqiptare”, Shkodër, 31 mars 1921, f. 416.

³⁶ Po aty.

xhvillohen epshimet apo pasionet më të dobta e t'egra e prisi (përparësia ose prirja-Red) i veprimevet politike, s'është qëllimi, teorija a mendimi, por njeriu, titulli e pasunia."³⁷

Gazeta "*Besa Shqiptare*", por edhe gazeta të tjera, përfshirë edhe "*Shqipëri' e Re*" që botohej në Konstanca të Rumanisë, shprehnin në faqet e tyre vlerësime të larta për ministrin Luftës. Ja si e portretizonte kjo gazetë ministrin: "... në tërë pikëpamjet ashtë vetëm një ushtar, me disiplinë, me kapacitet, me energji e i drejtë dhe dëshiron që sa me radikalitet të shtië një rregull të re n'ushtin e Shqipërisë".³⁸

Për prirjet dhe vizionin e ministrit Shkoza kanë shkruar me hollësi edhe gazetat e tjera që botoheshin në Shqipëri në vitet '20 të shek. XX, si gazeta "*Dit' e Re*", "*Shekulli*" e ndonjë tjetër.

Gazeta "*Besa Shqiptare*" në maj të vitit 1921 i rikthehet Regjimentit III të Ushtrisë Shqiptare. Në artikullin "*Përparimi i Ushtrisë s'onë*" vlerësohet një tjetër oficer i lartë i Ushtrisë Shqiptare, komandanti i Regjimentit III, nënkoloneli i njohur, Ismail Haki Tatzati : "*Nuk ka niri (njeri-Red.) në vend t'onë qi nuk ka çmue veprën e komandantit e të trupit t'oficeravet të Regjimentit të Shkodrës për përparimin e rregullimin e shpejtë t'ushtisë së këtij regjimenti... Na përgëzohemi për këtë vepër komandantit e Regjimentit të Tretë zotni Nënkol. Tatzatin si dhe me trupin e oficeravet të këtij regjimenti e shpresojmë se veprat e tyre ka për t'u çmue e shpërblye ndër vende të nalta.*"³⁹

Gazeta "*Dit' e Re*", ka qenë një pasqyrë e vërtetë edhe për shumë aspekte të organizimit, jetës dhe veprimtarisë së Ushtrisë Shqiptare, sidomos në harkun e viteve 1920-1924. Në faqet e saj janë trajtuar çështje delikate, si: ngjarje apo lëvizje në administratën ushtarake; operacionet për çarmatosjen e popullsisë në vitin 1922; zgjidhja dhe ecuria e problemeve të rekrutimit në Shqipëri në vitet 1920-1924; mbi nevojën dhe pamundësinë e krijimit të aviacionit ushtarak në Shqipëri. Pothuajse në të gjithë numrat e gazetës "*Dit' e Re*" botoheshin artikuj mbi : zbatimin e ligjit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak dhe masat për të ndaluar shmangien nga ky shërbim; rregullat mbi thirrjen e rezervistëve jashtë vendit; krijimin e batalioneve të radhëve të ushtisë (xhenios së punës); gjyqin ushtarak; operacionin ushtarak kundër lëvizjes separatiste të Mirditës; lëvizjen antiqeveritare të vitit 1922, si dhe për ngjarje apo dukuri të tjera që kishin lidhje me Ushtrinë Shqiptare.

Gazeta "*Zani i Ri*" që botohej në Tiranë, në fillim të muajit tetor 1920 përshkruante kualifikimet e larta ushtarake të ministrit të Luftës në qeverinë e

³⁷ Gazeta "*Besa Shqiptare*", Shkodër, 31 mars 1921, f. 416..

³⁸ Gazeta "*Shqipëri' e Re*", Konstanca, Rumania, nr. 29, prill 1921, fq. 31.

³⁹ Gazeta "*Besa Shqiptare*", Shkodër, 7 maj 1921, fq. 434

Sulejman Delvinës, gjeneral brigade Ali Riza Kolonja.⁴⁰

Ndërsa për emërimin e gjeneral Kolonjës në postin e lartë të ministrit të Luftës, në qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës, njoftohej në gazetën “*Shqipëria e Re*”, që dilte në Konstanca të Rumanisë.⁴¹ Disa rreshta më poshtë, po në atë faqe të së njëjtës gazetë vlerësohet për aftësitë profesionale, ushtarake dhe kulturën ministri i Luftës A. R. Kolonja : “...*asht i përmendur me zotsi të plotë për rregullimin e ushtrisë s’ onë kombëtare.*”⁴²

Nga ana tjetër, revista shqiptare “*Minerva*”, shumë e njohur në vitet ‘30 të shek. XX, i kushtonte një shkrim një personaliteti ushtarak të njohur shqiptar të viteve 1920-1939, majorit Xhavid Leskoviku. Ky ushtarak ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare në vitet 1921-1923. Pas largimit nga ky post në vitin 1923 “...*emërohet Atashe Ushtarak i Shqipërisë, së pari në Beograd.*”⁴³

Një ndër gazetatat e mirëfillta zyrtare të shtetit shqiptar ishte “*Fletorja Zyrtare*“. Aty gjenin pasqyrim qarkore, vendime të qeverisë dhe ligje të Kuvendit Shqiptar. Një numër i vlerësueshëm i përkisnin institucionit të Luftës ose të Mbrotjtjes Kombëtare dhe Ushtrisë Shqiptare. Ndër to qenë qarkorja e lëshuar nga Ministria e Luftës me titullin “*Mbi dhanjen e leje ushtarve*”.

Në këtë qarkore që ishte pasqyruar në “*Fletoren Zyrtare*“, Ministria e Luftës bënte me dije : “*Kjo Ministrie tuej dashtë me ju pre hovin, atyre pretendimeve qi mund të jen edhe të pa drejta, botoj në Fletoren Zyrtare, se ndër kësi rastesh, nuk asht nevoja të ia paraqesin lutjet populli drejt kësajë Ministri, por duhet të ja paraqesin trupit ku mvaret ushtari në këto dokumenta:*

1. Lutja ngulitun (ngjitur-Red.) do të ket raportin mjekësor, qi vërteton sëmundjen.”⁴⁴

Po në këtë numër citohet *Ligji i Rekrutimit* (të detyrueshëm) për të rinjtë shqiptarë të moshës 18-19 vjeç. Ky ligj përfshinte shërbimin aktiv dhe atë rezervë. Sipas nenit 2 të këtij ligji: “*Detyrimi i shërbimit ushtarak të çdo djaloshi fillon në muejin gusht, pasi mbush 18 vjetët e hynë në moshën 19 vjet...*”⁴⁵ Ndërsa neni 3 parashikonte: “*Shërbimi ushtarak ndahet në dy pjesë: a) Shërbimi aktiv, b) shërbimi rezervë. Koha e shërbimit aktiv për të gjitha degët e trupat e ushtrisë asht 5 vjet dhe prej këtyre pes viteve një mot e gjysmës*

⁴⁰ Gazeta “*Zani i Ri*”, Tirane, nr. 14, 8 tetor 1920.

⁴¹ Gazeta “*Shqipëria e Re*”, Konstanca (Rumani), nr. 20, 10 Janar 1921.

⁴² Gazeta “*Zani i Ri*”, Tiranë, nr.14, 8 tetor 1920, f.1.

⁴³ Revista “*Minerva*”, nr. 9, 15 prill 1933, f.9.

⁴⁴ “*Fletorja Zyrtare*”, nr.7, 14 shkurt 1923, f.3.

⁴⁵ Po aty, f.3.

d.m.th. 18 muaj kalohet nën armë. Gjindarmët e muzikantët shërbejnë 3 vjet nën armë. Koha e shërbimit rezervë për çdo degë të ushtrisë zgjatet nën moshën 53, dhe mënyra e këti shërbimi caktohet me një rregullore të veçantë.”⁴⁶ Më tej vijojnë nenet e tjerë që plotësojnë këtë ligj me rëndësi të posaçme për kohën kur u miratua dhe u bë publik. Midis ligjeve, në këtë gazetë gjetën pasqyrim edhe disa qarkore të lëshuara nga Ministria e Luftës. Ndër to përmendim qarkoren “Mbi martesat e oficerëve dhe ushtarakëve”:

“1. Oficerat në gradë Kapiten e poshtë dhe gjithë nën-oficerat e ushtarët nuk mund të martohen pa lejen e Komandës qi mvaren.”

Po në këtë qarkore, Ministria e Luftës njoftonte udhëzimet e saj “Mbi teshat ushtarake” për mos lejimin e tyre për shitje etj. Në fund të kësaj qarkoreje njoftohej edhe “Mbi çeljen e shkollës për nënoficera.”⁴⁷

Në një tjetër qarkore, Ministria e Luftës udhëzonte : “...mbi mos të përzimit e Oficerave në zgjedhje. Sikur u kemi porositë edhe ma parë Oficerët nuk duhet kurrsesi të përzihen ner zgjedhje, e cila asht një e drejtë vetëm e popullit.”⁴⁸ Në këtë gazetë gjetën pasqyrim edhe shumë ligje, të cilat u përgatitën dhe miratuan nga Kuvendi Shqiptar në harkun e viteve 1923-1939, madje edhe në vitet e pushtimit fashist të Shqipërisë. Midis tyre ishin edhe “Ligjë mbi kompletimin e trupit t’oficervet e mbi gradimin e Oficervet”, publikuar nga kjo gazetë më 11 shtator 1926; “Dekret-Shtojcë-Ligjës Organike t’Ushtrisë”, publikuar në këtë gazetë më 15 shkurt të vitit 1928; ashtu si dhe “Ligji Organik i Ushtrisë e Gjindermarisë”, që ishte dekretuar më 24 qershor të vitit 1928 dhe publikuar në “Fletoren Zyrtare” gjashtë ditë më vonë.⁴⁹

Aty vijonte publikimi edhe i ligjeve apo i vendimeve e qarkoreve që kishin të bënin me ushtrinë e xhandarmërinë shqiptare. Një ndër to ishte ligji “Mbi rregullimin e Ushtrisë Kombëtare”, i cili ishte botuar në Kuvend, më 24.11.1934 dhe ishte deklaruar nga Mbreti Zog I. Në historinë e Ushtrisë Shqiptare, në vitet 1925-1939, u përgatitën katër ligje që kishin për qëllim pikërisht rregullimin e kësaj ushtrie. Ligji i parë datonte në vitin 1929, i dyti pas tri vitesh, më 1932, i treti i përket vitit 1934 dhe së fundmi ai i vitit 1937.

Ligji “Mbi rregullimin e Ushtrisë Kombëtare” i publikuar në “Fletoren Zyrtare” parashikonte mënyrën e organizimit. Në të bëhej e qartë përbërja e ushtrisë që nga kreu i saj, personeli ushtarak, që përfshinte oficerët, nënoficerët dhe trupën. Më pas vijonte personeli civil.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ “Fletorja Zyrtare”, nr.19, Tiranë, 14 prill 1923, f.2.

⁴⁸ “Fletorja Zyrtare”, nr.2, Tiranë, 12 janar 1924, f.6.

⁴⁹ “Fletorja Zyrtare”, nr. 69, Tiranë, 30 qershor 1928, f.5-8.

* Subalterno, - it. vartës, i varur (Red.).

Sipas këtij ligji, oficerët ndaheshin në: “a) *Oficera Generala...b) Oficera eprorë...c)Oficera depror..., Oficera nëndepor (subalterna)*. 2. Nën-oficera. Jerarkia nër grada të trupës asht si vijon: Nënreshtar (Nënreshter, – T.K.) Tetar, Nëntetar i rojës kufinit, Ushtarë-nxanës rojes kufini-detar...”⁵⁰*

Brenda kreut I të këtij ligji përshkruhet edhe “*Përberja e Ushtrisë Kombëtare*”, e cila përbëhej nga: “*Komanda e Mbrojtjes Kombëtare; Fuqiët Tokësore; Fuqiët Detare; Fuqiët Ajrore*”.⁵¹ Po këtu trajtohet gjithçka kishte të bënte me Komandën e Mbrojtjes Kombëtare.

Kreu II i kushtohet fuqive tokësore. Neni 7 përshkruan elementët përbërës të këtyre forcave, si shkollat ushtarake në vend, llojet e armëve, të këmbësorisë, artillerisë dhe xhenios. Po kështu trupat*, si ajo e rojës mbretërore të kufinit, trupi shëndetësor i intendancës dhe i rekrutimit.

Neni 8 pasqyron mënyrën si organizohej fuqia tokësore: 2 divizione me 6 grupe të përzier; trupa e shërbime që nuk bënë pjesë në divizione; trupa e rojës mbretërore të kufirit.

“Fletorja Zyrtare“ i përshkruante elementët e mësipërm me detaje, nga divizioni deri tek trupi i fundit përbërës i këtyre forcave.

Kreu III u kushtohej fuqive (forcave) detare. Edhe kjo lloj force, që ishte krijuar së pari në dhjetor të vitit 1925, mbetej modeste në krahasim me hapësirën detare të Shqipërisë. Neni 30 i këtij ligji parashtron se kjo forcë përbëhej nga dy trupa: i marinës luftuese (luftarake, – T.K.) dhe trupa e kapitenerive të detit.

Kreu IV i kushtohej fuqive ajrore dhe neni 36 i ligjit përcaktonte se: “...*ka m’u caktue me ligjë të veçantë*”.⁵² Ligji vijon me kreun V, që trajton dispozita të ndryshme dhe parashtrohej në gjashtë nene (neni 37-42). Ndërsa ligji përmballej me kreun VI me dispozita të përkohshme e të fundit, me nenet 43-46.⁵³

Në faqet e po kësaj gazete, në një numër të muajit korrik po të vitit 1934, u pasqyrua dekret-ligji i emërtuar “*Mbi modifikimim e ligjës datë 5.II.1923 mbi pensjonet ushtarake të ligjës datë 2.VI.1932 mbi ndryshimin e disa dispozitave të ligjës së Pensjoneve Ushtarake*”.⁵⁴

Në qershor të vitit 1937 kjo gazetë publikoi “*Ligjë mbi plotësimin dhe ndryshimin e ligjës mbi Rregullimin e Ushtrisë Kombëtare datë 14 Prill 1934*”.

⁵⁰ “Fletorja Zyrtare“, nr. 23, Tiranë, 23 prill 1934, f.1-6.

⁵¹ Po aty.

* Trupa, dëndur përdorej si “trupi”, ishte emërtimi i disa shërbimeve në Ushtrinë Shqiptare (Red.)

⁵² “Fletorja Zyrtare“, nr. 23, Tiranë, 23 prill 1934, f. 1-6.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ “Fletorja Zyrtare“, nr. 37, Tiranë, 3 korrik 1934, f.11.

Në nenin 5 shtohet: “*Inspektorija e Përgjithëshme e Ushtrisë pranë Oborrit Mbretnuer dhe dy Inspektora të Komandës Mbrojtjes Kombëtare.*”⁵⁵ Pak më poshtë jepeshin edhe plotësime të tjera që i bëheshin strukturave të caktuara të Ushtrisë Shqiptare.

Pothuajse të gjithë gazetat që dilnin në vend, përjashtuar “*Përlindja e Shqipëniës*”, “*Dit’ e Re*” dhe më së shumti “*Fletorja Zyrtare*” pasqyronin sipas mundësive dhe vlerësimit të tyre tema apo çështje që kishin lidhje me ushtrinë dhe ushtarakët shqiptarë. Ndërsa në tri gazetat e sipërpërmendura, që çmoheshin si organe shtypi zyrtare, pasqyroheshin dhe përshkruheshin ligje, vendime, qarkore, ngjarje, personalitete të Ushtrisë Shqiptare, që ishin të detyrueshme për to.

Veçanërisht “*Fletorja Zyrtare*”, si një organ shtetëror, përngjante si një pasqyrë e publikimit të vijueshëm, gati kronologjik të dukurive të mësipërme.

Pasqyrimi i organizimit dhe i veprimtarisë së Ushtrisë Shqiptare si dhe i personaliteteve ushtarake drejtuese, i lidhshimit të tyre, si dhe i dukurive e ngjarjeve të lidhura me to përbënin një dëshmi të informimit që organet e shtypit të kohës i bënin popullit shqiptar që nga viti 1913 deri në fundin e viteve ‘30 të shekullit XX. Gazetat e revistat që botoheshin përgjatë këtij harku kohor pasqyruan për popullin shqiptar, por edhe më gjerë, për rajonin dhe botën përtej kufijve të Shqipërisë, gjithçka që lidhej me Ushtrinë Kombëtare Shqiptare, për arritjet dhe mangësitë e saj, rolin e liderëve e trupës së oficerëve që e drejtuan dhe komanduan atë. Në këtë mënyrë shtypi u bë pasqyrë e veprimtarive, e lëvizjeve dhe ecurisë së tyre në sytë e popullit shqiptar, i cili shihte tek Ushtria mbrojtësinë e vendit dhe sigurinë e tij!

⁵⁵ Po aty, nr.42, Tiranë, 10 qershter 1937, f.1-2.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në:

Adresa: Akademia e Forcave të Armatosura, (AFA)
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)
Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit
Nr. Tel: 516 /1515
Adresa elektronike: ikshu.afa@aaf.mil.al
Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri